Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XL nr. 91 / 2010

Edukata Islame
Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XL nr. 91 - 2010

Botues:
Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës
Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84
Tel & fax: 038 / 224-024
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:
Mr. Qemajl Morina
qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:
Akad. Jashar Rexhepagiq, Akad. Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë:
Hajrullah Hoxha

Lektor:
Bislim Berisha

Korrektor:
Skender Rashiti

Realizimi: **Shtëpia Botuese**

Redaktor teknik &
Operator kompjuterik:
Nuhi Simnica

Shtyp: *Koha* - Prishtinë

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XL nr. 91 / 2010

Prishtinë
2010

EDITORIALI

Mr. Qemajl Morina

KISHA ORTODOKSE SERBE DHE SHQIPTARËT

Si do ta mbajnë mend shqiptarët e Kosovës patrikun Pavle?

Më 15 nëntor 2009, në spitalin e Akademisë Ushtarake në Beograd, në moshën 95-vjeçare, vdiq patriku Pavle, njeriu i parë i Kishës ortodokse serbe për afro dy dekada. Me këtë rast, qeveria serbe shpalli tre ditë zie në tërë Serbinë.

Patriku Pavle është lindur më 11 shtator 1914, si Gojko Stojqeviq, në fshatin kroat Kuçanci, në rrethin e Donji Miholcit, në një familje fshatare. Gjimnazin e kreu në Beograd, Shkollën Teologjike në Sarajevë, kurse Fakultetin Teologjik në Beograd. Në Athinë ishte për studime pasuniversitare gjatë viteve 1955-1957.

Patriku Pavle është i njohur si njeri tejet modest, që ka jetuar një jetë asketi. Në Kishën Ortodokse Serbe pati një jetë të bujshme. Ishte në poste me rëndësi. Për kalluxher është shpallur në vitin 1948. Ipeshkëv i dioqezës Rashkë-Prizren, me seli në Prizren është zgjedhur më 29 maj 1957. Në Kosovë ka punuar 33 vjet, deri në zgjedhjen tij, në postin e patrikut të 44 të Kishës Ortodokse Serbe në nëntor të vitit 1990.

Ai ishte në krye të Kishës ortodokse serbe në periudhën e shkatërrimit të ish-Federatës Jugosllave. Andaj, edhe mban një pjesë të përgjegjësisë për shkak të mosdistancimit të tij dhe të KOS-it për gjenocidin dhe agresionin e pushtetit serb ndaj popujve joserbë, në veçanti ndaj myslimanëve në Bosnjë, kroatëve në Kroaci dhe shqiptarëve në Kosovë.

Vendosja e patrikut Pavle në krye të KOS-it, në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, për shumicën dërrmuese të popullit të Kosovës, ishte një lloj shprese se ai do ta ngrejë zërin kundër atij terrori që po ushtrohej ndaj tyre nga regjimi serb i Milloshevigit, duke e ditur se ai për 33 vjet me radhë kishte jetuar në Kosovë dhe se i njihte shqiptarët më mirë se çdokush tjetër. Mirëpo, zhgënjimi ynë ishte i madh kur ai në një bisedë për gazetën britanike “The Guardian”, janar të vitit 1993, lidhur me të gjitha të këqijat që regjimi serb po ushtronte ndaj tyre, deklaronte: “Protesta e shqiptarëve i ngjan protestës së njeriut të mykur nga pasuria të cilit i është thënë se rroga do t'i zvogëlohet paksa”. Ndërsa në pyetjen e gazetarit rreth shkakut të largimit të thesarit kishtar serb nga Kosova, ai u përgjigj: “Thesari është dërguar në Beograd për restaurim, po sidoqoftë atje do të jetë më i sigurt nga kriminelët shqiptarë”.

Patriku Pavle, duke dashur të thotë se serbët janë duke zhvilluar luftë të drejtë dhe në anën e tyre kanë Zotin, për të njëjtën gazetë thotë: “Kur dy njerëz takohen, secili i armatosur me pushkë, ai që ka Zotin në anën e vet do të fitojë”.

Patriku Pavle, si prijës shpirtëror i popullit serb, nuk ka qenë dashur t'i paragjykojë gjërat, kështu me rastin e varrimit të gjashtë të rinjve serbë, në qytetin e Pejës, që kishin vdekur nga një eksplodim i një bombe, kishte parashikuar se pas atij akti të shëmtuar qëndrojnë shqiptarët. Për këtë, ai të pranishmëve iu ishte drejtuar me këto fjalë: “Vëllezër dhe motra, kjo fatkeqësi që na ka gjetur, me rastin e vrasjes së këtyre gjashtë të rinjve, të cilët ishin në lulen e rinisë, nuk ka fund. Mirëpo, dëshpërimi ynë do të ishte shumëfish më i madh, sikur këta të ishin në mesin e kriminelëve. Faji i tyre është se ata i përkasin një

tjetër populli, të cilit nuk i përkisnin kriminelët dhe se ata i përkisnin tjetrës fe dhe tjetrit libër të shenjtë” (Jedinstvo, 17 dhjetor 1998).

Patriku Pavle me rastin e mesazhit të Kërshëndellave ortodokse të vitit 1998, kur terrori serb kundër popullatës shqiptare kishte arritur kulminacionin, pjesën më të madhe të tij ua kishte kushtuar predikimeve politike për rrezikimin e “vatrës shekullore - Kosovës e Metohisë”, për “faktin” se “Kosova është djep i shpirtit dhe shtetësisë serbe”, se është “aorta e zemrës së bijve të Shën Savës”, se “të humbësh këtë themel të Shën Savës”, do të thotë të vësh në dyshim edhe shpirtin edhe vetveten”

Fjalët e përmendura të patrikut serb më shumë i përngjanin politikës ditore të regjimit serb, sesa kishin të bënin me një mesazh të një prijësi shpirtëror të një kombi. Ato nga goja e të parit të KOS-it ishin thirrje në luftë për vdekje kundër popullatës shqiptare, që jetonte në trojet e saj shekullore. Patriku, dinte se “të kujt janë delet, i tij është edhe livadhi”, por ai nuk donte ta dijë që delet me shekuj kanë të vetin edhe livadhin.

Unë kam shpresë se Kisha Ortodokse Serbe mund të mësojë shumë gjëra nga e kaluara dhe do të bëjë çmos që kur është në pyetje çështja e Kosovës do të ketë një politikë realiste. Sikur Kisha ortodokse serbe duhet të ishte e lirë nga politikanizmi, roli i saj në shoqëri do të ishte më pozitiv. Mirëpo, Kisha kërkon ndihmën e politikës dhe politikanët ndihmën e saj, ndërsa asnjëra nuk e kryen punën si duhet. Kisha merret me politikë, sepse i mungon fuqia shpirtërore mbi popullin, sikundër që edhe politikanët kërkojnë mbështetjen e Kishës kur kanë nevojë që veprimet e veta t'i arsyetojnë me qëllime religjioze.

Bashkësia Islame e Kosovës, si bashkësia më madhe në Kosovë, vazhdimisht ka treguar gatishmëri të plotë për dialog. Këtë gatishmëri e ka treguar para luftës dhe pas luftës. Konferenca e majit të vitit 2006 e mbajtur në Patrikanën e Pejës është dëshmia më e mirë. Mirëpo, këto takime duhet të jenë të vazhdueshme dhe nga to duhet të dilet me deklarata konkrete, për të mirën e Kosovës, atdheut tanë të përbashkët si dhe për një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallime fetare, etnie e gjuhësore.

KOS-si në kërkim të patriarkut të ri

Periudha dyvjeçare e sëmundjes së patrikut Pavle, në një farë mënyre e kishte paralizuar Kishën ortodokse serbe, në marrjen e vendimeve me rëndësi. Andaj, tre muaj pas vdekjes së tij, sipas Kushtetutës duhet të fillojë procedura për zgjedhjen e të parit të KOS-it. Këtë detyrë, që nga shtrirja e patrikut Pavle në spitalin ushtarak, kah fundi i vitit 2007, Sinodi i Kishës Ortodokse Serbe ia kishte besuar Amfillohije Radoviqit, mitropolit i Malit të Zi.

Kisha Ortodokse Serbe është para një sprove të madhe. Pas vdekjes së patriarkut Pavle duhet zgjedhur pasardhësin e tij, gjë që nuk është aspak punë e lehtë. Sipas qarqeve kishtare, asnjëri prej peshkopëve aktualë nuk ka autoritetin, karizmin dhe respektin, të cilin e kishte patriku Pavle.

Sinodi i Kishës ortodokse serbe, ditë më parë vendosi që zgjedhja e patriarkut të ri të fillojë më 22 janar e të përfundojë më 27 janar 2010, kur është edhe festa e Shën Savës, shenjtorit më të madh në Kishën ortodokse serbe.

Andaj, këto ditë si në qarqet kishtare, por edhe në shtypin serb është aktuale se kush do të ulet në fronin e Kishës ortodokse serbe. Ndërsa në pyetjen drejtuar, cilit do peshkop apo prift, se kush do të jetë në krye të KOS-it, përgjigja është: “Këtë e di vetëm Shpirti i shenjtë”.

Sipas mediave serbe, shanset më të mëdha për të fituar në rrethin e parë ka peshkopi i Zvornikut dhe Tuzllës, Vasilije. Ky kandidat ka shanse që në rundin e parë të fitojë 11 deri në 17 vota. Ka qenë vështirë pa pëlqimin e tij dhe të peshkopëve të afërt me të, që në mbledhjet e Sinodit të shenjt të kalojë ndonjë vendim gjatë kohës sa Patriku Pavle ishte në spital. Si duket grupi i peshkopëve të Bosnjë e Hercegovinës dominon në Sinodin e shenjtë të KOS-it, ku edhe bëhet zgjedhja e parit të Kishës. Andaj, politikanët e Beogradit, të cilët dëshirojnë të zgjedhin njerëzit e tyre në krye të KOS-it lypset të kërkojnë përkrahjen e kryeministrit të Republikës Serbe të Bosnjës, Millorad Dodik.

Favorit tjetër për kreun e KOS-it është, Amfillohije Radoviq, mitropolit i Malit të Zi. Amfillohije është ushtrues i detyrës së patriarkut Pavle, qysh nga koha e shtrirjes së tij në spitalin ushtarak në Beograd. Amfillohije Radoviq, paraqet krahun më ekstrem të Kishës ortodokse serbe, i njohur me nofkën tri "A-të" me peshkopët Artemije dhe Atanasije. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ai u bë i njohur për deklaratën e tij: "i mallkuar qoftë kushdo që njeh Kosovën". Kurse qëndrimin e tij, ndaj abortit e ka shprehur, në mesazhin dërguar besimtarëve serbë me rastin e vitit të ri 2008, ku shprehu dëshirën e tij që gjatë atij viti të ketë më shumë "nëna që lindin sesa fëmijëvrasëse".

Në mesin e peshkopëve seriozë për t'u ulur në fronin e KOS-it është peshkopi i Baçkes, Irinej Bulloviq. Përveç votave në Sinodin e shenjte të KOS-it, ai gëzon përkrahjen e qeverisë në Beograd. Po të pyetej shteti, ai do të zgjidhej në postin e patriarkut të KOS-it. Peshkopi Irinej është i arsimuar si dhe është shumë i respektuar në Perëndim, në veçanti në qarqet e Kishës katolike dhe përfaqëson Kishën ortodokse serbe në dialogun ndërfetar. Është anëtar i Këshillit të liderëve fetarë të Evropës.

Kandidati i katërt është peshkopi i Zahumit e Hercegovinës, i lindur më 1967, që për traditën e Kishës ortodokse serbe është tejet i ri. Pas shtrirjes së patrikut Pavle në spital, ishte paraqitur me një letër ku argumentonte ndërhyrjen e shërbimeve sekrete në çështje të kishës.

Partitë politike, natyrisht se kanë favoritët e tyre, në mesin e peshkopëve. Këtë e bëjnë për arsye se Kisha Ortodokse Serbe ka autoritet në popullatë dhe ato e shfrytëzojnë këtë për të tubuar sa më shumë vota gjatë fushatës zgjedhore. Kështu për shembull, mitropoliti Amfilohije është i preferuari i Partisë Demokratike Serbe të Koshtunicës. Peshkopi Fillaret, i cili gjatë luftës në Bosnjë ishte fotografuar me një kalashnikov, është i afërt me Partinë Radikale. Kurse peshkopi Irinej Bulloviq është i afërt me Partinë Demokratike të Tadiqit. Ndërkohë që peshkopi Irinej i Nishit është simpatizues i Partisë Socialiste të Daçiqit.

Është i njohur qëndrimi i KOS-it kur është në pyetje çështja e Kosovës, por ardhja në krye të saj të ndonjë personaliteti që është më i

moderuar, siç është peshkopi Irinej Bulloviq, do ta lëvizte dialogun ndërfetar në Kosovë dhe do të hapte horizonte të reja të dialogut ndërfetar për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Kosova prioritet i patriarkut të ri serb

Më 22 janar në selinë e Patrikanës së Kishës ortodokse serbe në Beograd, Sinodi i Shenjtë, në përbërje prej 44 anëtarëve zgjodhi patriarkun e ri, peshkopin e Nishit, Irinej Mirosllav Gavrilloviq, në vend të patrikut të ndjerë Pavle, i cili vdiq më 15 nëntor të vitit që shkoi. Analistët dhe njohësit e mirë të rrethanave brenda KOS-it kishin parapa një betejë të ashpër dhe pa kompromis për çdo votë për fronin e Shën Savës, në mes krahut radikal dhe atij pak më liberal. Por, për habi të gjithëve procesi zgjedhor kishte shkuar shpejt. Zgjedhja e patrikut të KOS-it bëhet nga trupi zgjedhor prej 45 peshkopëve. Për të hyrë në listën e ngushtë prej 3 anëtarëve kandidati duhej të fitonte së paku 23 vota. Këtë kusht në rrethin e parë e plotësoi, mitropoliti i Malit të Zi, Amfillohije Radoviq, në ndërkohë edhe rojtar i fronit të KOS-it, i cili ushtronte detyrën e patrikut për më shumë se dy vjet. Në rrethinë e parë, ai fitoi 25 vota, kurse askush tjetër nuk kishte fituar numrin e duhur. Tash votohej për dy peshkop, në rrethin e dytë peshkopi i Nishit, Irinej Gavrilloviq fitoi 23 vota dhe me këtë ai hyri në listën e ngushtë si kandidat i mundshëm për patriark. Votimi i rrethit të tretë nuk solli rezultatin e duhur, kurse në rrethin e katërt peshkopi i Baçkës Irinej Bulloviq, fitoi 23 vota dhe me të u plotësuan kushtet për të kaluar në fazën përfundimtare të tërheqjes së shortit nga mesi i tre kandidatëve. Tradita e tërheqjes së shortit nga tre zarfe të mbyllur e të vulosur në Kishën ortodokse serbe ka filluar të aplikohet pre kohës kur në krye të KOS-it ishte patriku Gjerman Gjoriq (1958-1990). Tërheqjen e shortit e bëri Arhimandriti Gavrillo nga manastiri Lepavina në Kroaci. Shorti kishte rënë që në krye të KOS-it të jetë peshkopi i Nishit, Iirinej Gavrilloviq, i cili sipas shumicës dërrmuese të njohësve të rrethanave brenda KOS-i është zgjedhja më e mirë për Kishën ortodokse serbe.

Sipas traditës së kishës serbe besohet se zgjedhjen e shortit e bën Shpirti i Shenjtë.

Peshkopi i deritanishëm i Nishit, është i lindur më 1930 në fshatin Vidovo të Çaçakut. Pas kryerjes së gjimnazit ka kryer shkollën e mesme teologjike në Prizren, kurse Fakultetin Teologjik në Beograd. Studimet pasuniversitare për teologji në Moskë.

Peshkopi Irinej, ashtu si paraardhësi i tij, patriku Pavle, është njohës i mirë i rrethanave në Kosovë. Ai kishte kaluar një kohë si nxënës, pastaj arsimtar dhe në fund kishte arritur të jetë rektor i Bogosllovisë në Prizren. Por, pjesën më të madhe të jetës së tij kaloi në postin e peshkopit të Nishit që nga viti 1975.

Pyetja e cila shtrohet para nesh është, si do t'i qaset patriku i ri çështjes së Kosovës. Nuk është reale të pritet nga Kisha Ortodokse Serbe të bëjë një ndryshim radikal, kur është në pyetje çështja e Kosovës, prandaj kjo nuk mund të pritet edhe nga patriku i ri. Megjithatë, është pritur prej tij që së paku të japë shenjat e para për një ndryshim nga ana e KOS-it, i cili ka qenë pjesëmarrës në të. Por, së paku sa u vërejt nga fjalimi i tij inaugurues, nuk premton se ardhja e tij në fronin e KOS-it mund të ndryshojë diçka. Ai në krye të prioriteteve dhe obligimeve të shenjta të Kishës, siç u shpreh është "ta ruajë Kosovën dhe Metohinë, sepse Serbia pa Kosovën dhe shenjtritë që gjenden atje, është pa shpirt, pa mendje dhe pa zemër".

Për të vazhduar: "Duhet ta ndihmojmë shtetin tonë, i cili po bën çmos për ta mbrojtur Kosovën nga ata, të cilët dëshirojnë të na grabisin. Kisha këtu duhet të ndihmojë, duke mos kursyer asnjë mund, nëse ka nevojë edhe për vetëflijim. Kosova është toka e jonë e shenjtë, Jerusalemi ynë. Nëse ne e harrojmë Kosovën, Kosova do të na harrojë neve", potencoi patriku i ri serb, për të pyetur:

"Është tragjike që pas këtij inaugurimi solemn duhet të shkojmë në Pejë, sepse atje është inaugurimi kryesor në fronin e patrikëve serbë. A mund ta bëjmë këtë? A duhet të shkojmë në një shtet të huaj? A mund ta vizitojmë Deçanin, Graçanicën, Prizrenin si dhe vendet tjera të shenjta", përfundoi patriku i ri serb, Irinej në fjalimin e tij inaugurues.

Megjithëkëtë, ne na mban shpresa se patriarku i ri do të ketë një qasje të re më realiste ndaj çështjes së Kosovës. Kosova tash është shtet sovran dhe i pavarur. Kisha Ortodokse Serbe do të ishte mirë të jetë nismëtare e hapjes së saj ndaj Kosovës së re dhe shqiptarëve, duke u kërkuar falje për të gjitha të këqijat që u janë bërë atyre në emër të serbizmit dhe ortodoksizmit gjatë shekullit që lamë pas. KOS-i ka marrë obligim, sipas deklaratës së përbashkët të nënshkruar nga të gjithë prijësit fetarë të Kosovës, në Patrikanën e Pejës, më 2 maj 2006 për vazhdimin e dialogut ndërfetar në Kosovë si alternativë e vetme e prosperitetit të përbashkët të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim besimi, etnie apo gjuhe. Shpresojmë se kjo do të ndodhë në një të afërme sa më të shpejtë, sepse gjuhës së urrejtjes dhe mosdurimit ndërfetar apo etnik i ka kaluar koha. Ballkani sot është më afër se asnjë herë më parë Bashkimit Evropian si dhe vlerave progresive evropiane.

Psikologjia e Islamit sipas patrikut të ri serb

Patriarku i posa zgjedhur serb, Irinej, në një intervistë dhënë të përditshmes, Blic të Beogradit (27.01.2010), në pyetjen e një gazetari, se cili do të ishte mesazhi i juaj për serbët e Kosovës, u përgjigj: "Mesazhi im i vetëm është, që ata t'i luten Zotit t'u jep kurajë, durim dhe fuqi të qëndrojnë në atë gjendje në të cilën ata gjenden, e cila është e pa sigurt dhe shumë e vështirë".

"Ata janë kthyer në pakicë në vendin e tyre. Kurse ne përafërsisht dimë se cila është filozofia dhe psikologjia e Islamit. Ata kur janë numerikisht pak, dinë si të gjenden dhe të jenë korrekt. Kurse kur numerikisht janë të barabartë, atëherë e ngrisin kokën, kurse kur e ndiejnë veten superior dhe të fuqishëm, nisin presionin që ata të shpërngulen apo të konvertohen në fenë e tyre. Kjo është filozofia e Islamit . Për këtë është vështirë për ata njerëz, të cilët jetojnë një jetë të pasigurt", përfundon konstatimin e tij patriarku i ri serb.

Ky prononcim i patriarkut të posa zgjedhur të Kishës Ortodokse Serbe, z. Irinej, është i papritur, i pashembullt, plotësisht e pabazë dhe deri në fund nënçmuese për Islamin, si fe e madhe botërore, të cilës i

përkasin mbi 1.5 miliardë e gjysmë myslimanë nga të gjitha meridianët e botës. Është për të habitur dhe tejet brengosëse që çështja politike dhe nacionale e shqiptarëve të Kosovës të vendoset në profilin e filozofisë dhe psikologjisë së Islamit në interpretimin e të parit të Kishës Ortodokse Serbe. Ta akuzosh Islamin për shkak të aspiratave politike dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës, është absurde dhe e pabazë. Në veçanti kur dihet se rezistenca e shqiptarëve të Kosovës në asnjë aspekt nuk ka pas të bëjë me aspektin fetar islam, por ajo ishte një luftë për çlirimin e një populli të tërë nga okupimi serb, ashtu siç kanë vepruar të gjithë popujt liridashës. Por, ajo që kuptohet nga deklarata e patriarkut të ri serb është se ai i dëshiron që “myslimanë të mirë” (lexo shqiptarët) janë vetëm atëherë kur ata janë të nënshtruar e jo të barabartë me popujt tjerë. Kjo deklaratë tregon edhe një herë se çfarë mendim ka i pari i porsazgjedhur i KOS-it ndaj islamit dhe myslimanëve si dhe për çfarë paragjykime dhe stereotipie kemi të bëjmë? Për këtë kjo deklaratë në fillimin e mandatit të patriarkut të Kishës Ortodokse Serbe nuk është fare inkurajuese për besimtarët e besimit islam, jo vetëm në Serbi, por edhe më gjer në rajon, kur dihet se nëpër çfarë peripeci kaluan myslimanët gjatë periudhës luftës së fundit në ish-Jugosllavinë. Patriarku, Irinej do të ishte më mirë sikur të kishte fuqinë që myslimanëve t’u kërkojë falje për gjenocidin që ushtria, policia dhe forcat paramilitare serbe ushtruan ndaj myslimanëve në Bosnjë e shqiptarëve në Kosovë, në vend se të merret me paragjykime, që mund të ekzistojnë vetëm në imagjinatën e tij të sëmurë. Andaj, pyetja e cila shtrohet është, se koha që është para nesh a mund të jetë dëshmitare e tensioneve të reja dhe mosdurimit ndaj islamit dhe myslimanëve në hapësirat ku dominon Kisha Ortodokse Serbe?

Patriarku Irinej u kërkon falje myslimanëve

Në ditën e pestë të inaugurimit të tij në fronin e Kishës Ortodokse Serbe, me rastin e festës së Shën Savës, njërit prej shenjtorëve më të mëdhenj serb, patriarku Irinej, kishte dhënë një deklaratë nënçmuese dhe tejet neveritëse për Islamin dhe myslimanët. Kjo deklaratë e dalë nga goja e të parit të KOS-it kishte shkaktuar reagime si tek organizatat islame brenda në Serbi, por edhe jashtë saj. Deklarata e patriarkut, kishte ardhur si një bumerang edhe për diplomacinë serbe, e cila po mundohet që ta mbajë botën islame, me lidhjet që ish-Federata jugosllave kishte ndërtuar me atë botë. I gjetur në një pozitë tejet të palakueshme, i pari i Kishës Ortodokse Serbe një ditë më vonë u detyrua t’u kërkojë falje myslimanëve për deklaratën e tij “të pakujdesshme për profilin psikologjik të myslimanëve, të cilën e kishte botuar e përditshmja Blic e Beogradit me rastin e festës së Shën Saves”..

Patriarku kishte shpreh “brengosjen e tij të thellë për shkak të deklaratës së tij dhe pasojat e saj, kurse myslimanëve, “të afërmve dhe vëllezërve tanë, u kërkoi falje më të sinqertë”. Ai përveç tjerash kishte deklaruar se “serbët në Kosovë kanë mbetur pakicë në vendin e tyre, e në anën tjetër ne e dimë, përafërsisht se cila është filozofia dhe psikologjia islamit, ata kur janë në numër të vogël, dinë të sillen mirë dhe të jenë korrekt, kurse kur të jenë numerikisht të barabartë , atëherë e ngritin kokën, kurse kur bëhen të fuqishëm dhe superior , bëjnë presion ose për t’i shpërngulur apo të bëhen si ata”.

Patriarku serb, duke vlerësuar se “deklarata e tij mund të komentohet në atë mënyrë ashtu siç e kanë kuptuar besimtarët e besimit islam, si dhe liderët e tyre, të cilët e kanë ndier veten të nënçmuar”. I pari i KOS-it potencon se “ nuk ka pasur një qëllim të tillë dhe se deklarata e tij fatkeqe nuk përmban qëndrimin e tij real ndaj Islamit, që është i bazuar në themelet e vlerësimit të identitetit, dinjitetit dhe integritetit të myslimanit si individ, bashkësisë islame si kolektivitet dhe islamit si religjion i madh botëror.”

Në fund të deklaratës së tij i pari i Kishës serbe , fajëson gazetën për shkak të nxjerrjes së deklaratës së tij jashtë kontekstit. Ai bënë thirrje "që të tejkalohen dallimet dhe të jetojmë së bashku në dashuri dhe respekt të ndërsjellë".

Deklaratën e patriarkut serb e kishin kritikua ashpër dy bashkësitë rivale islame në Serbi, Bashkësia Islame e Serbisë me seli në Beograd dhe Bashkësia Islame në Serbi me seli në Novi Pazar, duke akuzuar KOS-in si promotor të urrejtjes dhe gjenocidit ndaj besimtarëve të besimit islam. Kurse deklaratën e patriarkut të ri si një ogurzi për mbjelljen e pasigurisë tek popullata myslimane në ato pjesë ku Kisha Serbe shtrin ndikimin e saj.

Akti i kërkim faljes nga myftiu i Sanxhakut Muamer Zukurliqi u vlerësua si një hap i pranueshëm, por me të nuk mund të sanohen pasojat dhe dëmet që u janë shkaktuar Islamit dhe myslimanëve, por ato vetëm mund të zbuten.

Qemajl Morina

THE SERBIAN ORTHODOX CHURCH AND ALBANIANS
How will K/Albanians remember patriarch Pavle?

(Summary)

On November 15, 2009, patriarch Pavle died in a Belgrade hospital. He was 95. Patriarch Pavle was the head of the Serbian Orthodox Church for almost two decades. Three days of mourning were proclaimed by the Serbian government.

Pavle was born (Gojko Stojqeviq) on September 11, 1914, to a farmer family in the village of Kuçanci, near Donji Miholjac (in what is now Croatia). He graduated from a gymnasium in Belgrade. Afterwards he studied at a seminary in Sarajevo. He received a graduate degree from the Faculty of Orthodox Theology in Belgrade. Between 1955 and 1957 he took post-graduate studies in Athens.

Pavle was known as a very modest person, who lived an ascetic life. He held a number of very important positions in the Serbian Orthodox Church. He was ordained a hierodeacon in 1948. He was elected bishop of Rashka-Prizren on May 29, 1957. He worked in Kosovo for 33 years. In November 1990, he was elected the 44th patriarch of the Serbian Orthodox Church.

كمال مورينا

الكنيسة الارثودكسية الصربية و الالبانيون

(خلاصة البحث)

كيف سيتذكر البانيو كوسوفا رئيس الكنيسة الصربية السيد بافله؟

توفي في 15 نوفمبر 2009 بالمستشفى العسكري ببلغراد عن عمر يناهز خمسة و تسعون عاما رئيس الكنيسة الارثودكسية الصربية السيد بافله و الذي تقلد زمام رئاسة الكنيسة الارثودكسية الصربية لحوالي عقدين من الزمن و بهذه المناسبة اعلنت الحكومة الصربية حداد لمدة ثلاثة أيام.

ولد السيد بافله بتاريخ 11 سبتمبر 1914 و اسمه غويكو ستويتشفيش بالقرية كرواتيية "كوتشانس" بولاية "دونيي ميحولس". انهى المدرسة الثانوية بمدينة بلغراد بينما واصل دراسته الجامعية بكلية اللاهوت ببلغراد بينما واصل الدراسات فوق الجامعية بمدينة آثينا خلال السنوات (1955-1957).

السيد بافله اشتهر بتواضعه و بساطته و عاش حياة تغشق. تقلد مناسب عالية في الكنيسة الارثودكسية الصربية. كان راعى الكنيسة الالرثودكسية الصربية لمنطقة راشكا و بريزرن 33 سنة من تم اختياره رئيسا للكنيسة الارثودكسية الصربية سنة 1990 حتى وفاته بتاريخ 2009/11/15.

JURISPRUDENCË ISLAME

Jusuf Zimeri

VENDIMI DHE LEJIMI

Me nocionin vendim (el azimetu) dhe lejim (err-rruhsa) në terminologjinë e shkencës së Usuli fikut kemi për qëllim dispozitën esenciale dhe dispozitën joesenciale. Thënë ndryshe ndarja el Azime ve rusa është ndarja e dispozitës varësisht nga fakti se përputhet me argumentin, apo është në kundërshtim me të[1]. Andaj, që të jemi më të qartë këto dy terma do të bëjmë përpjekje që t'i shtjellojmë nga aspekti shkencor i Usuli fikut, sepse këto shpeshherë kanë rol vendimtar për përcaktimin e dispozitës ndaj një veprimi.

- I -
Definimi i nocionit Azime (vendim)

Nocioni "**el azime**" në kuptimin gjuhësor nënkupton; vendim qëllim, paluhatshmëri vendosmëri. Kjo vërtetohet me ajetin ku Allahu xh.sh. thotë: ***"....e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun...***[2]

Për definimin e nocionit "el Azime" (vendim) në aspektin terminologjik të shkencës së Usuli fikhut dijetarët e kësaj lëmie kanë dhënë

[1] Dr. Muhamed Abdulatif Muhamed Alij, El afimetu ver-ruhsa, studim usulist f.7, Revista e Fakultetit të Jurisprudencës islame El Ilm nr. 10,viti 1999, Tanta- Egjipt.
[2] Sure Ali Imran: 159.

definicione të ndryshme, por ajo që vërehet nga të gjitha definicionet është fakti se dallimet janë vetëm shprehimore, e jo edhe esenciale. Dijetari i famshëm imam Fahrul Islami El Bezdevij[3] azimen-vendimin e ka definuar: *"Nocion që ka për qëllim dispozitën që nuk ndërlidhet me aksidentalen"*[4]. Imam Serahsiu[5] azimen e ka definuar: *"Dispozita që është ligjësuar në esencë (fillimisht) dhe nuk ndërlidhet me aksidentalen"*. Ajo që kuptohet nga ky definicion plotësisht pajtohet edhe me definicionin që e definon edhe Sadru Esh-sheria [6].

Imam Shatibiu, dijetar nga shkolla juridike Malikite, azimen e definon: *dispozitat që janë ligjësuar fillimisht për të gjithë*.[7]

Ligjësim esencial konsiderohet dispozita fillestare për një send që më parë nuk ka ekzistuar dispozitë për të. Gjithashtu konsiderohet edhe dispozita e cila derogon dispozitën e mëparshme, ngase atë e anulon tërësisht dhe e bën sikur të mos kishte qenë. Nën nocionin Azime përfshihen edhe dispozitat që gjenden vetëm atëherë kur ekziston shkaku i ekzistimit të saj si p.sh. sharja dhe fyerja e zotave (idhujve).[8] Po ashtu nën nocionin Azime përfshihet edhe interesi i përgjithshëm për ligjësimin e tij në esencë, si shitblerja, qiraja, etj.

Cilat dispozita-norma quhen Azime

Dijetarët e shkencës së Usuli fikut nuk janë unikë në mendimet e tyre se me nocionin Azime a përfshihen të gjitha dispozitat bazore (hukmul aslij) apo ndoshta vetëm dispozitat që për ballë kanë edhe nocionin er-ruhsa (lejimin). Dijetarët e shkencës së Usuli fikut nga

[3] Fahrul Islami është nga dijetarët eminent nga shkolla juridike hanefite, me origjinë nga Semerkandi, i cili është i njohur si Fikhist dhe Usulist. Vepra e tij e Usuli fikhut njihet me emrin Usuli i Bezdeviut. Ka lindur vitin 400 h. Ka vdekur vitin 493.
[4] Dr. Muhamed Abdulatif Hasanejn, el hukmu esh-sherij indel usulijin, f.256. nga Keshful erar ala usulil el Bezdevij 1/229.
[5] Shemsul eimeti Imam Serahsiu ka vdekur vitin 483 h. Dijetar i medhhebit hanefij me origjinë nga Horasani i cili njihet si erudit nga lëmia e fikhut, usulit, hadithit dhe akaidit.
[6] Sadru Esheria dijetar hanefij që ka jetuar mes viteve 546-630 h.
[7] Dr. Muhamed Abdulatif Hasanejn, el hukmu esh-sherij indel usulijin, f.256 nga El Muvafikat nga Shatibiu 1/300.
[8] Dr. Vehbe Zuhejli, Usulu el fikhil islamij 1/109, Darul Fikri, Damask.

shkolla juridike hanefite, të udhëhequr nga Sadru Esh-sheria, janë të mendimit se nën nocionin Azime (vendime) përfshihen vetëm ato dispozita që për ballë kanë edhe lejimin (er-ruhsa). Për ta sqaruar këtë po ilustrojmë me shembull konkret. Dispozita e obligueshmërisë së agjërimit të muajit të Ramazanit është Azime (vendim), sepse shpeshherë kjo dispozitë mund të përballet edhe me Ruhsan (lejimin), pra lejimin e mosagjërimit, për shkak të udhëtimit apo sëmundjes ose ndonjë rasti tjetër aksidental. E kjo vërtetohet me ajetin Kur'anor ku Allahu xh.sh. thotë: ***"Kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme.."***[9] Nga kjo nënkuptohet se dispozita esenciale-bazore e agjërimit është Azime (vendim) për të gjithë ata që i plotësojnë kushtet e obligueshmërisë së agjërimit, mirëpo përderisa në rastet e caktuara siç janë udhëtimi dhe sëmundja, kjo dispozitë nga Azime (vendimi) shndërrohet në ruhsa (lejim), pra për ballë saj qëndron edhe norma e lejimit (ruhsas). Atëherë, dispozita esenciale-bazore, e cila pranon që për ballë saj të ketë edhe lejimin (ruhsan), mund të emërohet si dispozitë Azime, kurse dispozita esenciale që nuk pranon që për ballë saj të ketë lejimin nuk mund të quhet Azime, porse quhet vetëm Hukmul aslij (dispozitë esenciale). Shembulli i kësaj është dispozita e obligueshmërisë së besimit në Allahun xh.sh.. Kjo dispozitë esenciale nuk pranon që për ballë të ketë dispozitën e lejimit, sepse njeriu ka për obligim të besojë në Allahun xh.sh. në çdo kohë vend dhe gjendje dhe nuk ekziston rast aksidental që lejon njeriun të mos besojë në Allahun xh.sh. andaj themi se kjo dispozitë ngel dispozitë esenciale e nuk mund të jetë Azime, sepse nuk pranon Ruhsan (lejimin).

Nga ky shpjegim dijetarët hanefij të Usuli fikut përfituan një rregull ku thuhet: *"Çdo Azime (vendim) është dispozitë esenciale, por çdo dispozitë esenciale nuk është Azime*. Nga kjo nënkuptohet se dispozita esenciale është më gjithëpërfshirëse sesa dispozita el azime.

[9] El Bekare: 185.

Ndarja e Azimes

Shumica e dijetarëve të shkencës së Usuli fikhut[10] përfshirë edhe dijetarët e medhhebit hanefij[11] Azimen e ndajnë në pesë lloje që janë:

1. Farz, si është namazi dhe agjërimi,
2. Mendub, siç është suneti para drekës dhe pas saj,
3, Haram siç është amoraliteti dhe vjedhja,
4. Kerahet, siç është të vepruarit në kohën e namazit
5. El Ibahahatu siç është lejimi i ngrënies, pijes fjetjes etj.

- II -
Definimi i nocionit Er-ruhsa (lejim)

Nocioni "Er-ruhsa" në kuptimin etimologjik të fjalës nënkupton lejim, lehtësim. Me nocionin er-ruhsa në terminologjinë e sheriatit islam nënkuptojmë: "*Veprimin që Ligjdhënësi, të obliguarit i ka zgjeruar fushëveprimin e tij, në momentin kur ekziston që e ndalon atë vepër, për shkak të ndonjë arsyeje ose pamundësisë që ai ta veprojë atë veprim*[12], kurse, imam el Bezdeviu ruhsan e ka definuar: *dispozita e cila ndërtohet, ngrihet mbi arsyetimet e njeriut*[13]**.** Nga ky definicion nënkuptohet dispozita e cila lehtësohet për shkak të ndonjë arsyeje aksidentale që mund t'i paraqitet personit si sëmundja, që nënkupton se në këtë rast ekziston mundësia që norma nga ndalimi të shndërrohet në lejim, porse norma e ndalimit nuk zhduket tërësisht, ajo edhe më tutje ngel e vërtetuar dhe e plotfuqishme. Si shembull i kësaj është dispozita e agjërimit është farz, por ky farz mund të shndërrohet në lehtësim, pra të mos agjërohet nëse paraqitet sëmundja apo udhëtimi. Megjithatë, dispozita e agjërimit farz, nuk tretet tërësisht, ajo ngel në

[10] Dr. Muhamed Abdulati Muhamed Alij, El ayimetu ver-ruhsa, studim usulist f.7, Revista e Fakultetit të Jurispudencës islame El Ilm nr. 10, viti 1999 - Tanta- Egjipt.
[11] Me këtë ndarje nuk pajtohet dijetari Hanefij Sadru Esh-sheria i cili Azimen e ndau në katër lloje, farz, vaxhib, sunet dhe nafile.
[12] Bislimi Taxhedin, Hyrje në shkencën e Usuli fikut f. 222 Shkup 2003.
[13] El Bezdeviu, Keshfu el esrar ala usulil el Bezdevij 2/298.

fuqi edhe më tutje, ngase me evitimin e sëmundjes, sërish me automatizëm aktivizohet dispozita e agjërimit farz. Ose rasti tjetër, dispozita e ngrënies së mishit të derrit është haram, mirëpo me paraqitjen e rastit aksidental, kur njeriu nuk ka mundësi të mbijetojë pa ngrënien e tij, kjo dispozitë shndërrohet në Ruhsa, pra lejohet ngrënia e mishit të derrit. Mirëpo, rasti aksidental nuk e shkrin tërësisht dispozitën e haramit, sepse kjo dispozitë ngel në fuqi edhe më tutje, dhe vjen në shprehje me evitimin e rastit aksidental.

Ky definim i imam Bezdeviut, plotësisht pajtohet me definimin e dijetarëve tjerë kur nocionin er-ruhsa e definuan duke thënë: *“Dispozita sekondare (jo thelbësore) e ligjësuar dhe ngrihet mbi arsyetimet e njeriut”*. Kurse shumica e dijetarëve nga shkolla juridike e Shafive ruhsan e definojnë: *dispozita e cila ndryshon nga vështirësia në lehtësim për ndonjë arsye, porse edhe më tutje ekziston shkaku i normës thelbësore (esenciale)*.[14] Kurse vetë imam Shafiu Ruhsan e definon: *“Dispozita e vërtetuar në kundërshtim me argumentin nga i cili përfitohet dispozita esenciale por për arsye”*.[15]

Që të bëhet më e qartë për lexuesin, po shtjellojmë këto definicione me shembuj konkretë. Lejimi i ngrënies gjatë Ramazanit për të sëmurin dhe udhëtarin është lehtësim Ruhsa. Kjo dispozitë është sekondare, e dorës së dytë sepse dispozita esenciale është ndalimi i të ngrënit, pra agjërimi. Kjo normë e lejimin mbështet në Kur’an ku Allahu xh.sh ka thënë: ***e kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme..”***[16] Pra, me këtë ajet u lejua ngrënia gjatë Ramazanit pasi ishte e ndaluar. Sipas definicionit të imam Bezdeviut, nënkuptojmë se trajtimi i zbatimit të normës Er-ruhsa te Allahu xh.sh. ka tretmanin e veprimit të veprës së lejuar për lehtësira, e jo tretmanin se kjo vepër realisht është e lejuar, sepse argumenti i ndalimit të kësaj vepre qëndron edhe më tutje në fuqi. Meqë norma e këtij lejimi ka argument tekstual nënkupton se zbatuesi i kësaj norme nuk ka bërë mëkat, e më pas është amnistuar- falur nga Allahu xh.sh.,

[14] Dr. Muhamed Abdulatif Hasanejn, el hukmu esh-sherij inde usulijin, f.263, Kajro 1991.
[15] Dr. Vehbe Zuhejli, Usulu fikhil islamij 1/110, darul fikri Damask.
[16] El Bekare: 185.

për dallim nga personi i cili ka bërë ndonjë mëkat të madh, pastaj është falur nga Allahu xh.sh.. Rasti i dytë nuk është identik me të parin, ngase në këtë rast nuk është vepruar sipas normës Er-ruhsa porse bëhet fjalë për amnisti, e vetë amnistia nënkupton se është bërë veprim i ndaluar, e kjo nuk është identike me normën er-ruhsa, sepse zbatimi i ruhsas nuk ka amnisti por veprim sipas dispozitës që ka kërkuar ligjdhënësi.

Shkaqet e Ruhsas - lejimit

Nga definicioni i ruhsas vërejtëm se ajo është dispozitë e cila nuk përdoret në rastet normale, andaj që veprimi të kalojë nga Azime në Ruhsa duhet të ketë shkak - arsyetim për të. Shkaqet për përdorimin e kësaj dispozite janë:

- Domosdoshmëria (ed-daruretu) që është çështje e patjetërsuar për përqendrueshmërinë e interesit të njerëzve, saqë po mos të ekzistojë dispozita e Ruhsas atëherë destabilizohet sistemi jetësor dhe do të mbisundojë anarkia dhe trazirat[17].
- Nevoja (el haxhetu) është veprimi për të cilën njerëzit kanë nevojë, por nëse nuk ekziston nuk shkakton destabilizim në sistemin njerëzor.
- Ngritja e vështirësisë (ref’ul harexh) është veprimi i cili po nuk ekziston do të shkaktojë vështirësi te individi, si p.sh. mosagjërimi në udhëtim.

Ndarja Er-ruhsa sipas Hanefijve

Dijetarët e shkollës juridike hanefite duke e shtjelluar Ruhsan nga të gjitha aspektet, atë e ndanë në dy lloje kryesore që janë: Ruhsa e vërtetë dhe Ruhsa alegorike.

[17] Taxhedin Bislimi, Hyrje në shkencën e Usuli fikut, f. 224 Shkup, 2003.

Ruhsa e vërtetë

Dijetarët hanefij, duke studiuar në detaje llojin e parë të Ruhsas dhe duke u nisur nga fakti se ndonjëherë ajo lejon veprim përkundër argumentit që ndalon atë veprim, ose lejon mosveprimin pra braktisjen për kundër argumentit që obligon veprimin, përfitohet fakti se Ruhsa e vërtetë ndahet në dy lloje që janë:

1. Ruhsa (lejimi) për veprim

Lejimi i veprimit të veprës së ndaluar (haram) në rastet aksidentale, kur paraqitet domosdoshmëria apo nevoja e këtij veprimi. Shembulli i tillë është shqiptimi i kufrit (mohimit) kur njeriu është i kërcënuar me vdekje apo me shkatërrimin e ndonjë gjymtyre të trupit të tij[18], porse zemra e tij është e mbushur me iman-besim. Marrë parasysh faktin se kufri (mosbesimi) është mëkat prej mëkateve të mëdha, në gjendje normale, besimtari islam e ka të ndaluar (haram) të ekspozojë atë si në aspektin e brendshëm me bindje zemërore, ashtu edhe nga aspekti formal duke e shqiptuar kufrin vetëm gojarisht por, kur mbi personin ushtrohet dhunë dhe presion që të shqiptojë kufrin (mosbesimin), ai e shqipton atë duke e përdorur ruhsan lejimin për të, por zemra e tij duhet të jetë plot iman. Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë: ***"Ai që pas besimit të tij e mohon Allahun, me përjashtim të atij që detyrohet*** *(për të mohuar),* ***e zemra e tij është e bindur plotësisht me besim, por fjala është për atë që ia hap gjoksin mosbesimit, ata i ka kapur hidhërimi nga Allahu dhe ata kanë një dënim të madh".***[19] Lejimi i shqiptimit të kufrit në këtë rast nuk nënkupton zhdukjen e ndalimit (haramit) për shqiptimin e kufrit, sepse kjo ndalesë nuk derogohet asnjëherë.

[18] Disa fukaha me këtë dispozitë e kanë radhitur edhe rastin kur njeriu është i kërcënuar me zhdukjen e tërësishme të pasurisë së tij, sepse zhdukja e tërësishme e pasurisë në fund shpien edhe në shkatërrimin e tij.

[19] Suretu En-Nahl: 106.

Të shqiptuarit e kufrit me gjuhë humbet një e drejtë që është e drejtë e Allahut, që është deklarimi për njëshmërinë e Allahut në aspektin formal, porse ngel pjesa tjetër e së drejtës së Allahut që është besimi dhe bindja zemërore për njëshmërinë e Allahut xh.sh.. Deklarata e shehadetit njëherë brenda jetës, e plotëson imanin besimin, kurse deklaratat tjera janë vetëm vazhdimësi e vërtetimit, e vazhdimësia e vërtetimit nuk është shtyllë esenciale e besimit, andaj shprehja e kufrit gojarisht për ndonjë arsye e zhduk apo ndërpret vazhdimësinë, e kjo nuk paraqet prishje të besimit - imanit për shkak se ai është i përqendruar në zemër. Pra, imani përbëhet prej dy rukneve (shtyllave) që janë, rukni esencial që është besimi zemëror, dhe rukni shtesë që është dëshmia me gojë. Andaj, shqiptimi i kufrit nuk e zhduk dispozitën e ndalimit të shpalimit të kufrit, sepse ai ngel i përhershëm. Prandaj, lejohet të vepruarit me ruhsa, pra të shpalosë kufirin gojarisht, sepse me këtë nuk dëmtohet shtylla esenciale e imanit që është bindja zemërore (shpirtërore), e për këtë askush nuk mund të arrijë te zemra e njeriut përveç Allahut xh.sh.

Në vazhdim do të sjellim edhe një shembull nga lejimi i veprimit të veprës së ndaluar e që është nga veprat praktike të sheriatit islam, e që është e drejtë e Allahut xh.sh.. Nëse besimtarit islam që është i shëndoshë dhe nuk është në udhëtim, i imponohet që me dhunë ta prishë agjërimin, saqë nëse nuk e prish agjërimin kërcënohet, me vdekje apo zhdukje të ndonjë gjymtyre, agjëruesi i tillë ka të drejtë të përdorë Ruhsan në mënyrë që të mos zhduket e drejta e tij formale dhe reale. Në këtë rast nëse personi i tillë nuk e prish agjërimin, atëherë ka vepruar sipas Azimes (hukmit esencial), dhe në këtë rast ka rrënuar të drejtën e tij, e nëse e prish agjërimin ka vepruar sipas Ruhsas (lejimit), e në këtë rast rrënon të drejtën e Allahut por vetëm formalisht, ngase tek ai edhe tutje ngel bindja për obligueshmërinë e agjërimit. E drejta e përdorimit të Ruhsas në këtë rast i vërtetohet sepse ruajtja e së drejtës së robit është më prioritare nga e drejta e Allahut xh.sh.

Personi i cili gjendet në udhëtim apo është i sëmurë, lehtësimi i tij nuk është i këtij lloji, ngase nëse ai agjëron dhe nuk e prish agjërimin dhe vdes për shkak të agjërimit ai konsiderohet mëkatar, sepse atij i

ishte i lejuar agjërimi, pra dallim nga personi i cili gjendet i shëndoshë dhe nuk është në udhëtim dhe nuk i nënshtrohet imponimit që të prishë agjërimin konsiderohet se ka vepruar me Azime dhe sakrifikim në rrugën e Allahut xh.sh. dhe për të shpërblehet.

Shembull tjetër nga kjo lëmi kemi lejimin e ngrënies së mishit të kafshës së ngordhur që në esencë është veprim i ndaluar (haram), porse në raste aksidentale lejohet ngrënia e saj. Allahu xh.sh. thotë: **“***(Allahu)* ***ua ndaloi juve të ngordhtën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që theret jo në emër të Allahut..***[20]**”** Nga ky ajet nënkuptohet se Allahu xh.sh. në rastet kur kërcënohet jeta e njeriut, lejoi ngrënien e këtyre ndalesave me kusht që të mos ketë për qëllim që me veprën e tij t’i bëjë Allahut xh.sh. mëkat. Andaj, Allahu xh.sh. në ajetin e lartpërmendur thotë: **“Gajru bagin”** që do të thotë se të mos i mësyjë mëkatit me veprën e tij, dhe njashtu thotë **“ve la adin”** të mos i tejkalojë kufijtë e nevojës dhe domosdoshmërisë.[21] Pikërisht duke u nisur nga ky lejim që mbështetet në domosdoshmëri dijetarët e medhhebit hanefij janë të mendimit se lejohen ngrënia e tyre vetëm aq sa për të mbajtur jetën, e jo derisa të ngopet.

2. Ruhsa për braktisje - moszbatim të farzit

Lejimi për lënien, moszbatimin e farzit nëse në zbatimin e tij paraqiten vështirësi. Veprimet që i bëri Allahu xh.sh. obligim për njerëzit janë brenda mundësive të tij, duke mos i vështirësuar ata. Kjo nuk donë të thotë se njeriu nuk duhet të përjetojë lodhjen në kryerjen e këtyre obligimeve, por nuk rrezikohen në kryerjen e tyre. Andaj, në momentet kur paraqiten raste aksidentale, për të mos u rrezikuar njeriu, Allahu xh.sh. lejoi braktisjen e farzit duke e përdorur Ruhsan, ose kompensimin e tij me diç tjetër më të lehtë. Rast të tillë kemi përdorimi i tejemumit për të sëmurin të cilin e dëmton përdorimi i ujit. Allahu xh..sh. thotë: ***“Në qoftë se jeni të sëmurë, ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen prej vendit të nevojës, ose keni kontaktuar me gratë tuaja dhe nuk gjeni ujë, atëherë mësyje dheun e pastër dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja***[22]**.** Ajeti në fjalë na bën me dije se abdesi është obligim (farz) në gjendje të rëndomtë dhe dispozitë esenciale, por në rastet kur paraqiten vështirësi përdoret Ruhsa siç është rasti i të sëmurit që uji e dëmton shëndetin e tij, atëherë abdesi kompensohet me tejemumin.

[20] Suretu el Bekare: 173.
[21] Taxhedin Bislimi, Hyrje në shkencën e Usuli fikut 1/224, Shkup 2003.

Ruhsa Alegorike

Edhe dispozita alegorike ndahet në dy lloje që janë:

1. Lejimi i zbatimit të kontratave dhe sjelljeve tjera për të cilat paraqitet nevojë permanente e njerëzve, edhe pse ato kontrata janë në kundërshtim me parimet dhe principet e përgjithshme të sheriatit islam. Raste të tilla kemi kontratën e shitblerjes me parapagim, shitblerja me porosi etj.

Kontrata e shitblerjes me parapagim është kontratë që lidhet për blerjen e sendit që nuk ekziston në momentin e lidhjes së kontratës, e lidhja e kontratës për shitblerjen e sendit që nuk ekziston në momentin e lidhjes së kontratës është veprim i ndaluar dhe në kundërshtim me parimet e përgjithshme të sheriatit islam. Pejgamberi a.s. në hadithin që e transmeton Hakim b. Hizami i cili ka thënë: *“Më ndaloi i dërguari i Allahut s.a.v.s. që të shes atë që nuk e kam prezent”*[23]. Ky hadith qartë na e bën të ditur se lidhja e kontratës për sendin që nuk ekziston në momentin e lidhjes së saj është veprim i ndaluar, mirëpo marrë parasysh nevojën e njerëzve për kontrata të tilla, si kontrata me parapagim dhe vështirësitë që do të hasnin po të mos përdorej Ruhsa në këtë rast, e nxiti Pejgamberin s.a.v.s. që për këtë të thotë: *“Kush parapaguan, le ta bëjë atë për sasi dhe kohë të caktuar*[24]*”*

2. Pezullimi dhe derogimi i disa dispozitave të rënda që kanë ekzistuar në periudhën e pejgamberëve të mëparshëm, duke i lehtësuar ato dispozita për umetin e Muhamedit a.s.. Raste të tilla kemi mjaft, siç

[22] Suretu el Maide: 06.
[23] Termidhiu.
[24] Buhariu me transmetim nga Ibni Abasi.

është rasti i pendimit pas kryerjes së mëkatit. Te popujt e mëparshëm për t'u pastruar nga mëkati ishte e ligjësuar mbytja e vetes, kurse te Umeti i Muhamedit a.s. mjafton pendimi i sinqertë. Allahu xh.sh. thotë: ***"Pra, pendohuni para Krijuesit tuaj, dhe mbyteni veten.."***[25]

Vlen të përmendet se këto dy llojet e fundit të Ruhsas sipas dijetarëve të medhhebit hanefij konsiderohen Ruhsa alegorike, për shkak të mospërputhshmërisë së tyre me definimine Ruhsas së vërtetë.

Dispozita e të vepruarit me Ruhsa dhe Azime

Kur jemi te dispozita e të vepruarit me ruhsa (lehtësim) apo azime (vendim), dijetarët islam, gjegjësisht usulitët nuk janë të një mendimi se cila prej tyre ka prioritet të përdoret, Ruhsa apo Azime. Imam Shatibiu është i pari i cili bëri një krahasim ndërmjet Ruhsas dhe Azimes, duke i radhitur argumentet a atyre që përparësi i japin përdorimit të Ruhsas dhe të atyre që përparësi i japin përdorimit të azimes, porse vetë nuk merr qëndrim dhe nuk përkrah asnjërin mendim[26].

Dijetarët e medhhebit hanefij lejojnë përdorimin e ruhsas, porse përparësi i japin të vepruarit sipas Azimes. Gjykojnë kështu ngase përmes të vepruarit sipas Azimes, besimtari islam ruan të drejtën e plotë të Allahut xh.sh. si në aspektin formal ashtu edhe atë esencial, kurse flijimi i vetes së tij konsiderohet xhihad në rrugën e Allahut për të ngritur dhe mbrojtur të vërtetën, andaj edhe konsiderohet si shehid në luftë kundër jobesimtarëve. Argumentet ku mbështesin mendimin e tyre janë të shumtë e ne po paraqesim disa nga to.

- Transmetohet nga ebu Ubejde b. Muhamed b. Amar nga babai i tij i cili ka thënë: Idhujtarët e Mekës e kishin zënë Amar b. Jasirin dhe nuk e lëshuan për derisa ai kishte fyer të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe i kishte lavdëruar zotat (idhujt) e tyre. Kur Amari erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. ai e pyeti: *"Ç'ke pas vetes o Amar* çfarë lajmi do na sjellësh)". Amari i shqetësuar tha: "Keq nuk më lëshuan derisa ju nënçmova juve dhe i lavdërova zotat e tyre". Pejgamberi a.s. i tha: *"Po si*

[25] Suretu el Bekare: 54.
[26] Taxhedin BIslimi, Hyrje në shkencën e Usluli fikut, f. 227, Shkup 2003.

ishte zemra jote atë moment"? Amari tha: "E mbushur me iman". Atëherë Pejgamberi a.s. tha: *"Nëse të kthejnë kthe"*.[27] Ky hadith është argument se në këtë rast mund të përdoret edhe Ruhsa që të ruhet jeta e njeriut, por kjo nuk i jep përparësi përdorimit të ruhsas nga azime. Argument tjetër që vërteton se të vepruarit me Azime është me prioritet kemi rastin kur Musejleme Kedhabi i kishte zënë dy nga shokët e Pejgamberit s.a.v.s. dhe njërit prej tyre i kishte thënë: "A dëshmon se Muhamedi është i dërguari i Allahut"? -Ai iu përgjigj: po. Pastaj Musejlemi i tha: "A dëshmon se unë jam i dërguari i Allahut"? -Ai i tha: "Nuk e di se çfarë po flet". Musejlemi i shqetësuar dhe i inatosur për këtë e mbyti sahabiun, pastaj iu drejtua tjetrit duke i thënë: "A dëshmon se Muhamedi është i dërguari i Allahut"? -Ai i tha: po. -"A dëshmon se unë jam i dërguari i Allahut"? -Sahabiu i tha: po. Musejlemi si shpërblim i kësaj përgjigje e liroi këtë dhe nuk e mbyti. Kur arriti lajmi te Pejgamberi a.s. për rastin ai tha: *"Të parit Allahu xh.sh. i ka dhënë shpërblimin dy herë. Kurse i dyti ka vepruar sipas ruhsas (lejimit) të Allahut, e ai nuk ka mëkat.* Në një transmetim tjetër thuhet se Pejgamberi a.s. ka thënë: *I pari e ka mbrojtur të vërtetën, andaj myzhde për të, e i dyti ka vepruar sipas ruhsas.*[28]

Nga ky hadith qartë vërehet se Pejgamberi a.s. e kishte lavdëruar atë që nuk kishte shpalosur kufrin qoftë edhe formal, duke mos e konsideruar tjetrin që ka shpalosur kufirin formalisht si mëkatar, megjithatë kjo është argument se të vepruarit sipas azimes, që është mosshpalosja e kufrit është me prioritet sesa të vepruarit me ruhsa.

[27] Transmeton Hakimi, dhe Bejhekiu me sened të shëndoshë (sahih).
[28] Shih Kurtubiun, el xhamiu li ahkami el Kur'an 10/189.

Jusuf Zimeri

AZEEMA AND RUKHSA

(Summary)

The notions azeema and rukhsa in the terminology of Usuli fiqh are used to describe essential and non-essential provisions (whether they are in accordance with a certain argument or in contradiction with it). In order to clarify these two terms we will try to elaborate them from the scientific aspect of Usuli fiqh.

يوسف زيمبري

العزيمة و الرخصة

(خلاصة البحث)

ان الكلمة العزيمة و الرخصة في مصطلحات أوصول اللفقه يقصد بهما التشريع الاساسى و غير الاساسي لهما، او بعبارة أخرى تقسيم التشريع طبقا لإتفاقه أو عدم إتفاقه مع الأدلة و البراهين. بناء عليه لكى نكون أكثر وضوحا بهذين المصطلحين سوف نحاول أن نشرحهما من الجانب العلمى لأصول الفقه لانه طبقا لهذا الشرح يعتمد الاعمل به.

Kutb Mustafa Sano

PARIMET E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET MEDHHEBEVE ISLAME

Hyrje[1]

Nëse i kuptojmë vetëm disa nga synimet e larta të medhhebeve[2] (drejtimeve) të ndryshme islame, sendërtimin e të cilave e kanë synuar dhe ende e synojnë, nëse para kësaj gjendjeje jemi njoftuar me kontekstin historik të formimit të tyre dhe nëse i kemi analizuar hollësisht temat (mes'elet) më të rëndësishme programore të këtyre drejtimeve, në mënyrë të domosdoshme do t'i pranojmë orientimet shkencore, metodologjike dhe objektive, të cilat janë obliguese për myslimanët

[1] Ky nëntitull është i përkthyesit në gjuhën shqipe.
Burimi i origjinalit: Kutb M. Sano, Kejfe nete'ammelu ma'a'l-medhahibi'l-islamijjeti'l-'akadijjeti ve'l-fikhijjeti ve's-sufijjeh, Me'alim ve davabit (Kuala Lumpur, Daru't-texhdid, 2006), fq. 113-183. ***Burimi i përkthimit në gjuhën shqipe:***Ahmet Alibašić, *përgatitësi*, Savremene muslimanske dileme, *botues:* Centar za napredne studije, Sarajevo, 2009/1430 h.g..

[2] *Medhheb* (arab.) - Shkolla (juridike, akaidore) islame. Ekzistojnë katër shkolla sunite të gjithëpranuara: hanefite, malikite, shafiite dhe hanbelite. Shkolla më e njohur dhe më e shtrirë është ajo hanefite-maturidite, me përfaqësuesin e saj më të madh Imam Ebu Hanifen.

madhorë me rastin e shqyrtimit të ixhtihadeve[3] (zgjidhjeve, vendimeve) të ofruara nga themeluesit e medhhebeve dhe kur janë në kontakt me pjesëtarët e tyre. Të gjitha këto bëhen me qëllim të dobisë maksimale nga thesari i madh mendimor dhe kognitiv, të cilën e trashëgojnë në vete këto drejtime.

Me orientimet shkencore, programore dhe metodologjike këtu në rend të parë mendojmë në mënyrat (adab) dhe bindjet të cilat duhet t'i çojnë pikëpamjet tona në zgjidhjet e ofruara të themeluesve të atyre drejtimeve dhe të na tregojnë në mënyrat e veprimit ndaj pjesëtarëve të tyre, qoftë ka të bëjë me drejtimet që ekzistojnë apo që nuk ekzistojnë. Këto parime, para se të jenë bazuar mbi parimet e përgjithshme të Sheriatit dhe mbi normat speciale me të cilat është rregulluar raporti vëllazëror ndër myslimanët, janë ndërtuar në grumbullin e teksteve në të cilat theksohet thirrja në detyrueshmërinë e të folurit të butë, këshillës së mirë dhe përdorimit të asaj që është më e mirë në polemikë me oponentët në mësimin islam në përgjithësi, e sidomos në dispozitat individuale sheriatike (furu').

Deri te këto parime kemi ardhur me hulumtim studimor të teksteve të shumta të Librit të Urtë dhe Sunetit të pastër të Pejgamberit dhe të thënieve të as'habëve dhe të tabiinëve për çështjet e ixhtihadit.

Në vazhdim do të tregojmë në atë që do të mund t'i titullojmë si norma të mirësjelljes ndaj drejtimeve islame akaidore, juridike dhe tesavufiane, të cilat i kemi kategorizuar në formën e dhjetë parimeve.

[3] *Ixhtihad* (arab.) - Tekstualisht do të thotë përpjekje, angazhim, kurse si term teknik do të thotë: Angazhim, përpjekje e aftësive intelektuale që në bazë të Kur'anit, Sunnetit dhe traditës islame të arrihet deri te zgjidhja e dobishme, korrekte islame për çështjen, problemin, nevojën e caktuar etj. Përpjekje e muxhtehidit që të nxjerrë rregull nga burimet jo të qarta të shpallura; rezonim, mendim juridik i pavarur dhe kreativ duke përdorur arsyen, me qëllim të aplikimit të sheriatit në rrethana të caktuara, në mungesë të tekstit referent. Shekujve të fundit institucioni i ixhtihadit është rrezikuar, duke ia mbyllur dyert. Kemi disa lloje ixhtihadesh: mutllak, mustekil-l etj.

I. Ndalimi i gjakderdhjes, përdhosjes së nderit dhe shkatërrimit të pasurisë së pjesëtarëve të medhhebeve të tjera

Pa dyshim është i mirënjohur parimi i padiskutueshëm se Islami rigorozisht e ndalon gjakderdhjen e personave të pafajshëm, qofshin ata myslimanë apo jomyslimanë.

Prandaj, gjakderdhja është e ndaluar deri në Ditën e Gjykimit dhe në këtë ndalesë të përhershme mund të dyshojë vetëm dyfytyrëshi apo mohuesi inatçinj. Krahas kësaj, akti i lejimit të gjakderdhjes ndaj personave të pafajshëm vepruesin e nxjerrë jashtë kornizave të Islamit, pa marrë parasysh se a është personi i vrarë mysliman apo jo.

Ajetet e shumta të Librit të Urtë e konfirmojnë këtë parim:

“Për këtë *(shkak të atij krimi)* ***Ne u shpallëm*** *(ligj)* ***beni israilëve se kush mbyt një njeri*** *(pa të drejtë),* ***pa mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë*** *(krimi i tij)* ***është si t’i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall*** *(bëhet shkak që të jetë ai gjallë)* ***është si t’i kishte ngjallur*** *(shpëtuar)* ***të gjithë njerëzit ...”.*** *(El-Ma’ida, 32);*

“Thuaj: “Ejani t’ju lexoj atë që me të vërtetë iu ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapëta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë.” *(El-En’am, 151);*

“Dhe mos e mbytni njeriun që Allahu e ka ndaluar *(mbytjen e tij),* ***përveç me drejtësi*** *(që e kërkon sheriati).* ***E kush mbytet pa të drejtë*** *(pa faj),* ***kujdestarit të tij Ne i kemi dhënë të drejtë*** *(të kërkojë drejtësinë),* ***e ai të mos e kalojë kufirin në mbytje derisa ai është i ndihmuar*** *(prej Zotit)****.”*** *(El-Isra’, 33)*

Ndalimi i vrasjes nuk kufizohet vetëm në vrasjen e njerëzve të tjerë, por ndalimi përfshin edhe vetëvrasjen, për të cilën Krijuesi i Lartësuar thotë:

“O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete, dhe mos mbytni veten tuaj *(duke mbytur njëri-tjetrin).* ***Vërtet, Allahu është i mëshirueshëm për ju.”*** *(En-Nisa`, 29)*

Krahas ajeteve të urta, autenticiteti dhe domethënia e të cilëve nuk vihet në diskutim, ekzistojnë edhe hadithe të shumta të cilët e theksojnë ndalimin e gjakderdhjes. Nuk mund t’i theksojmë këtu të gjitha, por do të mjaftojë t’i theksojmë fjalët e njohura të Pejgamberit a.s. nga *Haxhi i Lamtumirës*:

“Me të vërtetë gjaku, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend.”

Nëse gjakderdhja me tekstet kur’anore-sunetike është e ndaluar pakontestueshëm, atëherë ky ndalim është edhe më i sigurt në çështjen e gjakderdhjes së një myslimani, për të cilën Kur’ani i madhërishëm thotë:

“Kush e mbyt një besimtar me qëllim, dënimi i tij është xhehennemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. Allahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh.” *(En-Nisa’, 93).*

Konfirmimi për këtë ndalim janë hadithet e shumta të cilët i zbulojnë mëkatet e të gjithë kriminelëve të përzier në gjakderdhjen e myslimanëve, të cilët krimet i arsyetojnë me komentimet e pasakta dhe jo të drejta, të cilat nuk kanë kurrfarë lidhjeje me dijen, Sheriatin, këmbëngulësinë dhe sinqeritetin.

Përkundrazi, shkenca, mirësia dhe këmbëngulësia nuk kanë asgjë me ta, pikërisht sikur që ujku nuk ka pasur gjë me gjakun e Jusufit a.s..

Ndalimit të gjakderdhjes i shtohet edhe ndalimi i përdhosjes së nderit (dinjitetit) të një myslimani dhe jomyslimani, ndalimi i shkatë-

rrimit të pasurisë së një myslimani dhe të një jomyslimani. Në Sheriat nderi dhe pasuria janë të pacenueshme dhe askujt nuk i lejohet ataku mbi to. Hadithi i cekur padyshim e ndalon veprimin e këtyre tri vepra-ve dhe i kategorizon në mëkate të rënda, që personin i cili e lejon këtë veprim e nxjerr nga Islami dhe e shpie në Xhehenemin e amshueshëm në Ditën e Gjykimit.

Në pajtim me këtë parim të përhershëm islam mund të pohojmë menjëherë se krahas asaj që qartë e ndalon gjakderdhjen, përdhosjen e nderit dhe shkatërrimin e pasurisë së jomyslimanëve të cilët nuk janë bashkëmendimtarë, Islami në mënyrë edhe më të prerë e konteston dhe e ndalon gjakderdhjen, përdhosjen e nderit dhe shkatërrimin e myslimanëve, të cilët nuk e ndajnë të njëjtin mendim. Nuk ekziston asnjë medhheb islam e lere imam-muxhtehid i mirënjohur, i cili pa-suesve të tij ua ka lejuar gjakderdhjen e personave që nuk janë bash-këmendimtarë në hollësitë teorike, praktike dhe edukative (furu'). Përkundrazi, për tërë mësimin islam me tërë tekstet kur'anore-sune-tike dhe me konsensusin e qartë të ulemasë është i huaj plotësisht çfa-rëdo komentimi i marrë për platformë për gjakderdhjen e personave të pafajshëm, shprehjes së armiqësisë dhe tmerrimit të personave për të cilët është e garantuar siguria.

Prandaj, fakti se jemi dëshmitarë që në shumë vise islame në më-nyrë të organizuar dhe të planifikuar vriten njerëzit në emër të medh-hebeve akaidore, fikhore apo sufiste, është sulm i neveritshëm mbi mësimet islame dhe mbi imamët e medhhebeve. Imamët, pa përjash-tim, janë plotësisht të pastër dhe të pafajshëm nga këto krime, të bëra në emër të tyre. Sulmi mbi nderin e dijetarëve të cilët mendojnë ndry-she dhe uzurpimi i padrejtë i pasurisë së tyre, numërohet në këto ndër-marrje kriminale. Shkaktarët e këtyre veprimeve duhet të ndiqen dhe të sanksionohen me dënim sheriatik të paraparë për veprat e këqija të këtij lloji.

Bindja, besimi i ndërtuar në perceptimin e mençur të medhhebeve teologjike, praktike dhe sufiste nuk dëshiron të ketë kurrfarë lidhjeje me qëndrimet dhe idetë të cilat çojnë në gjakderdhje, përdhosje të nderit dhe në shkatërrim të pasurisë.

Qëndrimet e tilla konsiderohen të futura në medhhebe dhe nuk ka kurrfarë ngjashmërie ndërmjet tyre dhe atyre medhhebeve. Bindja e mirëfilltë në rregullsinë e këtij parimi medoemos shpie drejt revidimit të çdo ixhtihadi të ofruar në të cilin ndjehet fryma e lejimit të gjakder-dhjes të atyre personave të cilët i përjetojnë në mënyrë tjetër çështjet e caktuara akaidore, praktike apo edukative. Pikërisht në këtë pikëpa-mje manifestohet ndihma e madhe për brezat e rinj në preventivën e bërjes së mëkateve të rënda.

Thelbi i çështjes qëndron në këtë: pasuesit e të gjitha medhhebeve islame janë të obliguar ta refuzojnë çfarëdo lidhshmërie të imamëve dhe të ixhtihadit të tyre me cilëndo ide apo qëndrim që e lejon gjakde-rdhjen e personave të pafajshëm, qoftë ka të bëjë me myslimanët apo me jomyslimanët. Islami kurrë dhe askënd nuk e fton në përdhosjen e nderit të jomyslimanit e lëre më të myslimanit. Po ashtu, është obli-gim madhor i të gjithëve ta kontestojmë çdo aspekt të lidhshmërisë së imamëve dhe ixhtihadit të tyre me ftesat publike apo sekrete për shka-tërrimin e pasurisë së myslimanëve dhe të jomyslimanëve.

Allahu qoftë i kënaqur me Enes ibn Malikun, as'habin e nderuar, i cili umetit ia ruajti njoftimin madhështor pejgamberik, të shënuar në Sahihun e Buhariut:

"Kush e fal namazin tonë, kthehet drejt kibles sonë dhe e han mish-in e kafshëve, të cilat i presim - ky është mysliman, është në mbroj-tjen dhe ruajtjen e Pejgamberit të Tij dhe mos e lëni pa mbrojtje të Allahut."

Allahu qoftë i kënaqur me Abdullahun, të birin e Omerit r.a., për arsye të thënies së tij historike:

"Kur të na ftojnë për namaz - do t'u përgjigjemi, kurse kur të ftohe-mi në gjakderdhje - do t'i refuzojmë."

Sidoqoftë, nevoja e përditshme e skenës së rrëmbyer islame është se të gjitha autoritetet fetare, akademitë dhe institucionet shkencore në botën islame duhet të njoftojnë edhe njëherë qartazi dhe në mënyrën më energjike ta konfirmojnë përhershmërinë e ndalesës të çdo forme të gjakderdhjes, të përdhosjes së nderit dhe shkatërrimit të pasurisë të pasuesve të medhhebeve ekzistuese islame.

II. Ndalimi i shpalljes për mosbesimtarë të imamëve dhe të pjesëtarëve të medhhebeve islame

Krahas asaj që me tekstet shprehimore kur'anore-sunetike ndalohet gjakderdhja e myslimanëve dhe e jomyslimanëve, ndalohet përdhosja e nderit dhe e shkatërrimit të pasurisë së tyre, është e ndaluar shpallja për mosbesimtar (tekfir)[4] edhe e imamëve dhe e pjesëtarëve të medhhebeve ekzistuese islame, për arsye sepse ata kanë qenë imamë të udhëzimit dhe të mirës, kurse në përkushtimin ndaj Allahut dhe në ruajtjen prej shirkut (idhujtarisë) të të cilëve dyshojnë vetëm inatçinjtë mendjemëdhenj, në korrektësinë dhe për thellësinë e imanit të të cilëve dyshimin e nxisin vetëm rrugaçët injorantë.

Të gjithë imamët në akaid, sikur Ahmed ibn Hanbeli, Abdullah ibn Ibade, Hasan El-Esh'ariu, Ebu Mensur El-Maturidiu e të tjerë, kanë qenë imamë të mëdhenj dhe jetën e tyre e kaluan në shërbim të fesë. Për këtë arsye ata iu nënshtruan pakënaqësive të mëdha dhe, si model për të tjerët, janë dënuar rreptësisht; shumica kanë kaluar një kohë të gjatë në terrin e birucave të burgjeve, por e tërë kjo ata nuk i pengoi nga angazhimi që t'i shërbejnë dhe ta mbrojnë fenë derisa nuk kanë vdekur si myslimanë dhe besimtarë, me besim të fuqishëm në Një Allah.

Imamët e fikhut si Xhafer Es-Sadiku, Xhabir ibn Zejdi, Ebu Hanife, Maliku, Shafiu, Ahmed ibn Hanbeli, Davud Edh-Dhahiriu, Taberiu dhe shumë të tjerë, kanë qenë, gjithashtu, imamë të mirë, me jetë botërore modeste, kanë qenë plotësisht të përkushtuar ndaj Islamit dhe të dhënies mësim njerëzve të zakonshëm. Njëjtë kanë bërë imamët e edukimit, të pastrimit të shpirtrave, të modestisë dhe të devotshmërisë, sikur Muhasibi, Shadhiliu, Tixhaniu, Senusiu e të tjerë. Të gjithë ata kanë ditur për Allahun dhe Atij iu nënshtruan ditë e natë.

[4] *Tekfir* - (arab.) - Shpallja e tjetrit për kafir, mosbesimtar. Akuza për mosbesim, apostazi, herezi. Shkollat juridike dhe besimore janë unanime që të mos shpallet askush për kafir - mosbesimtar, pa qenë e qartë deklarata apo veprimi i personit të caktuar.

Allahu e mëshiroftë shejh'ul-islam Ahmed Ibn Tejmijen kur i theksoi përpjekjet e këtyre imamëve dhe i tha fjalët e tij të njohura për imamët e shumtë të kelamit dhe të polemikave:

> "Çdonjëri nga ata i ka dhënë kontribut Islamit. Janë përgjigjur në shumë akuza të mosbesimtarëve dhe të novatorëve dhe se jashtëzakonisht shumë i kanë ndihmuar ehli-sunetit dhe fesë. Ky kontribut nuk mund të mbetet i fshehur për ata të cilët i njohin rrethanat në të cilat kanë jetuar dhe të cilët për ata flasin të bazuar, sinqerisht, drejtësisht dhe objektivisht... Nuk ka kurrfarë dyshimi se personit që hulumton për të vërtetën dhe fenë në bazë të asaj që është shkruar prej Muhammedit a.s. dhe që në këtë gabon - Allahu xh.sh. do t'ia falë, në pajtim me lutjen të cilën Allahu i Madhërishëm e pranoi nga Pejgamberi a.s. dhe besimtarët, kur thanë: "O Krijuesi ynë, mos na dëno neve nëse harrojmë apo veprojmë diç pa qëllim".

Në bazë të së theksuarës më lart, është mëkat dhe padrejtësi e madhe që njeriu, ashtu, nga inati i pastër ta shpallë ndonjërin nga këta imamë për mosbesimtar për shkak të lëshimit të tyre gjatë perceptimit apo gabimit në ixhtihad. Mendjemadhësi edhe më e madhe është që mëkatari të gjykojë për përkushtimin e tyre ndaj Allahut dhe për ruajtjen e tyre nga të gjitha format e politeizmit (shirkut).

Sheriati i pastër çdonjërit prej tyre i ka garantuar shpërblim në Ditën e Gjykimit, kurse atyre të cilët e vlerësojnë në mënyrë korrekte çështjen i ka garantuar shpërblim të dyfishtë, dhe, së këndejmi,...është plotësisht e papranueshme që dikush duke ecur në tehun e skajit t'i shpallë imamët e tillë mosbesimtarë dhe ta njollosë nderin e tyre, njëkohësisht duke harruar, ose duke mos ditur, se Allahu xh.sh. ua ka falur gabimet në të kuptuarit e normave të caktuara sheriatike, e ka pranuar lutjen e besimtarit dhe ua ka falur në pajtim me fjalët e Tij:

> ***"Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij, atij*** *(njeriut)* ***i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo*** *(e keqe)* ***që e meritoi. "Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën ne nuk kemi fuqi! Na i fshij mëkatet, na i mbulo të këqijat, na mëshiro. Ti je***

mbrojtësi ynë, na ndihmo kundër popullit pabesimtar”! *(El-Bekare, 286).*

Është e nevojshme të theksohet fare qartë se ndalimi i shpalljes për mosbesimtar nuk ka të bëjë vetëm me imamët muxhtehidë, teoricienët, sufinjtë dhe pasuesit e tyre. Ajo para së gjithash ka të bëjë me ndalimin e shpalljes për mosbesimtarë të mësuesve të tyre, të as’habëve fisnikë, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata dhe të gjithë besimtarët që i pasojnë në të mirë dhe dobi.

Nuk ka dyshim se ulemaja e mirënjohur e të gjitha medhhebeve shpalljen e as’habëve për mosbesimtarë e konsideron për mëkat më të madh dhe shkelje më të rëndë te Allahu se shpallja për mosbesimtarë të tabiinëve dhe tebei-tabiinëve. Ekzistojnë transmetime të shumta dhe tekste të qarta në të cilat ndalohet shqiptimi i fjalëve të këqija apo i mendimeve të shëmtuara për ata. Kur’ani ka dhënë shenjë në vlerën e tyre dhe i ka lavdëruar ata në disa vende. Pejgamberi a.s. ndërroi jetë nga kjo botë i kënaqur me ta. Në një hadith mutevatir, të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi, i cili flet mbi ndalesën e ofendimit dhe të shqetësimit të as’habëve, Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Mos i ofendoni as’habët e mi! Për Zotin në dorën e të cilit është jeta ime, sikur dikush nga ju të ndajë ari sa mali Uhud, nuk do ta arrijë as sa një grusht apo gjysmë grushti të mirësisë së tyre.”

Hadithi i përmendur në thelb udhëzon në ndalesën e ofendimit të të gjithë as’habëve r. anhum, kurse në kontekst më të gjerë të të kuptuarit të këtij hadithi, ndalesa ka të bëjë edhe me shpalljen e as’habëve për mosbesimtarë, mëkatarë dhe të shfrenuar. Nëse vetë ofendimi është i ndaluar pa marrë parasysh në atë që është më pak i dëmshëm nga shpallja e dikujt për mosbesimtar, mëkatar apo të shfrenuar, atëherë, thonë njohësit e metodologjisë së të drejtës së sheriatit - usulit, kjo ndalesë është më se e qartë në çështjen e shpalljes së dikujt për mosbesimtar, mëkatar apo të shfrenuar.

Ndalimi i shpalljes së imamëve për mosbesimtar nuk përfshin vetëm imamët ndër as’habët, ridvan’ull-llahi alejhim. Kjo ka të bëjë edhe me imamët nga radhët e tabiinëve dhe tebei-tabiinëve. Të shpallen tabiinët dhe tebei-tabiinët për mosbesimtarë është më e keqe dhe më

mëkatare nga shpallja për mosbesimtarë të imamëve dhe muxhtehidëve, të cilët kanë jetuar pas tyre, për shkak se përshkrimi i të mirës nga Pejgamberi s.a.v.s. ka të bëjë me ta në hadithin:

“Brezi më i mirë është brezi im, pastaj ai pas tij, e pastaj ai pas tij.”

Në bazë të kësaj përfundojmë se shpallja për mosbesimtarë të imamëve nga radhët e as’habëve, tabiinëve dhe tebei-tabiinëve, sikur edhe shpallja për mosbesimtarë të pasuesve të imamëve të medhhebeve me siguri është haram. E ndalojnë po ato tekste që e ndalojnë derdhjen e gjakut të personave të pafajshëm, përdhosjen e nderit dhe shkatërrimit të pasurisë. Shpallja e myslimanëve për mosbesimtarë bënë pjesë në përdhosjen e nderit, justifikim ky në të cilin thirren injorantët me rastin e lejimit të gjakderdhjes dhe të atakimit jolegal në shenjtëri dhe fytyrën e muslimanëve.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, është detyrë rigoroze e të gjithë pasuesve të medhhebeve që të distancohen nga sëmundja e ashpër e kohës bashkëkohore, të mishëruar në një grumbull të njerëzve kryesisht të rinjë dhe të arsimuar, të cilën nuk bënë ta përçmojmë, kurse e cila e shpallë për mosbesimtarë një numër të madh të imamëve nga radhët e as’habëve, tabiinëve dhe tebei-tabiinëve. Po ashtu, është detyrë rigoroze e të gjithë muslimanëve që drejtohen nga kibla të besojnë se si është e ndaluar të shpallen mosbesimtarë pasuesit e medhhebeve të pranuara islame sepse kjo është e ndaluar të bëhet edhe ndaj imamëve të atyre medhhebeve.

Në bazë të gjithë kësaj, mendimtarët islamë dhe udhëheqësit muslimanë janë të detyruar që në çdo cep të botës ta udhëzojnë këtë brez të ri, i cili lehtë mund ta pranojë shpalljen për mosbesimtarë të atyre pasuesve të kibles të cilët kanë mendim ndryshe në aspekt të çështjeve të caktuara akaidore, fikhore apo edukative. Është detyrë e tyre që edhe këtij brezi të ri t’ia sqarojnë thelbin e këtyre medhhebeve dhe pozitën e imamëve dhe të ulemasë te Allahu xh.sh. në Ditën e Gjykimit edhe te masa e zakonshme, të cilëve ata tërë jetën ua kanë sqaruar thelbin dhe dispozitat e kësaj feje të lartësuar.

Është detyrë e të gjithë pjesëtarëve të medhhebeve që t'i gjykojnë ato forca të cilat i shpallin për mosbesimtarë muslimanët e tjerë, ta tregojnë tërë padijen dhe amshtësinë e tyre, ta diskreditojnë neglizhencën e tyre dhe që secilin prej tyre ta njoftojnë me dëmin e madh që me këtë ia bëjnë Islamit. Nëqoftëse pjesëtarët e medhhebeve nuk do të bashkëpunojnë në orientimin e rinisë dhe gjykimin e atyre të cilët gabojnë, sigurisht do t'i godasë vuajtja dhe e keqja, kurse mëkati i tyre do t'i përfshijë të gjitha medhhebet. Në këtë rast të gjithë imamët do të jenë mosbesimtarë, për shkak të mosdijes, lajthitjes dhe shpifjes së atyre të cilët i shpallin si të tillë; kurse të gjithë muslimanët të cilët i pasojnë medhhebet do të bëhen renegatë nga mileti, për shkak të mosdijes së këtyre injorantëve dhe për shkak të marrëzisë së këtyre mediokrëve, do të bëhen renegatë nga mil-leti.[5]

E lusë Allahun që mos të na dënojë për shkak të asaj që e bëjnë injorantët, që t'i mëshirojë imamët dhe ulemanë tonë dhe që të gjithë neve të na përfshijë me faljen e Vet.

III. Ndalimi i dyshimit në korrektësinë e besimit të imamëve të medhhebeve

E kemi parë për çfarë arsye është e ndaluar gjakderdhja të pjesëtarëve të medhhebeve, përdhosja e nderit të tyre, shkatërrimi i pasurisë së tyre dhe shpallja e tyre për mosbesimtarë. Për arsyet e njëjta është e ndaluar të mohohet dhe të dyshohet në korrektësinë e besimit të imamëve të medhhebeve. Tashmë kemi dhënë shenjë në këtë se Sheriati i ndershëm garanton dy shpërblime për imamët ixhtihadi i të cilëve është i saktë, kurse një shpërblim për imamët ixhtihadi i të cilëve nuk është i saktë. Të supozojmë se kanë gabuar në disa vlerësimet e tyre, ata, sërish, edhe përkundër gabimit, për këtë angazhim i pretë një shpërblim. Së këndejmi imponohet pyetja se si dikush mund të mohojë dhe dyshojë në korrektësinë e besimit të imamëve, kur Allahu xh.sh. për ixhtihadin e tyre në Ditën e Gjykimit do t'ua jep dhuratën e Tij.

[5] *Mil-let* - (arab.) - Religjion, besim, ritual, sekt ose bashkësi shpirtërore, për dallim nga fjala *din* e cila do të thotë vetëm fe. Ka të bëjë vetëm me Islamin ashtu që 'ehl'ul-mil-le' përcakton muslimanët. Në Turqi dhe Persi fjala *mil-let* përdoret edhe në kuptim: kombi, populli ose shteti.

Nuk ekziston ndalesë në Sheriat, as nuk është e paarsyeshme që muslimanët e mëvonshëm ta zgjerojnë fushën e ixhtihadit të muslimanëve më të hershëm në fushat e kritikës konstruktive shkencore, revidimit objektiv, valorizimit të kuptueshëm dhe metodologjisë normale. Përkundrazi, detyrimi i muxhtehidit është që në çdo kohë dhe në çdo vend rishtazi t'i shqyrtojnë mendimet më herët të sjella, sidomos nëse janë bazuar në ruajtjen e normës së caktuar të trashëguar, të traditës apo gjendjes së gjetur. Nëse kjo normë ndryshohet, apo tradita ndërrohet me tjetër, apo vjen deri te ndryshimi i gjendjes, është detyrim i muxhtehidëve që rishtazi t'i hulumtojnë zgjidhjet më herët të marra për këto çështje. Dëshmia më e mirë për një raport të këtillë ndaj ixhtihadit të imamëve të hershëm është vetë praktika e imamëve-muxhtehidëve, të cilët rishtazi i kanë analizuar zgjidhjet (ixhtihadet) e shumta të as'habëve, tabiinëve dhe tebei-tabiinëve, sikur edhe ajo se kanë ofruar zgjidhje të cilat nuk janë përcjellë prej tyre. Kështu imamët sikur Shafiu, Ibn Hanbeli, Taberiu, Tusi e të tjerë e kanë zgjeruar fushën e ixhtihadit të dijetarëve më të hershëm në fushën e kritikës objektive shkencore dhe refuzuan të veprojnë sipas zgjidhjeve të shumta të bashkëkohasve të tyre, pa marrë parasysh në faktin se shumë mirë kanë qenë të njoftuar me argumentimin e tyre të zgjidhjeve të ofruara.

Këtu duhet të këmbëngulet në distancimin nga mospranimi i korrektësisë së besimit të imamëve dhe përkushtimit të tyre ndaj Allahut, Kur'anit dhe Muhammedit a.s., mospranimi i akuzës për mosruajtjen e tyre nga politeizmi, mospranimi i akuzës për mohimin dhe mosnënshtrimin ndaj Allahut. Por, edhe nëse ndodh që ndonjë musliman të hetojë ndonjë gabim në ixhtihadin e imamëve në çështjen e caktuar akaidore apo edukative, nuk është korrekte që atë qëndrim ta marrë si themel në bazë të të cilit imamin - muxhtehidin e caktuar do ta akuzojë për besim jokorrekt apo ta vë në dyshim përkushtimin ndaj Allahut dhe ruajtjen e tyre nga mëkatet.

Dyshimi në korrektësinë e besimit të imamëve është sëmundje me pasoja të këqija dhe të rrezikshme. Kjo, në të vërtetë, konsiderohet hyrje në proklamimin e imamëve për novatorë, pastaj për mëkatarë e pastaj edhe për mosbesimtarë. Kjo, po ashtu, konsiderohet kalim nëpër të cilin kalojnë të sëmurët të cilët e rrënojnë dinjitetin e ulemasë dhe ua marrin të drejtën legale për ixhtihad në ato tema për të cilat Allahu xh. sh. e ka lejuar ixhtihadin.

Dyshimi i tillë me gjuhën e atyre që merren me pastrimin e shpirtit quhet sëmundje e zemrës shkaku i së cilës është mendimi i keq, spiunimi, kujdestaria dhe tutoria mbi besimin e njerëzve.

Vërejtje të tmershme për këtë shfaqje rrënuese dhe këtë sëmundje të zemrës e gjejmë në fjalët e të Madhërishmit:

“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron ta hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është mëshirues, Ai e pranon shumë pendimin.” *(El-Huxhurat, 12).*

Në pajtim me këtë, dyshimi, në cilën do formë apo trajtë, konsiderohet si mendim i keq, kurse mendimi i keq për të tjerët është haram dhe rreptësisht i ndaluar me tekstet e Kur’anit dhe të Sunetit të pastër. Mëshira e Allahut qoftë mbi imamin Jahja bin Seidin, i cili ka thënë:

“Njerëzit vazhdimisht japin fetva. Disa e konsiderojnë diç të lejueshme, deri sa të tjerët po këtë e konsiderojnë të ndalueshme. Personi i cili e ndalon diç nuk mund ta shohë shkatërrimin e personit i cili këtë e lejon; as që personi i cili diç e lejon mund të shohë shkatërrimin e personit i cili këtë e ndalon.”

Ta rezimojmë!

Është detyrim i të gjithë pjesëtarëve të medhhebeve që ta refuzojnë çdo pikëpamje të dyshimit të fshehtë apo të hapur, publik apo sekret në korrektësinë e besimit të imamëve-as’habëve, tabiinëve dhe atyre që jetuan pas tyre, të atyre për të cilët konsiderojmë se kanë kultivuar qëllime të sinqerta ndaj Allahut xh. sh. dhe se tërë energjinë e

tyre, duke mos e kursyer veten, e kanë orientuar përjashtimisht në dobi të fesë. Është detyrim i të gjithë pjesëtarëve të medhhebeve që t’i frikësohen Allahut deri sa flasin për imamët të cilët e kanë mbaruar jetën e tyre dhe ecën pas asaj që e vepruan, kurse Allahu u mjafton dhe Ai do t’u jap atë që është për ata te Ai i përgatitur në Ditën e Gjykimit. Është e njohur se Pejgamberi a.s. ka këshilluar:

“...të vdekurit tuaj përmendni për të mirë, sepse ata shkuan pas asaj që e kanë bërë.”

Qysh moti imam El-Mubarek Abdullah ibn El-Mubarek ka thënë: “Mishi i ulemasë është helmues kurse ne themi se mishi i imamëve është edhe më helmues dhe më i rrezikshëm për ata që e prekin.“[6]

IV. Mosfavorizimi i medhhebeve dhe imamëve

Parimi të cilit duhet t’i përmbahemi kur flasim për medhhebet është mosdhënia përparësi të disa imamëve të medhhebit ndaj të tjerëve sikur edhe mosdhënia përparësi të disa medhhebeve ndaj disa të tjerëve. Ky parim zë fill në atë se medhhebet në esencë janë interpretimi i ixhtihadit, i cili kishte për qëllim t’i shërbejë fesë, ta mësojë me dispozitat e fesë popullin e zakonshëm dhe t’i saktësojë synimet e fundit të Sheriatit në çështjet e caktuara teologjike, praktike dhe edukative.

Kur tashmë është e gjithëpranuar se vetëm Allahu e di kush është më i devotshëm, më i ditur dhe më i ndershëm, atëherë është skajshmërisht e gabueshme që njeriu veten e tij ta detyrojë në kërkim të Zotit me imamin më të zgjedhur. Është krejtësisht e papranueshme sipas Sheriatit dhe sipas kritereve të arsyes se vetëm medhhebi i tij në besim, perceptim apo praktikim të Islamit është i drejtë dhe i pranuar tek Allahu xh. sh.. Pohimi sikur ky vetëm mund të shpjerë në pohim të ndaluar se njeriu e njeh gajbin (të padukshmen), kur e dimë mirë se asnjë njeri diç të tillë për vete nuk mund ta pohojë.

[6] Mendohet në përgojimin e ulemasë dhe të imamëve - vërejtja e përkthyesit.

Për këtë arsye, është detyrë e pasuesve të të gjitha medhhebeve që t’i shmangen favorizimit të panevojshëm të imamëve të caktuar të medhhebeve. Është detyrim të krenohemi me të gjithë imamët e Islamit, të respektohen, të konsiderohen ata dhe të orvatemi për vete të marrim atë që është e dobishme në mësimin e tyre. Imamët e besimit, perceptimit dhe të praktikimit të Islamit meritojnë çdo respekt, konsideratë dhe nder për tërë angazhimin madhështor të cilin e kanë dhënë për fenë. Krahas të gjitha këtyre, ata kanë të drejtë që të gjithë myslimanët t’i kujtojnë në lutjet për shkak se ua kanë lehtësuar rrugët e dijes, njohjes dhe të kuptuarit e fesë.

Së këndejmi, nuk ka nevojë për kurrfarë krahasimi të panevojshëm të imamëve, për shkak se ata janë imamë të udhëzimit, ndriçues të së vërtetës dhe kolosë të cilët jetën e vet ia përkushtuan shërbimit, mësimit dhe sqarimit të fesë.

Ky parim i obligon në bashkëpunim pasuesit e të gjitha medhhebeve në pengimin e atyre djelmoshave të cilët flasin shëmtuar ose i ofendojnë imamët te të cilët gjejnë vlerësimin (ixhtihadin) e gabueshëm në fushën e besimit, perceptimit apo praktikimit të fesë. Ky parim gjithashtu obligon në qortimin se e keqja e shkaktuar ndaj cilit do imam të pranuar do të konsiderohet e keqe shkaktuar të gjithë imamëve. Kështu ai i cili nuk e respekton në mënyrë meritore imam Xhafer Es-Sadikun është i barabartë me atë i cili nuk u kushton respekt meritor imamëve Shafiut dhe Malikut; kurse ai i cili nuk i tregon respekt meritor imamit Ebu Hasan El-Esh’ariut është i barabartë me atë i cili nuk i tregon respekt imamit Ebu Hasen Ahmed ibn Hanbelit. Rasti i njëjtë është edhe me ata të cilët i përçmojnë dhe nuk i çmojnë disa imamë të zuhdit dhe edukimit (terbijjeh), sikur janë Shadhiliu, Tixhaniu, Senusiu etj.

Mosdhënia përparësi medhhebeve dhe imamëve duhet ta përfshijë edhe shmangien e krahasimit absurd ndër as’habët, për arsye se Allahu xh. sh. i ka lavdëruar në ajete të shumta:

“Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve *(migruesve)* ***dhe prej ensarëve*** *(vendasve-ndihmëtarë)* ***dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur***

ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh.“ *(Et-Tewbe, 100);*

“Po, ata që besuan, migruan dhe luftuan për rrugën e Allahut, dhe ata që strehuan dhe ndihmuan, janë besimtarë të vërtetë. Atyre u takon falja *(e mëkateve)* ***dhe furnizimi në mënyrë të ndershme.”*** *(El-Enfal, 74);*

“Muhammedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të *(sahabët)* ***janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh kah përulen*** *(në ruku’),* ***duke rënë me fytyrë në tokë*** *(në sexhde),* ***e kërkojnë prej Allahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre është në Tevrat dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. Ata janë si një farë e mbjellë ku mbin filizi i vet, e ai trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet, ajo e mahnit mbjellësin.*** *(Allahu i shumoi).* ***Për t’ua shtuar me ta mllefin jobesimtarëve. Allahu atyre që besuan dhe bënë vepra të mira u premtoi falje të mëkateve dhe shpërblim të madh.”*** *(El-Fet’h, 29).*

Përveç kësaj, në hadithet e shumta qëndron ndalesa e qartë e ofendimit dhe lëndimit të së drejtës së as’habëve në pikëpamje të manifestimit të detyrueshëm të respektimit, konsideratës dhe admirimit ndaj tyre. Në një prej këtyre haditheve, të cilin e shënon Buhariu dhe Muslimi, thuhet:

“Mos i ofendoni as’habët e mi! Për Zotin në dorën e të cilit është jeta ime, sikur dikush nga ju të ndajë ari sa mali Uhud, nuk do ta arrijë as sa një grusht apo gjysmë grushti të mirësisë së tyre.”

Pejgamberi s.a.v.s. është shpërngulur nga kjo botë i kënaqur me ta. Së këndejmi, është detyrim i pjesëtarëve të umetit që të marrin shembull nga Pejgamberi a.s. dhe të bëhen të kënaqur me ta. Është detyrim dhe rrugë e drejtë dhe në tërësi - përgjithësisht dhe individualisht - t’i shmangen shtruarjes së gjykimit personal për ata të cilët kanë gabuar apo janë sjellë drejt në atë sprovë të tmerrshme (fitne) të lindur pas

vrasjes së dy halifëve, Osman ibn Affanit dhe Alij ibn Ebi Talibit r. anhuma. Është e mirëditur për të gjithë të diturit se Sheriati fisnik askënd as para nesh as pas nesh nuk e ka obliguar të japë mendimin as gjykojë për këtë sprovë të tmerrshme, e lëre më ta fajësojë dikë nga të përzgjedhurit të cilët I Mëshirshmi i bëri bashkëkohës të krijesës më të zgjedhur, Muhammedit s.a.v.s.. Për këtë arsye, me Sheriat dhe arsye është e ndaluar të ofendohen, të shpallen mëkatarë, të shfrenuar ose mediokër. Ata e meritojnë çdo respekt, admirim dhe konsideratë për tërë atë që e kanë bërë për këtë, për meritën të cilën deri në Ditën e Gjykimit nuk mund ta kthejnë të gjithë njerëzit së bashku. Allahu e mëshiroftë halifin e drejtë, të ditur dhe të palodhshëm, Omer ibn Abdulazizin, kur u përgjigj në pyetjen mbi mosmarrëveshjen ndër as'habët, ka thënë:

> "Ky është gjaku me të cilin Allahu i pastroi duart tona, vallë për këtë t'i njollosim gjuhët tona!"[7]

Thënë shkurt, të gjithë pjesëtarët e medhhebeve janë të obliguar - pa përjashtim - t'i respektojnë të gjithë as'habët sikur që janë të obliguar t'u drejtojnë te Allahu lutje për mëshirë (me fjalët *rahmet'ull-llahi alejh*) të gjithë tabiinëve dhe tebei-tabiinëve. Janë të obliguar të njoftohen me nderimet të cilat u janë dhënë këtyre imamëve dhe janë të obliguar të çmojnë angazhimin dhe kontributin e tyre. Më tej, janë të obliguar që për të gjithë ata të bëhen lutje që angazhimi t'u pranohet dhe t'u falet atë ditë kur fëmijët dhe pasuritë nuk do të kenë dobi dhe kur vetëm ai që vjen te Allahu me zemër të pastër mund të shpëtohet.

Parimit të mosdhënies përparësi imamëve domosdo duhet shtuar edhe parimin e mosdhënies përparësi cilit do drejtim akaidor, fikhor apo sufist, për shkak se favorizimi i tillë kryesisht ka për pasojë fanatizmin e verbër për medhhebin e caktuar dhe zvogëlimin e kontributit të imamëve, të cilët i kanë formuar medhhebet tjera. Kur dihet se është mendim i gjithëpranuar i dijetarëve islamë dhe të gjitha medhhebet janë të bazuara në udhëzim dhe mirësi, sepse të gjithë synojnë arritjen e caqeve dhe qëllimeve të njëjta, dhe për shkak të barabarësisë

[7] *Kejfe nete'amelu ma'a 't-turath*, 30.

në përkatësinë Sheriatit fisnik, atëherë favorizimi - pa dëshmi të fuqishme - konsiderohet dalje nga rruga dhe atak në atë që Allahu xh.sh. e ka mbajtur përjashtimisht për Vete, e kjo është njohja e më të saktës, më të drejtës dhe më të mirës te Allahu xh.sh. në Ditën e Gjykimit. Krahas kësaj, me favorizim merret llojllojshmëria e të kuptuarit dhe e njohjes me të cilën Allahu xh. sh. e ka bërë këtë umet unik.

Allahu e mëshiroftë Imam Es-Sujutiun, i cili e tërhoqi vërejtjen në rrezikun e favorizimit të medhhebit dhe të imamit, duke e numëruar si përvetësim të begatisë së Allahut për njerëzit, duke thënë:

> "...Dije se diversiteti i medhhebeve në këtë umet është begati dhe vlerë e madhe. Në këtë fshihet mister e shkëlqyeshëm, të cilin e zbuluan dijetarët, kurse injorantët nuk e shohin. Madje i kam dëgjuar disa injorantë duke thënë: "Pejgamberi a.s. erdhi me një Sheriat, andaj prej nga katër medhhebe?' Është e çuditshme edhe kjo se ai që i jep përparësi ndonjë medhhebi me këtë ai e zhvlerëson dhe e rrënon autoritetin e atij me të cilin e krahason dhe kjo ndoshta do të sjellë deri te konflikti ndër mediokër dhe do të nxisë fanatizëm dhe luftarakësi xhahilite. Kurse ulemaja nuk ka asgjë fare me këtë.... mospajtimi në çështjet dytësore ka ndodhur ndërmjet as'habëve dhe askush me askënd nuk është hidhëruar, askush për këtë nuk ka manifestuar armiqësi ndaj tjetrit, as që njëri-tjetrit i kanë thënë se ka gabuar apo se kanë bërë diç të shëmtuar. Në këtë mënyrë u bë e qartë se diversiteti i medhhebeve në këtë umet është vlerë e veçantë e vlefshme e këtij umeti dhe dhënie e gjerësisë Sheriatit fisnik dhe të lehtë...".[8]

Mendimi më i mirë për këtë çështje është ai sipas të cilit kërkohet shmangia e plotë, e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë e çdo forme të krahasimit dhe favorizimit të imamëve të medhhebeve nga një anë dhe vetë medhhebeve nga ana tjetër.

Në vend të kësaj, është detyrë të respektohen të gjithë imamët, të gjithë paçin mëshirë prej Zotit dhe të përpiqemi t'i shfrytëzojmë kurdo që na jepet rasti. Medhhebet duhet t'i konsiderojmë ashtu që të

[8] Es-Sujuti, *Xhezilu'l-mevahib fi ihtilafi'l-medhahib*, fq. 21-22.

gjitha ato e përbëjnë Islamin dhe se asnjë medhheb vetvetiu, për cilindo medhheb të jetë fjala, kurrë nuk mund ta prezantojë Islamin në tërësi.

V. Mosshpallja e pjesëtarëve të medhhebeve të tjera për mëkatarë dhe novatorë

Rregull i gjithëpranuar te dijetarët të cilët merren me studimin e usuli-fikhut[9] (metodologjisë së të drejtës islame) është se ai i cili gabon në çështjet e pjesshme akaidore, praktike apo metodologjike nuk është gabim dhe se gabimi nuk i merrej për të keqe, në pajtim me fjalët e Pejgamberit s.a.v.s. në hadithin sahih:

"Umetit tim i është falur ajo që bëhet nga gabimi, nga harresa apo nën detyrim."

Nëse themi se medhhebet janë formuar për shkak të shqyrtimit të çështjeve të kategorizuara si çështje të ixhtihadit, çështje të pjesshme, çështje të mundshme (madhnunat) apo çështje më pak të qarta (muteshabihat), atëherë personi i cili gabon në saktësimin e synimit final të Sheriatit për këtë çështje nuk numërohet ndër ata të cilët bënë mëkat, por ndër ata të cilët thjesht gabuan në vlerësim. Kurse është dallim i madh ndërmjet personit i cili *gabon* dhe personit i cili *bën mëkat*. Personi i cili bën mëkat e meriton dënimin në Ditën e Gjykimit, kurse personit i cili gabon - sikur që shihet nga hadithi i cekur - i është falur dhe kjo nuk i merret për të keqe.

Në bazë të kësaj, nuk është e mençur as me Sheriat e lejueshme që pasuesit e medhhebeve islame të konsiderohen për mëkatarë, për arsye se imamët e tyre, të cilët kanë gabuar në zgjidhjet e ofruara, te Allahu nuk janë mëkatar, por te Allahu i pretë shpërblim për ixhtihadin e tyre, sikur kjo qëndron qartë në hadithin-sahih të cilin e kemi përmendur më herët.

---

[9] **Usul'ul-fikh** - (arab.) - Parimet themelore të së drejtës islame; i formulon parimet dhe metodologjinë me anë të të cilave rregullat juridike nxirren nga burimet e tyre. Usul'ul-fikhu inkuadron studimin dhe formulimin e komentimeve juridike, detyrimeve dhe ndalimeve, parimet universale, ixhtihadin, ixhmain, kijasin etj..

Kur e dimë se personi i cili gabon në zgjidhjen e ofruar në ndonjë çështje të caktuar të pjesshme nuk është i gabueshëm tek Allahu për këtë, por, insha'Allah, i shpërblyer për këtë, atëherë nuk ka të drejtë askush ta konsiderojë të gabueshëm atë të cilin Allahu e ka ruajtur nga ajo, sikur që askush që beson tek Allahu, te Pejgamberi i Tij dhe në Ditën e Gjykimit nuk ka të drejtë ta konsiderojë të keq dijetarin i cili - sinqerisht dhe për hir të Allahut - është marrë me ixhtihad në ndonjë çështje të caktuar të pjesshme dhe nuk ka pasur sukses të plotë në këtë. Vërtet është sjellje e pahijshme për personin e mençur i cili e shpall për novator atë, ixhtihadi i të cilit nuk pajtohet me mendimin e tij në çështje të caktuara të pjesshme akaidore, fikhore dhe programore. Në bazë të kësaj, të konsiderohet për mëkatar imami-muxhtehid, gabimi i të cilit në ixhtihad është i mundshëm, mund të ketë për pasojë mendimin e kundërt, ashtu që muxhtehidi mëkatar do të kishte të drejtë ta konsiderojë mëkatar personin që e konsideron atë mëkatar. Po kjo e njëjta do të mund të lidhej edhe me atë që muxhtehidin e konsideron të degjeneruar apo novator, kurse në tërë këtë është e qartë skajshmëria dhe teprimi i qartë.

Përveç këtij parimi të cilin e lejojnë Sheriati dhe arsyeja, çdo gjë çon në pamundësinë e pagabueshmërisë njerëzore në ixhtihad. Pagabueshmëria as para as pas Kur'anit dhe Hadithit nuk do të përfaqësohet si rezultat i përpjekjes njerëzore. Nëse është e ditur se pagabueshmëria njerëzore është e pamundur, prej nga atëherë e drejta për dikë që njerëzit me ixhtihad ndryshe, në përpjekjet e veta të dyshimta, fanatizmin e planifikuar dhe teprimin e skajshëm, t'i konsiderojë mëkatarë, të shfrenuar dhe novatorë. Për këtë arsye, mospajtimet e pasuesve të medhhebeve në çështjet e caktuara akaidore, fikhore apo programore nuk do të duhej medoemos të jenë mëkate dhe vepra të shëmtuara të cilat duhet të kontestohen dhe mohohen. Dihet se diç nuk mund të shpallet haram në qoftë se për këtë nuk ekziston dëshmi e qartë dhe e pakontestueshme.

Nga tërë kjo që u theksua mund të përfundohet se pjesëtarët e të gjitha medhhebeve janë të detyrueshëm të gjitha mospajtimet e tyre të nënshtruara ixhtihadit dhe shumëkuptimësisë t'i nxjerrin nga zona e

mëkatit, shfrenimit, novotarisë dhe rrënimit. Sepse çdonjëra nga ato shfaqje duhet të konsiderohet lajthitje e qartë nga rruga e drejtë, shpifje e hapur ndaj Sheriatit fisnik dhe tutori dhe kujdestari shpirtërore e padrejtë mbi njerëzit.

VI. Eliminimi i çdo forme të mohimit të pjesëtarëve të medhhebeve

Nëse dihet se shpallja e të tjerëve për novatorë, mëkatarë dhe të shfrenuar është praktikë e kundërt me tekstet e Sheriatit dhe me normat e tij të pandryshueshme, nëse dihet se çdo akuzim i të tjerëve dhe bërje obligim i diçkasë që Allahu nuk e ka bërë obligim gjithashtu është në kundërshtim me tekstet e Sheriatit dhe me normat e tij të pandryshueshme, atëherë mohimi i të drejtave të pasuesve të medhhebeve që të zgjedhin mendime të caktuara dhe ixhtihad në çështje të caktuara të pjesshme duhet numëruar si dalje nga suazat e asaj për të cilën ulemaja islame është pajtuar dhe e ka pranuar. Kjo atëherë do të duhej të konsiderohej përvetësim dhe mohim i hapur i rregullit të njohur sheriatik se *"çështjet nga fusha e ixhtihadit nuk i nënshtrohen mohimit dhe kontestimit."* Këtë rregull e kanë theksuar shumë imamë të akaidit, fikhut dhe edukimit. Tërë kjo e forcon marrëveshjen e dijetarëve islamë për detyrueshmërinë e veprimit sipas tij dhe thirrjes në këtë gjatë procesit të bashkëpunimit me jobashkëmenduesit në çështjet e caktuara nga fusha e besimit, praktikës dhe edukimit. Njëri nga imamët i cili i thirri pasuesit e medhhebeve akaidore, fikhore dhe edukative në respektimin e këtij rregulli ishte edhe halifi i drejtë, Omer ibn Abdulazizi, i cili ka thënë:

> "Nuk do të dëshiroja që të gjithë as'habët e Pejgamberit të Zotit të kenë menduar njëjtë, sepse kjo vetëm do t'ua vështirësonte fenë. Ata kanë qenë imamë të cilët duhet ndjekur. Kur një njeri vepron sipas njërit mendim, kurse tjetri sipas mendimit tjetër, kjo atëherë sigurisht është rrugë më e lehtë." [10]

[10] El-Bagdadi, *El-Fekihu ve'l-mutefekkih*, 2: 85.

Këtë parim imami i Medinës, Malik ibn Enesi r.a., halifit Harun Er-Rreshidit, i cili dëshiroi ta shpallte për kushtetutë të shtetit abasit veprën e tij *El-Muwatta'*, ia shprehi me fjalët:

> "O sundues i besimdrejtëve, vërtet mospajtimi i ulemasë për umetin tim është mëshirë, sepse të gjithë e pasojnë atë që me siguri e dinë, të gjithë janë në udhëzim dhe të gjithë e bëjnë këtë për hir të Allahut." [11]

Juristi i njohur sheriatik nga Iraku Sufjan Eth-Thevriu ka thënë:

> "Kur sheh dikë se në çështjet rreth të cilave është ndarë ulemaja vepron të kundërtën e asaj që ti e konsideron të drejtë, mos ia kontesto këtë...“.[12]

Imami i hadithit dhe fikhut, Ahmed ibn Hanbeli, e ka lejuar këtë parim me fjalët:

> "Juristi sheriatik nuk duhet t'i obligojë njerëzit të veprojnë sipas medhhebit të tij, aq më pak duhet t'i detyrojë në këtë."[13]

Analogjikisht me këtë, oratori nuk duhet t'i kthejë njerëzit në medhhebin e tij, as t'i detyrojë në këtë. Rasti i njëjtë është edhe me pasuesin e tesavufit, nuk duhet t'i kthejë njerëzit në medhhebin e tij as që duhet t'i detyrojë në këtë.

Imam Zerkeshiu lidhur me këtë pyetje ka qenë mjaft i qartë dhe i saktë kur tha:

> "Kontestimi (inkar) përdoret atëherë kur mohohet ajo çështje rreth së cilës ulemaja islame ka arritur qëndrim unik (ixhma'), kurse sa u përket atyre çështjeve rreth të cilave nuk ekziston ujdi, për ato nuk qortohet. Sepse, çdo muxhtehid mund të ofrojë zgjidhje të saktë, dhe mund të ndodhë që vetëm njëri prej tyre të ofrojë zgjidhje të saktë. Ne këtë nuk e dimë. Myslimanët e parë kanë pasur qëndrime të ndryshme në disa çështje, por askush prej tyre nuk e ka kontestuar mendimin e kundërt. E mohonin vetëm atë që ishte në kundërshtim

[11] Tertibu'l-medarik, 1, fq. 192.
[12] El-Bagdadi, *El-Fekihu ve'l-mutefekkih*, 2, fq. 69.
[13] Abdullah Sha'ban, *Davabitu'l-ihtilafi fi mizani's-sunneh*, Kajro, Darul-hadith, 1997, fq. 96.

me Tekstin, me konsensusin (ixhmain) apo me analogjinë e qartë (kijasin)."[14]

Shejhul-islam Ibn Tejmijje e sqaroi këtë parim me fjalët:

"Nuk mund të kontestohet dhe mohohet qëndrimi i atij i cili në çështjet nga fusha e ixhtihadit thirret në mendimin e ndonjë dijetari islam, as që kjo mund t'i bëhet atij i cili vepron sipas njërit prej dy versioneve të shënuara prej dijetarëve islamë. Në rast se për një çështje ekzistojnë dy zgjidhje (vendime) të ndryshme, kurse njëri prej tyre duket më i drejtë, do të veprojë sipas tij; e në rast se nuk është i aftë ta vlerësojë korrektësinë, do ta pasojë ulemanë në përzgjedhjen e zgjidhjes që mbizotëron."[15]

Në një vend tjetër në veprën El-Fetava Ibn Tejmije thotë:

"Çështjet sikurse këto nuk pengohen me dhunë, as që dikush ka të drejtë t'ua imponojë të tjerëve. Argumentimi duhet të bazohet në fakte shkencore. Atij të cilit një mendim i duket më i drejtë, do të veprojë sipas tij; kurse atij që i pason ata të cilët e preferojnë mendimin ndryshe, kjo nuk mund t'u kontestohet."[16]

Dijetari nga Gadishulli Arab Muhammed ibn Abdulvehhabi shkoi një hap më tej dhe e ndaloi që pjesëtarëve të tesavufit t'u kontestohet e drejta në tevesul (theksimin në lutje të myslimanëve meritorë të vdekur), duke thënë:

"Për arsye se disa dijetarë tevesulin e kanë konsideruar të lejuar edhe për disa myslimanë veçanërisht meritorë, ndërsa të tjerët e kanë konsideruar të drejtë përjashtimisht të Pejgamberit a.s., dhe në bazë të kësaj këtë të drejtë ua kontestonin të tjerëve apo këtë e konsideronin vepër të qortuar, këtë e konsiderojmë një prej çështjeve sheriatike. Edhe pse mendimin e shumicës së ulemasë, e cila mendon se tevesuli është mekruh (i qortuar), e konsiderojmë të drejtë, të drejtën që këtë ta veprojnë nuk e kontestojmë për ata të cilët mendojnë ndryshe, sepse 'çështjet nga fusha e ixhtihadit nuk i nënshtrohen mohimit dhe kontestimit'".[17]

[14] Ez-Zerkeshi, *El-Mensuru fi'l-kavaid*, Kuvajt, Vizaretu'l-evkafi ve'sh-shu'uni'l-islamijjeh, 1985, 2, fq. 140.

[15] Ibn Tejmijje, *Mexhmu'u'l-fetava*, 2, fq. 207.

[16] Po aty, 3, fq. 79-80.

Ta përmbledhim atë që thamë!

Çdo formë e mohimit, kontestimit dhe ndalimit në çështjet e pjesshme nga fusha e besimit, praktikës apo e edukimit duhet të konsiderohet shkelje të qartë të këtij parimi të fuqishëm të miratuar nga ana e tërë ulemasë së mirënjohur islame. Mohim i fshehtë duhet konsideruar çdo sulm aktual në disa mendime të muxhtehidëve, ofendimin e tyre dhe largimin e librave të tyre nga duart e lexuesve të zakonshëm, në mënyrë që të ruhen dhe nga idetë e tyre. Kurse është e vërtetë se veprimi i tillë mund të jetë vetëm një lloj i mohimit që është e kundërt me praktikën e myslimanëve të parë; për arsye se myslimanët e parë një argument ia kundërvinin tjetrit dhe se mendimet e gabuara dhe ixhtihadin e gabuar e kanë përmirësuar në mënyrë që me këtë të mos lëndojnë dinjitetin e atij që ka gabuar.

Në bazë të gjithë të theksuarës, pjesëtarët e medhhebit duhet ta respektojnë këtë parim dhe t'i përmbahen kur të takohen me ixhtihadin, i cili është në kundërshtim me medhhebin e tyre, pa marrë parasysh se këto zgjidhje kanë të bëjnë me çështjet nga fusha e besimit, të dispozitave apo të edukimit. Këtu duhet të aplikohet standardi sipas të cilit në Sheriatin tonë është e lejuar diç të ndalohet apo të mohohet vetëm atëherë kur ka të bëjë për atë që me tekst është e ndaluar, që konsiderohet mosdëgjim ndaj Allahut dhe mëkatit. Kurse sa përket çështjeve në të cilat ekziston mospajtimi i ulemasë, mohimin e tyre nuk e miraton askush nga ulemaja e pranuar. Shkaku i kësaj është fakti se është e lejuar të ndalohet vetëm ajo që është mëkat dhe ajo që në atë është armiqësi e hapur ndaj të drejtës në ixhtihad, e që Sheriati ua ka lejuar të gjithë myslimanëve të kualifikuar për këtë, duke i garantuar çdo muxhtehidi dy shpërblime për zgjidhje të saktë, kurse një për jo të saktë.[18]

[17] Ibn Abdulvehhab, Muel-lefatu shejh Muhammed ibn Abdilvehhab, III dio, Fetava, fq. 69.

[18] Allahu i madhërishëm i ndihmoi robit të tij të varfër – autorit të këtyre rreshtave - ta shkruajë një vepër modeste mbi parimin sheriatik *Çështjet nga fusha e ixhtihadit nuk i*

VII. Obligimi i kërkimit të arsyetimit për gabimet e bëra nga imamët-muxhtehidët

Nëse është e ditur se shpallja për mosbesimtarë të ulemasë dhe të pasuesve të tyre është rreptësisht e ndaluar (haram) në Kur'an dhe Hadith, dhe se konsiderimi i tyre për novatorë, të shfrenuar dhe mëkatarë është krejtësisht e kundërt me praktikën e dijetarëve të akaidit, fikhut, usulit dhe edukimit, imponohet çështja e alternativës për akcesin e tillë në rastet kur te ulemaja dhe pasuesit e tyre vërehet gabimi në çështjet e karakterit formal nga fusha e besimit, praktikimit apo edukimit.

E konsiderojmë se gjetja e arsyetimit për gabimin e imamit është përgjigje korrekte në këtë dilemë, alternativë e mirëfilltë dhe obligim i madh ndaj tyre.

Obligim më i madh ndaj imamëve përbëhet nga gjetja e arsyetimit për gabimet e tyre. Dëshirojmë të gjejmë arsyetim edhe për ata imamë të cilët në ixhtihadin e tyre qartë kanë gabuar dhe në lutjet tona lutemi për ta me fjalët e të Madhërishmit:

"Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: 'Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues'!" *(El-Hashr, 10).*

Gjetja e arsyetimit për gabimet e imamëve dhe atyre që i kanë ndjekur zgjidhjet e tyre në çështjet e caktuara të pjesshme kërkon zemër të pastër dhe fisnike në të cilën nuk ka vend për përbuzje as për manifestimin e armiqësisë shpirtërore apo fizike ndaj tyre. Është e nevojshme të bëhet distancimi nga qëndrimi se duhet t'i konsiderojmë mëkatarë për shkak të mëkateve. Fuqishëm duhet besuar se Allahu iu ka garantuar shpërblim për angazhimin e dhënë në ixhtihad. Krahas

nënshtrohen mohimit dhe kontestimit', të cilën Shtëpia Botuese *Daru Ibn Hazm* e botoi këtë vit.

Shih: Ahmet Alibašić, *përgatitësi*, Savremene muslimanske dileme, *botues:* Centar za napredne studije, Sarajevo, 2009/1430 h.g., fq. 7 e tutje.

kësaj kërkimi i arsyetimit nënkupton se na janë të njohura shumë çështje në të cilat imamët kanë ofruar zgjidhjet e tyre të sakta. Këtë praktikë madhështore islame na ka theksuar imam Edh-Dhehebiu, i cili nuk është pajtuar në disa zgjidhje juridike me imam Ibn Abdulberrin, por kjo nuk i ka penguar që në biografinë e këtij imami ta shkruajë si vijon:

"Atij që i studion veprat e tij do t'i bëhet e qartë sa i ditur ka qenë, sa qartë i ka kuptuar gjerat dhe sa mendjemprehtë ka qenë."

Fjalët e çdo njeriu janë të mangëta, përveç fjalëve të Pejgamberit s.a.v.s.. Duhet ditur se kur imami gabon kjo nuk do të thotë se menjëherë duhet t'i harrojmë të gjitha meritat e tij, por që jemi të obliguar të lutemi për faljen e tij dhe të gjejmë arsyetim për mëkatin e bërë.

Është dëshpëruese që disa bashkëkohës tanë i përdorin gabimet e imamëve në ixhtihadin e disa çështjeve mbi besimin, dispozitat apo edukimin që t'i ofendojnë, ta manifestojnë dyshimin në korrektësinë e besimit të tyre, ta zvogëlojnë kontributin e tyre dhe pozitën që u përket dhe i groposin të gjitha meritat dhe të mirat e tyre që i kanë lënë pas vetes. Njëmend është e dhembshme të shikohet se si një numër i rinisë së arsimuar gjurmon gabimet dhe lëshimet e ulemasë, që pastaj të shkruajnë vepra të mëdha për këtë, duke menduar, nga inati, se me këtë bëjnë vepra grandioze.

Kjo shfaqje nuk është karakteristikë vetëm e kohës bashkëkohore. Me këtë padrejtësi qysh moti qenë goditur shumë dijetarë islamë, për ç'arsye pluhuri i ka mbuluar gjurmët dhe meritat e tyre, kurse njerëzit pakëndshm i kanë kujtuar, nuk e kanë përdorur dijen e tyre dhe as që kanë ardhur në kontakt me veprat dhe librat e tyre të shkruara.

Një nga dijetarët të cilit i është bërë padrejtësi historike, për shkak të lëshimit të cilin e shfrytëzuan armiqtë dhe të këqijtë, ka qenë dijetari i njohur hanbelit Nexhmudin Et-Tufi. Oponentët e tij e shfrytëzuan ixhtihadin e tij të gabuar në dhënien e *përparësisë dobisë së përgjithshme kundrejt tekstit sheriatik*, për çka e kanë akuzuar dhe përshkruar me cilësitë më të këqija. Mirëpo, këta armiq dhe smirëzi i shpërfillën shembujt e mirë të ixhtihadit të drejtë dhe meritat e padyshimta që i përkasin këtij imami. Pa shkathtësi i heshtën shërbimet e tij të përher-

shme historike të cilat i ka bërë për Islamin dhe nxënësit e asaj kohe. Vepra e tij e famshme *Muhtesaru'r-revda* është treguesi më i mirë se ky imam ka pasur talent të jashtëzakonshëm për perceptim të drejtë, përsiatje të pjekur dhe observim të thellë të rrethanave. Në këtë vepër ai ka sqaruar se si pas kënaqësisë fshihet fshehja e vështirësive, kurse pas pakënaqësisë zbulimi i turpeve.

Historia jonë bashkëkohore shënon shumë shembuj të agresionit të laikëve të arsimuar mbi besimin e kolosëve dhe alimëve islamë, të bazuar në lëshimet, rrëshqitjet dhe rrëzimet e tyre. I akuzojnë për çdo gjë dhe për gjithçka. Masa e paditur dhe e ditur manifeston dyshimin e saj në korrektësinë e besimit të tyre, përkushtimin ndaj Allahut dhe ruajtjen nga shirku. Tërë kjo e dezorienton dhe e frustron masën e zakonshme, kurse unitetin islam e bën jounik, të thyer dhe konfliktuoz.

Thënë shkurt, pasuesit e medhhebeve të pranuara parimin e gjetjes së arsyetimit për gabimet e muxhtehidit duhet t'i marrin si platformë dhe praktikë në përjetimin e gabimeve, të cilat në vete i bartin medhhebet e ndryshme islame.

Gjetja e arsyetimit është metoda më efektive në përmbushjen e zbrazëtirave, formimin e aleancave, arritjen e ujdive, unitetin e radhëve dhe të punës në ato fusha në të cilat janë dakorduar reciprokisht. Nuk ka nevojë për kurrfarë mospajtime akaidore, fikhore apo programore, në mënyrë që ato të mos bëhen *"pengesë në bashkëpunim dhe dashurinë e ndërsjellë"*. Të gjithë duhet të përfshihen me atë që Islami e bart në domethënien e vet. Edhe as'habët kanë dhënë fetva të ndryshme për çështjen e njëjtë. A mos ka rezultuar kjo me mospajtime në zemrat e tyre? A mos ka ndikuar kjo në unitetin e tyre apo kjo ndoshta e ka kërcënuar lidhshmërinë e tyre të ndërsjellë? Jo, për Zotin! Hadithi për namazin e ikindisë te Benu Kurejdha nuk na është i panjohur. Nëse janë ndarë ata të cilët ishin më së afërmi pejgamberisë dhe njohjes së thelbit të dispozitave, përse ne të rrihemi për shkak të mospajtimeve joqenësore nga të cilat nuk kanoset kurrfarë rreziku real. Nëse imamët, të cilët më së miri e kanë njohur Kur'anin dhe Sunetin, janë ndarë dhe për disa çështje kanë zhvilluar polemika, përse ne atëherë të mos kemi horizonte të cilat ata i kanë pasur? Nëse mospajtimet

kanë ndodhur në dispozitat më të njohura dhe më të qarta sheriatike lidhur me ezanin, me të cilin myslimanët pesë herë në ditë thirrin për namaz dhe për ç'gjë ekzistojnë transmetime të shumta, përse atëherë kjo e njëjta nuk do të ishte e mundur në çështjet të bazuara në argumentimin e mendimeve dhe përfundimeve.[19]

(përfundon në numrin vijues)

Përkthyesi:
Nexhat S. Ibrahimi

[19] Kejfe nete'amelu ma'a 't-turath, 133.

Kutb Mustafa Sano

THE PRINCIPLES OF COOPERATION BETWEEN ISLAMIC MADHABS

(Summary)

Introduction

If we analyze the objectives of different Islamic madhabs (schools of law), the fulfillment of which is still aspired / if we analyze the historical context in which they were formed and the subject matter of these schools, we will accept the approaches that need to be followed when exercising personal judgment (ijtihad) (as offered by the founders of these mahdabs). All this is done to benefit the most from the great cognitive richness contained in these madhabs.

قطب مصطفى سانو

مبادئ التعاون بين المذاهب الاسلامية

(خلاصة البحث)

مدخل:

اذا إسعطنا أن نفهم بعض الاهداف العالية التي تصبو إليها المذاهب الاسلامية المختلفة في بناء الفكر الاسلامى الصحيح بحيث نصل إلى أرضية مشتركة في تكوينهم التاريخي ودراسة المسائل و المواضيع و لمناهج الخاصة بها فإننا سوف نقبل اتجاهاتهم العلمية و أهدافهم التي هي واجبة على المسلمين. و كل هذا يتم بسبب الاستفادة من التراث الفكرى الخصب الذي تحتوى هذه المذاهب.

Ramadan Shkodra

XHAMIA “SULLTAN MURAT” (792h\1389) MONUMENTI MË I VJETËR ISLAM NË PRISHTINË

I. Hyrje

Trashëgimia kulturore-historike paraqet më së miri dëshmi të pamohueshme dhe vërtetësinë historike të krijuesve të saj. Apo thënë më qartë arti dhe trashëgimia arkitektonike me vërtetësinë e saj japin më së miri të dhënë të rëndësishme për të kaluarën dhe njëkohësisht është urë lidhëse për të tanishmen po edhe për të ardhmen. Vlerat ndërtimore, arkitektonike përpos që flasin dhe dëshmojnë identitetin, njëkohësisht ndihmojnë dhe zgjerojnë dijen lidhur me kulturën duke forcuar vetëdijen e një kombi.

Niveli i kulturës së një populli më së miri tregohet në kujdesin dhe trajtimin ndaj të kaluarës së tij.

Vetë termi monument, në kuptimin bashkëkohor, emërton, krahas realiteteve të tjera, edhe veprat arkitektonike apo ndërtimore me vlera të dyfishta historiko-kulturore, të cilat si të tilla mbrohen me ligj. Koncepti monument, me përmbajtjen e mësipërme kuptimore, është krahasimisht i ri në jetën kulturore të Kosovës, madje edhe në atë evropiane e më gjerë.

Në Kosovë, përpjekjet e para për vënie në mbrojtje të monumenteve i përket vitit 1947, duke u pasuar me shpallje të tjera në vitet e mëparshme. Është rasti që të themi se në Kosovë, procesi i identifikimit të monumenteve, për arsye jashtëshkencore nuk ka ndjekur kriterin e vlerësimit të çdo krijimtarie me vlera pavarësisht nga gjinia, apo përkatësia etnie e ndërtuese.

Ndër objektet monumentale që nuk zunë vendin dhe nuk u trajtuan siç duhet janë posaçërisht ato që i takojnë trashëgimisë islame te ne, megjithëqë si për nga vlera, ashtu edhe për nga rëndësia kanë plotësuar të gjitha kriteret e nevojshme për t’u trajtuar ashtu siç e meritojnë objektet me vlera monumentale.

Këtu do të paraqesim gjendjen dhe trajtimin e xhamisë “Sulltan Murat” që dëshmon më së miri trajtimin joadekuat të trashëgimisë islame-shqiptare nga sistemi i kaluar, por që fatkeqësisht edhe tash e 10 vjet pas luftës nuk shihet ndonjë qasje profesionale ndaj kësaj trashëgimie.

II. Historiku i xhamisë “Sulltan Murat”

Në periudhën e parë të depërtimit të osmanlinjve në vendin tonë, janë ndërtuar disa vepra të çmuara të artit islam, sidomos xhamitë, të cilat, për nga materiali ndërtimor, nga pamja e jashtme dhe e brendshme, magjepsin syrin e atij që i shikon. Këto xhami me arkitekturën dhe artin e tyre të bukur janë në harmoni me objektet e tjera përreth tyre, për më tepër, ato prore vazhdojnë të jenë pika referimi dhe orientimi për popullatën e qyteteve dhe vendeve ku gjenden ato xhami.

Një ndër to, është edhe xhamia “Sulltan Murat” e Prishtinës, e cila është ndër monumentet më të vjetra islame në Kosovë dhe rajon dhe një ndër xhamitë më të bukura që ekzistojnë edhe sot jo vetëm në Kosovë, por në tërë Gadishullin Ballkanik.

Xhamia “Sulltan Murat” ka filluar së ndërtuari më 1389 në kohën e Sulltan Bajazidit, ndërsa ndërtimi i saj ka përfunduar diku në dekadën e shtatë të shekullit XV në periudhën e sulltan Mehmet- Fatihut - Hanit.

Xhamia është e ndërtuar me gurë dhe me llaç. Ka formë kubike, është e mbuluar me kupolë sferike, veçohet për minaren e saj të veçantë, dhe ka një shtesë-aneks që i përket vitit 1902, si dhe një shtresë të suvatuar në vitet 70 të shekullit të shkuar.

Xhamia “Sulltan Murat” përveçse është objekti më i vjetër në Prishtinë, ajo, me sa dihet, është edhe xhamia e parë e ndërtuar në Kosovë.

Xhamia për shkak të vlerave historike, arkitektonike, ornamenteve dhe dekorimeve artistike që ka, ka statusin e objektit me vlera monumentale.

Të veçantë këtë xhami, e bën minarja që është e ndërtuar e tërë me gurë të gdhendur.

Për nga tipologjia kjo xhami bënë pjesë në grupin e xhamive me kupolë, që i përkasin shkollës së xhamive të Bursës (Ullu Xhami). Të këtij stili janë edhe shumica e xhamive të ndërtuara në këtë kohë në trojet tona.

2. Emërtimet e xhamisë

Në kohën e ndërtimit xhamia është emërtuar më emrin e Sulltan Muratit dhe, edhe sot e kësaj dite, njihet më këtë emër. Por, siç u tha më lart, kjo xhami është ndërtuar nga Sulltan Mehmet - Fatiu, por në shenjë respekti e mirënjohjeje i është dedikuar Sulltan Muratit.

Mirëpo, krahas emrit “Sulltan Murat”, me kalimin e kohës, kjo xhami ka marrë dhe ka njohur edhe emra të tjerë. Në Prishtinë është e njohur me emrin popullor “Xhamia e Çarshisë”, që ka një përdorim shumë të gjerë, madje me këtë emër është edhe si pikë referimi për orientimin e qytetarëve.

Për shkak se minarja e kësaj xhamie është më e veçantë se minaret e xhamive të tjera që janë ndërtuar në vendin tonë, njihet edhe si “Xhamia e Gurit”, sepse pjesa më interesante dhe më karakteristike e kësaj xhamie qëndron në minaren e saj, e cila që nga fillimi e deri në fund, madje edhe maja e minares, është e murosur me gurë.

Prishtinasit, këtë xhami e kanë quajtur edhe “Xhamia e Vogël”, sigurisht duke marrë për bazë se kjo është dukshëm më e vogël se Xhamia “Sulltan Mehmet-Fatih” dhe sepse kjo fundit njihet me emrin “Xhamia e Madhe”. Gjithashtu kjo xhami njihet, ndonëse më rrallë edhe me emrin “Bajazit Xhamia”, mbase për shkak se themelet e kësaj xhamie i ka vënë princi Bajaziti.

3. Vendndodhja e xhamisë

"Xhamia e Çarshisë" gjendet në qendër të qytetit, përballë ndërtesës në të cilën aktualisht është Muzeu i Kosovës (ish-ndërtesa e Komandës së ushtrisë Osmane) në anën e majtë, ndërsa në anën e djathtë përtej rrugës kryesore ("Agim Ramadani") gjendet ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.

Xhamia gjendet në këndin e rrugës kryesore që shkon në drejtim të Xhamisë së Llapit ("Xhamisë Ramadanije") dhe të rrugës që shkon në drejtim të dy xhamive të tjera: xhamisë "Jashari Pasha" dhe "Sulltan Mehmet - Fatih", që janë në të njëjtën rrugë me një lartësi pakë më shumë se një qind metra nga njëra-tjetra dhe të cilat korrespondojnë në mënyrë madhështore dhe shumë harmonike me njëra-tjetrën.

5. Mbishkrimi

Mbishkrimi i ndërtimit të kësaj xhamie nuk ekziston, por, në murin e jashtëm në drejtim të Kiblës në formë të rrumbullakët gjenden dy mbishkrime që i përkasin vitit 1902, d.m.th. atëherë kur është bërë restaurimi i kësaj xhamie.

Mbishkrimet janë botuar nga disa autorë.

Në mbishkrimin e parë shihet se ndërtimi ka filluar në kohën e Sulltan Muratit II dhe ka mbaruar në kohën e Sulltan Fatihut.

Ky mendim është përgjithësisht më i pranueshëm. Mirëpo, meqë Sulltan Murat Hudavendigari ra shehid në Betejën e Kosovës, vënia e themelit nga ana e tij nuk ka qenë mundur, andaj themelet e kësaj xhamie për hir të babait të tij i ka vënë princ Bajaziti.

Ndërsa në mbishkrimin e dytë shkruan se restaurimi i xhamisë është bërë nga ana e Abdulhamidit II.

III. Brendia e xhamisë (salla për namaz)

Brendia e xhamisë (salla për namaz) ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kube. Salla me vëllimin e saj unik është e mbuluar me kube sferike të konstruktuar drejtpërdrejt mbi të, nëpërmjet bazës që është ngritur me 12 kënde.

Dimensionet e xhamisë në matjen e brendshme janë 10.60x10.30m.

Sipërfaqja e tërësishme e xhamisë që shërben për t'u falur, duke llogaritur këtu aneksin dhe mafilin, është 232 metra^2.

Salla e lutjeve ka një hapësirë të brendshme unike, e cila ndriçohet nga një numër dritaresh të vendosura në muret anësore të xhamisë dhe në bazën e kupolës qendrore.

Në sallën e namazit hyhet nëpërmjet portës që është në anën veri-ore apo në ballin hyrës.

Muret e xhamisë, pastaj rrethet e dritareve, rrethet e dollapëve si dhe pjesa e brendshme e kupolës, janë të ilustruar me ornamente gjeometrike, kryesisht me motive nga bota bimore.

Në brendinë e xhamisë janë:

1. Mihrabi

Mihrabi është një ndër pjesët më të bukura të xhamisë, është i punuar nga mermeri. Në anën e sipërme të mihrabit është kurora që ia shton vlerat artistike mihrabit në veçanti, dhe xhamisë në përgjithësi. Kurora e mihrabit është e ngjyrosur kryesisht me ngjyra të kombinuara të kafesë, okerit, të gjelbër të errët dhe ngjyrë ari, ndërsa pjesa tjetër e mihrabit ka ngjyrë të kombinuar të së jeshiles, të gjelbrës dhe me korniza ngjyrë ari. Mihrabi është i ndërtuar në murin e Kiblës apo murin jugor të xhamisë

2. Mimberi

Edhe mimberi i xhamisë paraqet një vepër të veçantë arti dhe është i vendosur në anën të djathtë të mihrabit. Është i ndërtuar nga mermeri. Mimberi përbëhet nga porta, e që në këtë rast sipër saj ka një kurorë të stolisur me ngjyrë ari, në këtë kurorë është i gravuar ylli gjashtëcepësh. Mimberi në strukturë ka edhe shkallët që në këtë rast ka 10 sosh, një pjesë tjetër e mimberit është minarja në miniaturë.

Pjesa më e madhe e mimberit është e ngjyrosur me ngjyrë jeshile dhe të gjelbër,

ndërsa kornizat e tij kanë ngjyrë kafe. Ngjyrë të blertë ka edhe pjesa e sipërme konike e mimberit, ndërsa baza e saj është me ngjyrë dheu një pjesë tjetër ka ngjyrë të verdh të mbyllët.

3. Mafili

Pjesë përbërëse e xhamisë është Mafili, i cili është i ngritur në katër shtylla. Ka pamje të bukur dhe vërehet menjëherë në hyrje të xhamisë. Mafili është i ndërtuar me dru të punuar me dekorime të ndryshme që i japin vlera dekorative, vlerë arti.

Mafili është i ndërtuar nga druri, ndërsa shtyllat janë nga mermeri. Pjesa e drurit të Mafilit është ngjyrosur me ngjyrë të kaltër - bojë qielli, ndërsa kornizat me të gjelbër dhe më ngjyrë kafe, ndërsa shtyllat e mermerit kanë ngjyrë ari.

Edhe në pjesët e drurit të Mafilit ka dekorime artistike ku dominon bota bimore, një dekorim interesantë është në pjesën e Mafilit mbi derën hyrëse të xhamisë, ku në inkorporim me strukturën me katrorë në

pjesën qendrore janë bërë ilustrime me motive bimore, ndërsa ngjyrat janë në harmoni me ngjyrat që janë përdoruar në dekorimin e tërësishëm të xhamisë.

4. Qyrsia

Në këndin e majtë të xhamisë, aty ku bashkohen muri jugor (muri i Kibles) me murin lindjes (muri në anën e majtë) - është vendosur Qyrsia (Kursia), nga ku imami mbanë dersin. Qyrsia ka formë harkore, pjesa e sipërme e qyrsisë është e punuar me dru që është i ngjyrosur më të gjelbër, ndërsa pjesa e poshtme është me material që është ndërtuar edhe xhamia dhe ka ngjyrë të blertë. Për t'u ngjitur në qyrsi, shërben një shkallë që është e ndërtuar nga druri.

5. Dollapët

Në xhami, në dy muret anësore, në të djathtë dhe të majtë, në mes dritareve të nivelit të parë ka nga një dollap, që mbyllet me kapakë prej druri. Kapakët e drurit janë të ngjyrosur me ngjyrë të blertë, ndërsa korniza e tyre me ngjyrë jeshile. Mbi kapakë ka elemente dekorative me motive bimore.

6. Dritaret

Xhamia ka 33 dritare në madhësi të ndryshme, pa përfshirë këtu dritaret e aneksit. Dritaret janë të vendoura në 4 nivele, duke llogaritur këtu edhe dritaret e bazës së kuolës qendrore.

Dritaret e nivelit të parë, përpos që janë më të mëdha, brenda kanë kapakë të bukur nga druri. Në të katër anët xhamia ka nga dy dritare të tilla që do të thotë 8 sish në nivelin e parë. Dritaret e nivelit të parë kanë formë katërkëndëshe. Dritaret e nivelit të parë kanë përmasa 190 x 135.

Në nivelin e dytë xhamia në të katër anët ka 10 dritare, dy në murin hyrës, dy në murin e kibles dhe nga tri në dy muret anësorë. Këto dritare janë më të vogla dhe në pjesën e sipërme kanë harkore.

Xhamia po ashtu në tri anë ka nga një dritare në nivelin e tretë me përjashtim të anës së hyrjes kryesore.

Dritaret e nivelit të tretë në anën e brendshme të xhamisë kanë formë si të nivelit të dytë, por janë më me hark në pjesën e sipërme, ndërsa në anën e jashtme kanë formë të rrumbullakët (rrethit) që japin imazhin e syrit.

Dritaret e niveli të katër janë ato të bazës së kupolës ku janë 12 dritare, që do të thotë se kubja qendrore e xhamisë është në bazën 12 këndesh. Edhe këto dritare kanë formën e dritareve të nivelit të dytë, me hark në anën e sipërme.

7. Dera hyrëse

Dera e xhamisë është ndërtuar me pllaka të drurit e ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër. Dera në pjesën e sipërme ka formën harkore që paraqet një lloj porte në miniaturë, të tilla janë dyert e xhamive të stilit osman. Dera hapet në dy krah, ndërsa gjerësia e derës është 1.54.

8. Kupola

Xhamia mbulohet nga një gjysmë sferike që simbolizon kupën qiellore, e cila është e ngritur mbi në bazën 12 këndesh. Kupola është e mbuluar me plumb. Në bazën e saj Kupola ka 12 dritare që janë më të vogla se dritaret e mureve të xhamisë. Edhe dritaret e kupolës në anën e sipërme janë me hark. Brendia e kupolës është e dekoruar në qendër të saj është rozeta. Si rëndom, motivet e dekorimeve - arabeskave janë nga bota bimore, ku dominon ngjyra kaltër dhe e hirit me elemente të bardha, lule të kaltra, purpurta dhe kafe; kjo e fundi është e përdorur më shumë në korniza të rozetës që janë në formë rrathësh.

IV. Aneksi i xhamisë

Sikurse u tha më lartë në vitin 1902 xhamisë i është shtuar një aneks që i është bashkëngjitur në pjesën veriore-hyrëse të saj. Ky aneks nuk është në harmoni me stilin e xhamisë, sidomos kjo vërehet kur e vështron atë nga jashtë.

Aneksi në matjen e brendshme është 11. 27 x 4.40. Është i mbuluar me qeramidhe të shek. XX dhe është i suvatuar.

Aneksi i xhamisë ka 25 dritare, 12 në katin e parë, ndërsa 13 në katin e dytë.

Dritaret e katit të parë janë më të mëdha dhe në anën e sipërme kanë formën e harkut, ndërsa dritaret e katit të dytë janë më të vogla dhe kanë formën katërkëndëshe.

Ne nuk kemi të dhëna nëse kjo xhami para restaurimit të vitit 1902 ka pasur hajat me shtylla e me harqe apo aneksi i është shtuar për të parën herë në vitin 1902, në formë që e ka edhe sot.

Kjo pjesë e aneksit ka formë katërkëndëshe dhe tani përveç vendit ku mund të falen një numër i caktuar i xhematit, në anën e majtë të tij janë vënë edhe 6 çezme për abdes, ndërsa në anën e djathtë janë shkallët që qojnë në katin e dytë të aneksit e nga aty edhe në Mafil.

V. Minarja

Pjesa më e bukur, më interesante, më e veçantë dhe më me vlera artistike e kësaj xhamie, pa dyshim, është minarja, e cila është ndër të rrallat, në mos e vetmja, në Ballkan që është e ndërtuar nga fillimi e deri në mbarim me gurë të latuar, duke përfshirë këtu edhe majën e minares, gjë që e bën këtë minare të veçantë.

Meqenëse është e ndërtuar tërësisht nga guri, edhe xhamia e ka marrë emrin “Xhamia e Gurit”.

Bazamenti i minares ka formë kubike, ndërsa trupi ka formë cilindrike. Forma katrore e minares, përpos bazamentit, vazhdon deri te baza e kupolës qendrore, ndërsa nga këtu minarja apo trupi i saj, ka formë cilindrike. Minarja ka vetëm një sherife.

Minarja e xhamisë “Sulltan Murat” është e punuar me shije të veçantë e cilësore dhe paraqet një vepër të rëndësishme arkitektonike para së gjithash për mënyrën e ndërtimit me gurë të gdhendur fillim e mbarim, dhe sidomos për pjesën e sipërme të minares (majën e minares) që paraqet shijen e hollë dhe plot invencion të artistit që e punoi këtë vepër të artit islam ndër më të arriturat në këto anë.

Hyrja për në minare është në anën veriore të bazës së minares.

VI. Ndryshimet në xhami

Një ndryshim tjetër i xhamisë është edhe suvatimi që i është bërë në vitet 70 të shekulli të kaluar.

Xhamia në fillim të ndërtimit e deri më 1902 për kah stili i ndërtimit krahasohej me xhaminë “Sulltan Fatih”, më të cilën edhe kanë shumë ngjashmëri, mirëpo pas restaurimit të vitit 1902 dhe pas suvatimit të viteve 70 të shekullit të shkuar, xhamia ka pësuar disa ndryshime që tani e dallojnë nga xhamitë e stilit të kohës kur është ndërtuar ajo, po edhe me simotrën e saj “Xhaminë Sulltan Fatih”.

Këto ndryshime a shtime janë:

- aneksi,
- suvatimi i xhamisë nga ana e jashtme
- mbulimi i aneksit të xhamisë me qeramidhe të shek. XX.
- dhe tash së fundi vendosja e dritareve të rendit të parë të xhamisë nga plastika, dritare të kohës sonë.

Këto ndërhyrje janë në anën e jashtme, mirëpo duhet thënë që brendia e xhamisë ka ruajtur formën fillestare që nga planimetria, arabeskat, kupolën kryesore, minaren e gjatë dhe të bukur,

Oborri i xhamisë

Oborri i xhamisë është në formë katërkëndësh. Pas luftës së fundit, oborri dhe ambienti i xhamisë janë rregulluar, hapësira e oborrit të xhamisë është mbjellë me barë, dhe shfrytëzohet ditëve të xhumasë dhe bajrameve për të falë namazin. Oborri është i thurur, rrethoja në anën e djathtë të xhamisë është punuar me gurë, ndërsa në anën tjetër është rrethuar me fidanë (gardh nga fidanët).

Në oborr të xhamisë gjendet një çezme me dy kroje; kjo çezme është e rrethuar me pllaka të mermerit në formë tetëkëndëshe. Kjo çezme shërben për nevoja të qytetarëve dhe udhëtarëve për të pirë ujë.

Në anën e djathtë të oborrit të xhamisë është një varr që për net të mëdha qytetarët ndezin qirinj, një traditë kjo e hershme.

Thuhet se edhe në pjesët e tjera të oborrit të xhamisë ka pasur varre, por sot nuk ekziston asnjë.

Vlerat artistike të xhamisë

Xhamia “Sulltan Murat” në brendinë e saj është e dekoruar me piktura murale dhe ornamente që paraqesin vlera artistike. Në këtë objekt monumental na prezantohen edhe dekorimet e pikturave të realizuara në seko teknikë. Këto rea1izime të pikturave murale dekorojnë kryesisht sallën e namazit me kube. Këtu, përveç luleve të stilizuara, prezantohen edhe figura gjeometrike, motive arkitektonike, selvi etj.

Piktura është përqendruar kryesisht në dritare të sallës së lutjeve, në harqe dhe në padantive në kurorë, ku nga sistemi konstruktiv pandantiv kalohet në kube. Dekorime kemi edhe në vetë kubenë e objektit. Në piktura murale të xhamisë dominon ngjyra e kaltër, e blertë dhe ngjyrë kafeje si dhe nuancat e tyre.

Rozeta, si një tërësi kompozicionale, këtu dominon ngjyra e gjelbër me elemente të bardha të kafesë.

VII. Gjendja e xhamisë sot

Megjithëqë xhamia “Sulltan Murat” është objekti më i vjetër në Prishtinë dhe ndër monumentet më të vjetra islame në Kosovë, dhe meqenëse gjendet në qendër të qytetit, ka vlerë të objektit monumental me vlera të theksuara arkitektonike, pastaj shpreh vlera artistike përmes ornamenteve, pikturave murale, gravimeve në mermer e gdhendjeve në dru dhe meqenëse prej kohësh është shpallur si objekt monumental i mbrojtur nga Instituti Kombëtar për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe megjithëse është një nga perlat e Prishtinës, - ajo, për fat të keq, nuk e ka trajtimin e duhur institucional, dhe është në gjendje jo të mirë dhe jo të favorshme për jetëgjatësinë e saj. Ka kohë që të reshurat atmosferike nga kupola depërtojnë brenda në xhami, në pjesën e jashtme të mureve ka dëmtime serioze, sidomos në bazën e kupolës dhe rreth saj, pastaj brendia e xhamisë nuk trajtohet si duhet, sidomos vlerat artistike atakohen nga gjësende të kohës. Për këtë gjendje kanë ndikuar shumë faktorë:

- trajtimi joadekuat nga organet kompetente për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë së kulturës;

- mentaliteti i trajtimit të objekteve të trashëgimisë islame si të huaja për ne nga ana e institucioneve shtetrore;

- mostrajtimi adekuat me masa restauruese dhe konservuese siç e kërkon një objekt kalibrit të tillë

- menaxhimi joadekuat i hapësirës së brendshme të xhamisë nga ana e shfrytëzuesit e që në këtë rast është Këshilli i BI të Prishtinës.

Një çështje që duhet të na shqetësojë të gjithëve, është edhe menaxhimi joadekuat i xhamisë nga ana e KBI, kjo mund të vërehet sheshazi në brendinë e xhamisë. Me këtë rast duhet përmendur disa dukuri që e dëmtojnë rëndë xhaminë, si objekt me vlera artistike e monumentale:

- vendosja e dritareve të plastikës në rendin e parë në një objekt të shekullit XV, është një ndërhyrje joprofesionale dhe krejt e papranueshme në një objekt me vlerë monumentale. Nuk e kam të qartë si është lejuar një veprim i tillë në objektin më të vjetër të Prishtinës dhe në një objekt që është i mbrojtur me ligj.

- në brendinë e xhamisë, sidomos në murin jugor (murin e Kibles), po edhe në muret anësore, pa asnjë kriter të pranueshëm janë vendosur gjëra të ndryshme pa ndonjë shije dhe në mënyrë jo harmonike, duke nisur nga orët e ndryshme të formave dhe madhësive të ndryshme, pastaj te levat e kalendarë të ndryshëm që drejtpërdrejt dëmtojnë vlerat artistike të muraleve. Këto veprime nuk janë fare në harmoni me ambientin e xhamisë, e aq më pak me një objekt monumental. Askush nuk e ka të qartë, se çfarë funksioni dhe çfarë roli luajnë gjithë ato orë, të cilat, shih çudinë, asnjëra për nga saktësia nuk përputhet me tjetrën!.

- elektrifikimi i xhamisë është bërë në mënyrë joadekuate, ngase në shumë vende ka dëmtuar rëndë muralet dhe ornamentet

- po ashtu, zërimi në xhami është një problem në vete, aparatura për zërim është vendosur pa ndonjë kriter që mbron vlerat e xhamisë.

- në brendi të xhamisë, nën Mafil në të dy anën e derës hyrëse janë të vendosur rafte për vendosjen e këpucëve. Këto rafte, meqenëse nuk dihet kur janë vendosur, le që nuk janë në harmoni me hapësirën e xhamisë, por janë krejt të panevojshme dhe i japin një imazh të keq xhamisë. Rafte të mjaftueshëm për këpucë ka në sasi të mjaftueshëm në aneksin e xhamisë, andaj mendojmë se raftet në brendinë e xhamisë nuk e kanë vendin aty.

Të gjitha këto që i cekëm, si orët, levat, elektrifikimi, zërimi, raftet, etj. s’ka dyshim se i nevojiten xhamisë, por mendoj që vendosja e tyre duhet të behët nën kujdesin e ekspertëve të trashëgimisë kulturore, dhe duke marrë parasysh të gjitha specifikat e objektit. Ta zëmë, xhamia ka një sistem të mirë të akustikës, zërimi duhet të bëhet në harmoni me akustikën e jo sipas dëshirës së ndonjë donatori, që ka qëllim të mirë e human, por veprimi i tij pa konsultim me ekspertë dëmton vlerat e xhamisë. Apo elektrifikimi dhe vendosja e llambadarëve

duhet të jetë në harmoni të plotë me sistemin e kandilave, e jo vendosja e tyre të bëhet pa asnjë kriter. Këtu po përmend vetëm vendosjen e një poçi të thjeshtë elektrik mbi qyrsi, le që nuk ka as një funksion, është i dëmshëm për ligjëruesin, por mënyra e vendosjes është e vrazhdët dhe krejt diletante.

Nga këto që thamë në këtë vështrim modest, u munduam që të trajtojmë tri elemente 1. historikun e xhamisë, 2. përshkrimin e xhamisë dhe vlerat që ka si në aspektin artistik, ashtu edhe në atë historik e arkitektonik, dhe 3. gjendjen në të cilën gjendet xhamia sot.

Siç e pamë, xhamia është objekti më i vjetër funksional në Prishtinë, është objekt me vlera arkitektonike e artistike, mirëpo gjendja dhe trajtimi i xhamisë nuk është në nivel të duhur e meritor. Mendojmë që institucionet për ruajtjen e trashëgimisë kulturore duhet që sa më parë të marrin masat e duhura dhe ta trajtojnë objektin sipas parametrave dhe standardeve që e meriton një objekt i shek. XV. Për këtë qëllim, është e nevojshme që të organizohen ekspedita studiuese kushtuar xhamisë, këtu duhet të jenë të pranishëm ekspertë të fushave të ndryshme, dhe në harmoni me vendimet që dalin nga studimi të merren masa të nevojshme restauruese apo konservuese.

Ndërsa shfrytëzuesi i objektit që është edhe pronari vetëm i saj (KBI), objektin duhet ta trajtojë me përgjegjësi dhe profesionalizëm, të paktën të mos ndërmarrin veprime që dëmtojnë atë dhe shkojnë kah shkatërrimi dhe shëmtimi i saj.

Literatura e konsultuar:

- Zija SHKODRA, Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare, Akademia e Shkencave e RSP të Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë 1984.
- Mr. Fejaz Drançolli, Disa ndërtime arkitektonike islame në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX; Feja kultura dhe tradita islame ndër shqiptar, Prishtinë 1995, fq. 167-174.
- Emin RIZA, Njazi HALITI, Banesa qytetare e Kosovës e shek. XVIII-XIX, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2006.

- Monumentet e Kosovës-Kosova Monuments, kryeredaktor Baki Svirca, Instituti për Mbrojtjen e Monumente të kulturës, Prishtinë 2004.
- Trashëgimia e evidentuar e Kosovës-Evidentiranih Spomenici na Kosovu-Evidences Monuments of Kosova, botim i përgatitur dhe i udhëhequr nga Dr. sc. Fejaz Drançolli, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Prishtinë 2005.
- Aleksadër MEKSI, Arkitektura e xhamive të Shqipërisë shek XV-XIX, UEGEN, Tiranë 2007.
- Husref REDZIC, Pet Osmanlijski Spomenika na Kosovi i Metohiji, Starine Kosova i Metohija, knjiga I, Pristina 1961, st. 97;
- Raif VIRMIÇA, Fatih Sulltan Mehmed Han Camii (Camii Kebir) 865/1460-1461), Kosova'da Osmanli mimarleri, Ankara 1999, sayfa 210-215.
- Mr. Tefik MORINA, Monumentet e Kulturës Islame në Kosovë dhe mbrojtja e tyre gjatë periudhës 1945-1992; Feja Kultura dhe Tradita Islame ndër shqiptarë, Prishtinë 1995, fq. 518-527.

Ramadan Shkodra

THE “SULTAN MURAT” MOSQUE (792h\1389) – THE OLDEST ISLAMIC MONUMENT IN PRISHTINA

(Summary)

I. Introduction

Historical and cultural sites bear witness to the past and to those who have built them. Works of art and architectural heritage provide us with important information about the past. Apart from determining the identity of a nation, they help us deepen our knowledge about culture and strengthen national awareness.

The cultural level of a certain nation is best shown by the way it treats its past.

The word “monument” (in its present-day meaning), among others, means architectural works, which have historical and cultural value, and are, as such, protected by law. This concept, as defined above, has been introduced in Kosova just recently.

رمضان شكودرا

جامع "سلطان موراد" (792هـ/1389)
أقدم معلّم إسلامي بمدينة بريشتينا

(خلاصة البحث)

مدخل:

إن التراث الثقافي و التاريخى يمثل أدلة دامغة و قوية عن الذين قاموا بهذا العمل العظيم أو بعبارة اخرى يمكن القول بأن التراث المعمارى هو شاهد عن الماضى و الحاضر و المستقبل.

إن القيم المعمارية إلى جانب أنها تشهد عن الهوية هي تقوم بتوسيع المعارف عن الماضى و تقوم بترسيخ الوعى القومى و الديني لأى شعب من الشعوب.

إن المستوى الثقافي لأى شعب من الشعوب يتمثل بأحسن صورة في تعامله مع الماضى الثقافي.

إن المصطلح "معلم" بمفهومه الحاضر يطلق إلى جوانب أخرى مثل الألمبانى المعمارية التي لها قيم تاريخية و ثقافية و هي عادة توضع تحت حماية القانين.

TRASHËGIMI

Mr. Sadik Mehmeti

TRANSMETUESIT E HADITHEVE DHE NUMRI I HADITHEVE TË TRANSMETUAR NË VEPRËN *“MASHĀRIQ ASH-SHARĪF”* (Sipas Trajtesës në dorëshkrim të Ejub Sabrit)

Në bibliotekën e pasur të gjyshit tim**,** ixhazetliut të shquar të medresesë *“Emin Pasha”* të Prizrenit, myderrizit të njohur, Hoxhës së Madh të Kukit të Opojës, *Mulla Mehmet efendi Ramadanit* (1876-1965)[1], **-** të cilën e ka lënë pas dhe e cila edhe sot e kësaj dite, ndonëse e shpërndarë dhe e përgjysmuar, fatmirësisht ruhet, gjejmë e lexojmë edhe këta tituj librash kapitalë disavëllimësh që u përkasin fushave të ndryshme: *‘Umda al-Qārī fī sharh Sahīh ‘l-Buhārī*, nga Badruddīn ibn Muhammad, i njohur me emrin ‘Ajni al-Hanafī; *Durrar ‘l-hukkām fī sharh Gurrar ‘l-ahkām*, e autorit Al-Qādī, i njohur me emrin Mullā Husrav Hanafī; *Ash-shifā* nga ‘Ali Al-Qārī; *at-Tarika al-Muhamadiyya*; *Mağmu’ l-Anhur fī sharh Multakā ‘l-abhur*, nga Damād efendiu, *Ihjā ‘Ulumuddīn* e Imām Gazālī-ut; *Tafsīr-i* i Hazīn-it, *Tafsīr-i* i Ibn

[1] Më gjerësisht për jetën dhe veprën e Mulla Mehmet ef. Ramadanit, shih punimin tonë: *Mulla Mehmet ef. Ramadani (1876–1965) -Hoxha i Madh i Kukit*, në: “Dituria Islame”, nr. 144-145, Prishtinë, 2001, f. 49-51.

Kathīr-it, *Tafsīr-i* Ğalālajn-eve, Fjalori persisht - osmanisht..., dhe vargu i librave vazhdon.

Ndër ata libra shekullorë, ata margaritarë të çmuar të kësaj biblioteke, në margjinat e të cilëve vazhdojnë të ruhen me besnikëri shumë shënime të shkruar me një kaligrafi shumë të mirë *“të pronarit dhe zotëruesit të tyre” (ar. sāhib wa mālik)*, siç e kishte zakon ta shkruante mulla Mehmeti dhe siç figuron e shkruar pothuaj në të gjithë librat e tij, përveç të tjerash, ruhet edhe një *Risāla*[2], një *Trajtesë* në dorëshkrim në gjuhën arabe, e cila, për shumë arsye, të cilat do t’i shënojmë më poshtë, ka tërhequr vëmendjen tonë posaçërisht, prandaj dhe e kemi marrë në shqyrtim.

E kemi marrë në shqyrtim sepse kjo *Trajtesë* është një studim origjinal, unikat dhe në dorëshkrim, që i është bërë veprës së mirënjohur “*Mashāriq al-anwār ‘alā sihāh (sahāyih) al-āthār”:* مشارق الانوار على (صحاح) صحايح الآثار , të autorit kadi Abū ‘l-Fadl ‘Iyād b. Mūsā al-Yahsūbī (vdiq më 544/1149)[3], dhe e cila ka të bëjë me përmbledhje (fjalor) të haditheve të të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s.. Kjo vepër është mësuar në po thuajse të gjitha medresetë e kohës dhe ka qenë mjaft e njohur ndër ulematë tanë. Ka njohur shumë komentime, më i njohuri ndër ta është komenti që i ka bërë ash-Shayh al-imām ‘Abdul-latīf b. ‘Abdul’azīz ash-shahīr bi ibn al-Malak, vdiq në vitin 797/1395[4], me titull *“Mabāriq al-Az’har fī sharh Mashāriq al-Anwār”* مبارق الازهار فى شرح مشارق الانوار

[2] *“Risāla”* është shprehja më e shpeshtë në titujt përbërës në gjuhët arabe, perse dhe turke. *“Risāla”* në përgjithësi shpreh *trajtesën, kumtesën, letrën, shqyrtimin. Haxhi Halifa* (Katib Çelebiu) thotë se *“risāla”* përmban një numër të vogël pyetjesh nga një fushë dhe se është paraparë për t’iu dërguar dikujt si letër. (Mustafā b. ‘Abdullāh, Hağğī Halīfa, *Kashf az-Zunūn ‘an asāmi al-kutub wa’l-funūn,* II, Istanbul, 1310/1892, f. 537. Kurse *Sami Bey Frashëri* thotë se *“risāla”* në esencë është libër i vogël në formë të letërqarkores, d.m.th. është përmbajtje e shkurtër për ndonjë pyetje a çështje shkencore. (Sāmī Bey Frāsherī, *Qamūs-i Türki*, Istanbul, 1317/1899, f. 662. Përkthimi më i shpeshtë i fjalës *“Risāla”* është *trajtesë*, siç e kemi përdorur dhe e kemi parapëlqyer edhe ne.

[3] Kasim Dobraća, *Katalog arapskih, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 2000, f. 295.

[4] Disa burime të tjera (Zarkalī, al-A’lam II, 542; Sarkis, M. al-Matbū’āt I, 252; Shadarāt VII, 342; Flügel, III, 87 dhe Brockleman në disa vende, datën e vdekjes së këtij autori e

Risāla e jonë, sikurse u tha, është e shkruar me dorë, me një kaligrafi shumë të bukur me llojin shkrimit arab *nas'h* jashtëzakonisht të mirë, korrekt dhe të lexueshëm. Fundi i tekstit është i shkruar me shkrimin *ta'līq* me elemente *nas'h*.

Ajo ka dimensione 18x12 cm, kurse teksti është i shkruar në formë tabelare. Ka gjithsej 10 faqe.

Kjo *Trajtesë* paraqet një studim përkitazi me numrin e transmetuesve të haditheve dhe numrin e haditheve të transmetuara në veprën "*Mashāriq al-anwār 'alā sihāh (sahāyih) al-āthār*", ose, siç njihet shkurt "*Mashāriq ash-sharīf*", sikurse shënon edhe në dorëshkrimin tonë dhe sikurse e kemi përdorur edhe ne në vazhdim.

Ky studim i përmbledhur në këtë *Risāla* merr vlera edhe më të mëdha kur kihet parasysh fakti se është shkruar në një kohë të hershme nga një autor i yni, është kopjuar gjithashtu nga një vendor, është shfrytëzuar nga ulematë tanë dhe, për dallim nga shumë vepra të dorëshkruara të autorëve tanë që kanë shkuar në pakthim, kjo është ruajtur dhe vazhdon të ruhet ndër ne. Është me interes edhe për faktin se tregon edhe përkushtimin dhe interesimin e njerëzve tanë për fjalët e të Dërguarit, Muhamedit a.s..

Në të vërtetë, ky studim në dorëshkrim, sikurse edhe shumë vepra të tjera, përligjin dhe forcojnë konstatimin se shqiptarët me përqafimin e fesë islame nuk u bënë vetëm praktikues të thjeshtë të saj, por ata u bënë edhe bartës dhe kultivues të mësimeve të kësaj feje, në radhë të parë të Kuranit dhe Synetit të Pejgamberit a.s., si burime fondamentale të fesë islame. Dhe jo vetëm kaq, por ata edhe i studiuan dhe i zhvilluan shkencat e këtyre dy burimeve, duke lënë vepra dhe studime që i tejkalojnë kufijtë lokal të vendeve ku u rriten dhe ku jetuan këta autorë.

Në anën tjetër, dëshira dhe respekti për Synetin e Pejgamberit a.s. tek shqiptarët u manifestua në mënyra të ndryshme, përmes së cilave u shpreh dhe prore vazhdon të shprehet dashuria, nderi dhe respekti

shënojnë gabimisht. Shih: Kasim Dobraća, *Katalog arapskih, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 2000, f. 322.

për Pejgamberin e tyre, për jetën e tij, për detyrat dhe mësimet e tija që ua ka lënë amanet.

Duhet theksuar faktin se, përveç veprës së sipërpërmendur, ndër shkollat islame të kohës janë studiuar, mësuar, kopjuar e shpjeguar edhe shumë vepra të tjera që kanë të bëjnë pikërisht me hadithet e Pejgamberit a.s. dhe me jetëshkrimin e tij. Në të gjitha bibliotekat e ulemave tanë të mëhershëm që i kemi vizituar dhe në institucionet që ruajnë vepra dhe dorëshkrime islame-orientale, përveç veprave/përmbledhjeve të hadithit, kemi gjetur edhe veprën *"ash-Shamāil-i Sharīf"* (الشمآئل شريف) të autorit Hāfīdh Abī 'Īsā Muhammad ibn 'Īsā bin Sawrat ibn 'Īsā ad-Dahāq as-Salamī at-Tirmidhī (vdiq më 279/892)[5], veprën "*Dalā'ilu 'l-hayrāt fī shawārik al-anwār*" (دلآئل الخيرات فى شوارق الانوار) të autorit Abū 'Abdullāh Muhammad b. Sulaymān al-Ğazūlī, vdiq më 870/1465[6], pastaj veprën e mirënjohur "*at-Tarīka al-Muhammadiyya wes-Sīra al-Ahmadiyya*", e shkruar më 980/1572, tek ne e popullarizuar me emrin الطريقة المحمدية "*at-Tarika al-Muhamadiyya*" të autorit Muhammad b. Pir 'Ali Bargilī (njihet edhe me emrat Birgawī ose Birğawī), jetoi midis viteve 929-981/1523-1573[7] dhe vepra të tjera, të cilat përshkruajnë biografinë e Muhamedit a.s. dhe të cilat kanë shërbyer si doracakë themelorë në medresetë e kohës.

T'i kthehemi *Risalā-së* sonë. Shtrohet pyetja: *Kush është autori kësaj Trajtese, kur është shkruar, kur është kopjuar, kush e ka kopjuar* dhe *pronë e kujt ka qenë?*

Disa të dhëna për këto pyetje i gjejmë, si rëndom, në vetë dorëshkrimin. Aty shkruan: "Këtë *Trajtesë* e ka shkruar Ejub Sabri (Ayyūb Sabrī), i cili ka qenë nxënës i Sejfuddin Fevziut (Sayfuddīn al -Fawzī), e ky nxënës i Hafiz Ahmed Ilhamiut (Hāfiz Ahmad Ilhāmī), e ky nxënës i shejh Rexhep Hulusiut (shayh Rağab Hulūsī), e ky nxënës i

[5] Kasim Dobraća, *Katalog arapskih, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 1963, f. 123.
[6] Fehim Nametak, *Katalog arapskih, turski, perzijskih i bosanskih rukopisa, svezak četverti*, London - Sarajevo, 1999, f. 42.
[7] Kasim Dobraća, *Katalog...*, svezak prvi, po aty, f. 458.

Ismail Haki efendiut (Ismā'īl Hakkī efendi), qofshin të gjithë të nderuar dhe shpirtit të tyre, - për hir të Allahut, - një Fatiha".

كتبه الحقير الفقير ايوب صبرى من تلاميذ سيف الدين الفوزى وهو من تلاميذ حافظ احمد الهامى وهو من تلاميذ الشيخ رجب خلوصى و هو من تلاميذ اسماعيل حقى افندى حضرتلرى ولجميع ارواحهم لله الفاتحة

Për autorin *Ejub Sabri* këtu nuk jepen të dhëna më shumë se kaq. Nuk jepen të dhëna as për mësuesit e tij dhe kjo mbetet një çështje për t'u hulumtuar, sepse kemi të bëjmë me personalitete sigurisht të dëshmuara në fushën e kaligrafisë dhe të shkencave islame.

Dhe ndonëse nuk mund ta themi me siguri, ne mendojmë se Ejub Sabri është *Sabri Xhemili* nga Prishtina, i cili, sipas Dr. Jashar Rexhepagiqit, kishte mbaruar fakultetin në Stamboll, ka qenë pedagog dhe drejtor në shkollën normale *Darul-mual-limin* (Dāru 'l-Mu'allimīn) në Shkup, drejtor dhe mualim i gjuhës turke në Idadinë e Shkupit, poet dhe autor i disa shkrimeve në gazetën *"Jeni mekteb"* nga fusha e pedagogjisë që botohej në vitet 1910-1912 në Shkup si dhe përkthyes i doracakëve nga gjuha frënge etj.[8].

Ç'është e drejta, Dr. J. Rexhepagiqi është i pari që e ka identifikuar këtë personalitet dhe i pari që ka bërë fjalë për të, ndonëse e përmend me emrin e dytë të tij, saktësisht me pseudonimin letrar të tij, mbase me të cilin ky autor edhe ka qenë më i njohur. Duhet pasur parasysh se në kohën për të cilën po flasim ka qenë traditë që dijetarët të kenë nga dy emra: emrin e vërtetë dhe pseudonimin letrar. Sido që të jetë, emri i plotë i autorit të *Trajtesës*, sipas vulës personale të vënë në diplomën (viti 1905) e studentit të "Darul-mualimin" në Shkup, *Sherif efendi Dautit*[9] nga Peja, është: *Ejub Sabri i biri i Xhemilit*

[8] Dr. Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu od kraja XVIII stoleća do 1918 godine*, Prishtinë, 1974, f. 38-39.

[9] Diploma e Sherif ef. Dautit ruhet në Arkivin e Kosovës, *Koleksioni i Muharrem Krasniqit*, nr. i inventarit 37, kutia nr. 1. Më gjerësisht për këtë shih: Mr. Sadik Mehmeti, *Disa të dhëna për mektebin iptidai të Vranocit të Pejës (1907-1911) dhe mësuesin Sherif ef. Dautin (1885-1932)*, në: "Vjetari i Arkivit të Kosovës", nr. 39-40, Prishtinë, 2008, f. 563-570.

(Ayyūb Sabrī b. Ğamīl) dhe jo *Sabri Xhemil*. Pra, ky autor emrin e vërtetë e ka *Ejub*, kurse *Sabri* është pseudonimi/mahlasi letrar i tij, ndërsa *Xhemili* është emri i babait të tij.

Vula/myhyri e Ejub Sabrit (mbi vulë: *mualimi i gj. turke në shkollën idadi.* Brenda në vulë: *Ayyūb Sabrī b. Ğamīl)*

Për mësuesin e Ejub Sabrit, *Sejfudin Fevziun* mendojmë se është Sejfudin Tosko i biri i haxhi Jakubit, shejh i melaminjve dhe udhëheqës i teqesë së melaminjve në Prizren në fillim të shek. XX. Sejfudin efendiu ka vdekur në vitin 1913[10] dhe është vëllai i *Mehmed Kamil Toskës*[11].

Mësuesi tjetër, *Rexhep Hulusiu* mendojmë se është njëri ndër të parët udhëheqës të rendit melami në Prizren, i cili hilafetnamenë e kishte marrë nga themeluesi i rendit të melaminjve në Kosovë, *Muhamed Nuri* (ka vdekur më 1887). Rexhep efendiu ka qenë shehu i dytë i teqesë së melaminjve në Prizren dhe *postneshin* (epror, udhëheqës) i saj në Prizren[12]. Ka qenë edhe imam në xhaminë e "Myderriz Ali efendiut" në Prizren[13]. Rexhep Hulusi ka vdekur më 1900/1901.

[10] Jashar Rexhepagiq, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, Pejë, 1999. f. 202-203.

[11] Mehmed Kamil Tosko ka lindur në Prizren më 1879, ku edhe ka kryer shkollën fillore dhe të mesme. Ka qenë një kaligrafist i vërtetë. Ka kopjuar shumë vepra dhe sidomos të Haxhi Ymer Lutfi Paçarizit. Është i njohur edhe si poet. Jashar Rexhepagiq, *Dervishët..., p*o aty, f. 201.

[12] Po aty, f. 201.

[13] Arkivi i Kosovës, *Dokumentet osmane*, të parregulluara.

Vula/myhyri e Rexhep Hulusit
(mbi vulë: *imam i Mëhallës Myderriz*. Brenda në vulë: *Rağab Hulūsī 1303/1885)*

Për mësuesin e Rexhep efendiut, *Hafiz Ahmed Ilhamiun*, nuk kemi ndonjë të dhënë, përveç faktit se ky alim, sikurse edhe mësuesi i tij, Ismail Haki efendiu dhe nxënësi i tij Rexhep efendiu, kanë qenë, përveç të tjerash, profesor të kaligrafisë dhe se emrat e tyre i gjejmë të shënuar në dy ixhazetname/diploma për kaligrafi, të cilat u janë lëshuar dy kaligrafistëve të tjerë në Prizren, *Hasan Husni efendiut* (e lëshuar në vitin 1302/1884) dhe djalit të tij *Osman Nuri efendiut* (e lëshuar në vitin 1321/1903)[14]. Të dhëna nuk kemi as për mësuesin e këtyre mësuesve, Ismail Haki efendiun.

Në anën tjetër, emrat e këtyre myderrizëve, mënyra dhe stili i shkrimit të kësaj *Trajtese*, na shtyjnë të nxjerrim përfundimin se Ejub Sabri, përveç si studim shkencore, këtë *Trajtesë* e ka paraqitur para myderrizëve të tij/komisionit vlerësues edhe si punim të diplomës në fushën e kaligrafisë, kurse më vonë, nga origjinali i saj, është bërë edhe kopja të cilën ne e kemi marrë në shqyrtim. Kopjimin ndërkaq e ka bërë djali i madh i Mulla Mehmed ef. Ramadanit të sipërpërmendur, Nafiu (1922-2005), i cili, sikurse shihet, ka qenë një kaligrafist i vërtetë dhe i kujdesshëm, i cili nuk e ka shënuar se kur e ka bërë kopjimin, sikundër që edhe Ejub Sabri nuk e ka thënë se kur e ka shkruar këtë *Trajtesë*.

[14] Një kopje e këtyre ixhazetnameve/diplomave ruhet në bibliotekën tonë personale.

Sido që të jetë, ky studim është me rëndësi për studiuesit e fushës së hadithit, jo vetëm për sa i përket anës historike, por edhe asaj përmbajtjesore dhe kjo tregon përkushtimin e ulemave tonë dhe interesimin e tyre për të njohur dhe studiuar sa më mirë jetën dhe veprën e Muhamedit a.s., tregon dashurinë ndaj haditheve dhe fjalëve të Pejgamberit a.s. dhe shkencës së hadithit në përgjithësi. Për më tepër, kjo *Risāla/Trajtesë* pasuron listën botërore të dorëshkrimeve islame-orientale dhe është nga veprat e para të kësaj natyre të shkruara nga autorët tanë, të cilave u bëhet një vështrim.

Për sa i përket indeksit të transmetuesve të haditheve dhe numrit të haditheve të transmetuara në veprën *“Mashāriq ash-sharīf”*, autori ynë, Ejub Sabri e ka dhënë në mënyrë tabelare, ku krahas emrit të transmetuesit është dhënë edhe numri i haditheve që ai ka transmetuar në këtë vepër, si dhe shkronja e parë me të cilën nis emri i transmetuesit.

Sipas këtij studimi të Ejub Sabrit, në vëllimin e parë të veprës *“Mashāriq ash-sharīf”* ka gjithsej 2.177 hadithe të transmetuar nga 120 transmetues të ndryshëm, kurse në vëllimin e dytë, ka 79 hadithe nga 50 transmetues. Kjo domethënë se në këtë vepër janë përfshirë gjithsej 2.256 hadithe nga gjithsej 175 transmetues.

Ndër ata që kanë transmetuar më shumë hadithe që janë përdorur në veprën *“Mashāriq ash-sharīf”*, është Ebu Hurejre r.a. me 642 hadithe të transmetuara, më pastaj Aishja r.a. me 184, Enes ibn Maliku r.a. me 176 e kështu me radhë, dhe kjo është kuptueshme kur dihet fakti se këta ashabë të Pejgamberit a.s. janë ata që më së shumti kanë transmetuar hadithe nga Pejgamberi a.s. në përgjithësi.

Në fillim të *Trajtesës*, është vënë ky shënim në gjuhën osmane:

مشاريق شريفك روايتلريدر بوراده تحريرات

Në fund të saj shkruan se pronar të kësaj *Trajtese* kanë qenë fëmijët e Mehmedit, d.m.th. fëmijët e Mehmed ef. Ramadanit të sipërpërmendur: صاحب محمد بنده لرى

Dhe në fund fare, si në margjina, është dhënë një hadith i Pejgamberit a.s., i cili, sipas autorit të *Trajtesës*, “përmendet në veprën e Kastalanit, vëllimi i shtatë, faqe 176”.

Në të vërtetë, Kastalani është komentuesi i njohur i *Sahīh ‘l-Buhārī*-ut, dhe emri i tij i plotë është Ahmad b. Muhammad al-Hatīb al-Qastalānī (vd. 923/1517), kurse vepra e tij quhet ارشاد السارى لشرح صحيح البخارى - *“Irshād as-Sārī li sharh Sahīh ‘l-Buhārī”*.

ان عثمان سأل النبى عليه السلام عن عدد الملائكة المتوكلين بالادمى فقال لكل ادمى
عشرة بالليل و عشرة بالنهار واحد عن يمينه و اخر عن شماله واثنان من بين يديه و من
خلفه و اثنان على جبينه واخرقابض على ناصيته فان تواضع رفعه و هن تكبر وضعه و
اثنان على شفتيه ليس يحفظان عليه الاالصلوة على محمد صلى الله عليه و سلم والعشر
يحرسه من الحية ان تدخل فاه يعنى اذا نام هذا مذكور فى قسطلانى جلد سابع صحيفة
١٧٦

Hadithi në përkthim thotë:

“Osmani r.a. njëherë e ka pyetur të Dërguarin a.s. për numrin e melaqeve që janë të obliguara për t’u përkujdesur për njeriun. I Dërguari a.s. i paskësh thënë: “Për çdo njeri përkujdesen dhjetë melaqe natën dhe dhjetë melaqe ditën, prej tyre një i qëndron në anën e djathtë dhe një në të majtën, dy i qëndrojnë para dhe mbrapa dhe dy anash, një tjetër kujdeset për trupin e tij dhe nëse ai (njeriu) tregohet modest, melaqja e ngre dhe e lartëson atë, e nëse tregohet mendjemadh, atëherë e ulë dhe e përdhos atë, si dhe dy melaqe i qëndrojnë në buzët e tij, të cilat nuk kujdesen për gjë tjetër veçse për të ruajtur (regjistruar) salavatet që ky i dërgon për Muhamedin a.s., kurse dhjetë melaqe të tjera e ruajnë atë nga bolla që të mos i hyjë në gojë, kur ai është duke fjetur.”

Në vazhdim po paraqesim *Risāla*-n/*Trajtesën* e Ejub Sabrit mbi transmetuesit e haditheve dhe numrin e haditheve të transmetuar në veprën *“Mashāriq ash-sharīf”*, ashtu siç i ka dhënë ai, pa bërë ndonjë

shënim plotësues. Po paraqesim gjithashtu edhe faksimilen e kësaj *Trajtese* në dorëshkrim.

Vëllimi i parë			
Nr. rend.	**INDEKSI I TRANSMETUESVE TË HADITHEVE NË VEPRËN *“MASHĀRIQ ASH-SHARĪF”***		**Numri i haditheve të transmetuara në këtë vepër**
1.	Ebu Hurejre r.a.[15]	E	642
2.	Zejd ibn Halid El-Xhuhniu	Z	7
3.	Ibn Abasi r.a.	E	89
4.	Ibn Ymeri r.a.	E	114
5.	Aishja r.a.	A	184
6.	Enes ibn Maliku r.a.	E	176
7.	Sehl ibn Seadi	S	21
8.	Ebu Musa r.a.	E	49
9.	Muammer ibn Abdullah ibn Nafi’u	M	2
10.	Ibn Mes’udi r.a.	E	28
11.	Seid ibn Zejdi	S	2
12.	Sead ibn Ebi Vekasi	S	30
13.	‘Adi ibn Hatimi r.a.	A	6
14.	Xhabiri r.a.	Xh	139
15.	‘Adi ibn Amirete r.a.	A	1
16.	Ebu Isa Abdurrhaman ibn Xheberi	E	1
17.	Selmani r.a.	S	5
18.	Vail ibn Haxheri r.a.	V	3
19.	Ebu Emame Ijas ibn Tha’lebe el-Harithi	E	5
20.	Sufjan ibn Ebi Zuhejri	S	2
21.	Osmani r.a.	A	15
22.	Burejdete ibn El-Hasibi	B	6
23.	Ubadete ibn Es-Samiti	A	5
24.	Semrete ibn Xhendebi	S	5
25.	Mugirete ibn Shu’bete	M	9
26.	Ebu Derda r.a.	E	10
27.	Thabit ibn Dahhaki	Th	1
28.	Ebu Seidi r.a.		

[15] Transkriptimin e emrave të transmetuesve të haditheve, për arsye praktike, nuk e kemi dhënë sipas standardit të transkriptimit (në gjuhët evropiane) ZDMG.

29.	Ebu Mes’ud Ukbete b. Omer el-Ensari	E	11
30.	Ebu Katade el-Harith ibn Rebi	E	18
31.	Safije binti Ebi Abejdi	S	10
32.	Ebu Dherr el-Gaffari r.a.	E	33
33.	Selmete ibn El-Ekvei r.a.	S	10
34.	Xheriri r.a.	Xh	12
35.	Ummu Seleme r.a.	E	3
36.	Ebu Ejubi r.a.	E	8
37.	Xhendeb ibn Abdullahu	Xh	6
38.	Ummu Habibe r.a.	E	3
39.	Imran b. Hasini	A	12
40.	Muadh ibn Xhebeli r.a.	M	3
41.	Thu’bani r.a.	Th	8
42.	Ukbete ibn Amiri	A	11
43.	Tarik ibn Eshimi	T	2
44.	Abdullah ibn Amri	A	37
45.	Err-Rrebia binti Muavidh b. Ifra’i	E	2
46.	Sebrete ibn Ma’bedi r.a.	S	2
47.	Abdurrahman ibn Ebi Bekri	A	1
48.	Esma binti Ebi Bekri	E	4
49.	Ebu Bekrete r.a.	E	11
50.	Fedalete ibn Ubejdi r.a.	F	1
51.	Umeri r.a.	A	41
52.	Huvlete binti Hakimi	H	1
53.	En-Nu’man ibn Beshiri	E	6
54.	Hudhejfete b. Esejid el-Gaffari	H	5
55.	‘Ubejje ibn K’abi r.a.	E	7
56.	Vathil ibn Esk’ai	V	2
57.	Xhabir ibn Semrete	Xh	8
58.	Zejd ibn Erkami	Z	5
59.	Sheddad ibn Evsi	sh	2
60.	Nu’man ibn Makreni	N	1
61.	Hisham ibn Hakim ibn Huzzami	H	1
62.	Mexhashi’a ibn Mes’udi	M	1
63.	Fatime binti Kajsi	F	4
64.	Mejmunete binti el-Harithi	M	3
65.	Hudhejfete Ibn el-Jemani	H	13
66.	Musevvir b. Muhremete	M	16
67.	Mervan ibn Hakemi	M	11
68.	Havlete binti Thamiri	H	1

69.	Ammar ibn Jaseri	A	3
70.	Amr ibn el-Asi	A	4
71.	Usame ibn Zejdi	E	15
72.	Rafi’ ibn Hadixh	R	4
73.	Ebu sherif el-Hazzai	E	3
74.	Aliu r.a.	a	21
75.	‘Aid ibn Umeri r.a.	A	2
76.	Muavije ibn Ebu Sufjani	M	3
77.	Zejd ibn Thabiti r.a.	Z	4
78.	Ebu Besir el-Gaffari	E	1
79.	Muavije ibn el-Hakemi	M	2
80.	Umer ibn Ummi Selemete	a	2
81.	Sulejman ibn Sardi	S	2
82.	Hafsa r.a.	H	3
83.	Ebu Hamidi r.a.	E	5
84.	Sherid ibn Suvejd Eth-Thekafi	Sh	3
85.	Es-Sa’b ibn Xhuthamete	E	2
86.	Arkame ibn Sherih	A	1
87.	Abdullah ibn Mugaffeli	A	5
88.	El-Egarr el-Mezzeni r.a.	E	1
89.	Ummu Atije r.a.	E	3
90.	Amr ibn ‘Isa	A	4
91.	El-Berrae ibn Azibi	E	17
92.	Xhubejr b. Mut’ami r.a.	Xh	8
93.	Zejneb binti Xhahshi	Z	2
94.	Ebu Beshir el-Ensarij	E	1
95.	Ebu Murreththed r.a.	E	1
96.	Ummul-Fadli r.a.	A	1
97.	Ebu Xhurrej el-Hexhemi	E	1
98.	Abdurrahman Ibn Semrete	A	2
99.	Abdulmutalib bin Rebi’a	A	1
100.	Ebu Talhate r.a.	E	1
101.	Zejneb binti Ebi Selmete	Z	1
102.	Ebu Berzete r.a.	E	4
103.	Avf ibn Maliku	A	5
104.	El-Mikdad ibn Esvedi	E	6
105.	Ebu Bekri r.a.	E	9
106.	Abdullah ibn Hishami	A	1
107.	Burdete bin Nejari r.a.	B	2
108.	Ummu Mubeshshiri r.a.	E	2

109.	Muti’a ibn Esvedi	M	1
110.	Ammar ibn Ru’je	A	1
111.	Ebu Esejjidi r.a.	E	1
112.	Osman ibn Ebi El-Asi	A	3
113.	Talha r.a.	T	3
114.	Malik ibn Xhuvejrithi	M	1
115.	Suhejb ibn Sinani	S	3
116.	Amir ibn Rebi’a	A	1
117.	Ebu Tha’lebe r.a.	E	1
118.	El-Abbas ammu en-Nebijj	E	5
119.	Zejneb binti Ebi Muavije	Z	1
120.	Abdullah ibn Zem’ate	A	2
121.	El-Mukdam ibn M’adi	E	1
122.	Mustevred El-Fehri	M	2
123.	Hisham ibn Amir el-Ensari	H	1
124.	K’ab ibn Ixhzete	K	2
125.	Muakkil ibn Jesari	M	3
Vëllimi i dytë i veprës “*Mashāriq ash-sharīf*”[16]			
126.	K’ab ibn Maliku	K	5
127.	J’ala ibn Umejje	J	2
128.	Abdullah ibn Zejd el-Ensarij	A	2
129.	Sehl ibn Hunejf r.a.	S	1
130.	Kabisate ibn Mehariku	K	2
131.	Hakim ibn Huzzami	H	4
132.	Ez-Zubejr ibn El-Avvami	E	3
133.	Abdullah ibn Ebi Evfi	A	3
134.	Abdullah ibn Serxhese	A	1
135.	El-Musejjib ibn Huzni	E	2
136.	Ummu Halid binti Se’id ibn el-Asi	E	2
137.	Esma binti ‘Amis	E	1
138.	Malik ibn S’as’ati	M	1
139.	Ebu Xhuhejm Abdullah ibn El-Harithi	E	1
140.	Ummul-Hasini r.a.	E	2
141.	Muajkib ibn Ebi Fatimete	M	1
142.	Ummu Harram binti Mulhani	E	3

[16] Në përfundim të vëllimit të parë janë shënuar emrat: *All-llah xhel-le xhelaluhu, Muhammed alejhis-selam, Ebu Beker es-Siddik, Ymer el-Faruk, Osman dhun-nurejni; Ali kerremall-llahu vexhhehu, Hasan radijall-llahu anhu dhe Hysejn radijall-llahu anhu.*

143.	Ummu Hani binti Ebi Talibi	E	1
144.	Xhuvejrije binti el-Harithi	Xh	2
145.	Habab ibn El-Erithi	H	2
146.	Xhuddamete binti Vehbi	Xh	1
147.	En-Nuvas ibn Sem’ani	E	2
148.	Ebu Rafi’ mevla Resulul-llah	E	1
149.	Ebu Seid ibn el-Muali	E	1
150.	Temim ed-Dari r.a.	T	1
151.	Ebu Malik el-Eshari	E	2
152.	Malik ibn Behinete	M	1
153.	Harith ibn Vehb el-Hazza’i	H	2
154.	Ebu El-Lejthi r.a.	E	1
155.	Fatimetu ez-Zehra r.a.	F	1
156.	Abdullah ibn Xh’aferi	A	1
157.	Safije binti Hajji	S	1
158.	Mu’in ibn Jezidi	M	1
159.	Abdullah ibn Selami	A	4
160.	Amr ibn Th’alebe	A	1
161.	Handhale El-Es-Sejjidi	H	1
162.	Katade ibn Nu’mani	K	1
163.	Nafi’ ibn Utbete	N	1
164.	Abdullah ibn Shuhejri	A	1
165.	Urvete ibn Ez-Zubejri	A	3
166.	Amr ibn Avfi	A	1
167.	Nebishete El-Hedheli r.a.	N	1
168.	Ummu Kajs binti Muhsini	E	1
169.	Abdurrahman ibn Avfi	A	1
170.	Ukbete ibn el-Harithi	A	1
171.	Ebu Ubejdete el-Xherrahi	E	1
172.	Hamza ibn Umer el-Eslemi	H	1
173.	‘Ijad bin Hammar r.a.	A	1
174.	Ummu Selim binti Melhani r.a.	E	1
175.	Abdullah b. ez-Zubejr ibn el-Avvami	A	1



Mr. Sadik Mehmeti

HADITH TRANSMITTERS AND THE NUMBER OF HADITHS TRANSMITTED IN “MASHĀRIQ ASH-SHARĪF”

(Summary)

Among the various books in my grandfather’s library, *Mulla Mehmet effendi Ramadani* (1876-1965), who was a distinguished ijazah of the “*Emin Pasha”* Madrassa in Prizren, a distinguished muderiz and a hodja in the village of Kuki (Opoja), we can also find many volumes of very important books: *‘Umda al-Qārī fī sharh Sahīh ‘l-Buhārī*, by Badruddīn ibn Muhammad, also known as ‘Ajni al-Hanafī; *Durrar ‘l-hukkām fī sharh Gurrar ‘l-ahkām*, by Al-Qādī, also known as Mullā Husrav Hanafī; *Ash-shifā* by ‘Ali Al-Qārī; *at-Tarika al-Muhamadiyya*; *Mağmu’ l-Anhur fī sharh Multakā ‘l-abhur*, by Damād effendi, *Ihjā ‘Ulumuddīn* by Imām Gazālī; *Tafsīr* Hazīn, *Tafsīr* Ibn Kathīr, *Tafsīr* al-Jalalajn, Persian – Ottoman dictionary, etc.

صادق محمد

رواة الاحاديث و عدد الاحاديث في كتاب "مشارق الشريف"

(طبقا لما جاء بمخطوطة أيوب صبرى)

(خلاصة البحث)

في المكتبة الغنية لجدى رحمة الله عليه العالم المشهور بمدرسة "أمين باشا" بمدينة بريزرن، و المدرس المعروف و الامام المشهور بقرية كوكي بمدينة "أوبويا" ملا محمد افندى رمضانى (1876–1965) و التي بقيت محفوظة برغم من انها ناقصة نقرأ بها هذه الاسماء للكتب القيمة و الكبيرة التي تتكون من عدة أجزاء، مثل: عمدة القارئ شرح صحيح البخارى و مؤلفه بدرالدين بن محمد و المعرف باسمه عين الحنفيي، "درر الحكام في شرح غرر الاحكام" و مؤلفه القاضى و المعرف باسمه ملا حسرف حنفي، و كتاب "الشفاء و مولفه على القارئ، و الطريقة المحمدية، "مجمع الانهر في شرح ملتقى الابحر" و مولفه دماد افندى، "أحياء علوم الدين" للامام الغزالي و تفسير للخازن و تفسير إبن كثير و تفسير الجلالين و القاموس عثمانى – فارسى و هناك كتب أخرى لاحصر لها.

PSIKOLOGJI

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi

PSIKOLOGJIA E TË SË MIRËS DHE TË SË KEQES NGA ASPEKTI KUR'ANOR DHE SHKENCOR

A thua, edhe këtë kemi mundur ta bëjmë? Si nuk kemi ditur? Çfarë na ka penguar që në tërësi të zhvillojmë potencialet personale? Çfarë më ka frikësuar në meditim më të thellë?! - këto janë vetëm disa prej pyetjeve të cilat do të tingëllojnë në kokën e njerëzve atë ditë kur bien perdet e iluzioneve nga sytë.

Njëra prej gjërave më të rënda në botën tjetër do të jetë njohuria e njeriut për mosshfrytëzimin e potencialit shumë të madh mendor, i cili ka qenë i fshehur me mjeshtri prapa teknikave jo të zotëruara mendore si dhe lënien anash të shpirtit në rrënjët e negatives, të cilin e ka ngufatur bota e robëruar. Këtë dëshpërim do ta përjetojë edhe i varfri, i cili tek pas kalimit nga kjo botë do të kuptojë se gjatë tërë jetës së tij të mjerë nën dërrasat e kasolles së tij kanë qenë të fshehur margaritarët më të çmuar, të cilët nuk ka mundur t'i arrijë.

Allahu i Madhërishëm në Kur'anin fisnik urdhëron e thotë:

***"Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj,** (të keqen) **ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt".** (Fussilet, 34)*

Ky verset kuranor qartë thekson se e mira dhe e keqja janë kategori të ndryshme si dhe ekziston luftë e përhershme mes të mirës e së keqes.

Verseti kuranor, gjithashtu, trajton të përditshmen njerëzore në një mënyrë reale duke skicuar ekzistimin e armiqësisë mes njerëzve si një gjë të rëndomtë.

Meqë ky fakt i qartë i formave të ndryshme të armiqësisë mes njerëzve është një konstantë historike, atëherë Kur'ani fisnik i qaset këtij fenomeni në mënyrë delikate.

***"...Andaj,** (të keqen) **ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt".** (Fussilet, 34)*

Përmbajtjet në zemrat dhe mendjet tona jo vetëm që mund t'i ndryshojmë detajet e fizionomisë sonë sikur vijat e fytyrës apo ngjyrën e flokëve, por gjithsesi kontribuojnë edhe në atmosferën e tërësishme të shoqërisë, ku jetojnë, dhe këtë me llojin e energjisë, e cila rrezaton nga ne duke vërshuar mjedisin tonë.

Nëse ne në shumë forma të vogla të së keqes së përditshme të mjedisit, zemërngushtë përgjigjemi me të njëjtën masë d.m.th. me të keqe, ne bëhemi reflektorë të thatë të energjisë së huaj dhe kontribuojMë forcave të së keqes në përhapjen e tyre.

Me fjalë tjera, nëse në zili reagojmë me zili, në xhelozi, me xhelozi, në të keqe, me të keqe, etj. Ne pajtohemi me rolin e pjesëve të caktuara të pasqyrës pa vetëdije, e cila reflekton elementet me të cilët ballafaqohemi, duke shprehur në mënyrë pasive imazhin e shtrembëruar të botës.

Allahu i Madhërishëm, njeriut ia tërheq vërejtjen për rrezikun e lëshimit të pasioneve të ulëta të njeriut në vibracionet e trurit, andaj këshillon, në versetin e cituar në fillim, në kthimin e së keqes me të kundërtën e saj. Me këtë arrihen shumë dobi.

Njeriu demonstron humanizmin e tij përmes përzgjedhjes dhe vendosmërisë së tij, duke mbajtur të drejtën e tij, të bëhet ndryshe nga mjedisi dominues.

Me kthimin me të mirë në forma të ndryshme të së keqes së përditshme pasive, njeriu mbron qenien e tij nga mendimet negative dhe ndjenjat, duke u larguar në këtë mënyrë nga ngufatja në atmosferën e ndotur të urrejtjes, hakmarrjes, xhelozisë, gjegjësisht nga elementet që frenojnë zhvillimin e shëndoshë të individit;

Mënjanon racionalizimin e sjelljeve të padëshiruara personale;

Ndërpritet zinxhiri i negatives dhe kështu tjetri mësohet me bisedë dhe veprim kualitativ;

Njeriu lëshon një kozmos të errët të marrëdhënieve ndërnjerëzore;

Forcon shpirtin dhe intelektin individual, ngase çdo fitore kundër pasioneve të ulëta pasuron pushtetin subtil dhe ndjenjën e fitores;

Njeriu në këtë mënyrë sillet në përputhshmëri me para-materien (ujin) nga i cili u krijua, e jo në nivelin e zjarrit që i takon llojit njerëzor.

Një prej bukurive të Kur'anit fisnik qëndron në atë që i thyen iluzionet në copëza. Krijuesi i botëve edhe pse ofron një program praktik konkret për destruksionin e negatives, që ngulfat njerëzimin, nuk lëshon pa e theksuar me precizitet një nuancë në llojin e miqësisë, të cilën e arrijmë duke e kthyer të keqen me të mirë.

Kjo nuancë vërehet në shprehjen origjinale kuranore: *ke ennehu velijjun hamim d.m.th. si me qenë mik i sinqertë (intim, i afërt, i dashur).*

Metoda e kthimit të së keqes me të mirë vepron në realitet në dy kahe. Në mënyrë preventive për vete dhe në mënyrë regjeneruese për të keqin, i cili bie në mat pozicion me potezin e papritur, duke marrë rolin e ri sikur të jetë mik i ngushtë - i afërt.

Sa i rëndësishëm është ky proces dhe jo krejtësisht i thjeshtë dhe i lehtë, Allahu i Madhërishëm thekson në versetin kuranor vijues:

“Mirëpo, këtë nuk mund ta arrijë askush, pos atyre që janë të durueshëm, dhe nuk mund ta arrijë askush, pos atyre që kanë virtyt të lartë”. *(Fussilet, 35)*

Kur Allahu i Plotfuqishëm diç e quan të madhe, atëherë kjo ka supervlerë dhe meriton secilin atom të vëmendjes sonë.

Metoda e kthimit të së keqes me të mirë, bart dobi të madhe psikologjike për atë që e praktikon d.m.th. e begaton individin me kënaqësi të brendshme produktive për shkak të aftësisë së neutralizimit të keqes duke i dhënë predispozita të paparapara për zhvillim intelektual dhe shpirtëror.

Por, këtë e cila me të madhe varet nga fuqia e durimit mund të arrij vetëm shpirti i butë dhe intelekti subtil.

Këtu është me rëndësi të theksohet që islami nuk preferon pacifizmin e thatë dhe as kthimin e faqes tjetër për pranimin pasiv të goditjes kur është në pyetje nderi, feja, jeta, pasuria, shteti, etj.

Aisha r.a. transmeton që Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Përqeshni satirat e Kurejshëve, sepse kjo u vjen më rëndë se goditjet me shtiza”. (Muslimi)

Muhammedi a.s. e ka pasur poetin e tij Hasan bin Thabitin, të cilin e përdorte në luftën psikologjike - verbale kundër kurejshëve.

Kur Pejgamberi s.a.v.s. e ftonte Hasanin për t’u përgjigjur në konstruksionet gjuhësore të armikut, ai thoshte: *“Tani është koha ta thirrni këtë luan, i cili godet me bisht fuqishëm”*.

Aisha r.a. ka thënë: “Kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s.: *“Hasani i ka nënçmuar me ironi dhe i ka kënaqur besimtarët dhe veten”. (Muslimi)*

Myslimani duhet të jetë më i butë se trëndafili dhe më i fortë se guri dhe në bazë të vlerësimit personal të vendosë cilën anë të medaljes do ta tregojë në situata të caktuara. Në mjedisin armiqësor (sikur tek ne), nuk kalon imazhi i njeriut të butë, i cili mezi i flet 30 fjalë në minutë, han fasule thatë dhe flenë i qetë pasi që beson që për betejë nevojiten dy veta. Në këto vende është më mirë të kultivojmë imazhin e personit që di p.sh. 300 fjalë në minutë, ha mish të ..... dhe përballon me trimëri goditjet e mjedisit.

Mbrojtja nga iluzionistët

Në vijim Krijuesi i Gjithëdijshëm emërton edhe pengesën kryesore në rrugën e arritjes së kësaj lumturie të madhe, duke na mësuar të notojmë nëpër rrjedhat negative të jetës:

“E nëse ty të ngacmon ndonjë ngacmim prej djallit, ti kërko mbrojtje prej Allahut, se vërtet Ai është dëgjuesi, i dijshmi!” *(Fussilet, 36)*

Iblisi me pasuesit e tij vepron ditë e natë. Që nga momenti i kundërvënies së njeriut, nuk ka pasur dhe nuk do të ketë paqe në këtë luftë shumë shekullore, ndërsa ai vetes i ka dhënë detyrë t'i infektojë njerëzit me mendime të këqija dhe ndjenja të ulëta, duke lëshuar potencialin njerëzor në shkallë të ulët. Veprimi i tij, pa dyshim nuk është sporadik, por me një sistem të qartë, arma e të cilit më e shpeshta është vesvesja d.m.th. konstruksioni gjuhësor që ka për qëllim të përçajë të ekstravertët dhe t'i pasivizojë introvertët, duke i futur të parët në betejë, ndërsa të dytët duke i lënë pasiv në margjinat e shoqërisë. Në këtë mënyrë Iblisi fiton në hapësirë dhe nuk ka kundërshtarë të vërtetë në luftën të cilën e udhëheq me precizitet. Nga konstruksionet gjuhësore (vesvese) të tij, askush nuk është tërësisht i kursyer, ndërsa njerëzit më së shpeshti i njohin në dialogët e brendshëm personalë në formë mendimesh të përcjella me frikë apo me pikëllim (depresion) të thellë.

Kjo frikë irracionale sjell njerëzit në shumë vlerësime të këqija, të cilat shkaktojnë gabime seriale, ndërsa pikëllimi i thellë pasivizon njerëzit duke iu shkapërderdhur dëshirën dhe elanin e tyre për jetë në molekula të imta të shkumës detare.

Iblisi shumë shpesh shfrytëzon njerëzit nga rrethi ynë dhe nëpërmes gojës së tyre mundohet që gjeneratat në zhvillim t'i infektojë me frikësime irracionale, duke hedhur në veshët e tyre konstruksione gjuhësore, të cilat do ta tronditin vetë besimin duke i argëtuar me dilema të rrejshme apo duke i vënë thjesht në gjumë. Ky mjeshtër i iluzioneve dhe gënjeshtrave i ka zhvilluar teknikat e mashtrimit deri në ni-

velin e vetëmbrojtjes d.m.th. kur nuk është imun në gënjeshtrat personale.

“(Iblisi) ***Tha: “Për shkak se më humbe mua, unë do t'u ulem atyre*** *(do t'u zë pusi)* ***në rrugën Tënde të drejtë”.*** *(El A'raf, 16)*

Iblisi në versetin e cituar i drejtohet Krijuesit në mënyrë interesante duke zgjedhur fjalët: **“Për shkak se më humbe mua”,** zbulon qartë mënyrën me të cilën funksionon aparati i tij kognitiv. Pra, Iblisi, nuk u mallkua për shkak të një fjale që e tha me lehtësi, por për shkak të mënyrës tërësisht destruktive të menduarit, përplot racionalizëm subjektiv të sjelljeve personale, projektimit të padrejtë të dobësive tek të tjerët dhe ngjashëm. Të gjithë këta mekanizma mbrojtës me të cilët shërbehet e bëjnë të pamundur dhe të pakuptueshëm.

Gjithmonë duhet studiuar me kujdes fjalët e Iblisit, të cilat i thotë, e të cilat Krijuesi me precizitet i dokumenton në Kur'an.

Këto argumente zbulojnë mënyrën e të menduarit që mund të jetë i përfaqësuar tërësisht në kokën e secilit person, bile edhe praktikantit të rregullt të islamit, e që ai nuk është fare i vetëdijshëm.

Jo rrallë ndodh, që njeriu imazhin e jashtëm e interpreton në përputhshmëri me gjendjen e tij psikike (shqetësimin), dhe projekton imazhin e brendshëm të tij në faktorët e jashtëm duke racionalizuar në këtë mënyrë veset negative personale. Dhe mu kjo është ajo që e bëri Iblisi, për të cilën jemi të informuar nga verseti i mëparshëm d.m.th., subjektivisht e akuzoi Allahun e Madhërishëm që Ai ka shkaktuar dobësinë dhe gabimet e tij **(Për shkak se më humbe mua),** kështu arsyeton të këqijat e tija (...me siguri do t’u zë pusi...), për ta ruajtur paraqitjen narcisoide për vete me çdo kusht.

Shumë njerëz kalojnë nëpër të njëjtin proces për çdo ditë. Me fjalë tjera këta duhet të gënjejnë vetëdijen e tyre për të bërë krime. P.sh. shumë serbë, para vrasjeve, masakrimeve dhe dhunimeve në Bosnje dhe Kosovë, kanë bindur veten se nëse nuk i bëjnë këto gjëra, të tjerët do t'ua bëjnë atyre dhe kështu kanë gënjyer vetëdijen e tyre për ta ruajtur imazhin e tyre kinse janë një popull normal me sjellje normale.

Shembullin e serbëve mund ta krahasojmë me shembullin e Iblisit, për të parë sa kanë cilësi të përbashkëta në sjelljen e tyre. Edhe Iblisi,

sikurse shumica e serbëve, janë detyruar të gënjejnë për ta ruajtur imazhin e lartë për personalitetin e tyre. Iblisi mosbindjen e tij ndaj Allahut të Madhërishëm e arsyeton p.sh. me të metat e Ademit a.s. si krijesë nga balta:

“...A t'i bëj sexhde atij që e krijove nga balta?” *(El Isra, 61)*

Por, në realitet, ky arsyetim ishte vetëm pretekst prapa të cilit fshihej narcisoizmi i tij dhe bindja personale që është i përkryer dhe me këtë jashtë çdo kritike. Nëse një profil i këtillë i personave pranojnë se një pjesë e personalitetit të tyre është për t’u kritikuar, atëherë vetëdija e tyre do t'i shtynte të ndryshonin, por meqë procesi i ndryshimit të personalitetit është mjaft i gjatë dhe i dhembshëm, atëherë ata shërbehen me metoda të ndryshme të racionalizmit si sedativ për kontroll dhe vënie në gjumë të vetëdijes së tyre personale. Për këtë mund të themi se secili person pa vetëkritikë të shprehur, është i ekspozuar rrezikut nga ndryshimet patologjike të psikes.

Mu për këtë Kur'ani potencon si shembull më eklatant të keqen e Iblisit, duke na pasqyruar bindshëm proceset e tij mendore si rrënjë e fatkeqësive dhe anomalive shoqërore. Dhe natyrisht, ndryshimi mes miqve të Allahut dhe pasuesve të Iblisit nuk është aq në pamje sa në mënyrën e të menduarit, i cili formëson realitetin e brendshëm dhe të jashtëm të njeriut. Këtë ndryshim e njohim qoftë në marrjen e përgjegjësisë për gabimet tona, me vetëkritikën reale, me gatishmërinë për ndryshime pozitive, pa marrë parasysh moshën dhe mjedisin, ose në anën tjetër, nëpërmes ikjes nga realiteti, racionalizmi, ngatërrimi i shkaqeve dhe pasojave, hakmarrjes së padrejtë, forma të ndryshme të vetëmbrojtjes etj.

Energjia negative në pusi

Të jesh mysliman apo myslimane nuk do të thotë të shkosh përreth duke bërë vepra të mira, por të kesh vizion të qartë dhe afatgjatë dhe cak me rol personal të kuptuarit qartë për vendin dhe kohën ku jetojmë.

Aspekti moral dhe humanitar i islamit është vetëm një segment që fisnikëron mozaikun e personalitetit islam, i cili është jo komplet nëse ky mozaik nuk është i kompozuar me harmoni në një imazh të madh historik me role konstruktive të qartësuara.

Në atë moment kur ummeti u bë përmbledhje e njerëzve indiferentë të preokupuar me shpëtimin individual pa vetëdije kolektive proaktive, e cila nënkupton gabimet historike personale si dhe gatishmërinë që krahas me këtë kuptim të ndryshohen - myslimanët kanë përfunduar si gjah i copëtuar në barqet e ujqve kolonialë botërorë.

Ebu Dherri r.a. transmeton që Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: *“Ju do ta pushtoni Egjiptin. Ai vend shërbehet me hirat. Kur ta pushtoni silluni mirë me banorët e tij, sepse ata kanë të drejtë në mbrojtjen e lidhjes familjare. Por, kur sheh se aty dy njerëz kacafyten për vendin e vendosjes së tjegullës, largohu nga ai vend”.*

Ka thënë (Ebu Dherri r.a.): *“Kam parë Abdurrahman b. Shurahbil b. Hasenin dhe vëllanë e tij duke u zënë për vendin e vendosjes së një tjegulle dhe e kam lëshuar Egjiptin”. (Transmeton Muslimi)*

Hadithi i cituar gufon me urtësi dhe udhëzime, e ne me këtë rast do ta vendosim nën llupë.

Ajo që bie veçanërisht në sy është mënyra me të cilën Pejgamberi s.a.v.s. i ka sensibilizuar bashkëkohësit e tij duke u tërhequr vëmendjen, në shikim të parë në një fenomen të parëndësishëm duke i udhëzuar në aksione konkrete.

Reformatorë të vërtetë nuk ka pa sensibilitet të stërholluar, të cilët vërejnë lëvizjet më të vogla në shoqëri dhe krahas kësaj veprojnë me kohë dhe në mënyrë konstruktive. Pejgamberi s.a.v.s. informon Ebu Dherrin r.a. që gjenerata e tij në të ardhmen e afërt do ta pushtojë një

shtet të ri, e përkujton për të drejtat e banorëve të atij shteti dhe ia kushtëzoi lëshimin e saj kur sheh një fenomen interesant.

Pyetjet që duhet parashtruar në këtë rast janë:

Përse është problematik fenomeni i dy njerëzve që zihen për vendin e një tjegulle?

Përse ky fenomen është i rrezikshëm deri në këtë shkallë që Pejgamberi s.a.v.s., e këshillon Ebu Dherrin r.a. që të largohet në mënyrë radikale nga vendi ku jetojnë këta dy njerëz?

Hadithi qartë udhëzon në rrezikun nga njerëzit të cilët imponojnë tema margjinale dhe krijojnë nga këto çështje të mëdha.

Dëmi i cili fshihet në këtë qasje jetësore udhëzon në mosekzistimin e qartë të vizionit përmbledhës te këta njerëz.

Gatishmëria e tyre në imtësia, rreth temave të cilat nuk kanë asnjë vlerë kreative, deri te kundërthëniet e rënda tregojnë në shpirtrat e mbyllur dhe të dezorientuar që përhapin energji negative në përputhshmëri me nivelin mizeral të vibracioneve të tyre trunore. Çdo përpjekje jashtë institucionale i ngritjes së nivelit të menduarit dhe interesimit të tyre është i gjykuar në mossukses. Temat e vdekura janë sikurse topi i vdekur në tenis, i cili bie pas rrjetës dhe këshillohet lëshimi i tyre me qëllim të kursimit të energjisë, e cila nuk ka perspektivë.

Paraqitja e njerëzve që merren me tema margjinale janë shenja që tregojnë në ekzistimin e katastrofës më të madhe dhe ndaj saj duhet sjellë sikurse ndaj idesë së ndërtimit të shtëpisë buzë greminës.

Katastrofa e tërë situatës rrjedh nga gërshetimi i gabuar i diagnozave të vendosura, mosekzistimit të vizionit të qartë, mosshfrytëzimi i situatës dhe humbja e kohës kolektive dhe potencialit.

Rezultat i këtij gërshetimi është pashpresa, dëshpërimi, izolimi, skepticizmi, misticizmi dhe shumë forma tjera të pa mendjes.

Konkludim

Metoda e kthimit të së keqes me të mirë, në kontekstin e marrëdhënieve ndërmyslimane, zbut armiqësinë mu sikurse gjellëbërësi, i cili me mjeshtëri i shton gjellës një sasi të caktuar të sheqerit, pasi që më parë i ka shtuar uthull, dhe në këtë mënyrë e zbut ashpërsinë e saj, i harmonizon të gjithë elementet e tenxheres në specialitet, i cili ka shije të mirë, ushqen dhe të bën të lumtur.

Këndi për meditim

Meqë peshorja kuranore për suksesin e njeriut është përmbledhur në versetin:

“Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten”. *(Esh Shems, 9)*

1. Si ta ruani shpirtin tuaj nga negativizmat bashkëkohorë?
2. Si ta pastrojmë shpirtin tonë nga mëkatet?
3. Në çfarë mënyre dini në mënyrë të drejtë të definoni konkretisht armikun në vend dhe kohë ku jetoni dhe nga e keni filluar këtë luftë?
4. Në çfarë mënyre revitalizoni vlerat islame dhe ku i shihni në mënyrë konkrete frytet e punës suaj?
5. Çfarë bëni në diskreditimin e filozofisë perëndimore dhe margjinalizimin e ndikimit të saj negativ kulturor?
6. A mendoni se ende vetëm hoxha (kleriku) ka të drejtë dhe ka rol ekskluziv të shpjegimit të islamit dhe athua respekti juaj është aq i ulët sa pa krenari dhe turp lejoni që në mes jush dhe burimit - islamit keni terxhuman (përkthyes) në të cilët bazoheni mu sikur invalidi që mbështetet në thupra të shtrembëruara?
7. Nëse ndiheni që imamët tuaj të patalentuar dhe të përgjumshëm çdo xhuma iu malltretojnë nga mimberi me konstruksione gjuhësore të privuara nga cilësitë analitike dhe aftësi komparative, iu marrin kohën tuaj të vlefshme duke iu shpjeguar në detaje datat e njohura historike, pa qartësi për nxitjet e mjedisit dhe kohës në fazën kon-

krete, si do të silleni në këtë lloj dëmi duke respektuar metodën e kthimit të së keqes me të mirë?

8. A mendoni se duhet ndryshuar imamët apo xhemati?

Përgjigjet tuaja i presim sa më shpejt.

Literatura:

1. Sherif Ahmeti: Kur’ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe.
2. Terry F. Pettijohn: Psikologjia - Një hyrje koncize, Prishtinë, 1997.
3. Prof.dr. Pajazit Nushi: Psikologjia, Prishtinë, 2001.
4. Dale Carnegie: Psikologjia e suksesit, Prishtinë, 2003.

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi

THE PSYCHOLOGY OF GOOD AND EVIL – QUR’ANIC AND SCIENTIFIC ASPECT

(Summary)

How come that we were not aware of the extraordinary things we were capable of doing? What hindered us from fully developing our personal potentials? What was it that prevented us from deeper contemplation?! – These are just some of the questions that will resound in the heads of people the day the curtains of illusion fall.

One of the most difficult things to deal with (in the afterworld) will be the knowledge that we did not fully use our brain’s potential, which was skillfully hidden behind the mental techniques that have not been mastered as well as the disregarding of the soul. Similar will be the desperation of a poor person who dies and realizes that during his whole life (which was spent in misery) he was sleeping over a treasure trove (that he did not find).

علي الياسي

علم النفس للخير و الشر في إطار القرآن الكريم و العلم

(خلاصة البحث)

هل كان بإمكاننا أن نفعل هذا؟ كيف لم نفعل؟ ماذا منعنا من تطوير الكفائة الشخصية؟ ماذا خوفنى لاتأمل الكثر؟ هذه هي بعض التساولات التي سوف تثار عندما يواجهون الناس الاحقيقة أمامهم.

إن من أصعب القضايا إلتي سيواجه الناس في العالم الأخر سوف تكون عدم استقلال الانسان لملكة تفكيره الواسعة و وقوعه تحت تأثير نفسه اللوامة. و سوف يحس بهذا الحزن حتى الرجل الفقير الذي كان قابعا بين أخشاب كوخه و كان بإمكانه أن يكون ثريا.

و الله سبحانه و تعالى يقول في القرآن الكريم: "وَلاَ تَسْتَوِي الْحَسَنَةُ وَلاَ السَّيِّئَةُ ادْفَعْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ حَمِيمٌ".

Dr. Naceur Jabnoun

ISLAMI DHE MENAXHMENTI - (2)

Misioni

Në këtë kapitull do të prezantojmë misionin e përgjithshëm të muslimanëve ashtu siç konturohet në mësimet kuranore. Pastaj, janë prezantuar mësimet që një organizatë mund t'i marr nga ky mision.

Misioni është definuar si "biznesi" në të cilin është një organizatë.[1] Në përgjithësi, misioni është më tepër formulim i qëndrimit, pikëpamjes dhe i orientimit si formulim i hollësive dhe i qëllimeve të matshme.[2]

Formulimi i misionit, në përgjithësi përfshin produktin apo shërbimin, tregun dhe llojin e operimeve të përvetësuara nga një firmë.

King dhe Kleland[3] kanë konturuar objektivat vijuese të një misioni të definuar:

1. Sigurimi i njëzëshmërisë së qëllimit brenda organizatës.

[1] Cleland and King, "System Analysis and Project Management", Mc Graw Hill, N.Y., (1983), p. 61

[2] Pearce, J.A. Ii, et al. "The Company's Mission as a Guide to Strategic Action", "Strategic Planning and Management Handbook" edited by King and Cleland, (1987), p. 72

[3] King W. R. , and Cleland, D.I., "Strategic Planning and Policy", Van Nostrand Reynold, N.Y., (1978).

2. Sigurimi i bazës për motivimin e përdorimit të burimeve të organizatës.
3. Zhvillimi i bazës apo standardit për alokimin e burimeve organizative.
4. Krijimi i një toni të përgjithshëm për një klimë organizative, për shembull sugjerimin e operimit të biznesit.
5. Të shërbejë si pikë kryesore për ata të cilët mund të identifikohen me qëllimin, drejtimin e organizatës dhe të pengojnë ata të cilët nuk mund të marrin pjesë më tej në aktivitetet e organizatës.
6. Lehtësimi i përkthimit të objektivave dhe të qëllimeve në strukturë pune duke përfshirë caktimin e detyrave për elementët përgjegjës brenda organizatës.
7. Specifikimi i synimeve organizative në objektiva në atë mënyrë që parametrat e kostos, të kohës dhe të performansës të mund të vlerësohen e të kontrollohen.

Misioni i muslimanëve në këtë botë është të adhurojnë Allahun xh.sh. dhe të jenë mëkëmbës të Tij në tokë, duke iu nënshtruar dëshirës së Tij, siç është evidente në ajetin vijues kuranor:

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ ٱلْعَالَمِينَ ﴿١٦٢﴾ لَا شَرِيكَ لَهُۥ ۖ وَبِذَٰلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا۠ أَوَّلُ ٱلْمُسْلِمِينَ ﴿١٦٣﴾

***"Thuaj: "Namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve! Ai nuk ka shok** (nuk adhuroj tjetër). **Me këtë** (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) **jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve** (i pari që pranoj dhe i bindem)**!"** (el-En'amë: 162-163)*

Në një ajet tjetër kuranor, Allahu xh.sh. thotë që të dy, xhinët dhe njerëzit janë krijuar vetëm që ta adhurojnë Atë.

وَمَا خَلَقْتُ ٱلْجِنَّ وَٱلْإِنسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴿٥٦﴾

***"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë".** (edh-Dharijatë: 56)*

Gjithashtu, në ajete të tjera, Allahu xh.sh. ka shpjeguar faktin që funksioni i njeriut është të jetë mëkëmbës i Tij. Ajete të tilla përfshijnë atë që vijon:

وَإِذۡ قَالَ رَبُّكَ لِلۡمَلَٰٓئِكَةِ إِنِّي جَاعِلٞ فِي ٱلۡأَرۡضِ خَلِيفَةٗۖ ... ﴿٣٠﴾

“*(Përkujto Muhamed)* ***Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj*** *(po përcaktoj)* ***në tokë një zëvendës”!...”*** *(el-Bekare: 30)*

وَهُوَ ٱلَّذِي جَعَلَكُمۡ خَلَٰٓئِفَ ٱلۡأَرۡضِ... ﴿١٦٥﴾

“Ai është që ju bëri sundues *(zëvendësues)* ***në tokë pas shkatërrimit të atyre që ishin*** *(më parë)****…”.*** *(el-En’amë: 165)*

Në analizimin e ajeteve të mësipërme, Ahmed Sakr (1979: 29) thekson që adhurimi nuk ka kuptimin vetëm të shtyllave të Islamit, por gjithashtu përfshin edhe shumë aspekte të jetës: ushqimin, fjetjen, studimin, hulumtimin e universit, hulumtimin shkencor, marrjen me biznes, kërkimin e diturisë dhe pjesëmarrjen në aktivitetet sportive. Gjithashtu, përfshin fitimin e parave për të ushqyer dhe mbajtur gjallë familjen. Të gjitha përpjekjet dhe aktivitetet e njeriut, si dhe qëllimi për arritjen e kënaqësisë së Allahut janë pjesë e adhurimit.[4]

Derisa që të dy, xhinët dhe njerëzimi janë krijuar të adhurojnë Allahun xh.sh, njerëzimi është më i favorizuar se xhinët duke qenë mëkëmbësit e Allahut në tokë. El-Burej[5] thekson që mëkëmbja nuk është e kufizuar për një grup të veçantë të njerëzve, por është më tepër mision i çdo qenie njerëzore:

“Ky mision i të qenët mëkëmbës i Zotit nuk është monopol i apostujve dhe të dërguarve, të cilët janë dërguar t’i urdhërojnë njerëzit dhe as nuk është e kufizuar për mbretërit, guvernatorët (valinjtë) ose zyrtarët e lartë, që janë zgjedhur apo caktuar të administrojnë çështjet e kombeve të tyre. Është mision i hapur për çdo qenie njerëzore. Çdo individ është përgjegjës për njerëzit dhe gjërat në sferën e tij të influencës”.

---

[4] Quoted in Al-Buraey, M. “Management and Administrative Development in Islam”, (1990), p. 112.

[5] Ibid.

Historikisht, organizata të ndryshme muslimane kanë misionet e veta. Këto misione para se gjithash kanë të bëjnë me adhurimin e Allahut xh.sh. Megjithatë, ky adhurim është ndjekur në mënyrë të ndryshme ashtu siç mund të ndiqet adhurimi i punës përmes formave të ndryshme. Organizatat muslimane siguroheshin së paku që misionet e tyre të ishin në përputhje me misionin e përgjithshëm të Islamit [do të thotë mëkëmbja dhe adhurimi i Allahut xh.sh.. (Zotit)]. Që një mision i organizatës të jetë në përputhje me misionin e Allahut, organizatat muslimane duhet të pyesin veten nëse konsiderohen apo jo planet e tyre si vepra të adhurimit. Si të tilla, duhet të sigurohen të mos shkelin ligjet e Allahut xh.sh. duke bërë vepra të ndaluara (haram).

Tani, çdo organizatë muslimane duhet të ketë formulim misioni të qartë për ta përdorë si formë referimi në planifikim, implementim dhe në kontrollimin e aktiviteteve të tij. Formulimi i misionit të një nën njësie biznesi duhet të jetë në përputhje me misionin e biznesit amë. Të gjitha këto formulime misioni mund të fillojnë duke treguar emëruesin e përbashkët, që është “adhurimi i Allahut xh.sh. përmes…”. Pastaj, duhet të shtojmë atë që i dallon ato nga organizatat e tjera në industritë e tjera të tyre, duke pasuar me atë që i dallon nga organizatat e tjera brenda industrisë së tyre.

Duke supozuar misionin e saj, një organizatë duhet të arrijë një synim afatgjatë të caktuar. Ky synim afatgjatë është definuar si objektiv i organizatës. Kapitulli vijues do të përfshijë definimin e objektivit të përgjithshëm të muslimanëve dhe implikimet e tij për organizatat bashkëkohore.

Objektivi

Për të adresuar konceptin e objektivave dhe qëllimeve, do të fillojmë me zanafillën e disiplinës së sigurimeve në shekullin X nga filozofi musliman Muhamed ibn Ali Tirmidhiu në librin e tij, *“Namazi dhe objektivat e tij”*. Në këtë libër, Tirmidhiu krijoi një model, duke prezantuar rezultatin e arsyeve, apo shkaqet e namazit të përshkruar. Pikat reale të referimit në këtë disiplinë, megjithatë, janë veprat e dijetarit islam el-Xhuvejni (shek. XI) në librin e tij *“Prova në rrënjët e Ligjit Islam”*,[6] dhe studentit të tij, filozofit të famshëm musliman, Gazalit[7], i cili zhvilloi një model të plotë për të gjitha mësimet e Islamit në librin *“El-Mustafa”*. Në fund, pika kulmore e kësaj disipline është gjetur në *“El-Muvafekat”*, e cila është shkruar nga esh-Shatibi[8] në Spanjë në shekullin XV. Modelimi me objektiva të mësimeve të Islamit, i përdorur në disiplinën e qëllimeve të Jurisprudencës Islame, do të jetë një pasuri (aset) për disiplinën moderne të Planifikimit Strategjik. Pavarësisht kësaj, ajo mbi të cilën është arritur pajtimi mbi qëllimet e mësimeve islame do të prezantohet në kapitullin vijues. Pjesa e mbetur e këtij kapitulli do të fokusohet në konceptin e objektivit.

Objektivi është definuar si qëllim afatgjatë që njerëzit kërkojnë ta arrijnë. Disa autorë përdorin termin synim për qëllimin afatgjatë në vend të termit objektiv, siç është përdorë në këtë libër. Perspektiva islame e objektivave përfshin që të dyja, këtë botë dhe botën e përjetshme (Ahiretin). Qëllimi afatgjatë i muslimanëve është në Botën e Përjetshme (Ahiret), dhe asgjë tjetër përveç hyrjes në xhenet dhe shmangies së Xhehenemit (Zjarrit).

---

[6] Al-Juwayni Abu al-Ma’ali, “The Proof in the Roots of Islamic Law”, reviewed by Dib, A.A., Dar al-Ansar, Cairo (1982).

[7] Al-Ghazali, Abu Hamid, “Al-Mustafa”, Dar al-Fikr, Beirut.

[8] Ash-Shatibi, Abu Ishaq, “Al-Muwafaqat”, reviewed by Abdullah Draz, Dar al-Ma’arifa, Beirut.

كُلُّ نَفْسٍ ذَآئِقَةُ ٱلْمَوْتِ ۗ وَإِنَّمَا تُوَفَّوْنَ أُجُورَكُمْ يَوْمَ ٱلْقِيَـٰمَةِ ۖ فَمَن زُحْزِحَ
عَنِ ٱلنَّارِ وَأُدْخِلَ ٱلْجَنَّةَ فَقَدْ فَازَ ۗ وَمَا ٱلْحَيَوٰةُ ٱلدُّنْيَآ إِلَّا مَتَـٰعُ ٱلْغُرُورِ ﴿١٨٥﴾

“Secili njeri do të shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen Ditën e Kiametit, e kush i shmanget zjarrit e futet në xhenet, ai ka arritur shpëtim, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos një përjetim mashtrues”. *(Ali Imran: 185)*

Në një ajet tjetër kuranor, Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ بِـَٔايَـٰتِنَا سَوْفَ نُصْلِيهِمْ نَارًا...﴿٥٦﴾

“Është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t’i hedhim në zjarr”. *(en-Nisaë: 56)*

...وَتُنذِرَ يَوْمَ ٱلْجَمْعِ لَا رَيْبَ فِيهِ ۚ فَرِيقٌ فِى ٱلْجَنَّةِ وَفَرِيقٌ فِى ٱلسَّعِيرِ ﴿٧﴾

“…dhe t’u tërheqësh vërejtjen për Ditën e Tubimit *(Kiametit)*, ***për të cilën nuk ka dyshim. Një grup për në xhenet, kurse një grup për në zjarr”.*** *(esh-Shura: 7)*

إِنَّ ٱلْأَبْرَارَ لَفِى نَعِيمٍ ﴿١٣﴾ وَإِنَّ ٱلْفُجَّارَ لَفِى جَحِيمٍ ﴿١٤﴾

“E s’ka dyshim se të mirët janë në kënaqësinë e përjetimeve *(në xhenet)*. ***Dhe se mëkatarët janë në xhehenem”.*** *(el-Infitar: 13-14)*

وَٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّـٰلِحَـٰتِ سَنُدْخِلُهُمْ جَنَّـٰتٍ تَجْرِى مِن تَحْتِهَا ٱلْأَنْهَـٰرُ خَـٰلِدِينَ
فِيهَآ أَبَدًا ۖ لَّهُمْ فِيهَآ أَزْوَٰجٌ مُّطَهَّرَةٌ ۖ وَنُدْخِلُهُمْ ظِلًّا ظَلِيلًا ﴿٥٧﴾

“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, Ne do t’i fusim në xhenet nën të cilin burojnë lumenj, ku do të jenë përgjithmonë. Aty kanë edhe bashkëshorte të pastra e hije të mrekullueshme”. *(en-Nisaë: 57)*

وَتِلْكَ ٱلْجَنَّةُ ٱلَّتِىٓ أُورِثْتُمُوهَا بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٧٢﴾ لَكُمْ فِيهَا فَـٰكِهَةٌ كَثِيرَةٌ مِّنْهَا
تَأْكُلُونَ ﴿٧٣﴾ إِنَّ ٱلْمُجْرِمِينَ فِى عَذَابِ جَهَنَّمَ خَـٰلِدُونَ ﴿٧٤﴾

“E ky është xheneti që u është dhënë për atë që keni punuar. Aty keni shumë pemë prej të cilave do të hani. Ndërkaq, kriminelët janë në vuajtje të përjetshme të Xhehenemit”. *(ez-Zuhruf: 72-74)*

Objektivi i hyrjes në xhenet dhe shmangia e Xhehenemit (Zjarrit) mund të arrihet vetëm duke ndjekur në mënyrë adekuate misionin e adhurimit dhe mëkëmbjes së Allahut xh.sh.. Fakti që objektivi i muslimanëve është i dyfishtë, do të thotë duke përfshirë xhenetin dhe xhehenemin, tregon që Islami përdor të dy, joshjen e shpërblimit dhe frikën e dënimit në motivimin e njerëzve. Objektivi i hyrjes në xhenet dhe shmangies së xhehenemit është definuar qartë. Në të vërtetë, që të dy, xheneti dhe xhehenemi janë përshkruar gjerësisht në mësimet e Islamit.

Ajo që është aq unike në mësimet islame është fakti që çdo vepër që e bën njeriu është e lidhur drejtpërdrejtë me objektivin afatgjatë. Këto lidhje të drejtpërdrejta me Botën e Përjetshme (Ahiretin) janë shprehur në ajete të shumta kuranore. Këto vepra nuk duhet të lidhen me objektivin e fundit, vetëm përmes qëllimeve të ndërmjetme.



Lidhjet e drejtpërdrejta mes objektivit të fundit dhe veprimeve të shumta janë paraqitur në fig. 1. Mund të shihet që veprimet A21, A22, A23 janë ndihmues për G2 (që mund të konsiderohet si veprimi final për të përfunduar një qëllim të caktuar që shpie te objektivi O). Por, ekzistojnë akoma lidhje të drejtpërdrejta në mes tyre dhe objektivit më të lartë. Lidhja në mes të objektivit dhe veprimeve janë të theksuara më shumë në mësimet e Islamit sesa në lidhjet mes veprimeve të ndryshme të vazhduara të varura. Lidhjet në mes të objektivit të fundit dhe veprimeve të ndryshme shkojnë tej procesit të zakonshëm të prapaveprimit te një shkak i drejtpërdrejtë dhe marrëdhënie efekti. Çdo veprim, pavarësisht vlerën, ka shpërblimin apo dënimin përkatës në Botën e Përjetshme (Ahiret). Aliu r.a., halifi i katërt i muslimanëve, ka reflektuar për rolin e reve duke thënë: Objektivi i reve nuk është shiu, por ky është prej frutave të tij. Në këtë thënie, Aliu r.a. përmes urtësisë së tij, ka shpjeguar në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhënien në mes të reve dhe rezultatit përfundimtar, që janë frytet. Hapat ndërmjetës të procesit të prodhimit të fryteve që përfshijnë retë, janë shiu dhe ujitja e pemëve. Vendosja e shkakut të drejtpërdrejtë dhe marrëdhënieve efektive në mes të qëllimit afatgjatë dhe veprimeve të ndryshme të ndërmjetme është një vlerë e shtuar për këto veprime. Kjo është shumë e dobishme në motivimin e njerëzve t'i zbatojnë këto veprime në mënyrë efektive.

Fig. 1., lidhet shumë mirë me rastin e tre punëtorëve ndërtimi, të cilët që të gjithë bënin të njëjtën punë. Një nga këta punëtorë ishte pyetur çka po bënte. Ai kishte thënë që po shtronte tulla. Kjo i korrespondon nivelit më të ulët të veprimit në figurë. Kur punëtori i dytë ishte pyetur njëjtë, ishte përgjigjur se ishte duke ngritur murin. Kjo i korrespondon nivelit mesatar në figurë. Në fund, kur është pyetur punëtori i tretë, ishte përgjigjur se ishte duke ndërtuar shtëpi. Kjo i korrespondon objektivit të nivelit më të lartë në figurë. Është e qartë që punëtori i tretë ishte më shumë i motivuar, pasi që shihte më shumë domethënie në atë që ishte duke bërë sesa dy punëtorët e tjerë. Menaxherët duhet të bindin punëtorët se të gjithë janë duke ndërtuar shtëpi, apo janë duke kontribuar në qëllimin final, sesa t'i bëjnë të ndihen që ata vetëm

janë duke shtruar tulla apo duke kryer ndonjë detyrë më të rëndësishme e më të vështirë.

Mësimet e Islamit theksojnë objektivin afatgjatë në krahasim me çdo qëllim afatmesëm. Suksesi real i shprehur në mësimet islame do të jetë më i largët i mundshëm në kohë, qoftë në Botën e Përjetshme (Ahiret) apo në këtë botë. Arritjet e menjëhershme nuk do të ndihmojnë asgjë nëse rezultatet përfundimtare do të jenë një dështim. Në fakt, në shumë raste, fitimet e menjëhershme rezultojnë në humbje afatgjata. Kurani i jep theks të veçantë rezultateve përfundimtare, si në këtë botë ashtu edhe në Botën e Përjetshme (Ahiret). Termi arab akuiba apo ukba, që mund të përkthehet si rezultat përfundimtar është përsëritur shumë shpesh në Kuran. Ai mund të gjendet në forma të ndryshme në ajetet vijuese:

(Ali Imran: 137), (el-En’amë: 11, 135), (el-A’rafë: 84, 86, 103, 128), (Junus: 39, 73), (Hudë: 49), (Jusuf: 109), (en-Nahl: 136), (Ta Ha: 132), (el-Haxhxh: 41), (en-Neml: 14, 51, 69), (el-Kasas: 37, 40, 83), (err-Rrum: 9, 10, 42), (Llukman: 22), (Fatir: 44), (es-Saffatë: 74), (Gafir: 21, 72), (ez-Zuhrufë: 25), (Muhamed: 10), (et-Talakë: 9), (el-Hashr: 17), (err-Rra’dë: 22, 24, 35, 42), dhe (esh-Shems: 15). Këto ajete i adresohen që të dy përfundimeve në këtë botë dhe në Botën e Përjetshme (Ahiret). Veç kësaj, Muhamedi a.s. thotë:

“Veprat janë të bazuara në përfundime”. (Buhariu)

Kjo nuk duhet të merret si nënkuptim i frazës, “përfundimi arsyeton qëllimin”. Nuk ekziston një gjë e tillë në Islam. Si mjetet ashtu edhe përfundimet duhet të kënaqin parimin e të lejuarës (hallallit). Hadithi i mësipërm ka kuptimin që suksesi është relevant vetëm kur është afatgjatë dhe rezultat përfundimtar.

Disa idioma të gjuhës arabe theksojnë ngjashëm rëndësinë e rezultateve përfundimtare. Idioma të tilla përfshijnë: çështjet janë sipas përfundimeve të tyre dhe qesh ai i cili qesh i fundit. Studimet e fundit kanë konfirmuar rëndësinë e qëllimeve afatgjata dhe sesi fitimet e menjëhershme në fund të fundit do të janë shumë të dhembshme. Boston

Consulting Group ka bërë deklarimin vijues në lidhje me Industrinë Britanike të Motoçikletave[9]:

“Rezultati historik i industrive britanike fokusohet në faktin që profitabiliteti afatshkurtër ka pasur fitime të vogla dhe asnjë humbje në nivelin afatgjatë. Rezultati historik afatgjatë i industrive japoneze fokusohet në pjesën dhe në vëllimin e tregut, shpesh shpenzimet e profitabilitetit afatshkurtër kanë qenë plotësisht e kundërta: të larta dhe profitabilitet i sigurt”.

Për shembull, në nivelin individual, studenti duhet të zgjedh punën ose studimet e tij të mëtejme. Studenti, që vendos të punojë, është duke u fokusuar në nivelin afatshkurtër, pasi që puna do t’i jep fitim të menjëhershëm financiar. Derisa studimi i mëtejmë do të shtynë fitimin financiar, por ka mundësi të jetë më e dobishme në nivelin afatgjatë, si në aspektin financiar ashtu edhe në aspektin intelektual.

Gjithashtu, dikush mund të ballafaqohet me zgjedhjen që të ketë punë që paguhet shumë, përballë një pune për përmirësim të aftësive. Puna me zhvillim të aftësive mund të konsiderohet si investim i ardhshëm, derisa puna që paguhet shumë konsiderohet kënaqësi afatshkurtër. Kjo pasi që çdonjëri nuk është në gjendje të ruaj punën që paguhet shumë përgjithmonë, megjithëse shkathtësitë e tij janë gjithnjë me të. Nëse personi vendos për punën që paguhet shumë, mund ta gjej veten të papunë, pasi që nuk mund të ketë shkathtësitë e nevojshme për të gjetur ndonjë punë tjetër.

Nga diskutimi i mësipërm, dikush mund të konkludojë që çdo organizatë duhet të ketë objektiv të definuar qartë. Ky objektiv duhet të jetë konsekuent me misionin e tij. Nëse organizata është pjesë e një organizate më të madhe, gjithashtu objektivi i saj duhet të jetë konsekuent me misionin dhe objektivin e përgjithshëm të organizatës amë. Shkaku i drejtpërdrejtë dhe marrëdhëniet efektive në mes të aktiviteteve të ndryshme të një biznesi dhe objektivit të saj, duhet të formulohen qartë dhe fokusimi mbi objektiv duhet të jetë shumë i fortë.

---

[9] Boston Consulting Group, “Strategic Alternatives for the British Motorcycle Business”, Vol. 1, p.. 4, London department of Industry, Her majesty stationary office, (1975).

Objektivi i një organizate mund të arrihet vetëm pas kalimit të disa periudhave kohore. Këto periudha kohore janë disa pikësynime specifike përgjatë rrugës që shpie te objektivi dhe zakonisht quhen qëllime. Koncepti i qëllimeve do të diskutohet në kapitullin vijues.

Qëllimet

Qëllimet janë definuar në literaturën e menaxhmentit si pikësynimet e ndërmjetme apo si disa pikësynime specifike që duhet të kërkohen në disa kohë specifike. Kështu, qëllimet janë periudha kohore të specifikuara që shpijnë te disa objektiva[10]. Si të tillë, duhet të reflektojnë një përfundim të caktuar të strategjisë apo drejtimin e përgjithshëm ku ndiqen objektivat[11]. Në anën tjetër, qëllimet arrihen përmes programeve që përbëhen nga projekte dhe aktivitete të ndryshme. King dhe Kleland kanë bërë përmbledhjen vijuese të qëllimeve:[12]

1. Qëllimet janë hapa të specifikuar gjatë arritjes së objektivave të plotë.
2. Qëllimet janë vënë për të reflektuar përfundimet e pritura nga strategjitë.
3. Qëllimet arrihen drejtpërdrejtë përmes programeve.
4. Strategjitë zbatohen përmes programeve.

Horizonti kohor i qëllimeve varet nga fusha me të cilën kemi të bëjmë. Prandaj, për shembull shitorja me pakicë, mund të ketë qëllim të arrij një shitje të caktuar në fund të vitit fiskal. Duke parë muslimanët në sferën apo fushën më të gjerë të definimit që përfshin që të dyja, këtë botë dhe Botën e Përhershme (Ahiretin), dikush mund që jetën ta konsiderojë si horizont kohor për qëllimet e Islamit. Mendimtarët e disiplinës, “Qëllimet e Jurisprudencës Islame”, kanë definuar gjerësisht qëllimet e mësimeve islame, duke shërbyer në interes të njerëzve

[10] King, W., R. and Cleland, D., I., “The Choice of Strategic Management”, in strategic planning and Management Handbook, edited by King and Cleland, (1987), p. 64.
[11] Ibid.
[12] Ibid. p. 68.

dhe duke i mbrojtur ata nga çdo e ligë apo e keqe.[13] Gjithashtu, ata i kanë klasifikuar këto qëllime në tre kategori:

Kategori e parë konsiderohen qëllimet absolutisht të domosdoshme. Kategori e dytë, qëllimet e nevojshme, dhe kategoria e tretë konsiderohen qëllimet plotësuese. Pastaj është shpjeguar që qëllimet e nevojshme i shërbejnë dhe i plotësojnë qëllimeve absolutisht të domosdoshme, derisa qëllimet plotësuese i shërbejnë dhe i plotësojnë qëllimet e nevojshme”.[14]

Sipas shumë mendimtarëve, qëllimet e domosdoshme janë: Mbrojtja e fesë, mbrojtja e nderit dhe e dinjitetit të njerëzve, mbrojtja e jetëve të tyre, mbrojtja e pasurisë së tyre dhe mbrojtja e dhuntisë së mendjes. Mendimtarët tjerë formuluan qëllimet e mësimeve islame si drejtësi, dashamirësi dhe bujari, si dhe shfuqizimin e padrejtësisë, veprave të turpshme dhe mëkateve. Këto qëllime janë përfshirë në ajetin vijues kuranor:

ٱلَّذِينَ يَتَّبِعُونَ ٱلرَّسُولَ ٱلنَّبِيَّ ٱلْأُمِّيَّ ٱلَّذِى يَجِدُونَهُۥ مَكْتُوبًا عِندَهُمْ فِى ٱلتَّوْرَىٰةِ وَٱلْإِنجِيلِ يَأْمُرُهُم بِٱلْمَعْرُوفِ وَيَنْهَىٰهُمْ عَنِ ٱلْمُنكَرِ وَيُحِلُّ لَهُمُ ٱلطَّيِّبَٰتِ وَيُحَرِّمُ عَلَيْهِمُ ٱلْخَبَٰٓئِثَ وَيَضَعُ عَنْهُمْ إِصْرَهُمْ وَٱلْأَغْلَٰلَ ٱلَّتِى كَانَتْ عَلَيْهِمْ ۚ فَٱلَّذِينَ... ﴿١٥٧﴾

***“Që pranojnë të Dërguarin** (Muhamedin), **pejgamberin arab** (që nuk shkruan as lexon), **të cilin e gjejmë të cilësuar** (të përshkruar me virtytet e tij), **te ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet dhe heq nga ata barrën e rëndë dhe prangat që ishin mbi ta…”.** (el-A’rafë: 157)*

Ne duhet t’i formulojmë këto qëllime si shërbim i interesit të njerëzve, mbrojtjes së tyre nga çdo e keqe dhe e ligë, lirimit të tyre nga

[13] Ibn Abdus-Salam, A., “Legal Maxims in the Interest of Mankind”, Reviewed by Abdur-Raouf T., Dar al-Jeel, Cairo., p. 8.
[14] Ar-Raysouni, Ahmad, “The Theory of Goals”, IIIT., Virginia, (1992) p. 26.

zgjedhjet brenda strukturës së drejtësisë, bujarisë dhe dinjitetit. Kjo është evidente në ajetin vijues kuranor:

۞ إِنَّ ٱللَّهَ يَأۡمُرُ بِٱلۡعَدۡلِ وَٱلۡإِحۡسَٰنِ وَإِيتَآيِٕ ذِي ٱلۡقُرۡبَىٰ وَيَنۡهَىٰ عَنِ ٱلۡفَحۡشَآءِ وَٱلۡمُنكَرِ وَٱلۡبَغۡيِۚ يَعِظُكُمۡ لَعَلَّكُمۡ تَذَكَّرُونَ ٩٠

"Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim". *(en-Nahl: 90)*

Hulumtimi mbi kompensimin ka zbuluar që punëtorët shikojnë te kompensimi i tyre në bazë të asaj nëse janë kompensuar në mënyrë të drejtë, veçanërisht në lidhje me kolegët e tyre. Qëllimi i bujarisë siguron shpirtin e kujdesit dhe të ndarjes si dhe vëllazërisë. Gjithashtu, ajo e plotëson qëllimin e drejtësisë pasi të drejtit janë bujarë. Dhurata e miqve dhe e kushërinjve do të shpie në një mjedis që do të sigurojë zhvillimin, progresin dhe prosperitetin, duke siguruar kështu sigurinë shoqërore. Duke dhënë dobitë që rrjedhin nga faktorët e mësipërm, nuk është i habitshëm fakti që Islami i ka ato si qëllime të veta, pasi që është fe që është mëshirë për njerëzimin.

Me qëllim që të ndjek objektivin e tij, është detyrë e çdo organizate të ketë një mori qëllimesh (pikësynime specifike në kohë specifike) që si pasojë do t'i mundësojnë të arrijnë këtë objektiv brenda strukturës së misionit të saj. Në planifikimin për të arritur objektivin, një organizatë muslimane duhet të sigurohet që çdo pako pune, që planifikon ta implementojë, duhet të jetë në përputhje me misionin dhe objektivin e përgjithshëm të muslimanëve. Ky duhet të jetë një proces i pandërprerë reagues.

Qëllimet kryesore të Islamit janë arritur përmes arritjes së kategorive të tjera të qëllimeve, të cilat arrihen siç duhet përmes programeve, projekteve dhe veprimeve të caktuara të konturuara në mësimet islame. Tri kategoritë e qëllimeve të përmendura më lart, si dhe programet, projektet dhe veprimet e kërkuara për t'i arritur ato janë në përputhje me misionin dhe objektivin e përgjithshëm të Islamit të përshkruar më lart.

Nga diskutimi i mësipërm, një organizatë mund të mësojë të definojë disa qëllime kryesore që duhet të arrihen në një periudhë relativisht të gjatë. Pastaj, duhet të përcaktohen një mori tjetër e qëllimeve të ndërmjetme që janë ndihmues të qëllimeve kryesore. Në fund, duhet të përshkruhen qartë programet, projektet dhe veprimet e nevojshme për arritjen e këtyre qëllimeve.

Për shembull, objektivi i një organizate mund të jetë rritja prej 20% e fitimit nga vitet e kaluara. Me qëllim që të arrijë këtë, ndërton qëllimin për arritjet mesatarisht të një rritjeje mujore prej 2%. Për të arritur targetin mujor të shitjeve, ndërmerr një kampanjë agresive reklamuese për të rritur shitjen dhe të riorganizojë procesin e prodhimit, për të zvogëluar çmimin dhe për të përmirësuar programin. Megjithatë, programi, qëllimi dhe objektivi i mësipërm mund të arrihen vetëm nëse i komunikohen qartë organizatës në përgjithësi, duke u siguruar se ato janë të pranueshme për ata. Ky pranim mund të sigurohet nga kultura e duhur e korporatës.

Para zbatimit (implementimit) të veprimeve që çojnë te qëllimet e tij, një organizatë duhet të krijojë shkakun e drejtpërdrejtë dhe marrëdhënien efektive në mes të veprimeve të planifikuara dhe objektivit të saj afatgjatë. Nga shembulli i mësipërm, ky shkak dhe marrëdhënia efektive duhet të prezantohen nga një analizë mbi ndikimin e reklamave në fitime. Kjo është më efektive se vetëm shfrytëzimi i një procesi të thjeshtë reagues.

Shumë organizata zhvillojnë qëllimet e objektivat dhe punojnë për arritjen e tyre, por në fund kuptojnë që këto qëllime dhe objektiva janë të parealizueshme. Bazuar në mësimet e Islamit, koncepti i realizueshmërisë në procesin e planifikimit do të adresohet në kapitullin vijues.

Fizibiliteti

Ky kapitull tregon nevojën e domosdoshme për t'u siguruar që qëllimet e dëshiruara të një organizate të jenë të realizueshme. Gjithashtu, i nxjerr komponentët e fizibilitetit bazuar në mësimet e Islamit.

Arritja e qëllimeve të përgjithshme të muslimanëve është brenda mundësisë së tyre. Kurani thekson qartë që njerëzve u kërkohet të bëjnë vetëm atë që është në mundësinë e tyre. Kurani thekson qartë që Allahu xh.sh. nuk i ngarkon njerëzit me atë që është përtej mundësisë së tyre.

لَا يُكَلِّفُ ٱللَّهُ نَفۡسًا إِلَّا وُسۡعَهَا...﴿٢٨٦﴾

"Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij…". *(el-Bekare: 286)*

Nuk ka kuptim që ta përshkruajmë Islamin si fe e mëshirës, nëse u kërkon njerëzve të mbingarkohen në mënyrë që t'u binden urdhrave të Allahut xh.sh. Nëse Krijuesi nuk kërkon nga krijesat aktivitete që janë përtej mundësive të tyre, atëherë edhe organizatat që kërkojnë kënaqësinë e Allahut në ndjekjen e objektivit të tyre, nuk duhet të kërkojnë nga punëtorët të realizojnë detyra që janë mbi mundësitë e tyre.

Në një ajet tjetër kuranor, Allahu xh.sh. tregon që madje dhe devotshmëria kërkohet sipas mundësive të njerëzve.

فَٱتَّقُواْ ٱللَّهَ مَا ٱسۡتَطَعۡتُمۡ...﴿١٦﴾

"Andaj, sa të keni mundësi ruajuni prej dënimit të Allahut…". *(et-Tegabun: 16)*

Një ajet tjetër kuranor që ka të bëjë me shpenzimet, qartëson që çdo kush duhet të shpenzojë sipas një mesatareje të tij dhe se Allahu xh.sh. nuk i vë përgjegjësi ndonjë personi mbi atë që i është dhënë:

لِيُنفِقۡ ذُو سَعَةٖ مِّن سَعَتِهِۦۖ وَمَن قُدِرَ عَلَيۡهِ رِزۡقُهُۥ فَلۡيُنفِقۡ مِمَّآ ءَاتَىٰهُ ٱللَّهُۚ لَا يُكَلِّفُ ٱللَّهُ نَفۡسًا إِلَّا مَآ ءَاتَىٰهَاۚ سَيَجۡعَلُ ٱللَّهُ بَعۡدَ عُسۡرٖ يُسۡرٗا ﴿٧﴾

"Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngushtë nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë Allahu, e

Allahu nuk ngarkon askënd, vetëm aq sa i ka dhënë. Mirëpo, pas vështirësisë Allahu sjell çlirim *(begati)****".*** *(et-Talakë: 7)*

Pasi kemi sqaruar që misioni i njerëzimit është bërë i realizueshëm nga Allahu xh.sh., tani do të përpiqemi të gjejmë elementet që e përbëjnë këtë realizueshmëri. Elementi i parë i realizueshmërisë është një mori vlerash të natyrshme apo "fitra" që Allahu xh.sh. ia ka dhënë çdo qenieje njerëzore. Këto vlera sigurojnë natyrshmërinë e njeriut për një fëmijë që të jetë musliman. Në fakt, Muhamedi a.s. ka treguar që çdo foshnjë lind si musliman. Prandaj, duhet të sigurohemi që punët që u caktojnë njerëzve janë në përputhje me vlerat personale të tyre, për të siguruar realizueshmërinë e arritjes së qëllimeve tona. Gjithashtu, Allahu xh.sh. ka dërguar Shpallje që të sigurojë udhëzimin për njerëzimin dhe t'i ndihmojë ata të kapen pas "fitras" apo vlerave të lindura. Kjo sqaron rëndësinë e drejtimit krenar, për t'u siguruar për realizueshmërinë e arritjes së qëllimeve.

Islami na mëson, që Allahu xh.sh. pasi i krijoi njerëzit, u dha ndjenjat dhe aftësinë e mendjes, që i bëri të aftë në marrjen e diturisë dhe të shkathtësive. Kjo tregon rëndësinë e aftësive për të mësuar shkathtësi për sigurimin e realizueshmërisë së punës.

وَٱللَّهُ أَخۡرَجَكُم مِّنۢ بُطُونِ أُمَّهَٰتِكُمۡ لَا تَعۡلَمُونَ شَيۡـٔٗا وَجَعَلَ لَكُمُ ٱلسَّمۡعَ وَٱلۡأَبۡصَٰرَ وَٱلۡأَفۡـِٔدَةَ لَعَلَّكُمۡ تَشۡكُرُونَ ﴿٧٨﴾

"Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja *(si foshnje)* ***që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me*** *(shqisa për)* ***të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues".*** *(en-Nahl: 78)*

Pasi që qeniet njerëzore janë mëkëmbës të Allahut xh.sh. në këtë tokë, Allahu xh.sh. u ka siguruar të gjitha burimet e nevojshme, duke bërë që çdo gjë në tokë t'i nënshtrohet atyre.

هُوَ ٱلَّذِى خَلَقَ لَكُم مَّا فِى ٱلۡأَرۡضِ جَمِيعٗا...﴿٢٩﴾

"Ai *(Allahu)* ***është që për juve krijoi gjithçka ka në tokë…".*** *(el-Bekare: 29)*

هُوَ ٱلَّذِى جَعَلَ لَكُمُ ٱلۡأَرۡضَ ذَلُولاً فَٱمۡشُواْ فِى مَنَاكِبِهَا وَكُلُواْ مِن رِّزۡقِهِۦ ۖ وَإِلَيۡهِ
ٱلنُّشُورُ ﴿١٥﴾

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, vetëm te Ai është e ardhmja”. *(el-Mulk: 15)*

Çdo detyrë vjen me përgjegjësi e llogaridhënie dhe posti i mëkëmbësit nuk bën përjashtim. Çdo gjë që është në qiej e në tokë, i është nënshtruar njeriut. Megjithatë, ai gjithashtu do të jep llogari sesi i përdor ato, pasi që pjesa e fundit në ajetin e mësipërm tregon që ringjallja është te Allahu xh.sh.. Në të njëjtën mënyrë punëtorët janë përgjegjës dhe do të japin llogari për burimet që i kanë në dispozicion, për arritjen e qëllimeve dhe të objektivave të një organizate, dhe Allahu xh.sh. do t’i pyes për performansën e tyre.

Kurani specifikon që, Allahu xh.sh. jo vetëm që krijoi çdo gjë në këtë tokë për njerëzit, por madje i ka shpallur njerëzimit, që, Ai çdo gjë që është në tokë dhe në qiej i ka nënshtruar për njeriun.

ٱللَّهُ ٱلَّذِى خَلَقَ ٱلسَّمَـٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضَ وَأَنزَلَ مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءً فَأَخۡرَجَ بِهِۦ مِنَ
ٱلثَّمَرَٰتِ رِزۡقًا لَّكُمۡ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ ٱلۡفُلۡكَ لِتَجۡرِىَ فِى ٱلۡبَحۡرِ بِأَمۡرِهِۦ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ
ٱلۡأَنۡهَـٰرَ ﴿٣٢﴾ وَسَخَّرَ لَكُمُ ٱلشَّمۡسَ وَٱلۡقَمَرَ دَآئِبَيۡنِ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ ٱلَّيۡلَ وَٱلنَّهَارَ ﴿٣٣﴾
وَءَاتَـٰكُم مِّن كُلِّ مَا سَأَلۡتُمُوهُ ۚ وَإِن تَعُدُّواْ نِعۡمَتَ ٱللَّهِ لَا تُحۡصُوهَآ... ﴿٣٤﴾

“Allahu është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën, dhe Ai lëshoi prej së larti ujë *(shi)*, ***e me të nxjerr fruta si ushqim për ju, dhe për të mirën tuaj u vuri në shërbim anijet, të lundrojnë nëpër det me urdhrin e Tij, e në shërbimin tuaj i vuri edhe lumenjtë. Për ju nënshtroi diellin dhe hënën që në mënyrë të zakonshme vazhdimisht udhëtojnë. Për ju përshtati edhe natën e ditën. Ai ju dha gjithë atë që e kërkuat*** *(që kërkoi nevoja juaj)* ***edhe në qoftë se përpiqeni t’i numëroni të mirat e Allahut, nuk do të mund të arrini t’i përkufizoni*** *(në numër)****…”.*** *(Ibrahim: 32-34)*

Mirësitë e Allahut xh.sh. për njeriun janë të pallogaritshme. Kjo përfshin të gjitha aspektet e jetës së njeriut që nga shëndeti e ushqimi, e mes tjerash, nga transporti e deri te zbulimet shkencore. Njeriu duhet të jetë falënderues për dhurata të tilla duke i përdorur sipas dëshirës së Allahut xh.sh..

وَسَخَّرَ لَكُم مَّا فِى ٱلسَّمَـٰوَٰتِ وَمَا فِى ٱلۡأَرۡضِ جَمِيعًا مِّنۡهُ ۚ إِنَّ فِى ذَٲلِكَ لَأَيَـٰتٍ
لِّقَوۡمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿١٣﴾

“Dhe për ju nënshtroi gjithë ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë, njëmend për njerëzit që mendojnë më thellë, në këto ekzistojnë argumente”. *(el-Xhathije: 13)*

Pasi që njerëzit dhe xhinët janë krijuar për një qëllim që është adhurimi i Allahut xh.sh., këto mirësi të Allahut xh.sh. për njerëzit duhet t’i shërbejnë gjithashtu qëllimit të adhurimit.

Çdo gjë në këtë Univers është krijuar të shfrytëzohet nga njerëzit. Megjithatë, njerëzit nuk mund të ëndërrojnë t’i shfrytëzojnë ato pa mësimin dhe kuptimin sesi funksionojnë dhe pa disa lloje të transformimit apo procesit të prodhimit të materialeve të tij.

Nuk ka asnjë mënyrë për marrjen e ndonjë shpërblimi, pa kryerjen e punës së duhur. Ky proces i mësimit, kuptimit e planifikimit të një qëllimi të arritshëm, dhe pastaj zbatimi (implementimi) i planit është parakusht për ndihmën e Allahut xh.sh. Ajo që ndihmon fenë e Allahut në ajetin vijues do të thotë:

يَـٰٓأَيُّہَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ إِن تَنصُرُواْ ٱللَّهَ يَنصُرۡكُمۡ... ﴿٧﴾

“O besimtarë, nëse ju ndihmoni *(fenë)* ***Allahun, Ai u ndihmon juve…”.*** *(Muhamed: 7)*

Ajeti i mësipërm u tregon muslimanëve që nuk është e realizueshme për ta që të jenë të suksesshëm në këtë botë, por Allahu xh.sh. Krijuesi i qiejve dhe tokës, do t’i ndihmojë të kryejnë pjesën e tyre. Gjithashtu, kjo i mëson njerëzit që kurrë të mos nënçmojnë veten, pasi që Allahu xh.sh. u ka dhënë aftësinë e mendjes, ka nënshtruar Universin për ta dhe u ka premtuar ndihmë. Gjithashtu, Islami i mëson që fa-

kti që disa njerëz janë muslimanë nuk do t'i ndihmojë nëse nuk bëjnë punën e tyre. Kurani thotë:

لَّيۡسَ بِأَمَانِيِّكُمۡ وَلَآ أَمَانِيِّ أَهۡلِ ٱلۡكِتَٰبِۗ مَن يَعۡمَلۡ سُوٓءٗا يُجۡزَ بِهِۦ... ﴿١٢٣﴾

"Nuk është** (shpëtim) **sipas shpresave tuaja as sipas shpresave të ithtarëve të librit. Kushdo që i bën keq, do të ndëshkohet me të…". *(en-Nisaë: 123)*

Në Islam, shpërblimi është i varur me bërjen e veprave të mira.

مَنۡ عَمِلَ صَٰلِحٗا مِّن ذَكَرٍ أَوۡ أُنثَىٰ وَهُوَ مُؤۡمِنٞ فَلَنُحۡيِيَنَّهُۥ حَيَوٰةٗ طَيِّبَةٗۖ وَلَنَجۡزِيَنَّهُمۡ أَجۡرَهُم بِأَحۡسَنِ مَا كَانُواْ يَعۡمَلُونَ ﴿٩٧﴾

"Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë *(në këtë botë),* ***e*** *(në botën tjetër)* ***do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre".*** *(en-Nahl: 97)*

Në fund, Allahu xh.sh. ka caktuar një mision, një objektiv dhe qëllime për njerëz. Ndërkohë, i ka pajis me aftësitë e domosdoshme që të realizojnë misionin e tyre dhe të arrijnë objektivin dhe qëllimet. Njerëzit posedojnë aftësinë e mendjes apo shkathtësinë e nevojshme të realizojnë detyrën e tyre. Gjithashtu, e gjithë toka dhe Universi i është nënshtruar atyre, duke pasur kështu burimet e nevojshme për realizimin e detyrës së tyre.

Bazuar në diskutimin e mësipërm, studentët e Islamit duhet të mësojnë që organizatat duhet të zgjedhin disa qëllime alternative të arritshme në operimet e tyre. Ndjekja e një qëllimi të parealizueshëm konsiderohet humbje e burimeve të dhëna nga Allahu xh.sh.. Realizueshmëria rrethohet me shkathtësi dhe burime. Mungesa e një prej këtyre komponentëve e bën punën të parealizueshme.

Pas zhvillimit të planeve alternative të realizueshme, një organizatë duhet të zgjedh cilin prej tyre duhet përvetësuar. Procesi i vendimmarrjes mund të jep rezultate më të mira nëse realizohet përmes konsultimeve apo shuras. Kapitulli vijues do t'i adresohet këtij koncepti të rëndësishëm islam.

Menaxhmenti me pjesëmarrje/përfshirës

Menaxhmenti participues është përfshirja e vazhdueshme e njerëzve në vendimmarrje. Ajo është më shumë kulturë se program. Është obligim islam i udhëheqësit të konsultojë vartësit e tij/saj. Ky konsultim në Islam quhet shura. Në Kuran është theksuar që besimtarët, që do të shpërblehen në Botën e Përhershme (Ahiret) janë ata të cilët i udhëheqin çështjet e tyre me shura apo konsultim.

وَٱلَّذِينَ ٱسۡتَجَابُواْ لِرَبِّهِمۡ وَأَقَامُواْ ٱلصَّلَوٰةَ وَأَمۡرُهُمۡ شُورَىٰ بَيۡنَهُمۡ وَمِمَّا رَزَقۡنَٰهُمۡ يُنفِقُونَ ﴿٣٨﴾

"Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë". *(esh-Shura: 38)*

Në një ajet tjetër kuranor, Allahu xh.sh. urdhëron profetin e Tij, Muhamedin a.s. që të zbatojë shuran:

فَبِمَا رَحۡمَةٖ مِّنَ ٱللَّهِ لِنتَ لَهُمۡۖ وَلَوۡ كُنتَ فَظًّا غَلِيظَ ٱلۡقَلۡبِ لَٱنفَضُّواْ مِنۡ حَوۡلِكَۖ فَٱعۡفُ عَنۡهُمۡ وَٱسۡتَغۡفِرۡ لَهُمۡ وَشَاوِرۡهُمۡ فِي ٱلۡأَمۡرِۖ فَإِذَا عَزَمۡتَ فَتَوَكَّلۡ عَلَى ٱللَّهِۚ إِنَّ ٱللَّهَ يُحِبُّ ٱلۡمُتَوَكِّلِينَ ﴿١٥٩﴾

"Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falja atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që i mbështeten". *(Ali Imran: 159)*

Muhamed ibn el-Hasan el-Muradi ka theksuar katër arsye pse udhëheqësi duhet të përfshijë pasuesit e tij në vendimmarrje. Këto arsye janë:

"Së pari, pamjaftueshmëria e njohurisë e atij që kërkon këshillim për vendimmarrje. Së dyti, frika nga bërja e gabimeve në vlerësimin e gjendjes, madje edhe nëse nuk i mungon njohuria. Së treti, mundësia që pavarësisht inteligjencës dhe aftësive të tij, emocionet e dashurisë

dhe të urrejtjes mund ta ndalojnë nga marrja e vendimit të duhur… Së fundi, kur personi i konsultuar është partner apo mbështetës në një veprim, angazhimi në vendim mund ta inkurajojë për të bërë përpjekjet dhe mbështetjen maksimale, pasi që vendimi reflekton zgjedhjen e tij”.[15]

Shura synon arritjen e konsensusit që do t’i sjell dobi shoqërisë apo biznesit që duhet të marr vendim. Ne rast se nuk arrihet asnjë konsensus, duhet drejtuar votimit. Muhamedi a.s. thotë:

> “*Ymeti im nuk mund të pajtohet për një gabim dhe nëse insistohet për një konflikt, atëherë duhet të jetë me pëlqimin e shumicës*”. (Ibn Maxhe)

Duke komentuar thënien e lartpërmendur, Izetbegoviq[16] thotë që opinioni i shumicës është shprehje e mendjes së zakonshme të lartë. Kjo ndodh pasi që kjo jep rezultate më të mira se opinioni i një personi të vetëm. Izetbegoviqi shton, “Kjo është deklaratë e një procesi demokratik”. Gjithashtu, menaxhmenti participues është kritik për motivim. Përgjithësisht, njerëzit janë më të motivuar të ekzekutojnë vendimet, në të cilat ishin pjesë e vendimmarrjes.

Megjithatë, shura nuk është demokraci. Ndryshe nga demokracia, nuk supozon që konfliktet janë të pashmangshme. Prandaj, kërkon nga njerëzit të përpiqen për arritjen e konsensusit. Derisa konsensusi mund ta bëjë procesin e vendimmarrjes të gjatë, por kjo sigurisht që do të sigurojë implementim më të mirë. Demokracia në anën tjetër, është një mekanizëm i zgjidhjes së konflikteve përmes sundimit të shumicës. Mund të jetë më efiçiente se shura, por nuk garanton angazhimin e plotë të grupit/grupeve të humbura. Demokracia, në anën tjetër, është shumë më e mirë se sundimi autokratik, pasi që nuk injoron plotësisht opinionin e njerëzve. Tabela 1 krahason përdorimin e diktaturës, të demokracisë dhe shuras në vendimmarrjen strategjike.

[15] Al-Muradi, Pp. 61-62

[16] Izetbegovic, A.A, “Islam Between East and West”, 2nd ed. American Publications, Indianapolis, (1990).

Tabela 1. Mënyrat e Vendimmarrjes Strategjike

	Diktatura	*Demokracia*	*Shura*
Koha për të vendosur	E shkurtër	Mesatare	E gjatë
Kualiteti i vendimit	I ulët	I mirë	I lartë
Kualiteti i implementimit	I ulët	I mirë	I lartë

Megjithatë, duhet kuptuar që arritja e konsensusit nuk është praktike në vendimet operative. Në fakt, vendimet individuale të bashkuara, nëse nevojiten, me konsultimet e ekspertëve është mënyra më e mirë e vendimeve operacionale. Vendimet individuale nuk duhet të përzihen me diktaturën. Në fakt, ne mund të arrijmë konsensus real vetëm kur kemi njerëz të pavarur që janë të aftë të kenë opinionet e tyre dhe të marrin vendime. Përndryshe, nëse kemi vetëm njerëz të varur që nuk mund të qëndrojnë në veten e tyre, do të kemi të prezantuar diktaturën në formë të konsensusit apo të demokracisë.

Pasi vendimi po bëhet gjithnjë e më shumë strategjik, ekziston nevoja në rritje për konsensus. Mes ekstremeve operacionale dhe strategjike të një madhësie të vazhduar, ne mund të vendosim për sundimin e shumicës. Fig. 2., tregon madhësinë e vazhduar lidhur me llojin e vendimit dhe mënyrën e vendimit.



Figura 2. Llojet dhe mënyrat e vendimit

Ashtu si e kemi theksuar më lart, Shura ka qenë një kulturë gjatë kohës së Muhamedit a.s. dhe halifëve pas tij. Asnjë vendim i rëndësishëm kurrë nuk është marrë pa konsultim. Në shumë raste, opinioni i

Muhamedit a.s. është miratuar pasi që ka marrë mbështetjen e shumicës. Në raste të tjera, si gjatë betejës së Uhudit, opinionet e tjera kanë marrë shumicën dhe më pas janë miratuar. Në rastin e betejës së Uhudit, Muhamedi a.s. dëshironte të qëndronte në qytetin e tij, në Medine, kur dëgjoi që idhujtarët e Mekës ishin afër ta sulmonin. Por në fund, Muhamedi a.s. vendosi që në vend të kësaj të shkonte në malet Uhud, pasi që shumica e sahabëve (pasuesve) të tij preferonin ballafaqimin me armikun atje. Pavarësisht faktit që konsultimi ishte kulturë gjatë kohës së tij, Omeri r.a., halifi i dytë i Muhamedit a.s., krijoi një numër programesh për të fuqizuar këtë kulturë. Këto programe përfshijnë mbajtjen e një konference vjetore për të gjithë muslimanët, gjatë haxhit (pelegrinazhit) dhe themelimin e një agjencie për ankesa. Dijetarët muslimanë theksojnë që konsultimi nuk duhet të harrohet për asnjë arsye.[17]

Sfera e konsultimit duhet të jetë e gjerë aq sa është e mundur. Omeri r.a. ishte aq i mprehtë në dëgjimin e opinioneve të ndryshme saqë kërkonte opinionin e të rinjve në çështjet kritike. Në një nga thëniet e tij, Muhamedi a.s., ka përmbledhur gjithë fenë si këshillë, e cila mund të arrihet vetëm përmes konsultimit:

“Feja (religjioni) është këshillë e sinqertë”. (Muslimi)

Kultura e pjesëmarrjes së sahabëve (pasuesve) të Profetit a.s., ka rezultuar në nivel të lartë të kënaqësisë dhe të përfshirjes. Gjithashtu, ajo ka nxit risi të shumta administrative, veçanërisht gjatë kohës së Omerit r.a.. Këto risi përfshijnë ndërtimin e qyteteve të Basras dhe Kufes në Irak, dhe krijimin e departamenteve të reja, siç janë departamenti i listës së pagave dhe departamentit të dokumentimit, ku mblidheshin, dhe administroheshin informacionet. Në botën bashkëkohore, bizneset janë duke kuptuar rëndësinë e vendimmarrjes participuese dhe bizneset që konsultojnë punëtorët e tyre janë duke pasur më shumë sukses sesa ato që nuk e bëjnë këtë. Denisoni argumenton që menaxhmenti participues mund të kontribuojë në mënyrë të rëndësish-

[17] Awwa, M.S., “On the Political System of an Islamic State”, Cairo, (1980) Pp. 335-336.

me në suksesin afatgjatë të organizatës.[18] [19] Një paraqitje më e fuqishme që mund të jetë më afër kuptimit të Islamit është bërë nga Sashkini,[20] që thekson që menaxhmenti participues është efektiv, dhe në fakt, moralisht i domosdoshëm në organizata.

Ata që janë të përfshirë në vendimmarrje apo ata të cilët janë pjesë e konsultimit, duhet të shikojnë t’i shërbejnë interesit të përgjithshëm të organizatës. Fokusimi në interesin e një pjese të organizatës në kurriz të pjesës tjetër do të dëmtojë përfundimisht të gjitha pjesët. Veç kësaj, vendimmarrësit duhet të kenë në konsideratë sjelljen e të gjithë aksionarëve brenda mjedisit të organizatës së tyre. Kjo mënyrë, e njohur si mënyra e sistemeve, është paraqitur në kapitullin vijues.

Mënyra e sistemeve

Gibson et al.[21] definon mënyrën e sistemeve si një teori e bazuar në pikëpamjen që organizatat mund të parashikohen si sisteme. Stone dhe Freeman[22] theksojnë që:

“Mënyra e sistemit të menaxhmentit organizatën e shikon si një sistem të unifikuar e të vendosur, i përbërë nga pjesë të ndërlidhura. Kjo mënyrë i bën menaxherët ta shikojnë organizatën si një tërësi dhe si e veçantë nga mjedisi i gjerë i jashtëm. Duke vepruar kështu, teoria e sistemeve na tregon që aktiviteti i çdo segmenti të një organizate, ndikon në shkallë të ndryshme në aktivitetin e çdo segmenti tjetër”.

Mënyra e sistemeve përbëhet nga shtylla të caktuara. Shtylla e parë është konsiderimi i organizatës si një tërësi. Kjo shtyllë mund të shpjegohet më mirë nga thënia vijuese e Muhamedit a.s..

“Besimtarët janë si një njeri. Nëse i dhemb koka, i gjithë trupi do të vuaj, dhe nëse i dhemb syri, i gjithë trupi do të vuaj”. (Buhariu)

[18] Dension, D.R., “Bringing Corporate Culture to the bottom line”, Organizational Dynamics, Autumn Pp. 4-22.
[19] Ibid.
[20] Sashkin Marshall, “Participative Management is an Ethical imperative”, Organizational Dynamics, Spring, 1984 Pp. 4-22.
[21] Gibson et. Al. “Organizations”, 5th ed., Business Publications Inc., Texas, (1985) p. 30.
[22] Stoner and Freedman, “Management”, 5th ed. Prentice Hall, N. Jersey, (1992), p. 31.

Kështu, organizata duhet që së pari të shihet si një njësi e përbërë nga shumë pjesë që mbështesin njëra tjetrën dhe plotësojnë pjesët e tjera në njësi. Nëse ndonjëri ushtron njërën këmbë, e jo tjetrën, do të përfundojë duke çaluar. Ngjashëm, puna për një departament në një organizatë dhe jo tjerat, vetëm do të zvogëlojë efektivitetin e organizatës.

Shtylla e dytë e mënyrës së sistemit është konsiderimi i organizatës si pjesë e një mjedisi të gjerë. Nga ky këndvështrim, muslimanët besojnë në unitetin e njerëzimit dhe në domosdoshmërinë e ndërlidhjes së tyre. Kurani i drejtohet gjithë njerëzimit në shumë ajete:

يَـٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ إِنَّا خَلَقۡنَـٰكُم مِّن ذَكَرٍ وَأُنثَىٰ وَجَعَلۡنَـٰكُمۡ شُعُوبًا وَقَبَآئِلَ لِتَعَارَفُوٓاْۚ إِنَّ أَكۡرَمَكُمۡ عِندَ ٱللَّهِ أَتۡقَىٰكُمۡۚ إِنَّ ٱللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٣﴾

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur *(këqijat)* ***e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”.*** *(el-Huxhuratë: 13)*

Në ajetin e lartpërmendur, Kurani thekson diversitetin e njerëzimit. Megjithatë, një diversitet i tillë është mëshirë dhe nderon dinjitetin e të gjithë njerëzve pavarësisht fesë, racës apo kombësisë së tyre.

لَآ إِكۡرَاهَ فِي ٱلدِّينِۖ ... ﴿٢٥٦﴾

“Në fe nuk ka dhunë…”. *(el-Bekare: 256)*

۞ وَلَقَدۡ كَرَّمۡنَا بَنِيٓ ءَادَمَ وَحَمَلۡنَـٰهُمۡ فِي ٱلۡبَرِّ وَٱلۡبَحۡرِ وَرَزَقۡنَـٰهُم مِّنَ ٱلطَّيِّبَـٰتِ وَفَضَّلۡنَـٰهُمۡ عَلَىٰ كَثِيرٍ مِّمَّنۡ خَلَقۡنَا تَفۡضِيلاً ﴿٧٠﴾

“Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit *(njerëzit),* ***u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata*** *(i lartësuam)* ***ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam”.*** *(el-Israë: 70)*

Muslimanët kanë qenë të informuar për mjedisin e tyre të gjerë, madje edhe kur ishin të pakët në numër, e të shtypur në Mekë.

غُلِبَتِ ٱلرُّومُ ﴿٢﴾ فِيٓ أَدۡنَى ٱلۡأَرۡضِ وَهُم مِّنۢ بَعۡدِ غَلَبِهِمۡ سَيَغۡلِبُونَ ﴿٣﴾ فِي بِضۡعِ سِنِينَۗ لِلَّهِ ٱلۡأَمۡرُ مِن قَبۡلُ وَمِنۢ بَعۡدُۚ وَيَوۡمَئِذٍ يَفۡرَحُ ٱلۡمُؤۡمِنُونَ ﴿٤﴾

“Bizantinët *(romakët)* ***u mundën. Në tokën më afër*** *(tokës së arabëve),* ***po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjejnë. Brenda pak viteve. Çështja është vendim i Allahut, fillim e mbarim*** *(për disfatë dhe për fitore).* ***E atë ditë*** *(kur do të fitojnë bizantinët)* ***besimtarët do të gëzohen”.*** *(err-Rrum:2-4)*

Në Islam, sistemi më i gjerë përfshin gjithë botën dhe shtrihet edhe në Botën e Përjetme (Ahiret). Muslimanët konsiderohen sistem, misioni i të cilëve është adhurimi dhe janë mëkëmbës të Allahut xh.sh., objektiv i të cilëve është hyrja në xhenet dhe shmangia nga xhehenemi. Ky sistem duhet të merr parasysh mjedisin e tij dhe të veprojë me të, në një mënyrë që të jetë në pajtim me urdhërimin e Allahut xh.sh. dhe objektivin e përgjithshëm të krijimit. Fiset apo grupet muslimane (që mund të konsiderohen si shtete në terminologjinë bashkëkohore) janë konsideruar si nënsistem që kanë agjendën e tyre në mjediset e tyre regjionale dhe ndërkombëtare, duke u siguruar që kjo agjendë të jetë në pajtueshmëri me misionin dhe me objektivin e përgjithshëm të Islamit. Më tej, bizneset dhe familjet janë konsideruar si nënsisteme që kanë mjediset e tyre kulturore, politike, teknologjike dhe ekonomike. Operimi i çdo njësie brenda sistemit duhet të shfrytëzojë procesin reagues brenda mjedisit të tij më të madh dhe me misionin e përgjithshëm, objektivin dhe qëllimet e tij.

Funksionet e njësive dhe nën-njësive të ndryshme të një sistemi, gjithashtu duhet të janë koherente dhe në përputhje me njëri-tjetrin. Koherenca e sistemit është manifestuar shumë mirë në mësimet e Islamit, ku teologjia siguron dëshirën dhe drejtimin e përgjithshëm, e jurisprudenca siguron implementimin praktik. Në Islam, sistemet arsimore, sociale, morale, ekonomike, politike dhe ligjore funksionojnë si një tërësi, dhe asnjë nuk mund të aplikohet pa tjetrin.

Integrimi i plotë

Nëse shqyrtojmë me kujdes mësimet e Islamit, do të kuptojmë që ato përbëjnë një pako të pandashme, duke mbështetur çdo mësim, por është mbështetur edhe nga mësimet e tjera. Këto mësime janë të ndërlidhura horizontalisht, vertikalisht dhe diagonalisht. Allahu xh.sh. thotë:

أَفَلَا يَتَدَبَّرُونَ ٱلْقُرْءَانَ ۚ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِندِ غَيْرِ ٱللَّهِ لَوَجَدُوا۟ فِيهِ ٱخْتِلَـٰفًا كَثِيرًا ﴿٨٢﴾

***"A nuk e përfillin ata** (me vëmendje) **Kuranin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie".** (en-Nisaë: 82)*

Shembulli vijues shpjegon integrimin e plotë të mësimeve të Islamit. Me qëllim të ruajtjes së një jete shoqërore modeste (apo konservative), Islami i ndalon muslimanët nga shkelja e kurorës. Por, nuk është ndalur në këtë pikë. Në fakt, Islami i mëson muslimanët si të arrijnë këtë qëllim. Islami kërkon nga çdo musliman që të mos jetë në vetmi me asnjë person të gjinisë së kundërt. Gjithashtu, muslimanëve u kërkohet të ulin shikimin e tyre dhe të vishen në mënyrë modeste. Veç kësaj, Islami inkurajon martesën. Në anën tjetër, muslimanët duhet të kenë jetë të moralshme, duke u falur, agjëruar, duke dhënë lëmoshë dhe duke lexuar Kuran. Nga ata kërkohet të edukohen lidhur me këto çështje. Edhe nëse akoma vazhdojnë të shkelin kurorën pasi që këto parakushte të jenë plotësuar, ata do të ndëshkohen ashpër. Ky shembull i thjeshtë tregon sesa ngushtë janë të integruara mësimet e Islamit. Qëllimet pa varësi të qartë pasuese siç janë namazi, martesa dhe largimi nga shkelja e kurorës (zinaja) janë akoma mbështetëse të njëri-tjetrit, përveç kontributit të mbledhur për objektivin më të lartë të Islamit. Një prezantim skematik i këtij koncepti është ilustruar në figurën 3.



Figura 3. Mbështetja reciproke e qëllimeve paralele

Në fig. 3a, shohim dy qëllime paralele që kanë kontribut të mbledhur për objektivin më të lartë. Fig. 3b, rivendos të njëjtat komponentë të fig. 3a, por gjithashtu përmban një lidhje të mbështetjes reciproke në mes të dy qëllimeve paralele.

Shembulli i largimit nga tradhtia bashkëshortore (zinaja) nuk është i vetmi që tregon integrimin e mësimit islam. Në të vërtetë, ne mund të rivendosim të njëjtin argument, duke përdor çfarëdo mësimi islam. Një shembull tjetër është ndalimi i vjedhjes. Islami ndalon vjedhjen dhe për të implementuar këtë ndalesë, së pari e bën përgjegjës shtetin që të sigurohet se të gjithë banorëve të tij u sigurohen nevojat bazike të jetës. Njerëzit duhet të edukohen për të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve. Shtyllat e Islamit nuk i mbrojnë njerëzit nga arritja e një përgjegjësie të tillë, çdokush që vjedh do të ndëshkohet duke i prerë kyçin e dorës së tij/saj. Ky ndëshkim mund të duket i ashpër, por të shikojmë objektivin e tij. Objektivi i kësaj norme ligjore është ruajtja e pasurisë së njerëzve, e cila është mes pesë elementëve të jetës, duke ndaluar njerëzit nga vjedhja. Veç kësaj, kjo garanton ndershmërinë dhe drejtësinë, që janë ndër qëllimet e Islamit.

Integrimi i plotë i pjesëve të ndryshme të trupit të njeriut shpie te performansa më e mirë. Vrapimi i shpejt kërkon që gjithë trupi të angazhohet në lehtësimin e këtij ushtrimi dhe jo vetëm të këmbëve. Ne nuk mund të imagjinojmë një vrapues të shpejtë (sprinter) të fitojë garën, duke vendosur duart prapa, apo në kokën e tij. Lëvizja e duarve është e rëndësishme pothuaj sa lëvizja e këmbëve. Programet e veprimit organizativ duhet të janë mbështetës të njëri-tjetrit, për të arritur efektivitet më të lartë.

Planifikimi në mësimet e Islamit mund të parashikohet si një strukturë që duhet të përshtatet brenda një fqinjësie të caktuar në një qytet të caktuar, në një shtet të caktuar. Struktura duhet të skicohet për një mot të caktuar (duke përfshirë temperaturën, shiun, borën dhe erën), kushte gjeologjike të caktuara dhe sistemim të caktuar. Planifikimi islamik i ngjashëm shpjegon ndërlidhjet me mjedisin mesatar dhe të përgjithshëm të muslimanëve.

Plani i Islamit apo mësimet e Islamit përbëhen nga pako pune të ndryshme që duhet të implementohen në një sekuencë të caktuar. Si struktura fizike, plani supozohet të ketë disa shtylla, pa të cilat nuk mund të qëndrojë. Gjithashtu, plani duhet të ketë disa trarë, që duhen të mbështeten në shtylla, por gjithashtu duhet lidhur së bashku, duke mbështetur çatinë, dhe kështu duke forcuar stabilitetin e vetë shtyllave. Plani përfshin disa qëllime mesatare që janë të ngjashme me trarët në strukturën fizike.

Gjithashtu plani duhet të ketë anëtarë gjallërues diagonal për t'i shërbyer trysnive të mundshme nga mjedisi. Lidhjet në mes të pakove të punëve të ndryshme të planit, duhet t'i bëjë që ata të mbështesin njëri-tjetrin në atë mënyrë sikur të veprojnë si një njësi. Forma e planit duhet të paramendohet si një piramidë (shiko figurën. 4 poshtë, Integrimi i mësimeve Islame) apo një kon të përmbysur.



Mësimet islame specifikojnë veprime të caktuara që kurrë nuk duhet të ndërmerren. Këto veprime mund të konsiderohen si detyrime të ashpra, dhe mund të konturohen në politikat e një organizate. Detyrimet e ashpra janë të ngjashme me disa gabime të skicuara që mund të pengojnë stabilitetin e strukturës. Ky koncept planifikimi, përveç dimensionit të kohës përmban tri dimensionet e hapësirës. Organizatat moderne duhet të përpiqen të rivalizojnë konceptin e planifikimit shumë dimensional me qëllim të arritjes së efektivitetit më të mirë.

Përveç mënyrës së sistemeve, muslimanët përgjithësisht përvetësuan një mënyrë graduale në ndjekjen e qëllimeve të tyre.

- vijon -

Dr. Naceur Jabnoun

ISLAM AND MANAGEMENT – (2)

(Summary)

Mission

In this chapter we will present the overall mission of Muslims as contoured by the teachings of the Qur’an. Moreover, it presents the lessons that an organization can learn from it.

The mission is the “business” in which an organization is involved. In general, the mission is a formulation of the stance, views and orientation - a formulation of details and measurable objectives. In general, it includes the product and the service, the market and the kind of operations adopted by a firm.

د. نصر جابنون

الاسلام و الادارة

(خلاصة البحث)

الرسالة:

سوف نتناول في هذا الباب الرسالة بصورة عامة و المهمة التي يقوم بها المسلمون طبقا لمبادئ القرآن الكريم و الدروس التي يمكن لمنظمة ما أن تأخذها من هذه الرسالة.

و لقد تم تعريف الرسالة هنا "كتجارة" تقوم بها منظمة و يمكن القول بأن الرسالة بصورة عامة في موقف خاص تجاه أمور عامة أكثر من أن تكون الخوض في الامور الخاصة و الاهداف المحددة تحديد الرسالة بصورة عامة يتناول الانتاج و الثمار او الخدمة و كذلك أنواع الثمار الناجمة من شركة محددة.

PORTRETE

Qemajl Morina

SAMI FRASHËRI NË KRYE TË GAZETËS "TARABLUS GARB"NË TRIPOLI TË LIBISË

Diapazoni i gjerë i njohurive në fusha të ndryshme të veprimtarive kulturore-shkencore dhe shoqërore ka bërë që Samiu në kohën e vet të depërtojë shumë thellë në qarqet shkencore edhe jashtë Turqisë, ku jetonte dhe vepronte.

Sami Frashri, si njeri me njohuri të thella dhe të gjithanshme, i cili merrej jo vetëm me krijimtarinë letrare, si dhe me punën kreative shkencore, ai u shqua edhe si një publicist i kalibrit të lartë. Këtë më së miri e dëshmon veprimtaria e tij e gjerë në këtë lëmi. Ai krijoi emër e reputacion si gazetar e publicist në opinionin turk, ndërkaq roli i tij në publicistikën turke është shumë i madh. Që nga viti 1872 e deri më 1881 ai u mor me këtë veprimtari në mënyrë aktive.

Në moshën 23-vjeçare, Samiu hyn në redaksinë e revistës "Hadika," (Kopshti) brenda një kohe shumë të shkurtër lidhi miqësi pune në fushën kulturore me penat më të njohura letrare turke, me Ashir Efendiun, Ebu Zija Tefikun, Ahmet Midhatin, Namik Kemalin, e ca të tjerë. Me përkrahjen e tyre morale pas një viti e mori në dorë atë revistë, e drejtoi dhe e bëri organ të qarqeve demokratike turke.

Revista "Hadika" qe jetëshkurtër, ajo u mbyll për idetë progresiste që zhvilloheshin në të, pasi që Samiu kishte nxjerrë 72 numra të saj.

Në gjysmën e dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë, me nxjerrjen e ligjit të ri për formimin e vilajeteve në Perandorinë Osmane, më 1864, edhe Tripoli u shpall si vilajet. Atëherë sipas këtij ligji, në qendrën e çdo vilajeti u themelua nga një shtypshkronjë me nga një gazetë zyrtare apo gjysmëzyrtare. Kështu edhe në Tripoli filloi të dilte një gazetë në atë kohë, me titull "Tarablus garb" (Tripoli perëndimor) në dy gjuhë-arabishte e turqishte. Në krye të kësaj gazete erdhi shkrimtari i njohur i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Sami Frashëri (në vitin 1874). Ardhja e Samiut në krye të kësaj gazete ishte e natyrshme, pasi ai njihte jashtëzakonisht mirë gjuhën e kulturën arabe. Ndonëse Sami Frashëri qëndroi në Tripoli vetëm një vit, ai zhvilloi një aktivitet të madh gjatë asaj kohe. Mjafton të përmendet këtu se ai shkroi (në Tripoli) dramën e tij të njohur "Besa", e cila la ndikim si në dramaturgjinë turke, ashtu edhe në atë shqiptare, pas shqipërimit të saj më 1901. Ç'është me rëndësi, kjo dramë ka të bëjë edhe me praninë e shqiptarëve në Libi, përkatësisht me atë shtresë të vullnetarëve shqiptarë që shkonin në Tripoli për shërbime luftarake. Njëra prej figurave kryesore në këtë dramë është Fetahu, nga fshati Brosh, i cili qëndroi njëzet vjet në Tripoli, ku kaloi rininë nën "forcën e vapës dhe mundimin e luftës". Atij i kujtohej se kur doli prej fshatit për në Tripoli "kishin dalë e tërë afria, gjithë miqtë për të përcjellë". Atëherë, prej atij fshati ai u nis me njëzet e katër burra, por prej tyre nuk u kthyen më shumë se pesë. Ndonëse Fetahu kthehet më në fund në atdhe me një ngushëllim se "me qenë q'ate vend e shtruam, s'na duken mundimet fare!". Samiu nuk pajtohet me këtë fat të shqiptarëve derisa atdheu i tyre kishte nevojë për potencialin e tyre ushtarak, që u shpenzua në të vërtetë në

drejtime të ndryshme. Prandaj, figura tjetër e kësaj drame, Arsllani, shpreh qartazi qëndrimin dhe revoltën e Samiut kundër këtij fati: “Unë i kam zili fatit të atërvet t’anë! Kocka e ati t’endit në shkretëtira të Tarabullusit !” Sipas tij, del se “vdekja që ngjan për nder të mëmëdheut është më mirë se të gjitha!”.

Shumë biografë të Samiut mendojnë se dërgimi i tij në Tripoli të Libisë, në vitin 1874 ishte një lloj internimi për të. Me qëllim që të jetë larg rrjedhave të jetës në kryeqytetin e Perandorisë Osmane. Samiu nga numri 256, e mori ta drejtojë gazetën javore zyrtare “Tarablus garb”. Sido që të jetë shkuarja e tij në Tripoli dhe caktimi i tij në krye të gazetës ishte një përvojë e mirë për Samiun. Qëndrimi i tij njëvjeçar atje i solli atij njohuri të reja. Ai u njoh me një ambient të ri nga ai i Stambollit. Aty u njoh edhe me shumë shqiptarë, që kishin ardhur nga troje të ndryshme shqiptare për shkaqe të ndryshme, qofshin si ushtarë për të shërbyer në ushtrinë osmane apo edhe si tregtarë nga qytetet e bregdetit shqiptar, në veçanti nga Ulqini.

Ballina e gazetës “Tarablus Garb”, nr. 258 e 20 qershorit 1874,
pasi që Samiu kishte marrë udhëheqjen e saj

Në të njëjtën kohë, Samiu me vizionin e tij prej dijetari dhe me përvojën e tij të gjatë në gazetari, solli një shpirt të ri në faqet e gazetës “Tarablus garb”. Kjo më së miri shihet nga numri 256 i 10 qershorit 1874, ku bëri freski si në fizionominë, por edhe në përmbajtjen e gazetës. Në veçanti e pasuroi atë me tema nga lëmi i kulturës së përgjithshme. Mbetet obligim i studiuesve, në veçanti studentëve shqiptarë që studiojnë në Tripoli të Libisë, që t’ia shtrojnë vetes për obligim

t’i hulumtojnë në detaje numrat e kësaj gazete gjatë periudhës sa ishte Samiu kryeredaktor i saj. Aty do të gjenden shkrime me vlerë të Samiut për çështjen shqiptare. Sepse mundësitë e tij për veprim në rrafshin patriotik kombëtar ishin më të mëdha, kur dihet se në ato vite një lëvizje e tillë për një çlirim kombëtar kishte nisur edhe në vendet e ndryshme arabe, duke përfshirë edhe Libinë.

Më 1875 Samiu u kthye nga Libia, dhe në pranverë të vitit 1876, e gjejmë redaktor të gazetës së parë ditore turke “Sabah” (Mëngjesi), të cilën e drejtoi deri në numrin 257. Në vitin 1878, nga 23 qershori, Samiu mori ta drejtonte gazetën “Trexhuman-i Shark” (Interpreti i Lindjes), nga numri 74 dhe këtë punë e ushtroi deri në numrin 179. Kjo është gazeta e fundit informative që ka drejtuar Samiu. Por, Samiu prapë ishte i pranishëm në shtypin turk, ngase ai shkroi, madje edhe polemizoi edhe në gazetat “Ibret” (Këshilla), “Vakt” (Koha), “Terxhuman Hakikat” (Interpreti i të vërtetës) e në ndonjë tjetër, por më nuk ka drejtuar gazetë informative. Kjo mund të ketë ngjarë për shkak se siç shihet, puna e tij si drejtues gazete nuk zgjaste shumë, për shkak të guximit të tij që problemet shoqërore e politike t’i trajtonte shtruar e haptas, edhe pse ishte i vetëdijshëm se me shkrimet e tij ua prishte rehatinë qarqeve sunduese të kohës së tij.

Qemajl Morina

SAMI FRASHËRI – EDITOR OF THE “TARABULUS GARB” NEWSPAPER IN TRIPOLI (LIBYA)

(Summary)

The wide spectrum of knowledge in different areas enabled Sami Frashëri to join prestigious circles outside Turkey.

Sami Frasheri was an erudite with deep knowledge in many different areas. Apart from being known for his literary work he is also known for his scientific work and as a publicist. This can be best proved by his activity in the field of publicistics. In Turkey, he made a name as a journalist and publicist. His role in Turkish publicistics is great. Between 1872 and 1881, he was actively involved in such activities.

كمال مورينا

سامي فراشري رئيسا لتحرير جريد طرابلس الغرب

(خلاصة البحث)

إن الافاق الواسعة العلمية و الثقافية التي كان يتمتع بها سامى فراشري جعلته يشتهر خارج حدود الدولة التركية التي كان يعيش و يعمل بعاصمتها استانبول.

سامى فراشرى إشتهر ككاتب و عالم بالاضافة إلى ذلك أصبح معروفا في مجال الصحافة و أحسن دليل على ذلك هو عمله الطويل على رأس أشهر الصحف التركية التي كانت تصدر في ذلك الوقت و بصفة خاصة خلال الفترة من 1872–1881م.

KUMTESA

Jahja Hondozi

KRIJIMTARIA LETRARE E SHEH HILMI MALIQIT[1] (1865-1928)

Sheh Hilmi Maliqi konsiderohet njëri ndër shkrimtarët mjaft të frytshëm të letërsisë së bejtexhinjve duke qenë njëherësh përfaqësuesi kryesor i kësaj letërsie te shqiptarët në Jugosllavinë e paraluftës.

Gjatë dyzet vjetëve të veprimit të tij në Rahovec, Hilmi Maliqi zhvilloi një veprimtari letrare mjaft të begatshme si në prozë ashtu edhe në poezi.

Duke qenë një njohës i mirë i gjuhëve të Lindjes, ai bëri një punë të madhe e të shkëlqyeshme në fushën e përkthimeve nga arabishtja e persishtja në gjuhën shqipe dhe turke.

Veprimtaria e tij qe një përpjekje unike për të parandaluar një katandisje fetare e kulturore që po u kanosej shqiptarëve atëbotë.

Veprat origjinale të Hilmi Maliqit janë: Divani, Elifi dhe Risalet.

1. Divani - mund të konsiderohet me të drejtë kryevepra e Hilmi Maliqit. Ai përfshin gjithsej 83 poezi - vjersha, 81 prej të cilave janë shkruar në gjuhën shqipe, ndërkaq 2 në gjuhën serbokroate. Është

[1] Kumtesë e lexuar më 26. 12. 2008 në akademinë përkujtimore, që është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës në Rahovec, me rastin e 80-vjetorit të vdekjes së Sheh Hilmi Maliqit.

shkruar me alfabet arab, meqë shkrimi me germa shqipe ishte rreptësisht i ndaluar atëbotë.

Në fletën e tij të parë sheh Mala ka shënuar: *“Ky Divan asht shkrue në guhën shqipe”*.

Përmbajtja e shkrimeve të tij është më tepër fetare, por edhe didaktike dhe shpeshherë edhe lirikë e bukur.

Me bejtet (vargjet) e tij, ai apelon vazhdimisht te të gjithë njerëzit që të zgjohen nga plogështia e letargjia dhe ta e njohin të vërtetën absolute. Ai shpesh shprehu edhe pakënaqësi dhe frustrime duke konstatuar se punët kanë vajtur larg.

Me anë të poezive të tij, sheh Mala nxirrte në shesh dyfytyrësinë, syfaqësinë dhe demagogjinë e njerëzve të asaj kohe, dhe këtë e bënte me një gjuhë të butë përplot me këshilla.

Kështu, në divanin e tij e gjejmë të shkruar edhe këtë varg:

“Mos vesh hërk edhe qylah hallki me t’pa
Zemrën bone paq Perënija na tha”.

Sheh Maliqi, me një stil të rrallë e me një dozë ironie po mjaft e qëlluar, vë në pah qartazi qëllimin e krijimit të njeriut dhe ardhjen e tij në këtë botë.

Kështu, ai shprehet:

“Mire vesh ti ça je ardhun në xhihan
Mos rri lidhun ti në grazhd sikur hajvan
Ban tefekkur ku jam ardhun ku jam kan
Mos vikat krauv nëpër shpija si quran”.

Ai e këshillonte xhematin (besimtarët) e vet që të mos e kalojnë kohën kot, por të kërkojnë qamil - mësues, dije, njohuri, ngase kjo është çelësi i lumturisë.

Këto mendime ai i shpreh në vargjet e tij, ku thotë:

“Mos u sill n’alem sikur jabanxhija,
Lyp qamil qi t’çon te Hakk Madhnija!”

Në vjershën me titull *Halli i flutrës*, poeti thur vargje të bukura lirike, por njëkohësisht mjaft domethënëse, në të cilat fshihet edhe botëkuptimi i tij fetar, i shprehur në mënyrë figurative dhe diskrete:

“Halli i flutrës po m’huton,

Gjith kah zjarmi qysh po shkon,
Kurrkush t'ngratën s'un p'e mbron
Gjith kah zjarmi qysh po shkon."

Divani i tij ka zgjuar interesim të madh te studiuesit dhe hulumtuesit e shumtë, sidomos pas gjysmës së dytë të shekullit të kaluar.

Megjithëkëtë, edhe sot e kësaj dite, ai ka mbetur i pabotuar në tërësi, po duhet përmendur që atë pjesërisht mund ta gjejmë te përmbledhja "Poezia e bejtexhinjve" përgatitur nga Hajdar Salihu.

Një kontribut të çmuar mbi divanin ka dhënë edhe dr. Isa Memishi, i cili e ka trajtuar atë nga aspekti gjuhësor në disertacionin e doktoratës me titull: *"Transkriptimet e shkrimeve shqipe me alfabet arab"*.

Origjinali i Divanit sot ruhet në teqenë e melamive në Rahovec. Mund të konstatohet me plot të drejtë se ndonëse është shkruar para më se njëqind vjetësh, nuk e ka humbur aspak vlerën dhe rëndësinë e tij të rrallë.

2. Elifi ose Alfabetarja - është një tjetër vepër e Hilmi Maliqit. Ajo është një vepër didaktike me 29 shenja të alfabetit arab.

3. Risalet - është një përmbledhje prozaike në gjuhën shqipe, e cila përfshin gjithsej 16 tregime të shkurtra, ku trajtohen dispozitat dhe parimet e besimit islam.

Disa nga këto kanë tituj mjaft interesantë, si p.sh.: *"Fillesa e kitabi ezel"*, *"Mullari i zemrës"*, *"Kopshti i dashurisë"*, *"Loçka e zemrës"* etj.

4. Përveç këtyre veprave që i përmendëm më sipër, Hilmi Maliqi ka shkruar edhe disa ilahi - vargje në turqisht.

Në fushën e përkthimeve, Hilmi Maliqi ka dhënë gjithsesi një kontribut mjaft të çmuar. Ai, kështu, përktheu nga arabishtja veprën "Varidat" nga autori arab Bedruddin Sulltani (vdiq më 1420). Ajo radhitet njëra ndër veprat më të rëndësishme të mistikës islame, e cila shtjellon

dhe trajton diskutime dhe shpjegime të filozofisë islame. Veprën e Bedruddin Sulltanit, Sheh Mala e ka përkthyer edhe në gjuhën turke.

Dorëshkrimi i veprës "Varidat" në gjuhën shqipe ka rreth 400 faqe dhe gjendet po ashtu në teqenë e melamive në Rahovec.

Krijimtaria e tij letrare kësisoj do të bëhet objekt studimi për studiuesit dhe hulumtuesit e shumtë.

Sado që e pabotuar në tërësinë e saj, vepra letrare e Sheh Malës ka tërhequr interesimin e albanistikës në përgjithësi prej gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e këndej.

Në të ardhmen, u mbetet detyrë dhe përgjegjësi studiuesve dhe hulumtuesve që t'i zbardhin e t'i nxjerrin në dritë këto vepra të këtij krijuesi mjaft të frytshëm, t'ia shkundin pluhurin atij thesari të rrallë, i cili është lënë pas dore qe një kohë të gjatë.

Vepra e tij meriton ta shohë dritën ashtu që nga ajo të kenë dobi të gjithë admiruesit e trashëgimisë fetare, kombëtare e kulturore.

Jahja Hondozi

THE LITERARY WORKS OF SHEIKH HILMI MALIQI* (1865-1928)

(Summary)

Sheikh Hilmi Maliqi was a bejtexhi writer, the most distinguished representative of this literary gender among the Albanians in Yugoslavia.

He left a large number of writings in the form of prose and poetry.

Being fluent in a number of oriental languages he did a great work in the field of translation (from Arabic and Persian into Albanian and Turkish).

His activity was a unique effort to stop the religious and cultural decline of the Albanians at that time.

يحيي هندوزي

الاعمال الادبية للشيخ حلمى مالك (1865–1928)

(خلاصة البحث)

يعتبر الشيخ حلمى مالك من بين أكثر الكتاب انتاجا للشعر البيتجى و يعتبر في نفس الوقت الممثل الرئيس لهذا الجنس الادبي بين الالبانيين في يوغسلافيا السابقة قبل الحرب العالمية الثانية.

قدم الشيخ حلمى مالك خلال عمله الدؤوب لمدة أربعين سنة بمدينة راهوفس انتاجا أدبيا وفيرا في النثر و الشعر. و بما أنه كان لديه معرفة جيد للغات الشرق هو قام بعمل ممتاز في مجال الترجمة من العربية و الفارسية إلى اللغة الالبانية و التركية. إن عمله الادبى كان بثمانية محاولة جادة لإنقاذ الشعب الالباني من اضياع الثقافي و الدينى و القومى.

ESE

Avni Aliu

ËSHTË JETËSORE TË NDIQET RRUGA E ZOTIT

”Sa për ata që ndjekin rrugën e drejtë, Ai ua shton udhëzimin dhe u jep devotshmëri e vetëpërmbajtje”[1]

”Cili është më i udhëzuar: ai që ecën kokëposhtë me sy në tokë, apo ai që ecën drejt e i matur në Rrugën e Drejtë”[2]

Ju ka rënë të dëgjoni në ndonjë tubim fetar akëcili të thotë: ”Zemrën e kam të pastër.” Po këto fjalë, në formë pyetjeje, më rastisi edhe mua t’i dëgjoj nga goja e një djaloshi me pamje të butë, fytyra e të cilit shprehte plot mirësi, plot fisnikëri morale, ndonëse një çikë ishte i shqetësuar, por fliste me gjuhë të bukur dhe të rrjedhshme vetëm herë pas here i ngatërrohej gjuha dhe i ngecte të folurit: ”Po mirë, Hoxhë - marr guximin t’ju pyes - si qëndron puna me ata njerëz që nuk ndjekin rrugën e Zotit, por thonë me plot gojën: ”Zemrën e kam të pastër. Kam nijetin e mirë”?!

Ndonëse kisha për qëllim të flisja për një çështje krejtësisht tjetër, por me të vërejtur interesimin dhe disponimin e të pranishmëve që ishte kthyer më tepër nga pyetja e këtij të riu, ndërrova temë, dhe vazhdova të përgjigjem në pyetjen që u shtrua: Të thuash ”zemrën e kam të pastër” etj., - s’ke thënë asgjë, nëse kjo nuk dëshmohet në vepër. Vetëm aktiviteti mund të gjykohet nga të tjerët, jo përmbajtja e zemrës. Vetëm Zoti mund të shikojë në zemrat e njerëzve e të gjykojë qëllimet e mendimet e tyre. ***”Zoti e di se çfarë është në zemrat e tyre.[3],*** kurse ne nuk e dimë çfarë ka në zemrat e njerëzve të tjerë. Me qëllim të sqarimit më të mirë dhe për bindjen tuaj më të mirë, këtu po sjell një hadith shumë të famshëm, duke kritikuar një shok që gjykonte se ushtrimi i besimit nga dikush ishte fals, Pejgamberi a.s., pyet: ”Ia hape gjë zemrën për të parë?” Besimi është çështje midis Zotit dhe qenieve njerëzore. Kjo sa i përket besimit. Sa i përket aktivitetit apo veprimit njerëzor, varet nga shëndetshmëria e zemrës dhe pastërtia e saj. Po përmendim një hadith shumë domethënës të Pejgamberit a.s.: ”Dijeni se në trup ndodhet një organ, i cili, po qe i shëndoshë, i gjithë trupi është i shëndoshë, e po qe i sëmurë, i gjithë trupi sëmuret. Ky organ është zemra”.[4] Në një hadith tjetër të cilin e transmeton Taberaniu[5] Muhammedi (a.s.) duke bërë fjalë lidhur me shenjat e shëndetshmërisë së zemrës, e cila reflektohet nga vendosmëria e njeriut në fe dhe guximi e tij për të vërtetën ka thënë: ”Allahu i Madhëruar ka në tokën e Tij disa enë, që janë zemrat e njerëzve. Më pranë Tij janë ato më të butat, më të pastrat dhe më të qëndrueshmet. Pastaj ai e komentoi këtë me këto fjalë: butësia nënkupton frikën ndaj Allahut, pastërtia është për vëllezërit e fesë dhe qëndrueshmëria nënkupton vazhdimësinë e bindjes ndaj Allahut”.

Është detyrim i myslimanit t’i kushtojë kujdesin e duhur zemrës së tij, të njohë gjendjen e saj, të jetë i vëmendshëm në pastërtinë e saj [6],

[1] Kur’ani, sura Muhammed, ajeti 17.
[2] Kur’ani, sura El-Mulk, ajeti 32.

[3] Kur’ani, 33: 51.
[4] Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
[5] Taberaniu, hadithi është hasen - i mirë.
[6] Zemër e pastër është ajo që nuk është e ndotur nga asnjë lloj shirku. Në konceptin islam, zemra ka dy kuptime: kuptimi material, domethënë, zemra si organ; dhe kuptimi abstrakt, ku zemra perceptohet si burim i ndjenjave dhe i mendimeve. Kështu, në Kur’an, fjala “zemër” përdoret në kuptimin e dytë. Kur zemra është e pastër edhe mendimet edhe ndjenjat e njeriut janë në rregull, njeriu është në rregull nga të gjitha drejtimet, edhe nga ana e shëndetit. Ndërsa, kur zemra degjenerohet, edhe jeta materiale e shpirtërore e njeriut është e tillë. E vërteta është se, me anë të mendjes e kuptojmë se ç’është mire, e

të kuptojë aktivitetin e saj apo edhe indiferencën e saj. Gjendja e mirë dhe e keqe e trupit lind nga zemra, sepse ajo është vendi nga fillojnë lëvizjet trupore dhe dëshirat. Çfarëdo vlere që lind në zemër ndikimi i saj do të reflektojë edhe në organet e trupit, ashtu që ato do të veprojnë në përputhje me atë vlerë. Një zemër medituese, e gjallë, aktive e cila gjallërisht dhe thellësisht mediton mirësitë e Allahut të Plotmëshirëshëm dhe ka kujdes për jetën e amshueshme mund t'i hetojë lehtë idetë e këqija**.** Dëshirat e mira janë pasojë e ruajtjes së zemrës nga sëmundjet e saj, si zilia, koprracia, mendjemadhësia, urrejtja, mashtrimi etj., ndërsa dëshirat e këqija janë pasojë e zemrës së prekur nga sëmundjet e mësipërme. Gazaliu, në librin e tij "Ihja Ulumi'd Din" përdor një krahasim interesant[7], i cili, në një kuptim hedh dritë në këtë temë. Ai thotë se zemra e njeriut ngjason me një pasqyrë që pasqyron figura të mira e të qarta kur fshihet ose kur lustrohet. Zemra e njeriut bëhet e ndriçuar me cilësi fisnike dhe kështu, i pasqyron më mirë të vërtetat dhe realitetet; por, kur preket nga cilësi të mbrapshta, atëherë, si një pasqyrë e mbuluar me pluhur, ajo nuk mund t'i pasqyrojë realitetet. Për të njëjtën arsye, "mosdëgjimi" lidhet me "vulosjen e zemrës" për arsye të veprave të gabuara, siç tregohet në ajetin e mëposhtëm të Kur'anit të shenjtë: ***"…Po të donim Ne, Ne do t'i dënonim për mëkatet e tyre dhe do t'ua mbyllnim zemrat e tyre, kështu që ata nuk do të dëgjonin"***[8] ose ajeti tjetër: ***"Jo, nuk është ashtu! Por të këqijat që punuan, ua mbuluan zemrat".***[9] Kështu, dëgjimi i fjalës së drejtë lidhet me devotshmërinë; mosdëgjimi i fjalës së drejtë ose vulosja e zemrës lidhet me mëkatet. Me një rast është pyetur Muhammedi a.s.: "O i Dërguari i Allahut! Kush mund të jetë njeriu më i mirë"? Ai tha: "Çdo besimtar zemërpastër." Pastaj e pyetën: "E ç'është zemërpastërtia"? Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Ai është i devotshmi që nuk mashtron, që nuk sulmon, që nuk tradhton, që nuk urren, që s'ka zili."

ç'është keç, por me anë të zemrës vendosim se ç'duam apo se ç'do të punojmë, do punojmë mirë apo keq.

[7] Ebu Hamid Muhammed el-Gazali, op.cit, vëll. 3, f. 12-14.

[8] Kur'ani, sura El-A'raf, ajeti 100.

[9] Kur'ani, sura El-Mutafifin, ajeti 14.

Qetësimi dhe strehimi i njeriut tek Allahu në çfarëdo kushtesh dhe rrethanash janë, gjithashtu, shenja që tregojnë shëndetshmërinë e zemrës. Në Kur'anin famëlartë Allahu i Lartësuar thotë: ***"Atij që Allahu ia ka zgjeruar kraharorin për besimin islam, ai është në një dritë të sigurt prej Zotit të tij".***[10] Duke e komentuar këtë ajet, Muhamedi a.s. ka thënë: "Me zgjerimin e kraharorit nënkuptohet kur drita që hidhet në zemër, bën që të zgjerohet, (çlirohet, lehtësohet) dhe hapet gjoksi."

Meditimi dhe veprimi

Meditimi dhe veprimi janë dëshmi e zemrës së pastër dhe e shëndetit të saj. Zoti i Gjithëfuqishëm krijesës më të zgjedhur - njeriut i ka dhënë flamurin e që është zemra, e cila, kur i hidhet drita e Zotit, ajo zgjerohet dhe bëhet e aftë të bëjë vend për njohjen e Allahut, për dashurinë ndaj Tij, adhurimin ndaj Tij, sinqeritetin ndaj Tij, mbështetjen tek Ai dhe pendimin para Tij. Njeriu, në zemrën e të cilit ekziston imani dhe zemra e të cilit është e ndriçuar me nurin e Zotit, nuk mundet dhe nuk guxon të jetë e dëmshme. Ai imanin e vet e argumenton vetëm me vepra të mira. Aq sa u bën mirë të tjerëve, aq i vlen edhe imani. Zemra e ndien, e pranon dhe e përjeton të vërtetën, ndërsa mendja e zbulon. Mendja është kreatore e teorisë, kurse zemra e praktikës. E vërteta mbetet në fjalë, në teori, në abstraksione gjithë derisa sublimen e saj nuk e pranon dhe nuk e përjeton zemra dhe përmes vullnetit nuk e shndërron në vepër. Kur'ani i Lartësuar zemrës i kushton vend të veçantë në më se njëqind ajete. Vlera dhe përparësia e njeriut qëndron pikërisht në atë që iu është dhënë nga Zoti, në atë që iu është frymëzuar e që ne e quajmë zemër dhe shpirt.

Ai i cili është ngjitur në lartësinë e besimit dhe ka dhënë dëshmi të një fisnikërie të zemrës, të një lartësie shpirti dhe shëndeti të mirë moral në të cilën nuk arrihet pa një lartësi të njëjtë besimi e bindje e mendimi në Zotin, e ka të qartë se bota e këtushme është vendi për të bërë vepra të mira, për të ndërtuar dhe për të vënë rend. Çdo gjë e saj është krijuar për t'i shërbyer njeriut të përmbushë misionin e tij si më-

[10] Kur'ani, sura Ez-Zumer, ajeti 22.

këmbës i Zotit në tokë, duke e populluar atë, duke vendosur rend, duke përdorur çdo gjë të saj për vullnetin e tij të mirë, duke u kujdesur për të, duke e shfrytëzuar me efektshmëri dhe pa shpërdoruar duke mbjellë fesad e shkatërrim anembanë saj. Lidhur me këtë Kur'ani urdhëron: ***"Dhe përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu. Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët."***[11]

Ai i cili është ngritur në lartësinë e besimit, e ka të qartë, gjithashtu, se vullneti i lirë i njeriut buron nga dituria absolute e të Gjithëfuqishmit dhe ekziston në saje të urdhrit të Tij. "Ai, përbën një nga mrekullitë e krijimit të Allahut", siç do të thoshte njëri nga dijetarët e njohur,[12] dhe një shenjë të madhështisë dhe fuqisë së tij." Ai e krijoi atë me vullnetin e Vet, ashtu siç krijoi gjithçka tjetër. Ai, i qofshim falë, e veçoi dhe e nderoi njeriun duke i dhënë lirinë e zgjedhjes.

Njerëzit janë krijesat më të nderuara të Allahut xh.sh., sepse Ai u dha atyre privilegjin e vullnetit të lirë. Nëse ata ndjekin të vërtetën me zgjedhjen e tyre dhe, vendosin marrëdhënie të drejta me Krijuesin, ata do të jenë eprorë dhe të suksesshëm.

Nëse u referohemi teksteve kur'anore do të na bëhet e qartë se marrëdhënia e njeriut-krijesë me Allahun-Krijues është marrëdhënie disipline me bindje dhe kontroll të plotë, dhe jo skllavërie e zvetënimi; është marrëdhënie përgjegjësie dhe nderimi, dhe jo poshtërimi e shfrytëzimi. Kthimi i njeriut tek Allahu, ndjekja e urdhrave të Tij, dhe shmangia nga ato që Ai ka ndaluar, është marrëdhënie respekti dhe nderi, sepse e arrin të Vërtetën, e cila është e mirë dhe reale, arrin Rrugën e Drejtë, qëllimin e lartë për të cilin mundohen të gjithë njerëzit e mirë. Njeriu lartësohet nëpërmjet përpjekjeve të tij, prandaj në të kuptuarit islam të kësaj marrëdhënieje nuk ka vend për koncepte të tilla si zvetënimi, poshtërimi, shfrytëzimi, përbuzja, e tjera e tjera.

[11] Kur'ani, sura El-Kasas, ajeti 77.
[12] Abdul Hamid A. Sulejman, Kriza në mendjen e muslimanit, Tiranë 2006, f. 92.

Mirëpo, çka ndodh me njeriun e sotëm? Ndodh që ndonjëherë ai të mos e gjejë vetveten në mjedisin që ia ka caktuar Zoti. Shpeshherë ndodh të harrojë pozitën që ka dhe fillon të ndjekë një rrugë të gabuar. Vazhdon të jetojë sikur Zoti të mos ekzistonte. Vazhdon të jetojë duke i përbuzur ligjet e Tij, duke gënjyer, duke mos pasur aspak respekt për prindërit, dhe aspak për emrin e Allahut. Atëherë ai po e shkatërron qëllimin e jetës. Madje, jo rrallë do të hasësh individ, të cilin, po ta pyesësh se cilës përkatësi fetare i përket, ngurron të tregojë. E ka për turp të thotë: "Unë jam mysliman, i takoj besimit islam!". Po edhe nëse të thotë, nuk gjen kurajë të të shikojë drejt në sy. Të tillët, madje, nuk marrin guximin të hyjnë në xhami as për ditë feste të Bajramit!!

Ndërkaq, nëse njeriu devijon nga rruga që ka caktuar Zoti dhe injoron të vërtetën, ai do të bëhet i lig dhe i dhunshëm. Asgjë s'është më lehtë për njeriun se të bëhet rob i barkut të tij. Dhe lëshimi i njeriut në epshe, s'do mend, sjell krizë shëndetësore morale, probleme, vështirësi, pakënaqësi, dëshira, të këqija e të mira. Kështu, varfëria shpirtërore, përmbysja e vlerave, imoraliteti, mbizotërimi i kiçit e i shundit, arroganca e kiç njerëzve sidomos në medie, papërgjegjshmëria, korrupsioni, luksi i shfrenuar, privilegjet e paarsyeshme e të palejueshme, padrejtësitë e llojllojshme, të cilat ngufasin jetën dhe botën njerëzore - të gjitha këto janë të këqija, të cilat do të duhej t'i shohim qartë në dritën e diellit dhe t'i emërtojmë qartë, ndaj, të bëjmë përpjekje që të shërohemi prej tyre. Këtë e urdhëron Kur'ani: ***"Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun…"***[13] Dhe në një vend tjetër urdhëron e thotë: ***"Le të ketë prej jush një grup që të thërrasë për mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit".***[14] Sa të nevojshme për ne këto mesazhe të Kur'anit, sidomos kur jeta njerëzore është bërë dinamike dhe po zhvillohet me një ritëm të shpejtë. Së këndejmi, ky zhvillim dinamik i jetës njerëzore, paraqet edhe probleme të reja, ne-

[13] Kur'ani, sura Ali Imran, ajeti 100.
[14] Kur'ani, sura Ali Imran, ajeti 104.

vojën për marrjen e qëndrimeve të reja, pikëpamjeve të një filozofie të re dhe kërkon zgjidhje të reja konform vullnetit dhe Ligjeve të Zotit. Dhe kjo mund të arrihet vetëm me shpirt të shëndoshë besimor dhe me ndërgjegje të pastër.

Shikoni se ç'po ndodh rreth nesh! Njerëzit thjesht nuk mund të gjejnë një rrugëdalje nga vështirësitë, madje as ata që fitojnë para të mëdha. Të gjithë janë të shqetësuar. Kë të pyesësh për jetë e për halle, të thotë: "Nuk është mirë". Njëmend, asgjë nuk shkon mirë në jetën e tyre private dhe çdo gjë shkon keq në jetën e tyre familjare.

Tani, pikërisht, duhet t'ju them këtë gjë: Askush nuk mund t'ia dalë mbanë në jetë pa besim te Zoti dhe pa ndjekjen e Rrugës së Tij, të cilën rrugë e jetësoi Pejgamberi, Muhammed (a.s.) Me vetë faktin se njeriu, si qenia më e përsosur, posedon bërthamën shpirtërore të pavarur dhe vullnetin e lirë, është përgjegjës për të, për veprimet që bën dhe për komunitetin ku ndodhet. Prandaj, duhet të jetë i vëmendshëm: Të edukojë shpirtin. Të ketë shëndet të mirë shpirtëror. Për myslimanët, rritja shpirtërore e njeriut është i lidhur në mënyrë të pandashme me të gjitha format tjera të natyrës së tij.

Me qëllim të qartësimit të kësaj çështjeje me sa është e mundshme themi kështu: njeriu ka dy natyra që e përmbushin dhe e plotësojnë njëra-tjetrën. Këto janë natyra e brendshme dhe natyra e jashtme, të cilat nuk mund të ekzistojnë pa njëra-tjetrën. Natyra e brendshme e njeriut i takon shpirtit dhe natyra e jashtme e tij i takon trupit. Natyrës sonë si njeri duhet t'i kushtojmë vëmendje. Trupi kërkon ushqim, ujë dhe ajër: me këtë nuk kemi bërë asgjë të keqe, nëse kësaj kërkese ia plotësojmë dëshirën. Mirëpo, jo një herë është thënë se njeriu nuk jeton vetëm nga buka. Nëse gjykojmë të lëmë pas dore shpirtin, atëherë jemi gjykuar për shkak të grykësisë mëkatare. Pse? Sepse si njeri i humbur, i pavëmendshëm, shkapërderdhës i pasurisë, mjafton të jetë shembull i mirë për këtë të keqe të zgjeruar njerëzore. Ai është bërë rob i materializmit. Prandaj, nuk mjafton të thuhet: "Kam nijetin e mirë. Kam zemër të pastër", etj., në qoftë se ajo nuk e ka gjetur mjedisin e vet, vendin e vet.

Ata që pretendojnë në pastërtinë e zemrës pa ndjekur rrugën që e ka caktuar Zoti i Lartësuar, vazhdojnë të jetojnë sikur Zoti të mos ekzistonte. Ata nuk mund të jetojnë as mund të vdesin në paqe. Dhe prandaj ne insistojmë në domosdonë e të besuarit në Zotin, në respektimin e Ligjit të Tij dhe në ndjekjen e Rrugë së Tij. Ndryshe do të ndodhemi në një gjendje pa rrugëdalje! Zemra është nuri (drita)i trupit. Shkenca që merret me ndreqjen e zemrës, ka si kusht të saj punën me gjymtyrë dhe sinqeritetin në zemër. "Nëse ti do të veçosh nijetin në zemrën tënde duke thënë që mjafton vetëm zemra e pastër, pastaj ti vjedh, bën imoralitet, merr kamatë, gënjen, pi alkoolin, je mendjemadh, atëherë çfarë vlere ka nijeti dhe zemra jote e pastër. Edhe nëse e adhuron Allahun, agjëron, fal namaz dhe je i thjeshtë, ndërsa në zemrën tënde ke syfaqësinë dhe shkatërrimin e të tjerëve, atëherë çfarë vlere ka puna jote?!" Ajo zemër që nuk ka bazë edukative në fe të Allahut, nuk mund t'u rezistojë sfidave e joshjeve të ulëta që ofron jeta, vardiset e sorollatet andej kah e thërret zëri i egos. Ajo zemër nuk mund të rrezatojë qëndresë as qëndrueshmëri. Më kotë thotë njeriu: "Zemrën e kam të pastër". Kjo i ngjan një tregimi që titullohet: "Loza e kungullit dhe pema madhështore": "Iu kishte ngjitur loza e kungullit pemës madhështore sa i kishte dal përmbi dhe, duke ia zënë frymën me fleta të mëdha e të gjëra po i lavdërohej: E sheh kush jam unë? shih ku të qëndroj, mbi kokë? Ndërsa pema madhështore ia kthen: "Prit sa të vij vjeshta. Pastaj e shohim kush je ti dhe kush jam unë".

Le ta shpjegojmë këtë në mënyrë tjetër. "Le të pretendojmë se ti ke një peshk të vogël të kuq. Një ditë ty të lind një ide e ndritur: "E shkreta krijesë e vogël,- i thua ti.- Sa e tmerrshme duhet të jetë të qëndrosh gjithë kohën në atë ujë të ftohtë. Prit një minutë; të shoh se ç'mund të bëj për ty". Kështu ti e nxjerr peshkun e kuq nga uji, e than atë me peshqir dhe e vë në një kafaz të bukur të praruar. I jep atij ushqimin më të mirë për një peshk të kuq dhe i thua: "Peshk i vogël, ti ke një kafaz të bukur të praruar, ushqim të shijshëm dhe ajër të freskët të mrekullueshëm. Jeta për ty tani është madhështore!". Ç'mendoni se do të bëjë peshku i kuq? Të përdredhë pendët e tij dhe të thotë: "Faleminderit. Oh, faleminderit"? Jo! Kurrë ndonjëherë! Ai do të përpiqet

me dëshpërim të mbajë frymën. Dhe nëse mund të fliste, do të thoshte: "Unë nuk e dua kafazin tënd të praruar apo ushqimin tënd shumë të shijshëm. Unë dua të kthehem në mjedisin tim të natyrshëm - ujin". Ibn Kajjimi ka thënë: "Përkujtimi i Allahut për zemrën është si uji për peshkun."

KUJDESI PËR PASTËRTINË E ZEMRËS[15]

1. Përmendja e Allahut Mëshirëplotë

Është më se e nevojshme për njeriun, madje është jetike që ai t'i kërkojë Allahut ta udhëzojë në rrugën e drejtë. Njeriu është mjaft nevojtar për këtë lutje, dhe asgjë nuk është më e dobishme për të sesa të përmendurit e Allahut shpesh. Pejgamberi Muhammed a.s., i lutej Allahut me këto fjalë: "O Ndryshues i gjendjes së zemrave, ma forco zemrën time në fenë tënde". Lutja e cila në formën e saj më të lartë është medituese dhe bashkuese e dijes dhe veprimit, sjell shpëtim dhe çlirim të shpirtit nga vartësitë dhe mangësitë dhe shpie në veprim të drejtë. Shpirti i mirë dhe kënaqësia e zemrës, dëfrimi, hareja, qetësia, rehatia, drita, gjerësia, imuniteti i zemrës prej ahengjeve të ndaluara, kapriceve dhe dyshimeve të kota janë mirëqenia e vërtetë. Disa nga të devotshmit që e kanë shijuar këtë kënaqësi, madje kanë thënë: "Sikur mbretërit dhe princërit të dinin se në ç'kënaqësi jemi ne tani do të na luftonin të na rrëmbenin me shpatë". E çfarë kënaqësie dhe mirëqenie më të mirë mund të kesh në jetë sesa mirësia e zemrës, paqja në kraharor, njohja e Zotit të Lartësuar, dashuria ndaj Tij, bindja ndaj Tij dhe në emër të Tij ta detyrosh mendjen, zemrën, trupin e t'i dhurosh

[15] Zemra mund të jetë e pastër nëse është larg pesë gjërave: Nga shirku i cili cenon Njëshmërinë e Allahut, nga epshi i cili cenon urdhrin, nga hutimi i cili cenon përkujtimin e Allahut, nga dëshirat e papërmbajtura të cilat cenojnë sinqeritetin dhe nga lloji i risive të cilat cenojnë sunnetin (traditën e Pejgamberit a.s.) Ibn Kajjim el-Xhevzi, Miftah dari's-seadeh, Rijad, pa datë botimi, f.183.
Bidat (risi) është ajo që futet në Fe e që nuk është prej saj… Shih gjërësisht Prof. Dr. Muhamed Seid Ramadan El-Buti, Fetva bashkëkohore dhe konsultime, Botues "Asr ", Tetovë, 2008/1429, f. 99.

vepra njerëzimit. A mund të ketë jetë të vërtetë përveç jetës me zemër të pastër dhe të shëndoshë? Allahu xh.sh., e ka lavdëruar mikun e Tij, Ibrahimin a.s., për zemrën e pastër, duke thënë***: "Edhe Ibrahimi ishte prej ndjekësve të Tij*** *(Nuhut)* ***kur iu bind Zotit të vet me zemër të pastër"[16]. "Atë ditë nuk do të kenë dobi as pasuria dhe as fëmijët, përveç atij që i vjen Allahut me zemër të pastër"[17].*** Zemra - një term që shpeshherë përdoret në një kontekst të tillë në Kur'an - nuk është kryesisht vendi i emocioneve. Ajo është më shumë aftësi specifike ose organ spiritual, që ndan qeniet njerëzore nga jonjerëzore. Zakonisht kësaj i referohen me fjalë të tilla si inteligjencë.

Një zemër e shëndetshme është e aftë të kuptojë natyrën e gjërave, por shumë zemra janë, sipas termave kur'anore "të sëmura" ose "të ndryshkura" apo "të kyçura":

"Ata kanë zemra, por nuk kuptojnë me to"[18]

"Nuk janë sytë që janë të verbër, por të verbra janë zemrat ndër kraharorë"[19]

"Si, a nuk thellohen për Kur'anin? Apo mos kanë dryna në zemra?"[20]

"Ata do t'u dredhonin Zotit dhe besimtarëve, e do gënjenin vetëm veten e tyre, por ata nuk e dinë. Në zemrat e tyre ka sëmundje".[21]

Vetëm një zemër e shëndetshme është e aftë t'i shikojë gjërat ashtu si janë. Universi gjigant nuk është tjetër, veçse një vend adhurimi në të cilën besimtarët mund të hyjnë vetëm atëherë kur i pastrojnë shpirtrat e tyre, kur nënshtrojnë zemrat e tyre dhe kur janë të aftë ta pranojnë të vërtetën dhe ta dëshmojnë atë: ***"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët: Për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve***

[16] Kur'ani, sura Safat, ajeti 83, 84.
[17] Kur'ani, sura Shuara, ajeti 88, 89.
[18] Kur'ani, 7: 179.
[19] Kur'ani, sura 22: 46.
[20] Kur'ani, sura 47: 24.
[21] Kur'ani, sura 2:10.

dhe të Tokës *(duke thënë:)* ***"O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh*** *(nga çdo e metë)!* ***Prandaj, na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit".***[22]

Në të vërtetë, kur njeriu e kupton se si ndikon drejtpërdrejt përsiatja e brendshme, ndjenjat, perceptimet, imagjinata dhe idetë në formimin e sjelljes së tij - synimet, besimet, aktivitetet e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, zakonet e mira dhe të këqija - bëhet e mundur të kuptohet më mirë edhe arsyeja se pse Kur'ani dhe Sunneti e theksojnë aq shumë meditimin e thellë dhe aktiv në krijimin e qiejve dhe të tokës; nga se pikërisht ato e mbushin zemrën dhe mendjen e njeriut me madhështinë e Krijuesit dhe përsosurinë e atributeve të Tij.

"Ata - në zemrat e tyre Ai ka shkruar besim".[23]

"Është Ai që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, që të mund të shtonin bindje në besimin e tyre".[24]

"Besimi është jeta e zemrave dhe mosbesimi është vdekja e tyre. Bindja është shëndeti i zemrave, ndërsa vazhdimësia në mëkate është sëmundja e tyre. Përmendja e Allahut është vigjilenca e zemrave, ndërsa hutimi është gjumi i tyre", siç ka thënë edhe Muhammedi a.s.: "Mos flisni shumë pa përmendur Allahun, sepse ju ngurtësohen zemrat".[25] I Dërguari i Allahut, Muhammedi a.s., i këshillonte besimtarët se si duhet kushtuar kujdes zemrave, në mënyrë që ato ta mbërrijnë shkallën e misionit, të cilin duhet ta bartin dhe ta arrijnë masën e nevojshme për ballafaqimet me të cilat do të ndeshen gjatë jetës. Zemrat ndryshken siç ndryshket hekuri - ka thënë Pejgamberi, Muhammed a.s.(- Innel kulubi tasdeu mithlel hadid). Atëherë ato se kryejnë funksionin dhe rolin e tyre që e kanë **(…Lehum kulubun la jefkahune biha…)** thotë Kur'ani.[26] Ndërkaq, përmendja e Allahut largon ndryshkun e zemrës dhe e bën atë të butë. "Çdo gjë ka grihës, e grihësi i zemrave është përmendja e Allahut. Nuk ka asgjë që shpëton më shu-

[22] Kur'ani, sura Ali Imran, ajeti 190-191.
[23] Kur'ani, sura 58: 22.
[24] Kur'ani, sura 48: 4.
[25] Hadithin e transmeton Tirmidhiu.
[26] Surja El-A'raf, ajeti 179.

më prej azabit (ndëshkimit) sesa përmendja - përkujtimi i Allahut", ka thënë Muhammedi a.s.[27] "Të menduarit e thellë është fillimi dhe çelësi i çdo të mire… është funksioni më efikas dhe më i dobishëm i zemrës"[28] Kjo, për shkak se, përmendja dhe përkujtimi i vazhdueshëm në Zotin dhe meditimi i thellë në krijimin e qiejve dhe tokës mundëson ndryshimin e nocioneve dhe ideve negative, të gabuara dhe të dëmshme para se ato të shndërrohen në dëshira dhe motive, ngase kontrollimi i një motivi ose dëshire është më i lehtë sesa ndryshimi i një veprimi pasues, ndërsa ndryshimi i një veprimi është më i lehtë sesa ndalimi i tij pasi që të jetë shndërruar në zakon të përditshëm.[29]

Është e qartë se fillimi i çdo veprimi të vullnetshëm nis me mendim të brendshëm, me një fjalosje apo pëshpëritje të fshehtë ose monolog të brendshëm. Me fjalën "pëshpëritje e fshehtë" nënkuptojmë fjalën që e përdor Kur'ani për të përshkruar ngasjen e fshehtë të djallit të mallkuar: "juvesvisu fi sudurin-nas", dhe i këshillon besimtarët të bëjnë jetë të lumtur dhe të devotshëm duke i luftuar vesveset negative para se ato të shndërrohen në ndjenjë ose impuls. Pra, eliminimi i një sjellje emocionale ose lakmitare është më i lehtë më herët para se ajo të ketë fituar në fuqi. Ebu Zejd El-Belhi sugjeroi se, "ashtu siç mban më vete një person i shëndetshëm ndihmën e parë për aksidente të papritura fizike, po ashtu ai duhet të mbajë më vete mendime dhe ndjenja të shëndetshme në mendjen e tij për kriza të papritura emocionale. Një zemër medituese e cila vazhdimisht kujton mirësinë e Allahut mund t'i luftojë lehtë idetë e këqija që kalojnë vetvetishëm nëpër mendje…Nëse një ide e keqe kalon nëpër mendje, ndjenja e mirë e heton atë, e bllokon dhe e eliminon efektin e saj, pikërisht, ashtu, siç e heton sistemi imun i trupit praninë e mikrobeve dhe antigjeneve, që pastaj i rrethon dhe i shkatërron nëpërmjet qelizave të specializuara dhe antitrupave. Zemra e pastër dhe shpirti i atyre që e kujtojnë vazhdimisht mirësinë e Zotit është sikur një kala e fortifikuar: çdoherë që idetë e

[27] Hadithin e transmeton Bejhekiu.
[28] Ibn Kajjim el-Xhevzi, Miftah dar es-sea'deh, Rijad, Ri'aset el Ifta, f. 183.
[29] Malik Badri, Konteplimi - një studim psiko-spiritual Islam, Logos-A, Shkup, 2008, f. 59.

këqija provojnë të ngjallen, perceptimi i mprehtë i fituar nga meditimi i thellë dhe përkujtimi, menjëherë i sulmon dhe i eliminon ato”.[30] Kur’ani pohon: ***“Me të vërtetë ata që janë të ruajtur, kur e prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë Allahun dhe atëherë shohin të vërtetën”.***[31] Ndërsa Muhammedi a.s., ka thënë: “Kur njeriu kujton Allahun, sprapset shejtani i tij, e kur ai habitet, i bën vesvese (pëshpëritje)”. Me fjalë të tjera: “Ngurtësia e zemrës vjen nga që njeriu nuk i ruhet Allahut Fuqiplotë. Fillimisht, zemrën e zë hutimi. Po nuk e përmendi Allahun, hutimi bëhet mendim kalimtar. Po nuk e ktheu Allahu, mendimi kalimtar bëhet ide. Po nuk e ndryshoi Allahu, ideja kthehet në vendosmëri për të bërë mëkat. Po nuk e ruajti Allahu, njeriu bën mëkatin. Po nuk e shpëtoi Allahu, duke e bërë të pendohet, vendosmëria për të bërë mëkat, kthehet në fuqi. Po nuk e zbuti Allahu, mëkati kthehet në ves, që zor se hiqet nga natyra e njeriut.”[32] Kur kemi parasysh këtë që u tha më sipër Hadithi i të Dërguarit a.s., na bëhet edhe më i qartë kur thotë: “Mos flisni shumë pa përmendur Allahun, sepse ju ngurtësohen zemrat”.[33]

2. Shoqërimi me Librin e Allahut - leximi Kur’anit

Kur’ani është libër i qartë i Allahut. Ka ajete të shkurtra dhe përmban rregulla precize, rregulla të veçanta dhe të përgjithshme, këshilla, urdhëresa dhe ndalesa, rrëfime për popujt e mëhershëm, dhe ka pak ajete jo të qarta. Themelore e Kur’anit është ajo që vlen për çdo kohë dhe hapësirë, sepse Ai që e ka shpallur është Krijuesi i kohë - hapësirës. Allahu Fuqiplotë është i vetmi që bën që fjalët e Tij të mos bien në relativitetin e kohës dhe hapësirës. Fjalët e Tij janë të përkryera dhe vlejnë përherë. I vetmi libër prej shpalljeve të Zotit që ka mbetur i shëndosh nga ndërhyrjet njerëzore. Allahu Plotëmëshirë thotë: ***“Vërtet, Ne e kemi shpallur Kur’anin dhe Ne do ta ruajmë atë me siguri”.***[34] Prandaj, e domosdoshme është të marrim udhëzime vetëm prej tij. I Dërguari i Allahut, Muhammed a.s., e porositi Ebu Dherrin duke i thënë: “Mos harro leximin e Kur’anit, sepse ai është dritë për ty në tokë dhe thesari yt në qiell”. Kurse në hadithin tjetër ka thënë: ”Njëmend, ky Kur’an është gostia e Allahut, ndaj, afrojuni gostisë së Tij sa të mundeni. Vërtet, ky Kur’an është litari i Allahut, drita e Tij e qartë, shëruesi i dobishëm; është siguri për atë që i përmbahet, shpëtim për atë që e ndjek; nuk lakohet për t’u drejtuar, as nuk thyhet për t’u ndrequr; mrekullitë e tij kurrë nuk mbarojnë dhe konfrontimet nuk e lodhin dot. Lexojeni Kur’anin sepse Allahu ju shpërblen për leximin e tij. Për çdo shkronjë ju jep dhjetë të mira dhe unë nuk them se Elif-Lam-Mim është shkronjë, por Elifi, Lami dhe Mimi (janë tri shkronja)”.[35]

Është në dëm të besimtarit nëse e kalon qoftë edhe një ditë të vetme pa lexuar Kur’an. I Dërguari a.s., ka thënë: “Ata që e mësojnë Kur’anin dhe lexojnë atë, janë njerëzit më të dashur të Allahut”. Detyrë e besimtarit është të lexojë Kur’an dhe ta ndjen me shpirt me zemër atë që po e lexon. Të jesh i përgatitur me mendje, shpirt e zemër derisa lexon Kur’an, sikur ai po të shpallet ty në ato çaste. Ta ndjesh sikur ai po të drejtohet ty drejtpërdrejt. Ndryshe, me çfarë e dëshmon lidhjen tënde me këtë fe nëse nuk mëson dhe nuk lexon Kur’anin? Mos lejo orë të tëra të harxhosh kot, kurse leximit të Kur’anit të mos ia kushtosh as një çast. Shoqërohu me ata që e mësojnë dhe lexojnë Kur’anin. Muhammedi a.s., ka thënë: ”Ata njerëz që mblidhen në një nga shtëpitë e Zotit (xhamitë), lexojnë Kur’an dhe e mësojnë me njëri-tjetrin, do t’u jepet qetësia shpirtërore, do t’i rrethojnë melekët, do t’i përfshijë mëshira e Zotit dhe do t’i përmendë Zoti ndër banorët e qiellit”.

30 Malik Badri, Konteplimi – një studim psiko-spiritual islam, Logos-A, Shkup 2008, f. 68.
31 Surja El-Bekare, ajeti 201.
32 Imam Ahmed bin Hixhazi El Feshni, Komenti i 40 Haditheve të Imam Neveviut, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2004., f. 93.
33 Transmetoi Tirmidhiu.

34 Kur’ani, sura El-Hixhr, ajeti 9.
35 Hadithin e transmeton Abdullah Ibn Mes’udi.

3. Mbikëqyrja e Allahut xh.sh.

Besimtari është i vetëdijshëm se Allahu sheh dhe vështron çdo gjë. Kjo vetëdije vërtetohet dhe thellohet në shpirtin e tij së bashku me rritjen e ndjenjës së afërsisë së Allahut ndaj tij. ***“Ne e krijuam njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”***[36] ***”Nuk ka bisedë të fshehtë midis tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti; as midis pesë vetave e që Ai të mos jetë i gjashti; as kur janë më pak as kur janë më shumë, që Ai të mos jetë me ata, kudo që të ndodhen; Ai në Ditën e Kijametit do t’i njoftojë ata se çfarë kanë bërë, se, me të vërtetë, Allahu di çdo gjë!”***[37] Pastaj thotë i Lartmadhërishmi: ***”Vallë, a mos kujtojnë ata se Ne nuk i dëgjojmë fjalët e tyre tinëzare dhe bisedat e tyre të fshehta? Pa dyshim, Ne dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë që janë pranë tyre shënojnë.”***[38]

Në qoftë se besimtari është i vetëdijshëm se gjithnjë gjendet nën vështrimin e Allahut, ai do të ndërgjegjësohet në atë masë sa të bëjë një jetë të qetë dhe të lumtur, duke e pasur, njëkohësisht, zemrën e pastër dhe pa probleme. Në qoftë se myslimani është i vetëdijshëm se Allahu e dëgjon dhe e sheh kudo që të jetë, atëherë edhe fjala e tij do të jetë fjalë e mirë, qëndrimi i tij do të jetë qëndrim korrekt, hapi i tij do të jetë hap i drejtë, dora e tij nuk do të puqet me haramin, ndërsa e gjithë lëvizja e tij do të jetë lëvizje pozitive e nijetit të çiltër dhe e mendimit të mirë. Në qoftë se besimtari është i vetëdijshëm se jeta e kësaj bote është një sprovë e fitores apo e dështimit tij, atëherë e adhuron Allahun dhe e kujton shpesh. Zemra e pastër dhe e shëndetshme e urdhëron njeriun - pronarin e vet që t’i drejtohet Allahut dhe të lidhet me të. Në ibadet, ndonëse i lodhet trupi - nuk mërzitet, përkundrazi, ai gjen kënaqësinë, ushqimin shpirtëror, qetësinë dhe mbështetjen në Allahun. Kur bën namaz zemra e besimtarit lirohet nga të gjitha brengat e kësaj bote. Vuan për kohën e humbur, nga se frymëmarrjen e konsideron si pasurinë më të madhe. Besimtari me zemër të shëndetshme dhe të pastër kujdeset për veprat e veta në kualitet, në cilësi dhe ruhet që të mos i zhvlerësojë ato. Rëndësia e zemrës qëndron pikërisht në faktin se ajo është vendstrehimi i besimit. Kurse një zemër e mbushur me besim, hedh mënjanë çdo vepër që është haram, ndërsa Allahu e shpërblen me ëmbëlsinë e besimit, të cilën e ndjen brenda vetes.

[36] Kur’ani, sura Kaf, ajeti 16.
[37] Kur’ani, sura El-Muxhadele, ajeti 7.
[38] Kur’ani, sura Ez-Zuhruf, ajeti 80.

Dhe krejt për në fund:

Shenjë e zemrës së pastër dhe të shëndoshë është se ajo e do fjalën e Allahut më shumë se çdo fjalë tjetër. Kush dëshiron të dijë se a e do Allahun - le të provohet me Kur’anin, e nëse del se e do Kur’anin, atëherë e do Allahun, nga se Kur’ani është fjalë e Allahut. Prandaj, nuk mjafton të thuhet “zemrën e kam të pastër, kam nijetin e mirë” po qe se ajo “zemër e pastër” dhe “nijeti i mirë” nuk shkëlqen, nuk stoliset dhe nuk fisnikërohet me besim dhe vepra të mira. I Dërguari Muhammed a.s., ka thënë: “Allahu nuk shikon pamjen dhe trupin tuaj, por shikon zemrat dhe punët tuaja”.

Avni Aliu

IT'S ESSENTIAL TO FOLLOW THE RIGHT PATH

(Summary)

And (as for) those who follow the right direction, He increases them in guidance and gives them their guarding (against evil).

Is one who walks while slumped over on his face better guided, or one who walks straight on the right path?

Quite frequently we hear people say: “My heart is pure”. Just recently, a boy asked me: “What about those who do not follow the right path but can be heard saying “My heart is pure and my intentions are good”?!

عوني علي

من المحتم علينا أن نتبع الطريق المستقيم

(خلاصة البحث)

وَالَّذِينَ اهْتَدَوْا زَادَهُمْ هُدًى وَآتَاهُمْ تَقْوَاهُمْ (سورة محمد: 17)

أَفَمَنْ يَمْشِي مُكِبًّا عَلَى وَجْهِهِ أَهْدَى أَمَّنْ يَمْشِي سَوِيًّا عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ (سورة الملك: 22)

ربما انجست لكم الفرصة أن تسمعوا في مجلس دينى أن يقول أحد الحاضرين: "لي قلب نظيف" و لقد صادق لي أن أسمع هذه الكلمات من شاب وسيم تبدو من هجهه علامات الطيبة مع أنه تبدوا عليه علامات القلق، إلا أنه كان يتكلم بلغة فصيحة إلا أن جمع قواه و سألني: "و لكن يا شيخ كيف سيكون مصير هؤلاء الذين لا يتبعون أو أمر الله و لكن بكل ثقة يقولون: لي قلب نظيف و نيتى سليمة".

HISTORIOGRAFI

Prof. dr. Hysen Matoshi

HAPËSIRA ETNIKE E KULTURORE SHQIPTARE DHE KISHA ORTODOKSE SERBE

Ka një përputhje të plotë ndërmjet ekspansionit territorial të Serbisë, gjatë shekujve XIX dhe XX, dhe tkurrjes territoriale të shqiptarëve në Ballkan. Kjo është një gjë lehtë e vërtetueshme, thjesht empirike e rreth së cilës s'ka se si të mos pajtohen studiuesit, pavarësisht se nga cila anë i qasen problemit. Tkurrja më dramatike do të ngjajë në periudhën 1878-1912, kur shqiptarët do të mbesin me vetëm një të tretën e tokave të tyre, me popullsi të përgjysmuar; ndërkohë që serbët do ta shumëfishonin hapësirën për shtetin e tyre, duke pasur si synim përfundimtar daljen në tri dete që lagin brigjet e Ballkanit.

Ideologjia shoviniste, e ravijëzuar në kokat e brezave të tërë të politikës serbe, e cila parim thelbësor e ka okupimin e hapësirës së tjetrit, qoftë edhe me çmimin e gjenocidit, krahas mentores së devotshme projektuese - Akademisë së Shkencave të Serbisë, pati edhe frymëzuesen e saj shpirtërore - Kishën Ortodokse Serbe. Madje, qoftë për faktin se ka vepruar në një periudhë shumë më të gjatë se Akademia Serbe, qoftë për faktin se ka mobilizuar, krahas mendjes edhe shpirtin e kolektivit, dhe sidomos për faktin se komunikimi i saj ka qenë i përmasave gjithëpërfshirëse popullore, roli i Kishës Ortodokse Serbe në

këtë drejtim është i pakrahasueshëm me cilindo faktor tjetër. Përtej konstatimit të Norman Cigarit[1] - studiuesit të njohur amerikan, sipas të cilit elita intelektuale serbe, duke e arsyetuar ideologjikisht gjenocidin, nga vrasësit e rëndomtë krijonte heronj, ndërkaq Kisha Ortodokse Serbe atyre u ofronte shfajësim moral - them se roli i kësaj kishe nuk duhet parë në rrjedhojat e në pasojat shkatërrimtare të luftës që serbët e bënë kundër të tjerëve përreth tyre, përkundrazi, realisht roli i saj është roli i projektueses dhe i frymëzueses së luftës në të cilën ndërgjegjja njerëzore përjetoi njërën ndër humbjet më të mëdha.

Tri "argumentet" e Kishës Ortodokse Serbe

Sistemi i argumentimit, i cili rrjedh nga Kisha Ortodokse Serbe, mbi të drejtën e Serbisë ndaj tokave shqiptare, është mbështetur në zhvillime që ndërlidhen me tri periudha të ndryshme të zhvillimeve në këtë hapësirë. Së pari e drejta serbe, sipas tyre, buron nga fakti se këto toka ishin pjesë të Perandorisë mesjetare të Car Dushanit, pastaj mbështet në "faktin" tjetër, sipas të cilit Betejën e Kosovës e zhvilluan dhe e humbën serbët ortodoksë dhe përfundimisht pohojnë se serbët masivisht e kishin braktisur Kosovën në krye me patriarkun Arsenije Çarnojeviq më 1690.[2] Pa u ndalur në këto "argumente" të shtrembëruara historike, kur e kur edhe mitologjike, është e kuptueshme se Kisha Ortodokse Serbe i ka përdorur ato, jo për t'ua mbushur mendjen të tjerëve, por për t'i mobilizuar potencialet e veta njerëzore e materiale në ndërmarrjet pushtuese të Serbisë. Rrjedhimisht, diskursi i kësaj kishe e ushqente fushatën antishqiptare me idenë se serbët nuk po bënin di-

[1] Cituar sipas librit Muslimani Balkana: "Istočno pitanje" u XX. vijeku, priredio Fikret Karčić, Tuzëll, 2001, f. 21.

[2] Duke u bazuar mbi një mori burimesh që vijnë nga anë e nga autorë të ndryshëm, prof. dr. Muhamet Mala, në doktoraturën e tij ***Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII*** vë në pah falsitetin e së ashtuquajturës shpërngulje masive serbe nga Kosova. Sipas argumentimeve të shumanshme të Malës, Arsenije Çarnojeviqi nuk ishte vënë në ballë të ndonjë turme të madhe serbësh, por ai u tërhoq me suitën e tij prej disa priftërinjsh dhe në krye të një karvani prej dhjetë kuajsh, të ngarkuar me pasuri të ndryshme. Madje, edhe plaçkitja e tij në rrugë e sipër nga rasianët (serbët) është një dëshmi se ai i printe një grupi të vogël priftërinjsh.

çka të pazakontë - ata po kthenin të drejtën e tyre mbi tokën, të cilën e zotëronin para qindra vitesh dhe se po merrnin hak për gjakun e derdhur serb në mbrojtje të këtyre tokave. Nëse për Kosovën (tokat shqiptare) luftën pushtuese KOS-i e argumentonte me sa u tha më lart, në meshat e mbajtura, tekste të të cilave i botonte edhe "Vesnik Srpske Crkve", organin e Lidhjes së Priftërinjve, nuk fshiheshin pretendimet as ndaj tokave të popujve të tjerë ballkanas. Kështu, në Kishën e Ringjalljes në Beograd, prifti Lubomir Mitroviq, gjatë ligjëratës së tij, do të shpallte se me pushtimin e tokave shqiptare nuk kishte marrë fund puna, ngase pretendimet serbe ishin për më shumë hapësirë për vete e në dëm të të tjerëve. Ai, duke iu premtuar shpirtrave të serbëve të rënë, shprehet: "Mos u brengosni shpirtra kreshnikë të heronjve të rënë. Zoti tha: Ja, do ta dërgoj engjëllin me degën e paqes, të shenjtëruar me gjakun tuaj, që ta spërkatë edhe një herë flamurin e pamposhtur të kombit tuaj, i cili në mënyrë madhështore po bartet nga Adriatiku në Edrene, nga Vidini në Lerin dhe i cili shpejt do të valëvitet edhe nëpër Bosnjë-Hercegovinë, Dalmaci dhe Istër, Banat, Baçkë dhe Srem, Kroaci dhe Sllavoni".[3] Saktësisht, po për pushtimin e këtyre hapësirave, që i kishte evidentuar prifti serb në fillim të shek. XX, Serbia do ta ndërmerrte fushatën më gjakatare në fund të këtij shekulli. Politika serbe, e frymëzuar nga Kisha Ortodokse Serbe, e mësuar nga Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë[4], nuk i kishte ndryshuar për asnjë milimetër apetitet e saja pushtuese. Argumentet mbi të drejtën historike, mbi të drejtën hakmarrjes kombëtare për disfatat e pësuara para shekujsh, ishin të nevojshme vetëm sa për ta nisur luftën, sa për ta legjitimuar atë, kurse, në fakt, e gjithë kjo ndërmarrje gjakatare gjente mbështetje te maksima: qëllimi e arsyeton mjetin.

[3] Vesnik Srpske Crkve, korrik-gusht 1913, fq. 481.

[4] Në ndërveprimin antishqiptar të Kishës Ortodokse Serbe me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, autori i librit ***Djajtë nuk flenë***, Kolë Berisha, me të drejtë, përfshin edhe "kontributin" e Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë, e cila sidomos në vitet e suprimimit të autonomisë së Kosovës u tregua shumë aktive.

Akti i parë i zhbërjes së hapësirës etnike dhe kulturore shqiptare

Humbjet e vazhdueshme ushtarake e politike të Perandorisë Osmane, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, rezultuan me forcimin e kombeve shtetformuese ballkanase, por ato njëkohësisht u konvertuan edhe në humbje të territoreve etnike e kulturore shqiptare. Kongresi i Berlinit, përveçse i la trojet e Sanxhakut e Nishit pa shqiptarë, ishte i kobshëm edhe në planin e trashëgimisë kulturore. Kështu, përveç faktit se nga qytetet si Nishi, Piroti, Leskoci, Vranja, Prokupla e Kurshumlia, por edhe më se 500 fshatra përreth tyre, u dëbua masivisht popullata shqiptare, pushtuesi i frymëzuar nga mosdurimi fetar, të cilin e mbillte Kisha Ortodokse Serbe, u përkujdes që gjurmët kulturore të shqiptarëve t'i zhbënte kudo që i ndeshte. Qëllimet e kësaj ndërmarrjeje ishin të qarta: pushtuesi, duke i shkatërruar argumentet kulturore-fetare të ekzistencës së shqiptarëve, do të krijonte premisa për krijimin e argumenteve të reja etnike e kulturore në ato hapësira. Se cilat ishin përmasat e këtij shkatërrimi mund të bindemi lehtë nga vetëm disa të dhëna, të cilat i ka qëmtuar gjithandej studiuesi i mirënjohur dr. Sabit Uka[5], njëri ndër njohësit më të mirë të fatit tragjik të kësaj trashëgimie kulturore islame e shqiptare. Vetë kryeqyteti aktual i Serbisë, Beogradi, sipas Evlija Çelebiut, në vitet 70 të shek. XVII kishte 270 xhami, mesxhide e objekte të tjera islame. Dua të sjell ndërmend se e vetmja xhami, nga e gjithë kjo trashëgimi kaq e pasur, Bajrakli xhamia, që e mbijetoi kohën, u dogj në marshin e neopiromanëve serbë më 2004. Nishi, nga ana tjetër, në vitet 60 të shek. XVII, kishte 22 mejtepe që kryesisht funksiononin pranë xhamive, ndërkaq në periudhën 1877-1878, pra në prag të pushtimit nga serbët, i kishte 13 xhami të mëdha, 6 xhami të vogla, 4 tyrbe të njohura, kundruall vetëm dy kishave dhe një sinagoge. Edhe xhamia e vetme e mbijetuar

[5] Dr. Sabit Uka, ***Xhamitë, mesxhidet dhe teqetë në Sanxhakun e Nishit deri më 1878***, në ***Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*** (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, f. 147-151.

deri në kohën e sotme nuk u shpëtoi neronëve modernë serbë më 2004. Më tutje, Piroti më 1873 kishte 9 xhami të mëdha, disa mesxhide, tri teqe, 2 kisha dhe një sinagogë. Leskoci, sipas autorit Miliqeviq, më 1872 kishte 8 xhami dhe 10 teqe. Vranja më 1873 kishte 5 xhami të mëdha, disa mesxhide të vogla, 6 teqe dhe 2 kisha. Prokupla më 1873 kishte 5 xhami, 8 tyrbe dhe 1 kishë, ndërkaq Kurshumlia (sipas Evlija Çelebiut) më 1660, kishte 3 xhami, kurse në këtë qytet para Kongresit të Berlinit jetonin vetëm 3 serbë. Për ta kuptuar më qartë se cili është dimensioni i ndryshimit drastik të hapësirës kulturore dhe etnike, do të sjellim ndërmend të dhënat për një hapësirë më të madhe territoriale, dikur me trashëgimi dominuese islame, nga e cila tani nuk ka ngelur as edhe një gjurmë e vetme. Kështu, bie fjala, të dhënat flasin për një pamje krejtësisht tjetër të Pashallëkut të Beogradit në kohën kur ishte pjesë e Perandorisë Osmane, kundruar në aspektin e trashëgimisë kulturore, e cila, gjithsesi reflekton shumëçka edhe nga ajo etnike. E dhëna se ky pashallëk kishte dikur më se 600 xhami flet vetvetiu në këtë drejtim[6].

Në histori janë të njohura rastet kur në një territor një etni zëvendësohet nga etnia tjetër, kryesisht si rezultat i raporteve që prodhon forca, por nuk janë të pashembullta rastet, sikundër është ky që po trajtojmë, kur lufta e ardhacakëve vazhdon edhe kundër trashëgimisë kulturore të popullit që paraprakisht i banonte ato vise. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për procesin e shkatërrimit të kësaj trashëgimie si rezultat i lënies pas dore të objekteve të caktuara, fjala është për zhbërje të planifikuar e sistematike të saj, për zëvendësimin e saj me shenjat etnike e kulturore-fetare të pushtuesit. Kisha mund të ndërtoheshin edhe pa i shkatërruar xhamitë dhe objektet e tjera që gjithanshëm përdoreshin nga popullata shqiptare. Fakti më ilustrues në këtë drejtim është rasti i ruajtjes së trashëgimisë ortodokse serbe për shekuj me radhë në

[6] Dr. Rexhep Boja, ***Gjenocidi, kulturocidi dhe urbicidi serb në Kosovë***, në Monografinë tregjuhëshe ***Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (shkurt '98 - qershor 99)***; ***Serbian barbarities against islamic monuments in Kosova (February '98 - June '99)*** ShB "Dituria Islame", Prishtinë, 2000, f. 5.

Kosovën e sotme, megjithëse gjatë gjithë kohës qeverisej nga një shtet islam dhe në të dominonte popullata shqiptare e besimit islam.

Akti i dytë: Priftërinjtë serbë - "engjëj" të luftës

Roli i Kishës Ortodokse Serbe do të pësojë transformim esencial, duke u kthyer nga një forcë frymëzuese në një mekanizëm zbatues të politikës gjenocidiale serbe, sidomos në periudhën e luftërave ballkanike. Priftërinjtë serbë, nga predikues të paqes, tashmë ishin shndërruar në "engjëj" të luftës, e cila si shprehje, që në vete ngërthen edhe engjëllin edhe luftën, habit edhe qëmtuesin më të pasionuar të oksimoronit. Kështu, këta priftërinj, të cilët ishin vënë në krye të bandave dhe të formacioneve të rregullta serbe, për të vrarë, për të dëbuar e për të djegur çdo gjë shqiptare, gazeta "Hrišćanin", në Urimin e Krishtlindjeve, i quante hiq më pak se "engjëj" të luftës.[7] Shtypi zyrtar i KOS-it do t'i cilësonte edhe me epitete të tjera të zgjedhura priftërinjtë që kishin marrë mbi vete detyrën e çlirimtarëve "të vëllezërve të tyre të shtypur". Cilësimet si prifti-vullnetar, prifti-hero, prifti-çetnik etj., në të vërtetë, ishin në funksion të ofrimit të modeleve për krijimin e të cilave angazhohej me të gjitha mjetet Kisha Ortodokse Serbe. Për rolin e veçantë që e kishin priftërinjtë serbë në këtë luftë dëshmon edhe shkrimi "Priftëria në shërbim të Atdheut" i famullitarit Panta Dragojeviq, ku theksohet: "Shpallja e luftës për çlirim u pranua me entuziazëm, por ne na duket se asnjë kategori tjetër e njerëzve nuk e ka pritur çështjen e shenjtë të çlirimit me aq entuziazëm sa priftërinjtë serbë. Nxituan që, me kryq në dorë, të dalin në ballë të ushtrisë serbe, që me fjalimet e tyre ta inkurajojnë atë sa më shumë.

Një numër i madh i priftërinjve u regjistruan vullnetarë e komitë dhe me kryq e armë në dorë i shkatërruan aziatikët e egër. Mediet e kohës janë përplot me raporte mbi qëndrimin trimëror të priftërinjve në këtë luftë".[8] Duhet theksuar edhe faktin se të dhënat për pjesëmarrjen e priftërinjve serbë në luftë, gjithnjë sipas burimeve të shtypit

[7] Hrišćanin, janar 1913, fq. 12.
[8] Vesnik Srpske Crkve, mars-prill 1913, fq. 255.

kishtar serb, kapnin shifrën prej 100 sish. Disa prej tyre madje ishin vënë në krye të çetave, duke kryer edhe detyrën e udhëheqësit shpirtëror, por edhe të udhëheqësit ushtarak. Në këtë pikëpamje veçohej shembulli i priftit Sekula Dobriqanin, i cili i kishte mbledhur 300 vullnetarë dhe i kishte vënë në shërbim të mbrojtjes popullore, natyrisht duke i tejçmuar me këtë rast vlerat e tij prej një atdhedashësi model.[9]

Në mënyrë që të dëshmohet se nuk ishte fjala, në asnjë rast, për veprime të veçanta të priftërinjve, të cilat nuk e merrnin parasysh qëndrimin e kreut të Kishës, po citojmë pjesë të ligjëratës së Peshkopit serb Dimitrije, mbajtur në njërën ndër kishat më të mëdha të Beogradit, nëpërmjet së cilës, nga pozitat udhëheqëse kishtare, klithte: “Shkojmë në Kosovën e lavdishme, në Deçanin madhështor, në Shkupin e mrekullueshëm, që ta kërkojmë fronin e shkëlqyer të Dushanit të fuqishëm. Shkojmë në Prilep.

Kreshnikët tanë krenarë tashmë kanë shkuar. Ndërkaq, unë, si bari suprem dhe si atë shpirtëror i tokës serbe, që të gjithë i bekoj.”[10] Nëse kështu fliste dhe shkruante “Kryengjëlli i luftës”, atëherë fare nuk e hutojnë askënd shkrimet që pohonin vënien e plotë të Kishës në shërbim të shtetit, përkatësisht në shërbim të zgjerimit të tij e të realizimit të idealit që përmblidhej në togfjalëshin Serbi e Madhe, madje duke çrrënjosur çdo gjurmë etnike e kulturore të popullatës që gjithnjë kishte jetuar në të. Edhe Peshkopi i Nishit, Domentijani, gjatë vizitës që ua bënte të plagosurve serbë, përveç urimit për shërim të shpejtë, i porosiste që të ktheheshin sa më parë në fushëbeteja dhe, siç i porosiste ai, “të vazhdonin të thernin turq e të grinin shqiptarë”.[11] Shtypi kishtar serb i kohës gjithashtu nuk lë asnjë dyshim sa i përket karakterit të angazhimit të Kishës Ortodokse Serbe në këtë luftë. Ajo nuk ishte e përfshirë në këtë ndërmarrje kriminale e organizuar nga dikush tjetër, ajo ishte vetë organizatorja e ideatorja kryesore, e cila kishte punuar pa pushim me qëllim që t’i krijonte kushtet për këtë ndërmarrje gjakatare mbi popujt dhe mbi kulturat e tjera, ajo e kishte përgatitur me shekuj

9 Glasnik Pravoslavne Crkve u Kraljevini Srbiji, 1 dhjetor 1912, f. 368.
10 Vesnik Srpske Crkve, tetor-nëntor-dhjetor 1912, fq. 982.
11 Večernje novosti, 22 tetor 1912.

kombin serb për këto ditë, të cilat në artikullin programatik “Crkva u službi Otadžbine”, i quan, hiq më pak se, të shenjta: “Kisha dhe priftëria jonë sot mund të pohojnë se secili në Mbretërinë e Serbisë e kryen me përkushtim detyrën e vet, ashtu siç e ka mësuar dhe e ka edukuar kombin serb vetë kisha serbe, duke e përgatitur për këto ditë të shenjta”.[12] Disa muaj më vonë, pasi që pjesa më e madhe “punës” ishte kryer, Kisha Ortodokse Serbe e kërkonte hisen “e meritës” që, pa asnjë dyshim, i takonte: “Priftëria serbe e ka kryer detyrën e saj edhe ndaj kishës edhe ndaj popullit, sepse përveç përgjigjes ndaj organeve ushtarake dhe shërbimit të obligimeve fetare në luftë, kishte priftërinj të cilët vullnetarisht shkonin në luftë, me qëllim që me praninë e tyre t’i trimëronin vëllezërit e tyre, ndërsa me sakrifikimin e tyre fituan simpatinë e pjesëmarrësve në luftë dhe të organeve kompetente ushtarake”.[13]

Përgjithësisht shkrimet e medieve të Kishës Ortodokse Serbe, ose të medieve që e mbështesnin mendësinë e saj gjakatare, karakterizohen nga një ligjërimi i përmbytur në patosin e shfrenuar mbi ndjenjën e madhe të serbizimit të çdo gjëje dhe të urrejtjes çmendurake ndaj çdo gjëje që shfaqej si pengesë në këtë rrugë. Shqiptarët dhe kultura e tyre kanë pasur fatin e keq që të vihen në tehun e sulmit të përgjithshëm, me qëllimin e vetëm zhbërjen etnike dhe mohimin e çdo shenje të vlerave kulturore e civilizuese të tyre. Përveçse me shkrime diskursive, priftërinjtë serbë, të vetëdijshëm për forcën shprehëse të artit poetik, gjatë periudhës dramatike të luftërave ballkanike, shpeshherë urrejtjen kombëtare do të synonin ta konceptonin në vargje, qofshin ato popullore, qofshin të autorëve priftërinj. Po sjellim këtu vetëm vargjet e lahutarit Klonimir nga kënga “Ëndrra e bariut kosovar” (San kosovskog čobančeta):

“Në vaj thoshte nëna e Milloshit:
‘Kishim shtëpinë me gjithë kopsht,
Por na ranë të mallkuarit shqiptarë,

12 Vesnik Srpske Crkve, tetor-nëntor-dhjetor 1912, fq. 1014.
13 Vesnik Srpske Crkve, janar-shkurt 1913, fq.75.

Na e dogjën shtëpinë me zjarr,
I ke pasur edhe dy vëllezër,
Shqiptarët që të dy i zunë,
I therën si qengjat e bardhë"[14].

Natyrisht, botimi i kësaj kënge në valën e masakrave të papara mbi shqiptarët ishte thjesht në funksion të krijimit të klimës së hakmarrjes, të yshtjes së bandave ushtarake për hakmarrje e për ndreqje të "padrejtësisë historike mbi serbët ortodoksë".

Kisha Ortodokse Serbe, në mënyrë të veçantë, e trumbeton edhe rëndësinë e madhe të Aleancës Ballkanike, karakteri pushtues i së cilës zbulohet madje edhe nga vetë tekstet e fjalimeve të përfaqësuesve të saj, megjithëse, jo një herë, insistohet se bashkimi i të krishterëve ortodoksë ka për synim çlirimin dhe përparimin e Ballkanit. Fjalimi i priftit të garnizonit, Sava Bozhiq, i mbajtur para Regjimentit II kalorësiak të Kralevës, qartëson qëllimin përfundimtar të Aleancës Ballkanike: "Që të katër shtetet e krishtera ortodokse të Ballkanit (Serbia, Bullgaria, Greqia dhe Mali i Zi, vër. H.M.) do të luftojnë së bashku; ushtria e bashkuar e krishterë, në emër të Zotit, së shpejti do ta arrijë fitoren dhe do ta ndajnë ndërmjet tyre Perandorinë Turke.

Trima,

Të bashkuar do ta mposhtni armikun, ndërsa në Prizren, në kryeqytetin e Dushanit, do ta ringjallni Fronin e Serbisë së Re e të Madhe."[15] Pra, është plotësisht e kuptueshme se ndarja e tokave të Perandorisë Turke, në pjesën më të madhe të çështjes, ishte vetëm një shprehje tjetër për ndarjen e tokave etnike shqiptare, lakmia e pamasë ndaj të cilave i shtyri disa nga shtetet aleate në një luftë të re, si pasojë e shpërputhjes së interesave dhe mospajtimeve të thella ndërmjet tyre. Megjithëse, nuk u realizuan në tërësi synimet për ndarjen e të gjitha tokave shqiptare ndërmjet shteteve aleate ortodokse ballkanike, duhet thënë se kjo fazë ishte ndër më tragjiket për ekzistencën fizike të shqiptarëve, sikundër edhe për vlerat e tyre kulturore. Ishte periudha kur

[14] Hrišćanin, qershor 1913, fq. 12.
[15] Večernje novosti, 8 tetor 1912.

dy të tretat e tokave shqiptare ranë nën sundimin sllavo-grek, ndërsa si tërësi qenia shqiptare u vu para pikëpyetjes së ekzistimit.

Konvertimi si formë e zhbërjes etnike të shqiptarëve

E vetëdijshme se potencialet njerëzore të shteteve ballkanike, veçmas ato të Malit të Zi, ishin të pamjaftueshme për t'i populluar dhe veçmas për t'i mbajtur nën kontroll tokat e pushtuara, Kisha Ortodokse Serbe dhe udhëheqja politike e kohës e Serbisë dhe e Malit të Zi filluan konvertimin masiv të shqiptarëve të Kosovës Perëndimore. Duke zbatuar të gjitha mjetet represive që kishin, konvertimi i shqiptarëve myslimanë dhe katolikë në ortodoksë, madje duke ua ndryshuar edhe emrat, ishte një përpjekje për ta ndryshuar përgjithmonë strukturën etnike të tokave shqiptare. Ushtria pushtuese, e udhëhequr nga barinjtë shpirtërorë, priftërinjtë ortodoksë, u jepte ultimatum banorëve të vendbanimeve shqiptare që ta pranonin fenë ortodokse, në të kundërtën, alternativë e vetme për ta mbetej pushkatimi. Ndërkaq, në arenën ndërkombëtare dhe para përfaqësive të ndryshme diplomatike, veçmas para atyre austro-hungareze, tentohej që konvertimi të paraqitej si kthim i vullnetshëm i shqiptarëve në besimin e të parëve, pikërisht sikundër provohej dekada më parë të imponohej bindja se ishte "vullnetare" edhe shpërngulja e shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, pas Kongresit të Berlinit. Fillimisht, për ta qartësuar situatën në të cilën ndodhej popullata shqiptare, po zë ngoje dëshminë e kapitenit Vujosheviq lidhur me atë se si i trajtonte pushtuesi vendësit autoktonë në Guci: "Popullata e këtushme muhamedane nuk gëzon kurrfarë të drejtash dhe lirie, madje as lirinë e jetës. Ja pse: sepse i nxjerrin natën nga shtëpitë e veta dhe i rrahin për vdekje me pushkë e me bajoneta nëpër rrugët e fshatrave; sepse ua zënë rrugën dhe, duke shtënë me pushkë mbi kokat e tyre, i plaçkitin dhe i grabisin; sepse natën goditen shtëpitë dhe faltoret e tyre (xhamitë)..."[16]. Ja në këtë atmosferë pretendohet se shqiptarët dhe boshnjakët po e pranonin vullnetarisht ortodoksinë.

[16] Zekeria Cana, Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913 (Dokumente), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, f. 285.

Ky pranim bëhej në situatën kur tellalli urdhërohej që të bërtiste rrugëve të Beranës që “muhamedanët t’i mbajnë detyrimisht pakicat malazeze dhe të kryqëzohen, se në të kundërtën do të vriteshin...”[17] Se i gjithë ky proces orkestrohej nga Kisha Ortodokse Serbe dëshmi është edhe fakti se udhëheqësit ushtarakë, bazuar në dokumentet - raportet e kohës, që ua dërgonin urdhërdhënësve të tyre, gjithnjë kërkonin këshillat e organeve të kishës, ose ishin në pritje të personelit përkatës kishtar, duke preferuar që për këtë punë të kishin më shumë priftërinj të cilët e dinin shqipen, me qëllim që procesi i konvertimit, i cili në raporte identifikohet si kthim në fenë e të parëve, të përfundonte me sukses. Interesant në këtë drejtim është dokumenti sekret nr. 7775, dt. 21.12.1912/3.1.1913, i ministrit Jovan Plamenac, të cilin ua drejtonte “Organeve të pushtetit në viset e sapoçliruara” mbi konvertimin e shqiptarëve, e ku thuhej: “Duke u bazuar në raportet e disa organeve policore se sa myslimanë në viset e sapoçliruara deklarojnë se duan të kalojnë me familjet e tyre me vullnet në fenë ortodokse të stërgjyshërve, i nënshkruari i është drejtuar Mitropolisë së Hirësishme me lutje që t’u japë udhëzime organeve kishtare të dioqezës së saj, prandaj ajo drejtori, secilin që paraqitet për këtë qëllim le ta udhëzojë te kleriku kompetent, i cili do ta kryejë detyrën e tij. Ministri J. Plamenac”[18].

Përveçse në dokumentet e dëshmitë e tjera të shkruara të kohës, konvertimi i shqiptarëve në ortodoksë, me qëllimin përfundimtar të shndërrimit të tyre në element etnik serbo-malazias, ka mbetur si ngjarje e shënuar dhe e dhimbshme edhe në kujtesën tonë popullore[19]. Lidhur me këtë ngjarje janë ruajtur dhjetëra këngë e variante këngësh, në të cilat kanë gjetur vend trajtimi mizoritë e pushtuesit drejt realizimit të këtij qëllimi ogurzi, por spikatin edhe qëndresa e heroizmi i paparë i popullatës shqiptare në kundërshtim të imponimit të një identiteti të huaj e në mbrojtje të dinjitetit kombëtar. Gjithsesi këngët më të

[17] Po aty, f. 205.
[18] Po aty, f. 123.
[19] Lidhur me konvertimin e dhunshëm të shqiptarëve në ortodoksë shih punimin e dr. Adem Zejnullahut konvertimi i dhunshëm i shqiptarëve në fenë ortodokse sipas këngëve popullore.

njohura të kësaj periudhe, ndër më të zezat e historisë sonë, janë ato që u kushtohen të bëmave të dy protagonistëve famëkëqij, pa dyshim zbatuesve më të egër të konvertimit, sikundër ishin Avro Cemi dhe Savë Batarja. Mundësia e vetme për të mbetur gjallë, sipas vargjeve të këngës popullore, të cilën ua ofron Avro Cemi shqiptarëve është që të pranojnë ndërrimin e fesë dhe të kombësisë:

-Ju shqiptarë idikatli,
Të gjithë n’ kishë due m’u shti,
Me ja u vu shishakt’ e zi,
Besë e fe aty me nrrue
Ose të gjithë kini marue!

Natyrisht, edhe kënga popullore shqipe konstaton faktin e rezistencës së madhe në të cilën hasi kjo ndërmarrje e turpshme e serbomalazezve. Pushkatimet masive, prej qindra vetash që nuk e pranuan konvertimin, pushteti okupator mundohej t’i arsyetonte me faktin se kinse bëhej fjalë për komitë - kryengritës që ua kishin kthyer pushkën organeve të tij.

Po ashtu, lidhur me konvertimin e shqiptarëve në ortodoksë, do të shkruante edhe shtypi kishtar serb. Natyrisht, edhe me këtë rast do të hetohet përpjekja e qartë për shtrembërimin e fakteve, duke bërë përpjekje që konvertimi i shqiptarëve katolikë, për të cilët kishte reaguar ashpër Austro-Hungaria, të paraqitet si akt vullnetar i kthimit në grigjën e vet: “Gjakova sot përjetoi një pamje të pazakonshme e të rrallë. Në shtypin austriak kishin gjetur vend thashethemet se si nga Gjakova po marshojnë 30 000 shqiptarë në ndihmë Shkodrës së rrethuar, por ne nuk pamë asnjë gjurmë të kësaj ushtrie të fuqishme. Pamë diçka tjetër: pamë se si fshatra të tëra, të katolikëzuara dhe të shqiptarizuara, erdhën në Gjakovë që të kalojnë në ortodoksi.”[20] Ky është një trillim i paqëndrueshëm i Kishës Ortodokse Serbe, ngase Atë Luigj Palaj[21] nuk

[20] Vesnik Srpske Crkve, mars-prill 1913, fq. 270.
[21] Lidhur me trajtimin dhe vrasjen e Atë Luigj Palajt nga autoritetet pushtuese malazeze, shih librin ***Në udhëkryqet e historisë shqiptare*** të dr. Lush Culajt, botoi Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009. Autori vë në dukje se si Luigj Palajn pushtuesit malazez, në

u vra nga forcat serbe për shkakun se dëshironte të kalonte në besimin ortodoks, duke mohuar fenë dhe kombin e vet, por, përkundrazi, ai u pushkatua vetëm për faktin se, me gjithë presionet e shumta e torturat që iu bënë, nuk e pranoi një gjë të tillë.

Gjithsesi edhe burimet e palëve që nuk ishin të përfshira në këto zhvillime, përveç burimeve shqiptare dhe serbo-malazeze, e konstatojnë konvertimin si një fakt të pamohueshëm historik e tronditës për ndërgjegjen e njerëzimit. Udhëpërshkruesja dhe njohësja e shkëlqyeshme e rrethanave në Ballkan, Mis Edit Durham, do të bëhej njëra ndër dëshmitaret e veprimeve barbare serbo-malaziase. Përshkrimet e saj lidhur me pasojat e konvertimit dhe të kundërshtimit të tij nga ana e shqiptarëve janë vërtet rrëqethëse: "Në mbarim të gushtit shkova në Malësitë e Shkodrës, kur pashë refugjatët e Krahinës së Gucisë që i kishte grabitur Mali i Zi, se si po vinin në gjendje të mjeruar. Këta qenë ata që mbeten nga masakrimet që bëheshin në emër të krishterimit. Pyeta dëshmues të vërtetë, katër batalione malazeze kishin kallur tmerrin në atë anë. Myslimanët ose duhej të pagëzoheshin ose i priste vdekja. Të luturit në mënyrë islame qe ndaluar. Qenë therur plot njerëz, grave të të cilëve ua kishin zbuluar fytyrën, i kishin pagëzuar e në disa raste edhe çnderuar."[11]

Nga kjo që u tha më lart, del se konvertimi me dhunë i shqiptarëve në ortodoksë në këtë periudhë kohore bëhej nga Kisha Ortodokse Serbe për qëllime të pastra politike, ndërsa të gjithë mekanizmat e tjerë pushtetarë ishin vënë në shërbim të kësaj ideje çmendurake dhe krejtësisht të papranueshme për parimin e shenjtë, sipas të cilit, në fe nuk ka dhunë.

rrugëtimin nga Gjakova për në Pejë, gjatë të cilit edhe e vrasin, fratin katolik e kishin lidhur me të njëjtat pranga me një të burgosur tjetër, i cili ishte shqiptar mysliman.

[11] Edith Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike 2, Tiranë, 2001, f. 263.

Akti i tretë: Toka e djegur shqiptare - tokë e lirë serbe

Megjithëse dhuna e pushtetit okupator serb mbi popullatën shqiptare nuk pushoi në asnjërën nga fazat vijuese të zhvillimeve gjatë shek. XX, një kthim më të fuqishëm të Kishës Ortodokse Serbe në këtë proces e ndeshim në vitet 80. Deri në këtë kohë rolin e ideatorit të shtypjes së shqiptarëve dhe të mohimit të vlerave të tyre kulturore e kishte luajtur Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë. Shkasi i kushtimit të vëmendjes më të madhe rolit të Kishës në shoqërinë serbe u mor nga përvjetori i 600-të i Luftës së Kosovës dhe nga e ashtuquajtura shtypje e serbëve të Kosovës që kinse u bëhej nga shqiptarët shumicë, kurse shkaku i vërtetë është se kjo strukturë nuk kishte pushuar së vepruari në projektin e saj në asnjë fazë historike dhe, sidomos, në kohën e relativizmit të rolit të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë (Serbisë) si forcë përcaktuese e zhvillimeve shoqërore, kisha po rishfaqej edhe më fuqishëm për ta përmbushur hapësirën mobilizuese që po e linte ajo në shoqërinë serbe. Propaganda e paparë mbi shqiptarët si elementë ekstremistë, pastaj mbi autonominë e pamerituar të Kosovës, të cilën, sipas saj, ia kishte dhuruar Titoja, ishte e orkestruar në bashkëveprim me faktorët politikë të Serbisë dhe me Akademinë e Shkencave të Serbisë. Kisha do të dilte në krah të liderit të fortë Slobodan Milosheviq, pikërisht për faktin se ai kishte shprehur vendosmëri që çështjen e shqiptarëve të ish-Jugosllavisë ta zgjidhte sipas recetës qindravjeçare kishtare serbe. Që nga mitingjet e famshme të jogurt-revolucionit e deri te vendosja e pushtetit absolut të Miloshevigit, në të gjitha manifestime e rëndësishme popullore e institucionale, kleri ortodoks serb do të shfaqej si një komponent i pashmangshëm i rreshtit të parë të auditorëve. Kisha Ortodokse Serbe ia dha bekimin e saj Milosheviqit, duke besuar te vendosmëria e tij për ta çuar deri në fund projektin për Serbinë e Madhe, pjesa kryesore e së cilës projektohej të ngrihej mbi lëkurën e shqiptarëve, pa mohuar këtu faktin se jo më mirë do të duhej të kalonin edhe kroatët, boshnjakët, maqedonasit etj. Kisha, si institucion fetar, nga natyra e saj do të duhej të ishte diçka

tjetër krahasuar me aparatin pushtetor dhe sidomos me dhunën, do të duhej të shquhej për një qasje më humane e më morale karshi problemeve shoqërore, karshi shtypjes policore e ushtarake, shkeljes së të drejtave elementare të pjesëtarëve të shoqërisë..., por jo Kisha Ortodokse Serbe kishte zgjedhur që ta mbronte aparatin e fuqishëm e të dhunshëm shtetëror dhe nomenklaturën politike në krye të tij, gjithnjë duke shpresuar se do ta realizonte projektin e saj shovinist. Në këtë pikëpamje, për një dekadë dhune sistematike të Serbisë mbi shqiptarët, nuk mbahet mend që Kisha Ortodokse Serbe ta ketë ngritur zërin për asnjërin nga veprimet që cenonte të drejtat elementare të njeriut, ndaj shkeljes së të cilave, vërtet, sot askund në botë nuk heshtet. A mund ta shohë një bashkësi fetare shkatërrimin total të vlerave të një bashkësie tjetër, me të cilën bashkekziston për shekuj të tërë (e në saje të tolerancës së të cilës ka mbijetuar në tokat shqiptare) dhe të bëhet sikur nuk po ndodh gjë? Po shkatërrimi i 218 xhamive në Kosovë[22], a nuk ishte edhe kjo një arsye që të ngrihej zëri?! Përkundrazi, nëse mbështetemi në faktet e padiskutueshme, të përfshira në monografinë Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (shkurt ’98-qershor ’99), do të vërejmë se si në përdhosjen e këtyre monumenteve bëjnë pjesë edhe grafi e mbishkrime karakteristike për Kishën Ortodokse Serbe dhe për kulturën serbe përgjithësisht, sikurse janë kryqet e bëra mbi muret e xhamive, pastaj katër “s” që simbolizojnë bashkimi serb etj. Madje, një xhamie në hyrje i ishte vënë mbishkrimi përbuzës e ironizues Crkva svetog mačka. Numri i objekteve të tjera kulturore, sikundër janë shkollat, bibliotekat, shtëpitë e kulturës, monumentet e shpallura kulturore të trashëgimisë shqiptare, sikundër janë kullat e lashta etj. të shkatërruara ishte po ashtu i madh. Janë djegur me qindra biblioteka private, pastaj dorëshkrime me vlerë të papërsëritshme etj.

Falangat “çlirimtare” serbe, në marshin e tyre vdekjendjellës, kishin vënë në thumb çdonjërin që nuk ishte serb, çdo shenjë kulturore

[22] Sabri Bajgora, Aktet dhe veprimet shkatërrimtare të pushtetit serb mbi monumentet fetare islame në Kosovë gjatë viteve ’90, në Gjenocidi i pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve ’90 (materialet e sesionit shkencor, mbajtur më 29 qershor 2000), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2001, f. 139-170.

që nuk ishte serbe e ortodokse; rrjedhimisht u vranë e masakruan mbi dhjetë mijë shqiptarë, u dogjën qytete, fshatra të tëra, por në mënyrë të veçantë u atakuan objektet e kultit dhe klerikët e devotshëm në to. Përvoja e fundit e kësaj mësymjeje të përgjakshme tregon se si forcat serbe e fillonin sulmin mbi një vendbanim, duke u përqendruar rrënimin e shenjës më identifikuese kulturore e fetare, mbi minaret e xhamive, për të përfunduar me shkrumbimin e tyre total, që nga këto forca do të konsiderohej çlirim territori. Krahas shkatërrimit në masë të objekteve fetare islame, forcat pushtuese serbe nuk ngurronin që mllefin e tyre ta shfrynin edhe mbi udhëheqësit fetarë, duke ushtruar një dhunë të paparë, fizike e psikike, një dhunë që kapte përmasat e cenimit të rëndë të dinjitetit njerëzor e fetar, që në mjaft raste kishin si përfundim edhe vdekjen. Përveçse nga urrejtja e tjetrit, i cili në aspektin fetar e kombëtar dukej ndryshe, represioni i forcave okupatore serbe mbi hoxhallarët motivohej edhe nga veprimtaria që kleri ynë realisht e bënte në drejtim të mbrojtjes së identitetit fetar e kombëtar të shqiptarëve. Numri i imamëve tanë pjesëmarrës në luftërat e fundit çlirimtare e dëshmon më së miri kontributin që e dhanë ata për mbrojtjen e qenies sonë kombëtare e kulturore. Sakrifica e dëshmorëve si Jonuz efendi Zejnullahu, Arben efendi Hyseni, Selim efendi Selimi, Sami efendi Plakolli, Fadil efendi Rashiti e shumë e shumë të tjerëve është prova më e mirë se si udhëhiqet shpirtërisht kombi në rrugën e lavdishme të lirisë. Këta dëshmorë nuk u vranë në luftë për tokën e tjetrit, për lakmi territoresh e pronash të huaja; përkundrazi, u vranë në mbrojtje të vlerave kulturore e qytetëruese të kombit të tyre, të dinjitetit të vëllezërve të tyre... Vlera morale e kësaj kategorie për luftën çlirimtare ishte e jashtëzakonshme, ngase ata, me sakrificën e me përkushtimin e paparë liridashës, u kthyen në një forcë motivuese për t’i vazhduar përpjekjet kundër okupatorit shumë herë më të përgatitur ushtarakisht. Prandaj, jo rastësisht, forcat serbe i vunë imamët në shënjestër si njërën ndër forcat motivuese të luftës sonë. Mbase këtë, simbolikisht, më së miri e dëshmon fakti se forcat serbe teksa po tërhiqeshin me turp nga Kosova, pak kilometra para se ta kalonin pikën kufitare, bënë aktet e fundit të dhunës mbi shqiptarët. Objekti i fundit që e

dogjën ishte xhamia pesëshekullore e fshatit Dobërçan dhe shqiptari i fundit që e vranë ishte imami i saj, Nysret efendi Hajdari. Ky akt i fundit në fakt dëshmon për qëllimin përfundimtar të politikës gjenocidiale serbe ndaj kombit shqiptar dhe ndaj vlerave kulturore-fetare të tij. E gjithë kjo ishte vetëm një përbërës i veprimit të gjithanshëm të Serbisë për të mohuar ekzistimin e një kombi tjetër dhe për t'i çrrënjosur gjurmët e një kulture e të një besimi tjetër në tokat etnike shqiptare.

Shqiptarët - halë në sytë e një patriarku

Fushatat serbe për spastrimin e tokave shqiptare, përkatësisht nga elementi etnik autokton dhe trashëgimia e tij kulturore, si përpjekje përfundimtare për ta shlyer çdo gjurmë dëshmuese të zotëruesve të saj, gjithnjë niste me një propagandë që synonte demonizimin e plotë të popullatës vendëse. Në mënyrë që fushata të shënonte suksesin për ta mobilizuar shoqërinë serbe në marshin pushtues, ishte nevojshme që kjo të bëhej nga njerëz e institucione që gëzonin respektin e saj. Në këtë pikëpamje, Kisha Ortodokse Serbe luante një rol të pazëvendësueshëm. Ajo do t'i angazhonte potencialet e veta më të afta njerëzore për këtë qëllim. Shembulli që kemi sjellë në vijim e dëshmon më së miri këtë intencë. Fjala është për patriarkun Pavli, i cili për më se dy dekada qëndroi në krye të kishës serbe. Mirëpo, para se të bëhej patriarku i Kishës Ortodokse Serbe, ku do ta zëvendësonte Germanin, sikundër dihet, Pavli kishte shërbyer për tre dhjetëvjetësha në Prizren si peshkop. Nga raportet e tij të shumta, të cilat ia dërgonte Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Serbe, në gazetën *Večernje novosti*[23] të Beogradit u hartua një fejton prej 11 vazhdimesh. Edhe pse një bari shpirtëror ka për detyrë t'i mbjellë e t'i kultivojë me kujdes atëror në mesin e besimtarëve dhe në ambientin ku vepron dashurinë, mirëkuptimin, tolerancën ndërmjet pjesëtarëve të fesë së vet, por edhe në raport me ata me të cilët në këtë pikëpamje dallojnë, partiaku i ardhshëm serb, nën veladonin e shenjtërisë, të përkushtimit e të përvuajtjes, do

[23] Kosmet očima patrijarha, fejton në gazetën Večernje novosti, Beograd.

të vishte rrobat e politikës hegjemoniste serbe, duke u marrë më parë me çështje politike dhe më rrallë me ato fetare. Çështjet politike në Kosovë do ta preokuponin Pavlin që në fillim të misionit të tij. Madje, nga gjuha me të cilën raporton, dëshmohet qartë se ai nuk kënaqet vetëm me konstatimin e thjeshtë të gjendjes, duke shfaqur një rreptësi qëndrimi, madje edhe një qortim për strukturat e kohës, të cilat, kinse, atëbotë i paskan sjellë në pozitë pavolitshme serbët në Kosovë: "Meqenëse nga Serbia e Vjetër u krijua Qarku Autonom i Kosovës dhe Metohisë, serbët, përnjëherë, madje në vendin e tyre, u shndërruan në pakicë, pikërisht sikurse në kohën e Turqisë. Që në raportet e mia të para, të cilat ia kam dërguar Sinodit të Shenjtë, kam tërhequr vërejtjen se, megjithëse serbët janë pushtet, në të vërtetë, Kosovën e zotërojnë shqiptarët."[24] Qartazi në këto fjalë nuk e gjejmë peshkopin, preokupimi themelor i të cilit është përkujdesja fetare. Statusi i Kosovës, pavarësisht se është fjala për një nivel shumë të ulët të autonomisë (sikundër ishte ajo e viteve 50 e 60), është një çështje thjesht politike, e cila, sikurse shihet, e preokupon tërë vëmendjen e Peshkopit të atëhershëm të Prizrenit. Konstatimi vijues, që edhe e shpreh shqetësimin e tij të madh, është tepër kundërthënës. Në të vërtetë, ai përfundon se, megjithëse serbët janë në pushtet, Kosovën e zotërojnë shqiptarët. Pra, shqiptarët nuk ua cenojnë pushtetin serbëve, ata përbëjnë problem vetëm me faktin se ekzistojnë, se janë të pranishëm në numër aq të madh sa serbët ndihen pakicë. Ndaj nuk është e rastit që gjithë angazhimi i Serbisë është i përqendruar në pakësimin e numrit të shqiptarëve, duke përfshirë si veprime kryesore pamundësimin e jetës, vrasjet dhe veçmas dëbimin e tyre nga trojet stërgjyshore. Në këtë pikëpamje Serbia kishte modelin e "suksesshëm" të zbatuar ndaj shqiptarëve të Sanxhakut të Nishit, trojet e të cilëve i kishin pastruar, qoftë nga elementi etnik, qoftë nga dëshmitë kulturore.

Pavli, në kontekst të urrejtjes patologjike ndaj shqiptarëve, në mënyrë të veçantë, e ka zët gjuhën shqipe, të cilën ai me përçmim e quan si *šiptarski jezik*. Përdorimi i kufizuar i shqipes në administratë dhe në

[24] Po aty.

dokumentet zyrtare të kohës, përveçse e pengon atë, nga ajo që shkruan, kuptojmë se madje e fyente rëndë. Pra, përdorimi i shqipes, i gjuhës së popullit dominues në Kosovë, për Pavlin është jo më pak se cenim i të drejtave të serbëve. “Duke bërë fjalë për atë se si në Kosovë dhe Metohi shkelen të drejtat njerëzore, se si serbët, në shtetin e tyre, ishin shndërruar në pakicë kombëtare, Pavli këtë e argumenton me shembullin e tij: - Letërnjoftimi të cilin e kam edhe tani, sepse edhe më tutje jam pensionist i Kosovës, më është lëshuar më 1979 në Prizren. Në të gjithçka është e shënuar fillimisht në shqip *(na šiptarskom*, sikurse shprehet ai, vër. H. Matoshi), pastaj në serbisht. Madje edhe në kopertinat e dokumentit identifikues së pari është vënë emërtimi shqip për letërnjoftimin, me shkronja të mëdha, kurse nën të gjendet ai në serbisht. Kështu - në kohën e RSFJ-së, e cila konsiderohet si përparimtare - të dhënat kryesore personale peshkopit të njërës ndër dioqezat më të vjetra serbe i shkruhen së pari në gjuhë të huaj”. Sipas kësaj logjike, të drejtat gjuhësore të dy milionë qytetarëve duhet të shkelen në mënyrë që të mos ndihet i fyer a i cenuar peshkopi serb. Po të zbatohej “logjika” e këtillë “pavliane” në Stamboll, ku ndodhte selia e Kishës Ortodokse, nuk do të duhej të përdorej si gjuhë zyrtare turqishtja, por ndonjëra nga gjuhët që do të preferonte kisha. Pse, në të vërtetë, e kërkon këtë Pavli, pse synon ta kufizojë përdorimin e shqipes në Kosovë? Natyrisht kjo është pjesë e programit për tkurrjen e dhunshme e të vazhdueshme të hapësirës etnike e kulturore shqiptare. Kjo gjë mund të arrihej nëpërmjet cenimit të të drejtave elementare kombëtare dhe të demonizimit etnik të shqiptarëve.

Është tepër e qartë se peshkopit serb, Pavlit, ia zinte frymën çdo gjë që ishte shqiptare, edhe pse një pjesë të madhe të jetës e kishte kaluar në një ambient krejtësisht shqiptar, edhe pse kisha e tij për shekuj kishte vepruar e pacenuar, e pse të mos thuhet edhe e mbrojtur, në këtë kontekst kulturor e etnik ku kanë dominuar gjithnjë shqiptarët. Madje, edhe vlerat kombëtare shqiptare të njohura gjithandej në botë, sikundër është Skënderbeu dhe lufta e tij kundër pushtuesve osmanë, ishin bërë halë në sy për peshkopin e Rashës e të Prizrenit. Në një raport për Sinodin ai do të shkruante i alarmuar: “Para do kohësh në

Llabjanin e Kosovës, fshat serb, është festuar jubileu i Skënderbeut”[25]. Shenjat shqiptare në Kosovë nuk do të duhej të shfaqeshin në asnjë mënyrë, ato duheshin margjinalizuar, qoftë edhe kur janë të tilla që i pranon bota mbarë.

Vëmendjen e Pavlit, në mënyrë të veçantë, do ta preokupojnë zhvillimet kryesore politike të kohës për të cilat ia i jep vlerësimet e tij. Po kështu e gjejmë të bëjë vlerësime politike për demonstratat e vitit 1981, për karakterin, për organizatorët dhe për qëllimet e tyre. Në vend se ta dënonte dhunën e ushtruar shtetërore masivisht mbi të rinjtë, studentët shqiptarë, por edhe mbi popullatën shqiptare gjithandej në Jugosllavi, ai do t’i akuzonte edhe autoritetet federative, veprimi i të cilave, sipas tij, u kishte hapur rrugë zhvillimeve në Kosovë më 1981: “Kryengritja nuk u bë për shkak se shqiptarët ishin të trajtuar padrejtësisht (përkundrazi, Pavli gjithnjë shprehej se shqiptarët kanë më shumë të drejta se sa i meritojnë, vër. H. Matoshi), por për shkakun se nuk u plotësuan të gjitha kërkesat e tyre (pa dyshim, këtu e ka fjalën për avancimin e statusit të Kosovës në bazë të Kushtetutës së vitit 1974, vër. H. Matoshi). Ata nuk e kanë merituar autonominë[26], ajo u është dhuruar, megjithëse Shqipëria e madhe (Velika Šipnija) e kishte humbur luftën. Atyre u shkoi për shtati edhe politika e Jugosllavisë federative dhe për këtë ishin të vetëdijshëm ata që i organizuan trazirat dhe pakënaqësitë e shqiptarëve të Kosmetit. Kryengritja u bë me qëllim që, nëpërmjet bukës së autonomisë, të kërkohej pogaçja e republikës”[27]. Duke i lexuar këto konstatime krejtësisht politike e të njëanshme të Pavlit dhe duke i krahasuar me qëndrimet e Lidhjes Komuniste mund të përfundojmë se ato janë plotësisht identike dhe ko-

---

[25] Po aty. Duhet thënë, për hir të së vërtetës, se Llabjani nuk është një fshat serb në pikëpamje etnike. Në fakt fjala është për një fshat etnikisht të përzier, ku edhe sot jetojnë shqiptarë dhe serbë.

[26] Koncepti racist i Pavlit dhe i pjesës dërrmuese të inteligjencies serbe kundruall muslimanëve të Ballkanit, veçmas koncepti i orientalistëve serbë, sipas të cilit të drejtat kombëtare i meritojnë vetëm disa popuj të caktuar, është trajtuar gjithanshëm në librin e Norman Cigarit, botim dygjuhësh i ShB “Logos A”, ***Roli i orientalistëve serbë për justifikimin e gjenocidit ndaj muslimanëve në Ballkan*** / ***The role of Serbian orientalist in justification of genocide against of the Balkans***, 2003, f. 106.

[27] Kosmet očima patrijarha, fejton në gazetën Večernje novosti, Beograd.

herente në pikëpamje të vlerësimit të së keqes që i vinte Serbisë dhe interesave të saj nga shqiptarët, paçka se peshkopi serb në raste të caktuara bën përpjekje të pasuksesshme që të vërë një vijë përkufizimi ndërmjet kishës serbe dhe Lidhjes së Komunistëve.

Jemi mësuar që, kudo në botën e civilizuar, të shohim udhëheqës fetarë të cilët e ngrenë zërin kundër dhunës, të cilët e kundërshtojnë shtypjen e njeriut nga njeriu, e kombit nga një komb më i fuqishëm, por është anakronike që, në fund të shek. XX, një udhëheqës shpirtëror ankohet zëshëm se si një komb nuk po dhunohet e nuk po shtypet në përmasën që, sipas tij, e meriton.

Përfundimisht hipokrizia e Pavlit mund të qartësohet edhe nëpërmjet një shembulli të thjeshtë, të nxjerrë nga krahasimi i pikëpamjeve të tij. Pjesën më të madhe të raporteve Pavli ia kushton të ashtuquajturit rrezikim të trashëgimisë ortodokse serbe, përkatësisht të pronës së kishave e të manastireve serbe. Ankesat janë të llojllojshme. Ai vajton për faktin se si barinjtë shqiptarë i kullosin kafshët në pronat e manastireve, se si shqiptarët presin dru në malin e kishës, se si fëmijët shqiptarë i fyejnë e i tallin priftërinjtë e murgeshat serbe e për ankesa të tjera për të cilat gjithnjë i fajëson shqiptarët, por, njëkohësisht ankohet për faktin se një serb 17-vjeçar ishte dënuar me një vit burg "vetëm" për shkak se ishte kapur duke e rrënuar xhaminë në fshatin Banjskë[28]. Pra, afërsisht për të njëjtat veprime ndaj objekteve të kultit, Pavli ka qëndrim të ndryshëm: ankohet pse nuk dënohen shqiptarët dhe ankohet pse dënohen serbët. Parimi moral i tij është se bën faj vetëm ai që e cenon kishën ortodokse, ndërsa është e kundërta e kësaj nëse dikush e cenon xhaminë. Kjo është aq lehtë e hetueshme edhe në raportet e tjera të peshkopit serb. Urrejtja për përkatësinë etnike, fetare e përgjithësisht kulturore të tjetrit, si përcaktuese e çdo përfundimi që nxjerr, e diskrediton rëndë këtë "bari". Ankohet për mosdhënien e lejeve për ndërtimin e ndonjë kishe ortodokse në lokalitete të caktuara, por nuk pushon së vajtuari, madje edhe më zëshëm, për faktin se po ngrihej ndonjë xhami apo kishë katolike diku në Kosovë. Ankohet se si serbët

[28] Po aty.

po e braktisin Kosovën, ndërkohë që shqiptarët po shtohen në dëm të serbëve, se si organet e pushtetit në Kosovë shpërfillin madje edhe vendimet e Federatës, se si po ngrihen shkolla në gjuhën shqipe etj.

A ishte e mundur që një njeri të jetojë për 30 vjet me shqiptarët, të shihej e të takohej me ta përditë në rrugë, ta vëzhgonte nga afër jetën e tyre, me tërë të metat dhe të mirat që kanë, dhe të mos mund ta veçonte as edhe një vlerë të tyre njerëzore, të mos e thoshte as edhe një gjë për ta në kontekst pozitiv? Kjo për mua është e pabesueshme. E besueshme është se Pavli qëllimisht e ka paraqitur për vite një pamje të këtillë të shqiptarëve, me qëllim që ta krijojë një qëndrim të përgjithshëm antishqiptar të shoqërisë serbe, duke e mobilizuar atë drejt një përplasjeje përfundimtare etnike. Ka dy dëshmi të fuqishme se ai, në pjesën më të madhe, ia doli ta manipulonte opinionin serb në këtë drejtim. Së pari, si shpërblim për punën e suksesshme në Kosovë, më 1986 e zuri vendin e patriarkut serb, ndërsa fakti se të gjithë mekanizmat politikë e ushtarakë më 1998-1999[29] u vunë në shërbim të çrrënjosjes së "të keqes", të cilën e kishte identifikuar Pavli vite më parë, është dëshmia më bindëse për krijimin e suksesshëm e sistematik të frymës antishqiptare në mesin e shoqërisë serbe. Ndërkaq, qëllimi përfundimtar i tërë kësaj fushate të egër e të pamëshirshme u bë i qartë, nëpërmjet realizimit praktik, në pranverën e vitit 1999: Kosova pa shqiptarë dhe pa shenja të kulturës së tyre. Gjithsesi, nuk duhet shpërfillur faktin se dëbimi masiv i shqiptarëve dhe rrënimi i pjesës dërrmuese të objekteve të tyre kulturore e fetare, i bërë më 1999, si projeksion kishte filluar shumë më herët, madje në kokat e kreut të Kishës Ortodokse Serbe.

[29] Me gjithë veprimin e gjithanshëm të strukturave policore, ushtarake dhe paraushtarake serbe, edhe në luftën e fundit të Kosovës spikat roli i Kishës Ortodokse Serbe, e cila nuk kurseu mundin dhe objektet e saj, duke i vënë në shërbim të soldateskës serbe. Për më tepër shih: Mr. Qemajl Morina, ***Roli i kishës serbe për ngjarjet në Kosovë***, "Dituria Islame", nr. 111-112, viti 1999, f. 4-7.

Përfundimi

Se cilat ishin përmasat e vërteta të zgjerimit të Serbisë në dëm të hapësirës etnike e kulturore shqiptare mbase më së miri mund të na dëshmojnë vetë pohimet e elitës udhëheqëse serbe. Kështu, princi Milan Obrenoviq, i entuziazmuar nga arritjet marramendëse pushtuese pas vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit, nuk ngurronte të pohonte me krenari: “Arritëm që me shpatë dhe zjarr ta shndërrojmë rajonin e Toplicës prej një toke thjesht të banuar me popullsi shqiptare në një tokë të pastër serbe”[30]. Pra, shpata zuri çdo frymë të gjallë shqiptare, ndërsa zjarri dogji çdo shenjë kulturore të popullsisë deri atëherë autoktone në këtë treva tona me vijimësi të padiskutueshme etnike. Përveç mbështetjes që e kishin nga disa fuqi ushtarako-politike të kohës, hordhitë serbe, në ndërmarrjet e këtilla barbare, u frymëzuan gjithanshëm nga Kisha Ortodokse Serbe, e cila, nëpërmjet organeve të saj të informacionit, por edhe të shtypit tjetër që ishte vënë në mbështetje të projekteve serbomëdha, thërriste për vazhdimin e luftërave çlirimtare, gjithnjë përderisa shqiponja e bardhë nuk do të valonte në tri dete, përderisa tokë serbe nuk do të konsiderohej gjithë hapësira ndërmjet Budapestit dhe Selanikut dhe nga Deti i Zi e deri te deti Adriatik[31]. Për ta rritur sa më shumë frymën mobilizuese luftarake e hakmarrëse, qoftë nëpërmjet medieve të saj, qoftë nëpërmjet përfaqësuesve më të lartë të saj që mbanin fjalime e mesha nxitëse e pushtuese gjithandej, e madje edhe në vetë frontet e luftimeve, Kisha Ortodokse Serbe e paraqiste popullatën vendëse shqiptare si të egër, të pacivilizuar, të padenjë, pushtuese, vrastare. Në një klimë të tillë vërtet nuk kishte vend për mëshirë, vdekja mbizotëronte kudo që kalonte kjo ushtri “çlirimtare” e frymëzuar nga kisha serbe, ndërsa lidhur me këtë gjithanshëm dëshmojnë edhe një numër i konsiderueshëm burimesh të

30 Cituar sipas veprës ***Çështja shqiptare dhe diplomacia serbe*** 1912-1913 të prof. dr. Xheladin Shalës, botoi Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2006, f. 9.

31 Glasnik Pravoslavne Crkve u Kraljevini Srbiji, korrik 1912.

shkruara serbe.[32] Madje, edhe sot mund të themi se përfaqësuesit e Kishës Serbe[33] - megjithëse në toka qind për qind shqiptare e kanë vazhduar punën e tyre të pacenuar për shekuj me radhë - nuk kanë ndryshuar asgjë në diskursin e tyre. Dashuria hyjnore, të cilën realisht do të duhej ta propagandonte kjo kishë, është dorëzuar para urrejtjes më të ulët njerëzore, para ambicieve politike për ta sunduar e për ta përvetësuar një pjesë tërë të botës, qoftë edhe me çmimin e gjenocidit. Kështu, në vend se të provojë të bëhet krijuese e paqes ndërmjet njerëzve e popujve të origjinave e të bindjeve të ndryshme, të cilët fati i ka gjykuar të jetojnë pranë njëri-tjetrit, Kisha Ortodokse Serbe edhe sot mbetet palë konfliktuale dhe dirigjuese e mjaft luftërave në Ballkan, duke mbjellë urrejtje për gjithçka që nuk është serbe. Fakti se, edhe pas përfundimit të konflikteve të armatosura në Ballkan dhe imponimit të paqes nga forcat e NATO-s, Kisha Ortodokse Serbe shquhet për frymën mospajtuese që shfaq ndaj realitetit historik, qoftë duke e kundërshtuar vullnetin e shqiptarëve të Kosovës për të jetuar të lirë, qoftë duke e kundërshtuar të drejtën e maqedonasve dhe të malazezve për ta pasur kishën e tyre kombëtare ortodokse, është dëshmi e mjaftueshme se edhe për një kohë nuk mund të pritet reformimi aq i domosdoshëm i shoqërisë serbe. Pa dyshim se, duke i mbjellë në vijimësi fatkeqësinë, urrejtjen, luftën e tmerrin, kjo kishë nuk mund të presë që ta bëjë fatlum as popullin në emrin dhe në interesat e të cilit thirret.

Prishtinë, tetor 2009

32 Lidhur me masakrat më të tmerrshme serbe mbi popullsinë shqiptare dëshmi rrëqethëse ofron gazeta me orientim social-demokrat “Radničke novine” dhe njëri ndër përfaqësuesit e socialdemokracisë serbe, Dimitrije Tucoviq.

33 Për ta ilustruar qëndrimin e sotëm të Kishës Ortodokse Serbe do të sjellim vetëm disa nga pikëpamjet të patriarkut Pavle, i cili vdiq para pak kohësh. Në të vërtetë, ai para se të zgjidhej në krye të kishës serbe (1986), kishte shërbyer si peshkop i Prizrenit dhe Rashkës për një kohë të gjatë. Në fejtonin që e botoi gazeta “Večernje novosti” e Beogradit, me titull “Kosmet očima patrijarha” (Kosova në sytë e patriarkut), Pavli do ta shprehte mosdurimin e urrejtjen e hapur ndaj çdo gjëje shqiptare. Në këto shënime nuk mund të gjendet as edhe një cilësi dalluese për të mirë e popullit në mesin e të cilit jetoi për një kohë shumë të gjatë. Përkundrazi, këto raporte të tij janë të mbushura me ankesa nga më absurdet për popullatën shqiptare. Asnjë thirrje për vëllazërim ndërmjet popujve të ndryshëm, për tolerancë, për mirëkuptim ndaj veçorisë së tjetrit.

Prof. dr. Hysen Matoshi

THE ETHNIC BOUNDARIES OF ALBANIA AND THE SERBIAN ORTHODOX CHURCH

(Summary)

The territorial expansion of the Serbs during the XIX and XX century fully coincides with the contraction of the Albanian lands in the Balkans. These claims cannot be refuted (despite the different approaches to the problem). The most dramatic loss occurred between 1878 and 1912, when the Albanians lost about 2/3 of their lands and about half their population. At the very same time the Serbs managed to expand their territories (with their final objective of getting access to the seas of the Balkans).

حسين ماتوشي

الخريطة الاثنية و الثقافية الالبانية و الكنيسة الارثودكسية الصربية

(خلاصة البحث)

هناك توافق تام بين الهجوم الصربى على الاراضى الالبانية خلال القرنين التاسع عشر و العشرين و تقصير هذه الأراضي بشبه جزيرة البلقان. و هذا عمل واضح كل الوضوح و ليس هناك أدنى خلاف بين المؤرخين الذين تناولوا هذا الموضوع. و قد تم اعتلال الاراضى الالبانية بصورة مثيرة خلال الفترة من (1878-1912) حيث بقى للالبان ربع أراضهم ليعشوا فيها و قد نقص عدد سكان تلك الاراضى إلى النصف. و في نفس الوقت تضاعف مساحة الاراضى إلى يسكنوا بها الصرب و زاد عددهم حتى انهم خططوا للخروج إلى الابحر الثلاثة ألتي تصل مياههم إلى شبه جزيرة البلقان.

DRAMË

Hajrudin S. Muja

ISABELA - (3)
(Sipas novelës me të njëjtin titull të shkrimtarit Maulana Muhammed Said)

Pasi Isabelën e prunë në dhomën e madhe, ku gjendeshin shoqet e saja të ulura, murgjit informuan se Princezë Arkia do të vinte së shpejti, pasi të kishte mbaruar lutjet e rëndomta, kurse vetë ata dolën. Këtu Mirano, Martha dhe Hana gjetën rastin të shkëmbejnë një bisedë të shkurtër sekrete me Isabelën, lidhje me situatën dhe planet e tyre për lirimin e saj. Sipas planit, për ta liruar nga ky burg torturash, i thanë Isabelës që përkohësisht të pranonte krishterimin. Por, Isabela që ishte shumë e vendosur do ta refuzonte këtë ofertë, duke thënë se në çdo situatë do të qëndronte nën hijen e Islamit dhe në dashtë Allahu nuk do të hynte në mëkate të tilla. Bindja e saj ishte se ajo gjithsesi do të lirohej nga ky burg torturash vetëm kur të bëjë emër Allahu.

Pas një bisedimi të shkurtër por të sinqertë, u pajtuan të gjitha për një plan, rreth së cilit duhej të veprohej, në çdo situatë të paraqitur. Pastaj të gjitha iu përkushtuan lutjeve, secili në lutje, secila në mënyrën e vet. Lutja e Isabelës ishte shumë e thjeshtë por tejet domethënëse: *“O Zot, më udhëzo në të vërtetën dhe më jep aq fuqi që të më shpie deri në sukses”*. Mirano filloi të recitojë salutime mbi profetin, kurse

dy vajzat tjera recituan lutje... kur dera u hap dhe princesha e Francës hyri, duke u mirëpritur nga të gjithë.

Arkia: *Më vjen shumë keq që Isabela ka lënë besimin e krishterë dhe është bashkuar me kompanionin satanik. Bash mbrëmë ëndërrova sikur një i shenjtë i myslimanëve po digjej në flakën e zjarrit të ferrit, kurse kjo e shkreta donte ta ndiqte. Nëse ajo do të kapet për kryqin e Zotit dhe do të jetojë me mua ca ditë, unë do t’i mundësoj asaj ta shohë Zotin!*

Mirano: *Sigurisht, është madje e turpshme që vajza e një kryeprifti të famshëm të braktisë besimin. Për këtë arsye ne të ftuam ty që të influenconi mbi të, me fuqinë tënde shpirtërore dhe ta ktheni atë nën këmbët e Zotit. Ajo s’mund të qëndrojë e heshtur dhe e pabindur kundrejt argumenteve tuaja, sepse te ju mbivepron fuqia shpirtërore.*

Arkia: *Shumë mirë, sot do të veproj me lutjen e devotshmërisë dhe shpresoj që Isabela të kthehet drejt Virgjëreshës, por ama nuk kam asnjë dyshim se deri nesër, ajo do të bëhet një Isabelë tjetër, një Isabelë e devotshme. Unë haptas po shoh se Zoti po pret Isabelën krahëhapur. Ju mos u shqetësoni, vetëm qëndroni që të shihni ç’do të ndodhë deri në mëngjes.*

Isabela donte të thoshte diçka, por i tërhoqën vërejtjen të qëndrojë e heshtur. Derisa Arkia fliste për mrekullitë e saj, u hap dera dhe hyri kryemurgu, për të pyetur Miranon nëse gjithçka ishte në rregull. Por, Mirano i dha të kuptojë se tani për tani kishte nevojë vetëm për qetësi. Duke u larguar, kryemurgu premtoi se do t’i vizitonte për çdo dy orë, gjatë gjithë natës.

Kishte hyrë mesi i natës, kur vajzat iu përkushtuan lutjeve bashkë me Arkian, e cila po qëndronte para idhullit të Virgjëreshës. Të tjerat qëndronin pak larg njëra-tjetrës për rreth saj. Mirano ishte vendosur më afër Isabelës.

Pas një orë lutjesh, Mirano i pëshpëriti Isabelës *“Ti nuk duhet të ndërhysh, vetëm dëgjo dhe prano gjithçka që të them unë”*. Arkia, gjatë lutjeve bënte lëvizje të çuditshme. Nganjëherë, ajo hapte duart sikur priste dike në to, nganjëherë bërtiste pakuptueshëm e nganjëherë qante e vajtonte. Këto gjeste ajo i përsëriste herë pas here: *“Po, po, Zoti të*

bekoftë, Shpirti i Shenjtë shpejt do të na përkrahë dhe do të na ndihmojë”.

Kishin hyrë në orën e dytë të lutjeve, kur Mirano u çua, lëshoi një britmë vajtimi dhe ra si e pandjenja. Isabela shikonte fare e hutuar kurse Martha dhe Hana vrapuan tek ajo, për t'i ndihmuar, duke e stërpikur me ujë, por Arkia i ndaloi, duke u thënë *“Mirano ka parë Zotin dhe lutjet tona të sotme janë të suksesshme. Mos u shqetësoni, është një fat për ne që Zoti ka ardhur në manastir.* (afër Isabelës) *Pra Isabelë, ende heziton të ngresh lart kryqin e Zotit tonë?”.*

Isabela çuditërisht qëndroi e heshtur, një heshtje që bëri Akian të besojë se vërtet Zoti ka ardhur këtu dhe ka derdhur Mëshirën e tij mbi Isabelën. Në atë çast hynë kryemurgu dhe sheh Miranon që ende ishte e pandjenja, ndërsa të tjerët tek qanin pranë saj.

Murgu: *Çka ndodhur?*

Arkia fillon tregimin për fuqinë e lutjeve të saj, dhe i thotë me besim të plotë se Zoti ka mëshiruar Isabelën, për të cilën gjë murgu nuk kishte asnjë dyshim. Ndërkohë që Mirano erdhi në vete, murgu me kuriozitet të madh i afrohet dhe e pyet:

Murgu: *Pra... Mirano... Si je? Na jep ndonjë lajm të mirë.*

Mirano (duke treguar drejt Arkias): *Është krejt manifestim i Shenjtërisë dhe mëshirës që më bëri të shoh Zotin!*

Arkia: *I madhërishëm është Zoti, qoftë i lavdëruar me emrin e Krishtit të Kryqëzuar!*

Murgu: *Çka pe...?*

Mirano: *Unë u isha përkushtuar lutjeve kur pashë një person të madh e të bukur, duke ardhur drejt meje por që po shikonte Isabelën dhe buzëqeshi...*

Murgu: *Urime, Urime...*

Mirano: *Tek po e shikoja atë, u kthye drejt meje. E pashë shenjen e tij të shkruar me shkronja drite “Shpirti i Shenjtë”.*

Isabela nuk mundi të durojë të qeshurën, por shpejt dhe pa u hetuar e ktheu në koll.

Arkia: *O Zot, qoftë i lavdëruar emri yt.*

Mirano: *Pastaj, ai shikoi me dhembshuri dhe derdhi ca pika mbi kokën e Isabelës...*

Arkia: *Kanë qenë pikat e frymëzimit religjioz, Isabelë Zoti të ka ndritësuar...*

Mirano: *Pastaj, Shpirti i Shenjtë më dha dy porosi...*

Murgu: *Porosi, çfarë porosish...*

Mirano: *Më tha që të shkoj në jug të Kordobës në një kishë ku ishin eshtrat e të shenjtërve, të denja për pelegrinazh dhe për atë që do të fitojë mëshirën e Zotit. Më tha se ai po shkonte atje dhe do të na priste dorëhapur.*

Arkia: *Zot i kryqëzuar. Qoftë i Lavdëruar emri i Tij. Sa me fat ky revelim. Unë e kam parë Zotin që nga momenti kur erdha këtu. E shihni se si revelimi i Miranos konfirmoi atë që u thashë më parë.*

Murgu: *Po e dyta, të tha tjetër Shpirti i Shenjtë?*

Mirano: *Tjetër...*

Murgu: *Po tjetër...*

Mirano: *Atë s'mund ta them këtu.*

Murgu: *Të porositi Shpirti i Shenjtë të mos e zbulosh?*

Mirano: *Po, ashtu më porositi.*

Murgu: *Kishte të bënte me ndonjë personalitet apo me ndonjë veprim?*

Mirano: *Mund të them vetëm se kishte të bënte me ty, si do ta dija unë se pozita jote para Zotit ishte aq e lartë?*

Murgu besoi menjëherë dhe iu dorëzua kënaqësisë. Princesha franceze Arkia u gjunjëzua para murgut, duke i puthur këmbët e duke e ledhatuar me sy të përlotur. Murgut i ishte ngritur tensioni i krenarisë dhe i kishte hyrë në qejf vetja. Duke parë që princesha murgeshë i ishte përulur, i ledhatoi flokët dhe i tha: *“Ki durim bij, edhe ti do të jesh me mua në Parajsë”*

Kështu kaluan edhe dy orë të tëra.

Arkia: *Pra, ç'do të bëjmë tani?*

Murgu: *Për të parë Zotin, na duhet të shkojmë në vendin që thotë Mirano. E sheh Isabelë, ty t'u shfaq Shpirti i Shenjtë në ne. Sinqerisht,*

me t'u takuar me Zotin do të bëhesh e shenjtë, aq sa mbretërit do të kërkojnë bekimin nën këmbët tua.

Mirano: *Mendoni se është e nevojshme që tani të shkojmë atje ku na fton Shpirti i Shenjtë?!*

Murgu: *Sa e thjeshtë që je. Ende heziton të zbatosh urdhrin e Shpirtit të Shenjtë, kurse ne duhet të arrijmë atje para mëngjesit.*

Mirano: *Mirë, çoje pra Isabelën në qeli, që të mos humbim kohë.*

Murgu: *Isabelën, jo ajo duhet të vijë me ne, ti do ta lësh atë për të cilën t'u shfaq Shpirti i Shenjtë? Isabela tashmë ka fituar shpërblim të madh prej Zotit, njëjtë sikur Shën Pjetri i njohur si armik i besimtarëve dhe i Zotit, fitoi bekimin e madhe të Zotit. Çohu, merre Isabelen me vete dhe le të shkojmë në Kishën e thënë...*

Hana: *Po nëse atë e zë gjumi udhës?*

Murgu (duke u qeshur): *Ti mendon se Zoti na ka ftuar në prezencën e Tij për asgjë? Mendon se ai nuk është në dijeni se personin që ka thirrur do ta marrë gjumi.*

Arkia: *Unë mendoj që të mos humbim më kohë, sepse sipas direktivave të Shpirtit të Shenjtë, ne duhet të jemi atje pa humbur kohë.* (Duke shikuar qiellin) *Unë vetëm po e shoh Shpirtin e shenjtë tek po zbret, qofsh i lavdëruar o Zot.*

Murgu: *Pra, unë po urdhëroj të tubohen gomarët e manastirit, dhe të përgatiten për udhëtim. Gomarët janë shumë të shpejtë dhe për një gjysmë ore do të na shpien në vendin e caktuar...*

Murgu thirri ca shërbëtorë dhe dha urdhër të përgatiteshin gomarët me një fshehtësi të pahetueshme. Murgu ndihej i gëzuar që Isabela, me të parë Zotin do t'i kthehej besimit, do të ngrinte kryqin e Krishtit, kurse kryeprifti, babai i Isabelës do të mahnitej para mrekullive të kësaj nate.

Ishin bërë gati. Isabela, Mirano, Martha, Hana, Arkia dhe murgu, ishin vendosur mbi gomarë të shpejtë dhe ishin nisur për udhëtim, që do t'u merrte vetëm një gjysmë ore kohë.

Arritën në Kishën e Shën Pjetrit, aty ku gjendeshin eshtrat e shenjtorëve më të respektuar të krishterimit. Besimtarët e të gjitha anëve vinin të bëjnë pelegrinazh e të kërkojnë shëlbim.

Kishte ende kohë para se të lindte dielli, ndërsa zemrat e të gjithë atyre që gjendeshin në kishë u mbushen me një frymëzim të papërshkrueshëm. Arkia e Murgu u përulën para një idhulli të madh në hyrjen e kishës, duke qarë zëshëm e duke shpresuar se do ta shihnin Zotin para se të delte dielli. Dhe kështu gjatë kohë do t'i mbushte me Shpirtin e Shenjtë.

Derisa ata po qanin zëshëm të mbushur me shpresa, Isabela dhe shoqet e saj vepronin në zbatimin sipas planifikimeve. Të katër vajzat iu afruan murgut i cili po qante e po gërvishte veten para një ikone të madhe të të shenjtërve. Dy prej vajzave, shpejt e shpejt ua lidhën duart, ndërsa dy të tjerëve këmbët. Gojën ia lidhën me një shami, dhe i gjori murg, në një sulm të tillë të befasishëm nuk pati kohë të kërkojë as ndihmë. Arkia nuk shikonte aspak duke e vënë veten në devocion para një ikone të një të shenjti tjetër. Pasi e lidhën mirë murgun, iu afruan Arkias dhe i pëshpëritën në vesh *"Eja motër e shenjtë, eja ta tregoj Zotin tënd"*

Arkia u ngrit e entuziazmuar, por kur e pa murgun e lidhur, u habit e pyeti *"Ç'është kjo?"*.

Isabela: *Ky është zoti yt për të cilin ke ardhur këtu!*

Pastaj, të katër vajzat i tërhoqën vërejtjen Arkias për të ardhmen dhe i predikuan Islamin. I thanë asaj, se po të donte ta shihte shpirtin e së vërtetës, ajo duhej të recitonte dëshminë e njënësisë së Zotit dhe të besonte në të dërguarit e Tij. Për ndryshe ajo kurrë s'do të mund ta shihte "Zotin e imagjinuar" deri në ditën e Kjametit.

Pasi i lanë mesazhin Arkias, katër vajzat, hipur mbi katër gomarët e shpejtë dolën nga oborri i kishës dhe u larguan në drejtim të panjohur. Pasi ikën, Arkia u ngrit si e çmendur. Iu afrua murgut dhe e liroi. Duke dëgjuar zhurmën, aty u afruan edhe disa pelegrinë të tjerë.

Katër vajzat që tashmë e kishin lënë kishën, ishin drejtuar për në shtëpinë e Umer Lahmit për ta lajmëruar atë dhe myslimanët tjerë për "shenjëtëritë' e ngjara. Zijad bin Umer gjithashtu ishte i interesuar për këto hollësira. Të gjithë të pranishmit falënderuan Miranon dhe vajzat.

IX

Kur ishin larguar katër vajzat nga kisha e Shën Pjetrit, murgu po qëndronte shtrirë, i pandjenja e duke u dridhur. Arkia i heq shaminë dhe e liroi nga të lidhurit, por kur pa se ishte jashtë ndjenjave, kërkoi ndihmë.

Pelegrinët i lanë qelitë dhe me të dëgjuar alarmin iu drejtuan ikonave me vajtime e gjëmë. Pas pak, murgu dhe Arkia morën gomarët dhe u kthyen në manastirin e tyre.

Me të ardhur në manastir, të gjithë murgjit e murgeshat dolën jashtë për të dëgjuar për mrekullitë që do të kishin ngjarë në Kishën e Shën Pjetrit. Por, u zhgënjyen dhe u çuditën kur mësuan të vërtetën e hidhur. Një njeri, megjithatë mori guxim të dalë në ballë e t'i flasë murgut.

Një njeri: *Zotëri i nderuar, ati i shenjtë (kryeprifti) ka dërguar këtë letër me disa direktiva që duhet t'i zbatosh menjëherë.*

Murgu: *I mjeri unë, si do të dal para atit të shenjtë, kur kam rënë në gjurmët dhe mashtrimet e djallit, atij djalli që i ka shpëtuar edhe Zotit pa e vënë para gjyqit. Ajo Isabela e mallkuar, bijë e vetë djallit, e futi veten në pabesi, por edhe mua më turpëroi... O Zot, vetëm ti e sheh se ç'janë duke hequr besimtarët e tu të devotshëm.*

Të gjithë murgjit e manastirit shprehën çudinë e madhe, kur dëgjuan fjalët e murgut. Vetë murgu, duke iu dridhur duart e hapi letrën dhe lexoi: "*Për të sjellë Isabelën në besim, tri vajzat kanë shkuar në manastir, sikurse ju kam informuar më parë. Mendoj se rikonvertimi i Isabelës është shumë i vështirë e gati i pamundur, prandaj kujdes. Nëse ajo nuk ndryshon mendimet dhe bindjet e saj, që tani t'i nënshtrohet inkuizicionit. Unë, do t'u dërgoj ca njerëz në mbrëmje që të kujdesen për vajzat. Shpresoj që së paku ata të mos jenë mashtruar prej djallit e të ndjekin gjurmët e Isabelës*".

Me të lexuar letrën, murgu filloi të qajë e të vajtojë. Pas një copë here foli: "*Çfarë përgjigje do t'i jap kësaj letre. Unë vetë do shkoj para kryepriftit e do t'i them se djalli mashtruaka edhe njerëzit e devotshëm*".

Me të thënë u çua, mori me vete edhe Princeshën e Francës për t'u takuar me 'atin e shenjtë' në shtëpinë e tij. I treguan gjithë ngjarjen të cilën 'ati i shenjtë' e dëgjoi me shumë kujdes, e tepër i pezmatuar foli.

Kryeprifti: *Kur unë ua dhashë direktivat të tregoheni të kujdesshëm për Islabelën, pse atëherë u besuat vajzave që me revelime false u kanë ikur nga manastiri?*

Murgu: *Ç'të them unë i shkreti, sigurisht kam qenë i dënuar dhe kam rënë në kurthin e djallit.*

Kryeprifti: *Më thuaj, cilët murgj tjerë kanë qenë të përzier në konspiracionin me vajzat?*

Murgu: *Asnjë, unë nuk i kam treguar asnjërit, ka qenë vetëm kjo murgeshë e njohur për devotshmërinë e saj.*

Kryeprifti (shërbëtorëve)**:** *Më sillni këtu Miçelin dhe Pjetrin, u thoni të lënë çdo punë që mund të kenë dhe të vijnë këtu me urgjencë.*

Pas pak, shërbëtorët kthehen me Miçelin dhe Pjetrin, të cilët me duar të kryqëzuar i bëjnë nderimin kryepriftit me përkulje.

Kryeprifti (Miçelit)**:** *Vajza juaj Mirano ka ikur bashkë me vajzën time Isabelën...*

Miçeli: *Mos për hir të Zotit, ç'po flisni kështu?*

Kryeprifti: *Jo vetëm Isabela e Mirano, por edhe Martha e Hana janë me to, ata i kanë tradhtuar njerëzit e manastirit dhe kanë ikur.*

Miçeli: *Të lutem at i shenjtë, na thuaj ç'ka ngjarë?*

Atëherë, kryeprifti urdhëroi murgun të tregojë ngjarjen nga fillimi, me çdo imtësi.

Pasi dëgjuan ngjarjen në detaje, Miçeli dhe Pjetri zëshëm ofshanë...

Kryeprifti: *Pse me ofshamë, mallkim, mallkoni këto shpirtra të fëlliqur, brenga më e madhe për mua është se Isabela i shpëtoi inkuizicionit.*

Miçeli: *At i shenjtë, nuk është një çështje aq e thjeshtë kjo, të krishterët e gjithë Korodobës do të dëgjojnë, e ne nuk do të jemi në gjendje t'u dalim përpara.*

Kryeprifti: *Sidoqoftë, ne duhet të gjejmë ku strehohen ato, për të tjerat mendojmë e punojmë.*

Tre ditë pasi kryeprifti kishte biseduar me murgun, pasi kishte kaluar pjesa e parë e natës, priftërinj të shumtë e të krishterë të rëndomtë të Kordobës filluan të tubohen në kishën e madhe. Ato, me fshehtësinë më të madhe drejtoheshin për te asambleja e kishës. As jashtë kishës, as brenda saj nuk kishte ndonjë shenjë që të kuptohej ndonjë tubim kaq i madh. Ata, grupe-grupe, me qetësinë më të madhe drejtoheshin te salla e madhe përballë altarit, murgjit e murgeshat, virgjëreshat e priftërinjtë.

Një kryq i madh zinte vend mbi altar, me Jezusin e varur dhe me virgjëreshën Mari duke iu përkulur. Muret ishin të mbushura me figurat e të shenjtëve e dishepujve, që ngjasonin shumë në figurat mitologjike të romakëve e të egjiptianëve. Gjithçka ishte e organizuar aq mirë sa askush prej kalimtarëve të rastit nuk mund të dyshonte se në kishë po mbahej ndonjë takim sado i vogël.

Por, për myslimanët nuk kishte sekrete të panjohura. Ata edhe nën një organizim të tillë ishin në dijeni se ç'po ngjiste brenda kishës. Aty, në rreshtin e parë përballë altarit ishin ulur një njeri me një zarf në dorë që i drejtohet njeriut të rastit përkrah tij.

Njeriu: *Vëlla, qoftë i lavdëruar emri i Zotit, këtu kam një letër që e kam për obligim t'ia dorëzoj kryepriftit pa filluar mbledhja. Por, meqenëse prifti Miçeli më urdhëroi të shkoj që të sjell këtu ca persona të caktuar, a mund ta merrni zahmetin të ma bëni këtë nder, t'ia dorëzoni kryepriftit posa të hyjë brenda.*

Njeriu tjetër: *Me kënaqësi, ti shko vepro si të është urdhëruar, këtë e ke të kryer, do t'ia jap atit të shenjtë posa të hyjë brenda.*

Njeriu: *Faleminderit shumë, unë pra po shkoj tani të zbatoj urdhrin që më është besuar.* Kështu tha njeriu i panjohur dhe pa u vënë re, doli nga kisha e u largua.

Tani salla e madhe e kishës ishte mbushur përplot. Ishin bërë verifikimet e duhura për të konfirmuar sigurinë se në mesin e tyre nuk kishte ndonjë mysliman. Të gjitha dyert e kishës u mbyllën, kurse jashtë

po qëndronin persona të caktuar, të cilët do të siguronin se nuk do të dëgjohej asgjë nga jashtë.

Kryeprifti dhe Miçeli, bashkë me dymbëdhjetë priftërinj të njohur, u vendosën në ballin e sallës së madhe në të majtë të altarit. Në këtë rast, u çua personi për të realizuar amanetin e dhënë, doli te kryeprifti, i dorëzoi letrën sipas porosisë dhe u kthye në vendin e tij.

Para se të hapte letrën, foli.

Kryeprifti: *Bijtë e bijat e mija, Sot, ju kemi shqetësuar me ftesën tonë, por duhet ta dini se është një ftesë për një çështje tepër të rëndësishme. Për këtë gjë, fjalën ia lë Miçelit, kurse ju e dëgjoni me qetësi e kujdes të madh.*

Miçeli u ngrit dhe filloi bisedën në të njëjtën kohë që kryeprifti kishte hapur letrën dhe filloi të lexojë. Me të lexuar ca rreshta, u bë si i tërbuar, bërtiste e dridhej si i çmendur. Të gjithë të pranishmit filluan të vështrojnë të çuditur, kurse Miçeli u desh të ndërpriste bisedën. Pas një qetësie të shkurtër, foli.

Kryeprifti: *Shikoni, pak më parë, njëri nga ju më dha një letër prej Isabelës... Ajo na fton të bëhemi myslimanë... Kush ma dha këtë letër?*

Një njeri: *At i shenjtë, unë ua dhashë, ma dha një njeri këtu për t'ua dhënë juve.*

I gjori, ende nuk e kishte mbaruar gjithë tregimin, kur e mbuluan rrebeshet e të rënave nga të gjitha anët, derisa i gjori e humbi vetëdijen. Pastaj e morën dhe ashtu të pavetëdijesuar e shpunë në një dhomë të vogël brenda kishës. Pas pak, pasi u qetësua pak gjendja, u çua kryeprifti.

Kryeprifti: *Duket se ky njeri është mysliman, por i veshmbathur me veshjet tona të shenjta që do të ketë ardhur këtu për spiunazh... Sido që të jetë, çështjen e tij e diskutojmë nesër, sot po merremi me vajzat, për të cilat i kemi dedikuar këtë tubim. Të vajzave që po na thërrasin në fenë e përgjakshme e barbare të Islamit. Pra, diskutime rreth asaj se si do të kemi sukses në arrestin e tyre dhe ç'mund të bëjmë në këtë çështje.*

Miçeli: *Vëllezër, qëllimi i mbajtjes së këtij tubimi sekret, veç ka dështuar, me të marrë letrën e Isabelës. Çka na ka mbetur neve tjetër veçse të dëgjojmë me durim e me lutje në Zotin, që ajo të kthehet në mëshirën e Zotit, ose të vuajë dënimin e ferrit sa më shpejt.*

Kryeprifti: *Ashtu është, atëherë silleni atë myslimanin e pavetëdijësuar këtu, të mësojmë më shumë prej tij. Ne e dimë se myslimanët janë shumë gjaknxehtë dhe nuk i japin lehtë sekretet e tyre, por mbasi ne këtë e kemi në dorë, shpresoj ta detyrojmë të mësojmë së paku ndonjë gjë.*

Të krishterin e pafajshëm, shkuan e morën dhe e prunë para priftërinjve, megjithëse gjithnjë i pavetëdijësuar. Kur e pa kryeprifti u befasua.

Kryeprifti: *Oh, po ky është prifti që shërben në një kishë në jug të qytetit dhe nipi im i vetëm.*

Pasi u identifikua, të gjithë priftërinjve u erdhi keq për të, por vetëdijen e tij s'mund ta kthenin dot.

Të nesërmen, pasi kishte ardhur në vete, u tregoi priftërinjve, se si një njeri i panjohur që i ishte dukur si i krishterë, i kishte dhënë një letër për t'ia dorëzuar kryepriftit, por pasi ai ishte me ngut, i gjori kishte marrë amanetin tij. Pasi e dëgjuan këtë, priftërinjtë u kujtuan se ky ishte një trik i myslimanëve. Për këtë arsye, ata i humbën shpresat se do ta shtinin Isabelën edhe një herë në dorë, kurse mbledhja e madhe e organizuar një ditë më parë, përfundoi "pa sukses".

Letra që kishte shkruar Isabela ishte një mesazh, një thirrje në fenë e vërtetë:

Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve. I Plotfuqishëm e Absolut, Krijues i qiejve e i tokës dhe gjithçkahes që gjendet në mes tyre. Ai, me fuqi absolute ka organizuar sistemin fizik po njëkohësisht edhe atë shpirtëror duke anuluar injorancën përmes revelimit dhe profetëve. Me dritë kanë anuluar errësirën duke predikuar të gjithë njënësinë e Zotit.

O babai im i nderuar! Le ta kesh të ditur se unë kam pranuar islamin, të vetmen fe të plotë e të pa të meta, e pastër prej çdo defekti, që të shpie në përsosmëri. Ju shmanga krishterimit për arsye se është

plot defekte e kontradikta në mësimet e veta. Shkurtimisht, dua të bëhem më e qartë.

1. Islami të mëson se Allahu është Një i Vetëm e i pashoq, i pafillim, i pambarim dhe askush i ngjashëm me Të. Ai nuk është biri i dikujt, as nuk ka trashëgimtarë. Ai ka jetuar, jeton e gjithmonë do të jetojë. Ai nuk kotet, nuk fle, nuk ushqehet as nuk është i nevojshëm për ato që ka nevojë njeriu. Unë nuk kam mundësinë t'i përmend të gjitha në këtë letër, por ti bëhu i mendshëm e mësoji vetë përmes studimit të Kur'anit.

2. Religjioni i krishterë beson se Zoti është Trini-At, Bir dhe Shpirt i Shenjtë, se Jezusi është i vetmi "biri i Zotit" Krijues dhe i përjetshëm sikurse Ati! Megjithëse, Bibla thotë se Jezusi ka qenë njeri, është ushqyer e ka fjetur... Po të ishte edhe Zoti i varur prej gjërave që është i varur njeriu, çfarë do ta ndryshonte atë prej njeriut? Kur'ani qartë flet se të gjithë ata që e konsiderojnë Jezusin si "Zot" apo "Bir i Zotit", e kanë tradhtuar Zotin dhe kanë hyrë në pabesi. Edhe Jezusi, sikurse Mojsiu, Abrahami, Noah, Davidi, Solomoni, etj, ka qenë i dërguar i Zotit për të udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë, ka qenë vetëm një njeri udhëzues dhe jo "Zot" as "Bir i Zotit". Tani vetëm mendo se sa udhëzim i logjikshëm e i drejtë është fjala Kur'anore.

3. Sipas Islamit, njeriu lind i pastër dhe i pamëkate, pastaj i ka dhënë kapacitet të ndjekë rrugën dhe udhëzimet e Tij dhe të abstenohet nga gjërat e ndaluara që njëkohësisht janë të dëmshme për të. Kur'ani tregon se Adami nuk ka mëkatuar por edhe të gjithë të dërguarit tjerë pas tij kanë qenë të devotshëm e të pamëkate. Nga ana tjetër, kredoja e krishterë më thotë se të gjithë njerëzit lindin me "mëkatin e trashëguar" vetëm pse profeti Adam ka mëkatuar!? Kjo s'mund të përkojë me logjiken e shëndoshë, kontradiktore me vetë mësimet e Jezusit. Edhe në këtë kontest, mësimet Kur'anore mbesin logjike e të pakundërshtueshme.

4. Mënyra se si Islami e paraqet të vërtetën Absolute nuk është e ngjashme me asnjë religjion tjetër. Islami thotë se njeriu do të fitojë ose do të humbë vetëm me veprimet e veta. Kështu kanë qenë mësimet e të gjithë profetëve. Askush nuk do të përgjigjet e as nuk do të shpër-

blehet për veprimet e të tjerëve. Ky është mësimi më i suksesshëm që nxiton njeriun në mirëbërje.

Mësimet e krishtera se Jezusi do të marrë mëkatet e tjerëve janë irracionale. Një njeri normal nuk mund të besojë që mëkatet e miliarda njerëzve t'i ngarkohen një njeriu (të vetmit "Bir i Zotit") plotësisht të pafajshëm. Ky lloj mësimi i ka hequr njeriut rëndësinë dhe e ka bërë të pavlefshëm. Shkurt, është një denigrim në maksimalen e tij.

5. Kur Kur'ani ka ardhur në botë dhe ka reveluar të vërtetën, një të vërtetë për një kohë të gjatë të harruar, ka vendosur ligjin e të gjithë profetëve me sukses. Islami ka refuzuar të gjitha shpifjet që u janë bërë profetëve të mëparshëm. Ka sqaruar dhe ka hedhur poshtë akuzat dhe shpifjet që i janë bërë Jezusit duke paraqitur ngjyrën e qartë e të vërtetë të devotshmërisë. Ka hedhur poshtë akuzat e rrejshme që i kanë bërë çifutët dhe të ashtuquajturit të krishterë. Ata janë akuzuar me shpifje, ndjekje e vrasjeve të profetëve. Po të mos e mbronte Islami, askush sot nuk do ta konsideronte madje as të moralshëm. Kjo është detyrë e Islamit, që të krishterët nuk do të mund kurrë t'ia kthejnë. Të krishterët jo vetëm që kanë manipuluar me librat, por kanë falsifikuar qindra bibla që nuk tregojnë as ma të voglin respekt për Jezusin. Kur'ani e mbron Jezusin nga të gjitha shpifjet, prandaj të thërras, ty dhe të krishterët tjerë ta lexoni këtë libër hyjnorë, i pasuruar si asnjë tjetër me të vërteta dhe me thirrjet e të gjithë Profetëve të dërguar.

6. Islami specifikon të drejtat e gruas, dhe çështjen e lirimit të skllavërisë, vendos vëllazëri ndërmjet njerëzve dhe vendos kontaktet ndërmjet njeriut e Zotit. Në krishterim nuk ka asnjë të drejtë për statusin e femrës. Vetëm burri mund ta ndajë gruan për çështje amorali, por gruaja nuk mund ta bëjë një gjë të tillë për burrin e saj. Asnjë fjalë mbi lirimin e skllavërisë në krishterim.

7. Islami filtron moralin njerëzor duke vendosur rregulla që njeriu duhet t'i respektojë. Kur'ani të lejon ta dënosh të keqen me të njëjtën masë, por "të këshillon se është më mirë për ty po e fale", shpërblen Allahu për të. Në Krishterim jashtë çdo logjike, ofenduesi nuk dënohet: Po të ra në njërën faqe, ktheja edhe tjetrën..." E si pra mund të

zbatohen këto mësime të palogjikshme. Si mund të besoj sipas këtij rregulli se të gjithë njerëzit janë lindur të barabartë?

Këto ishin vetëm ca shembuj sa për të ilustruar një nevojë të madhe të studimeve të tërësishme. Shkurt baba, unë kam gjetur se Islami është e vetmja fe që më jep ekzistencën e një Zoti të Përkryer, me askënd të ngjashëm, as në natyrën, as në Veten e Tij: "... Allahu është një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. Ai s'ka lindur kënd, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë." (Kur'ani 112-4).

Shërbëtorja e juaj - Isabela.

X

Myslimanët kishin mësuar mbi mbledhjen sekrete në kishën e madhe të Kordobës, e cila kishte përfunduar 'pa sukses' për shkak të letrës së Isabelës. Pas ca ditësh, nën shoqërimin e Zijad Bin Umejrit edhe ata organizuan një tubim ku ishte prezente edhe Isabela me shoqet e saj.

Një person: *Zotërinj të nderuar! Të krishterët kanë provuar të konfiskojnë Isabelën dhe nën presionin e dhunës ta konvertojnë atë sërish në besimin e krishterë, ndërkohë që qeveria myslimane nuk ka bërë asnjë veprim e asnjë ndërmarrje për t'ia kthyer lirinë kësaj vajze. Kur Isabela është deklaruar në Islam, mua ma merr mendja se ka qenë detyrë e qeverisë ta mbrojë atë, ta lirojë nga prangat dhe ta ruajë nga çdo rrezik.*

Zijad Bin Umejr: *Të gjitha aksionet e të krishterëve deri tani kanë qenë tepër sekrete, prandaj qeveria e kishte të pamundur të vepronte. Por është gjithashtu e vërtetë se kur një njeri pranon islamin e bëhet mysliman, është detyrë e qeverisë ta mbrojë atë prej shtypjes së jomyslimanëve. Ne qëllimisht kemi qëndruar të anuar në këtë çështje, sepse persekutimet që i ka përjetuar Isabela, e kanë forcuar atë moralisht...*

Një person: *Mendoj që për të ardhmen, duhet t'u tërhiqet vërejta të krishterëve...*

Zijad Bin Umejr: *Asnjë diskutim, në të ardhmen qeveria do të tregohet më aktive në mbrojtjen dhe përkrahjen e anëtarëve të vet. Për këtë arsye, ne kemi informuar profetin e krishterë për të gjitha detajet e Isabelës dhe i kemi bërë apel se qeveria është shumë e shqetësuar për sigurinë e saj dhe të vajzave të tjera dhe për çdo aktivitet të padëshirueshëm, ajo do të marrë masat e duhura.*

Umer Lahmi: *Të nderuar zotërinj, shoqet e Isabelës e kanë njohur islamin dhe e kanë pëlqyer atë, por deklaratën nuk e kanë bërë...*

Zijad Bin Umejri: *Pra, merre këtë detyrë dhe le të bëjnë deklarimin...*

Mirano: *Të nderuar Zotërinj! Më parë dua të bëjë deklarimin tim në Islam, por pastaj kam ca pyetje të cilat nuk i kam mjaft të qarta dhe nuk mund t'u jap përgjigje të kënaqshme të krishterëve.*

Umer Lahmi: *Jo, unë mendoj të bëhen të gjitha sqarimet e duhura para se të japish dëshminë. Unë e di se ti nuk dyshon në vërtetësinë islame, por është mirë të kuptosh më parë gjithçka që mund të kesh të paqartë.*

Mirano: *Jo, jo, asnjë paqartësi, unë dua të bëj dëshminë më parë.*

Të tri vajzat u konvertuan në Islam duke shqiptuar dëshminë, kurse të pranishmit ua uruan. Pastaj iu shtruan ca diskutimeve religjioze për të ndriçuar çështjet e paqarta dhe për të pasuruar më shumë njohuritë rreth Islamit e krishterimit.

Mirano: *Sipas të krishterëve, Teurati është 'Ligj i Zotit' ndërsa 'Bibla' është rregullore. Kështu, pasi që të dyja kanë qenë me njeriun në këtë tokë, atëherë s'ka qenë e nevojshme të zbresë Kur'ani. Nga ana tjetër vetë Kur'ani konfirmon Biblën dhe Teuratin.*

Umer Lahmi: *Ne të krishterët i atribuojmë disa cilësi librave të tyre të shenjtë, e kanë bërë të domosdoshëm të pranojnë origjinalitetin e tyre aktual, duke paraqitur kështu Teuratin si një ligj ndërsa Ungjillin si një përsosmëri, atëherë Kur'ani është persevativ që do të thotë një ligj edhe i përsosur. Këtë Kur'ani e konfirmon për veten, ndërsa Bibla nuk e bën një konfirmim të tillë për veten.*

Mirano: *Por, Teurati dhe Ungjilli janë penduar në Kur'an dhe është e domosdoshme që secili mysliman t'i besoj ato, apo jo... atëherë përse myslimanët nuk besojnë në to?*

Umer Lahmi: *Për arsye se ato nuk ekzistojnë më, pra të krishterët nuk e kanë Ungjillin që u është dërguar!*

Mirano: *Si nuk e kanë, atëherë përse i përmendë Kur'ani?*

Umer Lahmi: *Kur'ani ka konfirmuar një Teuratë e një Ungjillë dhe jo një Bibël të sajuar e të shpikur...*

Mirano: *Por, të krishterët thonë se është po ai Teuratë e po ai Ungjillë që konfirmon Kur'ani...*

Umer Lahmi: *Ashtu thonë të Krishterët, por Kur'ani thotë ndryshe. Kur'ani në Ahqaf 28:3 thotë se Zoti krijoi tokën e qiellin dhe nuk u lodh në krijimin e tyre, ndërsa Teurati thotë se Zoti i krijoi këto për gjashtë ditë, kurse ditën e shtatë pushoi. E pra, sipas Kur'anit Zoti nuk lodhet, sipas Teuratit edhe Zoti lodhet. Kështu, Kur'ani nuk po e pranon por po e refuzon dhe po e kundërshton atë. Për profetin Sulejman Kur'ani thotë se asnjëherë nuk ka qenë mosbesimtar, ndërsa sipas Teuratit ai ka adhuruar idhujt edhe këtu refuzim e jo konfirmim! Pastaj, në të katër Ungjijt Biblik thuhet se Jezusi ka vdekur në kryq, pra është kryqëzuar, kurse Kur'ani thotë 'as e mbytën as e kryqëzuan'. Prapë refuzim, jo konfirmim.*

Mirano: *Hë pra... Kur'ani nuk i konfirmuaka Teuaratin e Ungjillin...*

Umer Lahmi: *Kurani i konfirmon, por jo këto aktualët. Thënë ndryshe, Teurati dhe Ungjilli që konfirmon Kur'ani, nuk janë këto që mbajnë të krishterët në dorë sot. Ato origjinalet janë të humbura, kurse këto janë plot shpifje e gabime, plot tregime amorale e kundërthënie. Ato të sotmet madje i bëjnë ortak edhe Zotit. Pastaj thuhet se Jezusi (larg qoftë) ka pretenduar të jetë "Zot" ose "Bir Zoti", por Kur'ani të tillët që pretendojnë e besojnë këtë i quan kundërshtarë të besimit të tij të drejtë. Logjiko tani, a po e pranon apo po e kundërshton Kur'ani Biblën?*

Mirano: *S'ka dyshim se ky është refuzim.*

Umer Lahmi: *Vetë Kur'ani të jep mundësi të definosh se cili libër është i vërtetë dhe cili i falsifikuar. Ai thotë në Nisa:7 se po të mos ishte Kur'ani shpallje e Zotit, në të do të gjendeshin shumë kundërthënie e kontradikta. Kështu, librat që përmbajnë kontradikta nuk mund të jenë shpallje të Zotit!*

Mirano: *Në princip kjo duhet të jetë e natyrshme, secili libër që përmban kundërthënie e kontradikta, s'mund të jetë shpërfillje e Zotit, por cilët janë këto libra?*

Umer Lahmi: *Pikërisht ato për të cilat po flasim, dhe aq shumë sosh, sa nuk mund ta marrish me mend.*

Mirano: *Mund të japish ndonjë shembull, nga teksti...*

Umer Lahmi: *Sa të duash. Në librin e dytë të Samuelit (24), gjejmë flakërimin e Zotit që ndizet kundër Israelit, kurse në Librin e Kronikëve (21), është satanai ai që nxiti Davidin!. Kush pra e nxiti Davidin, Zoti apo Djalli (satanai)?. Në Librin e dytë të Kronikëve (36:9) "Joakimi ishte tetëvjeçar kur u bë mbret dhe mbretëroi në Jerusalem tre muaj e dhjetë ditë..." Por sipas Librit të dytë të Mbretërve (24:8): "Joakimi kishte 18-vjeç kur u bë mbret dhe mbretëroi në Jerusalem tre muaj..." Sa vjeç ishte dhe sa mbretëroi? Sipas Librit të dytë të Sameuelit (10:18) Davidi vrau shtatëqind kuaj të mprehur dhe dyzet mijë këmbësorë, ndërsa sipas Librit të parë të Kronikëve (19:18) shtatë mijë karroca lufte dhe dyzet mijë këmbësorë". Shtatëqind apo shtatë mijë...? Shiko pastaj kontradiktat e Librit të parë të Mbretërve (7:26) dhe Librit të dytë të Kronikëve (4:5) në përshkrimin e pallatit të mbretit Sollomon, 2000 apo 3000?! Në gjeanologjinë e Krishtit, Mateu (1:6-16) ka mbledhur 26 paraardhës, ndërsa Luka (3:23-31) ka mbledhur 41 paraardhës. Paraardhës të njëjtë në gjeanologjinë e të dyve janë vetëm tre: Davidi, Jezusi dhe Jozefi. Cili është frymëzuar nga Zoti, Mateu apo Luka? Shiko tani Mateu 1:6:"Jezusi ishte biri i Davidit prej Solomonit..." Ndërsa në Luka 3:31 thotë: "Jezusi ishte biri i Davidit nga Nathani..." Cila është e vërtetë, prej Solomoni apo prej Nathani. Gënjejnë të dy sepse e dimë se Jezusi u lind mbinatyrshëm. Ne mund të besojmë për mrekullitë e Jezuit në Bibël, por nuk mund të pranojmë deklarimin autentik dhe të inspiruar nga Zoti një tekst që tregon se vetëm 20 breza kanë ekzistuar ndërmjet njeriut të parë dhe Abrahamit, siç thotë për shembull Luka.*

Mirano: *Por gjeanologjitë mashkullore nuk kanë asnjë kuptim për Jezusin sepse ai u lind mbinatyrshëm, ai ishte djalë ekskluziv i Maries, pa baba biologjik.*

Umer Lahmi: *Sigurisht, shiko tani tutje, Gjoni në 17:12 thotë: "Derisa unë isha me ta, i ruajta në Emër tënd ata që mi dhe, dhe vërtet i ruajta". Asnjë nuk u bor pos birit të bjerrjes, në mënyrë që të plotësohej shkrimi i shenjtë". Por i njëjti "autor" në 18:9 thotë: "Ndodhi kështu që të shkonte në vend fjala që pati thënë: Nuk bora asnjë prej atyre që më dhe". Në rastin e parë Jezusi bori një, ndërsa në rastin e dytë asnjë. Dallimi në mes 0 (zero) dhe 1 është infiniti.*

Mirano: *Zoti na ruajt, vërtet kundërthënie të tepruara...*

Umer Lahmi: *Në Librin e parë të Samuelit (28:6) thuhet: "E pyeti për këshillë Zotin, por nuk iu përgjigj as me ëndrra as me urim, as me anën e profetëve". Në Librin e parë të Kronikëve (10:14) thotë: "...e nuk u këshillua me Zotin, prandaj edhe e vrau e mbretërinë e tij e kaloi mbi Davidin, birin e Isait. Në rastin e parë e pyeti Zotin por nuk mori përgjigje, ndërsa në rastin e dytë nuk e pyeti Zotin fare. Cila nga këto dy kontradiksione është fjalë e Zotit?*

Isabela: *Pa dyshim asnjëra.*

Umer Lahmi: *Sipas Mateut (2:1) Jezusi u lind në Betlehemin e Judesë në kohen e mbretit Herod, që përkon me vitin 6 para erës sonë, kurse Luka (2:1-7) thotë se ai u lind në kohen e Cezarit August kur Kuirini ishte guvernator i Sirisë, që do të thotë kah viti i 7-të i erës sonë. Në veprat e Apostujve (9:7) "dëgjuan zërin, por nuk panë askënd" dhe po aty në 22:9 "panë dritën por zërin nuk e dëgjuan. Tek Mateu 27:5, 'Juda u varë në lak', ndërsa te Veprat e Apostujve 1:18, 'Juda theu qafen, plasi përmjedis e iu derdhën të gjitha zorrët'. Sipas Mateut (11:13-14, 17:13) Gjon Pagëzuesi ishte Elia, por sipas Gjonit (1:21) 'Elia nuk ishte Gjon Pagëzuesi'. Mateu (21:12-18) thotë se Jezusi së pari shkoi në tempull e pastaj te fiku, kurse Marku (11:12-15) thotë se Jezusi njëherë shkoi te fiku, e pastaj në tempull. Sipas Markut (15:25) Jezusi u kryqëzua në orën tre, kurse sipas Gjonit (19:14) deri*

në ora gjashtë Jezusi nuk ishte i kryqëzuar. Mateu (27:32), Luka (23:26) dhe Marku (15:21) thonë se Simoni (prej Cirenës) mbarte kryqin e Jezusit. Por, Gjoni (19:17) thotë se kryqin e mbarte vetë Jezusi. Versioni 7:6 i librit të parë të Kronikëve thotë se Beniamini kishte tre bij, ndërsa versioni 8:1 thotë se kishte pesë!

Shih tani katër kontradiksionet lidhur me ato që vizituan varrin e Jezusit. Në Ungjillin e Mateut (28:1) "Pas të shtunës në të zbardhur të dritës, të ditës së parë të javës, shkuan Maria Magdalenë, dhe Maria tjetër për ta parë varrin". Sipas Ungjillit të Lukës (16:1): "Kur kaloi e shtuna, Maria Magdalenë dhe Maria e Jakobit e Saloma blenë erëra të mira për të shkuar ta përurojnë Jezusin". Sipas Ungjillit të Gjonit (20:1): "Ditën e parë të javës ende pa dalë drita, erdhi Maria Magdalenë te varri dhe pa se guri ishte hequr prej varrit...". Sipas Ungjillit të Lukës (24:10): "...Ishin Maria Magdalenë, Gjonia e Maria e Jakobit, po edhe gratë tjera që ishin me to..." Dhe, çka panë ata aty? Mateut (28:2-5) thotë se ata para se të hynin në varr panë engjëllin i cili iu tha se Jezusi u ringjall. Markut (16:5) thotë se ata hynë në varr e panë një djalosh ndenjur në anë të djathtë, të veshur me petk të bardhë. Luka (24:4) thotë se ata (në varr) panë dy burra të veshur me petka të ndritshme. Gjoni (20:12) thotë se pa dy engjëj të veshur me të bardha... Sipas Ungjillit të Lukës (24:9-10) Ata që ishin për të parë varrin e Jezusit "U kthyen nga varri dhe i njoftuan mbi të gjitha këto të njëmbëdhjetit e të gjithë tjerët, ishin Maria Magdalenë, Gjonia e Maria e Jakobit. Po edhe gratë tjera që ishin me to u treguan apostujve të njëjtën gjë". Por sipas Markut (16:1-8) "Ata (Maria Magdalenë, Maria e Jakobit dhe Soloma) dolën dhe ikën nga varri sepse i kapi frikë e madhe dhe tmerri. S'i treguan askujt asgjë, sepse kishin frikë..." Sipas Gjonit (5:31) "dëshmia nuk është e vërtetë". Por sërish Gjoni (8:14) thotë: " Dëshmia është e vërtetë..." Sipas Mateut, Jezusi u përgjigj, por sipas Gjonit (18:33-38) Jezusi nuk u përgjigj. Fjala e fundit e Jezusit ndryshon në të tre versionet te Luka (43:46), Gjoni (19:30) dhe Mateut (27:46,50). Fjala e fundit e Jezusit mund të ishte vetëm njëra prej këtyre.

Mirano: *Të gjitha këto te Besëlidhja e Re, po në të vjetrën, edhe aty ka kundërthënie?*

Umer Lahmi: *Njëjtë, fillimisht i ceka disa prej atyre në Besëlidhje të Vjetër. Por mund të vazhdojmë edhe më. A mund të shihet Zoti?*

Mirano: *Jo. Zotin nuk mund ta shohë askush!? "Hyjin kurrë askush nuk e pa..." (Gjonit 1:18). "Por (thotë Zoti) nuk do të mund ta shikosh fytyrën time, sepse njeriu nuk mund të më shohë e të mbetet në jetë" (Dalja 33:20). "Asnjë njeri nuk e pa dhe asnjë njeri s'mund ta shohë (Zotin)..." (Letra e parë drejtuar Timoteut 6:16).*

Umer Lahmi: *E kanë parë Moisiu me Aronin, Nadabin e Abihuin dhe me shtatëdhjetë pleqtë e Izraelit (Dalja 24:9-10)! Edhe Izaku (Zanafilla 26:2)! Me Mojsiun Ai fliste "fytyrë për fytyrë" (Zanafilla 32:30). E pa Abrahami" (Zanafilla 12:7, 17:1, 18:1)! E pa Jobi (Libri i Jobit 42:5)! E pa edhe Amosi (Profecia e Amosit 9:1)! E pa si: "...një njeri që po qëndronte mbi mur, për t'i dhënë lugë e në dorë mbante mistrinë e muratorit... (ky ishte Zoti)" (Profecia e Amosit 7:7-8).*

Isabela: *Subhanallah, ç'janë këto marrëzira që iu mveshën fjalës së Zotit!?*

Umer Lahmi: *A u ngjit ndokush në qiell?*

Mirano: *Jo, Gjoni (3:13) thotë se "Askush nuk u ngjit në qiell, përveç birit të njeriut që zbriti nga qielli (Parajsa)..."*

Umer Lahmi: *Ashtu thotë Gjoni por Libri i dytë i Mbretërve (2:11) thotë ndryshe: "Ndërsa ata po vazhdonin rrugën duke biseduar, kur qe një karrocë e zjarrtë dhe kuaj të zjarrtë, i ndanë dhe Elia me anë të vorbullës u ngjit në qiell...". Kështu, tashti nuk kemi me të parë e me të dëgjuar, por me të vepruar. Ligji i përtërirë (24:16) thotë se: "Për fajin e fëmijëve të mos vriten baballarët as fëmijët për fajin e baballarëve. Secili le të vdesë për mëkatin e vet..." Por, Isaiah (14:21) "Bëni gati masakrën e fëmijëve, për të padrejtat e prindërve të tyre, që të mos ngrihen më të pushtojnë tokën, e ta mbulojnë faqen e dheut...". Luka (11:50-51) thotë "Që prej kësaj breznie të kërkohet llogari për gjakun e derdhur të të gjithë profetëve që nga krijimi i botës, prej gjakut të Abelit deri te gjaku i Zakarisë, që u vra ndërmjet*

Iterit e shenjtërores. Po, unë po ju them, do të kërkohet llogari prej kësaj breznie”. Përkundër Ezekielit (18:20) ku thuhet: "Ai që mëkaton do të vdesë, djali s'do të përgjigjet për fajet e të et as baba s'do të përgjigjet për fajet e të birit...

Ungjilli sipas Mateut 26:6-9 thotë: " Kur Jezusi po gjendej në Batani, në shtëpinë e Simonit të grumbulluar, ndërsa po rrinte në tryezë, iu afrua një grua me një enë albastri plot parfum të shtrenjtë dhe ia zbrazi mbi krye. Nxënësit kur e panë u zemëruan e thanë: "Pse gjithë ky shpenzim, mundi të shitej shtrenjtë e t'u jepej skamnorëve..." Diçka përafërsisht të njëjtë gjejmë edhe në Ungjillin sipas Markut 14:3-7. Por kontradiksioni gjendet në Ungjillin sipas Lukës 7:36-39: "Një farise e grishti Jezusin për bukë. Ai hyri në shtëpinë e fariseut dhe u ul në tryezë. Kur, ja, hyri menjëherë një grua që ishte mëkatare e njohur në qytet. Ajo kur mori vesh se Jezusi gjendej në tryezë, në shtëpinë e fariseut, mori një enë alabastri me parfum, zuri vend pas tij, te këmbët e tij dhe duke qarë filloi me lot t'ia lajë këmbët, t'ia fshijë me flokë, t'ia puthë e tija lyejë me parfum..." Mateu dhe Marku thonë se ai ishte në shtëpinë e Simonit të grumbulluar, ndërsa Luka thotë se ai ishte në shtëpinë e fariseut, kurse Gjoni thotë se ai ishte në shtëpinë e Martës, Maries e Lazarit. Mateu dhe Marku thonë se ajo që pruri parfumin ishte një grua e (thjeshtë), kurse Luka thotë se ajo ishte një grua mëkatare. Gjoni thotë se ajo ishte Maria, motra e Lazarit. Marku dhe Mateu thonë se gruaja i parfumosi kokën e Jezusit, ndërsa Luka dhe Gjoni thonë se parfumosi këmbët e Jezusit. Si ka mundësi pra të konsiderohen këto fjalë të Zotit?!

Mirano: *Vërtet si ka mundësi, sa herë e kam lexuar Biblën dhe nuk kam mundur të vërej vetëm pak disa prej tyre, edhe ata, kur kam pyetur më kanë dhënë sqarime që nuk kam mundë t’i kundërshtoj, megjithëse sqarimet që më janë bërë nuk kanë kënaqur intelektin tim. Ka edhe më...*

Umer Lahmi: *Në librin e dytë të Samuelit 24:24, Davidi bleu lamën dhe gjedhin 50 sikla argjend, kurse në Librin e parë të kronikëve 21:22-25, Davidi bleu të njëjtën gjë për 600 sikla të artë. Tek Libri i Esderës (2:8) "Bijt e Zethusë: nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë". Ndërsa në Librin e Nehemisë 7:13: "Bijtë e Zetusë: tetëqind e dyzet e pesë". Libri i Esderës 2:12: "Bijt e Azgadit: njëmijë e dyqind e njëzet e dy". Libri i Nahemisë 2:17: "Bijt e Azgadit: dymijë e treqind e njëzet e dy". Libri i Esderës 2:15 "Bijtë e Adinit: ketërqind e pesëdhjetë e katër". Në librin e Nehamisë 7:20 "Bijtë e Adinit: gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë". Libri i Esderës 2:19 "Bijtë e Hasumit: dyqind e njëzet e tre". Libri i Nahemisë 7:22 "Bijtë e Hasumit: treqind e njëzet e tetë". Libri i Esderës 2:28 "Njerëzit e Belit e të Hajit: dyqind e njëzet e tre". Libri i Nahemisë 7:32 "Njerëzit e Belit dhe të Hajit: njëqind e njëzet e tre". Libri i Esderës 2:6 "Bijtë e Fahatmoabit: dmth: bijtë e Jozuehut e të Joabit: "dymijë e tetëqind e dymbëdhjetë". Libri i Nahemisë 7:11 "Bijtë e Fahatmoabit, dmth: bijtë e Jozuehit e të Joabit: dy mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë". Ka edhe shumë të tjera, por unë mendoj se mjaftojnë këto që të shihet se ç’është bë me fjalën e vërtetë të Zotit. Nga këto pra, edhe po të ketë mbetur ndonjë gjë e pandryshueshme, si definohet ajo?*

Mirano: *Pak më parë përmende tregime amorale, nuk të ndërpreva se ishe në një temë që më interesonte gjithashtu, por a mund të sqarohesh pak kur flet kështu për Biblën, mendoj ku gjenden këto tregime? Tek libri i dytë i Timoteut (3:16-17) lexojmë se: "I tërë shkrimi i shenjtë hyjnisht i frymëzuar është i dobishëm për të mësuar për të bindur, për të ndrequr, për të EDUKUAR NE DREJTESI që njeriu i hyjit të jetë i përsosur, i përshtatshëm për të kryer çdo vepër të mirë".*

Umer Lahmi: *Ashtu është e shkruar, por cila nga këto veti i përmban historia e ndyrë e Lotit (Lutit a.s) me vajzat e tija te Gjeneza (19:30-36). Shpifje për një profet të dehur që çon marrëdhënie intime me vajzat e veta. Ku është morali, dobia dhe edukata prej historive të tilla. Dhe pikërisht, ky veprim incesti nuk dënohet por shpërblehet me pasardhës që mbeten burimet kryesore të kombit të Moabitëve dhe të Amonitëve. Përveç incestit Loti ua dorëzoi vajzat epsheve të burrave të Gomorrës dhe i ftoi të bënin ç'të donin me to (Zanafilla 19:8). Çfarë edukate përmban rrëfimi i dy motrave (Oolës e Olibës) në kapitullin 23 të librit të Ezekielit?Ose historia e ndyrë e Judës me Tamarën në kapitullin 38 të Librit të Gjenezës, që vazhdon edhe te Mateu 1:3*

në brezat e Jezusit? Në Librin e Gjyqtarëve 16:1, kemi Simsonin që kishte qëndruar gjykatës për 20 vjet në Israel dhe tani duke shkuar me lavire hyri në "librin e Zotit" Çfarë na mëson historia e bijve të Noehit (Nuhit a.s) që e lakuriqësuan bijtë e vet?! Ose tregimi mbi gomaricën te kapitulli i 22:22-34 të Librit të Numrave? Ose tregimi për Abrahamin që duke tentuar të fitojë simpatinë e egjiptianëve, e dorëzoi gruan e tij të bukur të përdoret si grua për Faraonin?! Profeti David, jo vetëm që gjente kënaqësi tek shikonte të tjerët duke bërë dashuri, por gjithashtu tradhtoi të shoqen me gruan e Uriahut, të cilës i vrau edhe të shoqin (2 Samuel 11:2-5 dhe 11:15-18).

Mirano: *E çuditshme, si ka mundësi gjithë këto shpifje e skena amorale dhe të krishterët nuk shohin. A gjendet diçka e ngjashme edhe në Kur'an?*

Umer Lahmi: *Kur'ani profetët i paraqet shembull të besimit dhe devotshmërisë (shih: 21:27 dhe 22:52), ndërsa në Bibël gati të gjithë profetët paraqiten si mëkatarët më të dalluar në fushën e besimit dhe qëndrimit moral. Aktet të turpshme iu mveshen profetëve duke përfshirë adhurim nga ana e Aronit të Idhujve (Eksodi 32:1-20), prirjen e Solomonit drejt paganizmit, (1 Mbretërve 11:4), dhe kurthet dinake që Jakobi i ngrite të atit Isakut (Zanafilla 27:16). Ose Abrahami pranoi të bënte një martesë incesti me Sarahun ose ai qe thjeshtë një gënjeshtarë i pafytyrë. (Zanafilla 12:10-20 dhe 20:2-18). Për Jezusin thuhet se iu drejtua së ëmës me këto fjalë: "Grua, Cfar të duhet ty se ç'bëj unë dhe nuk bëj unë" (Gjoni 2:4). Me këto nuk dua të them se Jezusi nuk ka vepruar drejt, por dua të them se këto tregime nuk kanë asgjë të bëjnë me Jezusin. Shiko pastaj Kapitullin 27 të Zanafillës për dredhitë Jakobi Izakut. Kur'ani nuk akuzon asnjë profet me akuza të mësipërme...*

Kishte kaluar një kohë e gjatë që Umer Lahmi dhe Mirano sqaroheshin mbi argumentet se Bibla me tekstin që përmban nuk mund të jetë fjalë e Zotit. Edhe të tjerët dëgjonin dhe mësonin. Vajzat ishin habitur fare nga këto diskutime biblike dhe çuditeshin që, edhe pse e kishin lexuar Biblën, nuk i kishin vënë re këto kundërthënie në "Librin e Zotit".

Më në fund të gjithë u ndanë.

XI

Kishin kaluar katër vjet. Vajzat i ishin nënshtruar studimeve serioze, jo vetëm mbi Islamin, por edhe mbi zhvillimet shkencore të kohës. Ata tashmë kishin mësuar të flasin mirë arabishten dhe ishin bërë prej dijetarëve të njohur të Islamit. Isabela u bë gruaja më e famshme e Kordovës. Ajo u bë shembull i diturisë, moralit e urtësisë.

Kështu ngjet me çështjen e diturisë kur rrezaton drita në zemrën e atij që e do Allahu xh.sh. Isabela, bija e priftit më të famshëm të Spanjës, një e krishterë shumë e edukuar, tani ishte një myslimane e devotshme. Ajo ishte njohëse e mirë e të dy religjioneve dhe si e tillë kishte fituar famë jo vetëm në qytetin e Kordovës ku jetonte, por në gjithë Spanjën. Kishte arritur aftësitë për zgjidhjen e çdo problemi që mund të hasej, me mbështetje të argumenteve Kur'anore dhe tradicionale. Qindra të krishterë të Spanjës kishin përqafuar Islamin përmes saj.

Në këtë kohë kishte ardhur lajmi se një grua e krishterë, tepër e famshme dhe e devotshme, njohëse e mirë e Biblës dhe e Kur'anit, e pathyeshme në debate religjioze. Kishte njohuri të atilla që as vetë Papa nuk i posedonte. Të rinj e të reja, pleq e plaka nga e gjithë Spanja shkonin tek ajo dhe e kishin bërë si të shenjtë. Thuhej madje se ajo shëronte sëmundjet e njerëzve vetëm me të shikuar!

Kjo grua e dinte se Isabela kishte pranuar Islamin para disa kohësh dhe publikisht kishte proklamuar se sapo të shkojë Isabela tek ajo, do ta rikthente në krishterim me mrekullitë e saj dhe me forcën e argumenteve që posedonte. Por thoshte gjithashtu se Isabela kurrë nuk do të pranonte të shkonte tek ajo, se ajo as sot nuk e dinte arsyen pse ishte konvertuar në Islam!

Kështu, para kësaj prapaskene, Isabela me një njeri të ditur zunë një dialog për këtë çështje

Njeriu i ditur: *Kam dëgjuar për një proklamim të ri.*

Isabela: *Çka?*

Njeriu i ditur: *Një grua e ditur e krishterë ka kërkuar të polemizojë me ty, dhe ka proklamuar se sapo të takohet me ty do të rikonvertojë në krishterim me arsyet dhe argumentet e saj të forta.*

Isabela: *Një grua e krishterë pretendon se ajo mund të konvertojë një grua besimtare myslimane në krishterim me argumentet e saj!? Në fakt, unë kam humbur interesimin me gjëra të tilla. Çdonjëri që gjen udhëzimin e Allahut, edhe ashtu do të vijë tek unë. Duket se kjo grua është e etshme për famë!*

Njeriu i ditur: *Jo, ajo ka arritur famën e saj gjatë kohë, por tani është e 'inspiruar' të konfrontojë ty. Kjo çështje po përrallohet gjithandej nëpër qytet, nga të gjithë të krishterët.*

Isabela: *Kështu kam dëgjuar edhe unë, flitet se është shumë e edukuar në të gjitha subjektet e krishtera, por thonë se ajo ka njohuri të madhe edhe në Kur'an e synet dhe se asnjë mysliman nuk ka nivelin e saj të njohurive.*

Njeriu i ditur: *Shumë mirë, nëse ajo vërtet kërkon konfrontim, le të vijë këtu me njerëzit e saj dhe le të hapë debat mbi gjithçka që dëshiron.*

Gjashtë ditë pas kësaj bisede, Isabela kishte marrë një letër prej kësaj gruaje të famshme, ku i thoshte: "A pranon të kemi një bisedë në subjektin "islami dhe krishterimi. Nëse pranon të vij te ti, unë kam aftësi të sqaroj çdo imtësi lidhur me fenë e krishterë që ti mund të kesh dyshim".

Isabela, pasi lexoi kërkesën e saj, i ktheu përgjigjen: "Jo sa për të humbur kohë, por për të kërkuar të vërtetën jeni e mirëseardhur në shtëpinë time në çdo kohë".

Menjëherë, pasi mori letrën e Isabelës, gruaja e famshme e krishterë e shpalli publikisht takimin dhe ditën që pasoi, bashkë me njëqind gra të tjera të krishtera erdhën në shtëpinë e Isabelës, që në fakt ishte bërë një institut i studimeve Kur'anore.

Isabela fillimisht u shprehi mirëseardhje, kurse bisedën e nisi gruaja e krishterë.

Gruaja e krishterë: *Më kanë thënë se ju keni braktisur Jezusin dhe të gjithë shenjtët e tjerë, dhe keni pranuar një fe të prishur siç*

është Islami. Është më mirë që pas kësaj bisede t'i kthehesh sërish fesë së krishterë!

Isabela: *Edhe në qoftë se ndokush do të më djeg të gjallë, unë nuk do ta ndërroj islamin me kredot e turpshme të krishterimit. Tani, a kam të drejtë të them se ju keni ardhur këtu të më ftoni në krishterim dhe keni kundërshtuar urdhrin biblik, meqë askund në Bibël nuk është urdhëruar thirrja në krishterim!? Nga ana tjetër, është thënë se Krishti ka qenë dërguar vetëm për "delet e humbura të Israelit".*

Gruaja e krishterë: *Por, a shkruhet në Bibël se dyert e religjionit të krishterë janë të mbyllura për njerëzit?A janë këto kërkimet tua që të kanë frymëzuar në braktisjen e krishterimit?*

Isabela: *Po, është shkruar në Bibël, është vërtetuar në Kur'an se Jezusi ka qenë i dërguar për Israelitët!*

Gruaja e krishterë: *Kur kemi besuar në Kur'an që po na jepni leksione prej tij?*

Isabela: *Përmenda Kur'anin sepse çështjet kanë përgjasime në Kur'an dhe në Bibël! Dëgjo, tek Mateu (10:5), Jezusi dërgoi 12 dishepujt dhe i këshilloi ato të mos kalojnë në komunitete tjera, të mos hyjnë në qytetet samaritare por të shkojnë drejtë te 'delet e humbura të Israelit'! Pastaj një grua e Kananit erdhi duke qarë dhe i kërkoi Jezusit ndihmë, por ai nuk iu përgjigj. Kur u largua ajo, dishepujve u erdhi keq dhe e pyeten Jezusin, e ai u tha "Unë jam dërguar për delet e humbura të Israelit" dhe për askënd tjetër. Argument biblik që tregon se Jezusi nuk ka qenë dërguar për ne, por për israelitët, dhe është më mirë për ty t'i nënshtrohesh Ligjit të Zotit. Tani, të veprosh për konvertime në krishterim, është thyerje e urdhrit të Jezusit dhe rebelim ndaj tij!*

Gruaja e krishterë: *Çka të mos dish prej Biblës, kërko se kam aftësi të shpjegoj gjithçka. A nuk është shkruar në Bibël që ajo të predikohet gjithkund?*

Isabela: *Aspak...!*

Gruaja e krishterë: *Mos thuaj gënjeshtra Isabelë, që paku në bisedime të këtilla duhet të abstenohesh nga gënjeshtrat. Shiko si është shkruar në Ungjillin e Markut (16:15): "Shkoni në të gjithë botën dhe*

përhapni Ungjillin te të gjithë njerëzit. Secili që do të besojë në Bibël do të jetë i shpëtuar”

Isabela: *Ti mund të mos e dish, se kapitulli i gjashtëmbëdhjetë i Ungjillit të Markut, në origjinal ka pasur vetëm tetë versione, dhe gjithçka ke të shkruar më shumë janë shtesa të mëvonshme! Prandaj, këto fabrikime s’mund t’i paraqitni si dëshmi.*

Gruaja e krishterë: *Oh... në bazë të kujt ky konkludim?*

Isabela: *Në bazë të kërkimeve e studimeve të bashkëfetarëve tu. Sepse në gjetjen e një kopjeje të vjetër, 12 versionet e këtij kapitulli nuk janë të shkruara fare.*

Gruaja e krishterë: *Meqë ne nuk i kemi kopjet e vjetra, unë s’mund të them asgjë lidhur me të. Por ajo që mëson Kur’ani nuk është bibël, ç’të shtyri pra ta përqafosh Kur’anin.*

Isabela: *Në këtë subjekt kam pasur diskutime të gjata me priftërinjtë, përgjigjen kërkoje prej tyre.*

Gruaja e krishterë: *Si mund ta gjej unë çfarë përgjigje u ke dhënë ti priftërinjve!? Më thuaj çfarë gjete më parësore në Islam? Çka vërejte më superiore tek Islami?*

Isabela: *Po, ti a mendon se e kam pranuar islamin ashtu verbërisht? Sigurisht që ka diçka të fortë që më ka larguar nga krishterimi e më ka afruar për Islamin!*

Gruaja e krishterë: *Pse nuk i përgjigjesh pyetjes shkurt? Pse nuk më thua superioritetin? Të jesh e sigurt se në gjithë Spanjën nuk është askush i barabartë me mua në njohjen e fesë së krishterë. Ti as që mund t’i paramendosh gjërat që si unë. Sidoqoftë unë të shtrova një pyetje që me përgjigjen e saj, gjërat do të qartësohen dhe e vërteta do të ndryshojë haptas nga e pavërteta. Ti vetëm më thuaj, cilat kualitete të drejtësisë janë superlative: Ligji i mëshirës, apo Ligji i drejtësisë?*

Isabela: *Që të dyja janë superlative në vendin e vet dhe që të dyja janë defektive jashtë vendit të vet!*

Gruaja e krishterë: *Nuk e di a e kuptove pyetjen. Dëgjo, ligji i Teuratit është ‘drejtësi’, kurse ligji i Ungjillit është ‘mëshirë’ dhe për shkeljen e secilit rregull është caktuar dënimi. Por Ungjilli është ‘Ligji i mëshirës’ për të cilën vetë Jezusi ka autorizim në shlyerjen e mëkateve. Më thuaj, ti Isabelë, a e refuzon ‘Ligjin e mëshirës’?*

Isabela: *Unë të thashë se të dyja janë korrekte në vendet e veta. Nëse agresori është i falur me kusht që të reformohet dhe të mos e përsëritë agresionin, atëherë kanë vend falja dhe mëshira, por nëse agresori falet e mëshirohet vetëm përmes një rrëfimi, kjo është padrejtësi e madhe për viktimën!*

Gruaja e krishterë: *Më thuaj pra, nëse Kur’ani është ligj i mëshirës apo i drejtësisë?*

Isabela: *Sipas jush, Teurati qe ligji i drejtësisë dhe jo i mëshirës, ndërkohë që Ungjilli qe ligji i mëshirës dhe jo i drejtësisë! Të dy prej tyre janë defektive në vendin e vet, ndërkohë që Kur’ani mbulon të dy ligjet, të drejtësisë dhe të mëshirës, në mënyra korrekte të të përdoruarit! Për shembull, Kur’ani (26:4) flet për të kthyerit e të keqes me të keqe, po me atë masë, ky është ligji i drejtësisë! Por vazhdon, në qoftë se ‘jeni të durueshëm, kjo është më mirë për ju’, ky pra është ligji i mëshirës. Në një rast tjetër thotë: “Nëse ke bërë gabim, ktheje me po atë masë, kjo është drejtësi. Pastaj vazhdon “po nëse je i durueshëm, është më mirë për ty”, ky është ligji i mëshirës. Në rastin tjetër kërkohet që borxhliut t’i japish afat për ta paguar borxhin, ligj i drejtësisë, pastaj vijon “nëse ia falni, është më mirë për ju”. Ligj i mëshirës. Kështu Kur’ani kooperon me drejtësinë dhe mëshirën.*

Gruaja e krishterë: *E sheh, Kur’ani kërkon hakmarrje, ndërsa Ungjilli kërkon falje dhe ndalon hakmarrjen! Këtu pra është superioriteti i Biblës mbi Kur’anin.*

Isabela: *Ky nuk është superioritet, por defekt. Në qoftë se të padrejtit, mizorët, kriminelët, dhunuesit, janë të falur në të gjitha rastet e krimit, atëherë bota do të shndërrohet në një kaos. Nëse falet krimineli dhe ju i thoni drejtësi, por çfarë drejtësie ka për viktimën, apo mos drejtësia ekziston vetëm për kriminelë!?Kur’ani ka lejuar përdorimin e të dyjave, faljen dhe hakmarrjen, në kohë e masë të caktuar.*

Gruaja e krishterë: *Shiko se ku është fryti i një vepre të tillë, Jezusi nuk ka luftuar asnjëherë dhe me askënd, por gjithmonë i ka falur*

armiqtë e tij dhe e ka kaluar me durim. Ndërsa profeti yt i ka luftuar armiqtë e tij dhe asnjëherë nuk i ka falur.

Isabela: *Durimi, falja, drejtësia, janë cilësi e çdonjërit, por vetëm pak i kuptojnë signifikimet e tyre. Çdo kualitet moral është i mirë ose i keq, varësisht prej përdorimit në kohë e vend të caktuar. Falja është superlative vetëm kur ke fuqi për ta dënuar dikë dhe atëherë e falë. Kjo ka meritë të veçantë. Të pafuqishmit dhe të dobëtit nuk do t'i konsiderohet e meritueshme. Profeti jonë kur ka pasur fuqi të hakmerret, ka falur. Pas fitores në Mekë,. Disa jobesimtarë i sollën tek ai, e ai i la të lirë. Pra, në kohën që ai kishte mundësi t'ua presë kokat të gjithëve, ai i fali. Tani më thoni, cili ishte pozicioni i "Zotit tuaj" në faljen e armiqve? Ai ishte i shtypur dhe nuk kishte ndonjërin për ndihmë, as që kishte fuqi të hakmerrej. Durimi për të pafuqishmin nuk është mëshirë.*

Gruaja e krishterë: *Oh Isabelë, ti e quan të moralshëm njeriun që ka marrë pjesë edhe vetë në luftë, dhe nuk i jep meritën atij që nuk ka qenë shkaktar për asnjë gjakderdhje?*

Isabela: *Kjo është logjika jote e të kuptuarit. Po të pyes unë ty që të mendosh e të thuash me sinqeritet e vetëdije, nëse drejtësia është e mirë ose e keqe?*

Gruaja e krishterë: *Jo, të dyja të mira janë, unë nuk po refuzoj.*

Isabela: *Shumë mirë atëherë, më thuaj nëse masa e sinqeritetit mund të manifestohet përveçse në beteja dhe nëse drejtësia mund të qëndrojë veçse pas themelimit të qeverisë. Asnjëherë, prandaj Allahu i ka dhënë të dy oportunitetet profetit tonë. Dhe kjo është se ai u ka hapur luftë jobesimtarëve dhe ka marrë pushtetin duke manifestuar sinqeritetin e tij dhe duke zbatuar drejtësinë. Më thuaj nëse këto dy kualifikime bëjnë edhe për "Zotin" tuaj - Jezusin?*

Gruaja e krishterë: *Ti mendon se luftimi është meritë e madhe, Zoti jonë ka pru mesazhin e paqes dhe jo të luftës!*

Isabela: *Por, për profetin tonë të dyja këto janë të kombinuara. Nga njëra anë ai ka qenë i mëshirshëm për botën, falës, kurse nga ana tjetër luftëtarë në rrugën e Allahut, pra një shembull e model në të gjitha aspektet e jetës.*

Gruaja e krishterë: *Sa e palogjikshme është biseda jote Isabelë, a mund ta krahasosh një njeri luftëtar me njeriun e paqes?*

Isabela: *Nëse lufta kundër armiqve dhe shtypjes është e papranueshme ose konsiderohet si krim, atëherë çka mund të thuhet për profetin Mojsi (Musa a.s) jeta e të cilit ka kaluar duke luftuar, për të cilin dëshmon Dhjata e Vjetër. Është e vërtetë se Jezusi ishte profet i paqes e i sigurisë, dhe se ai asnjëherë nuk luftoi gjatë jetës së tij, por profeti ynë është profet i luftës dhe i faljes. Nëse nga një anë luftonte kundër armikut që pengonin përhapjen e mesazhit islam, sikurse profeti Mojsi, në anën tjetër sikurse Jezusi jepte mesazhin e paqes e të sigurisë mbi botën. Një shembull i përkryer ndërmjet Mojsiut e Jezusit.*

Gruaja e krishterë: *Më duket se të ka kapluar një konfuzion i madh, por unë nuk do të lë deri të fitoj këtë betejë diskutimesh. Unë dua të bisedoj hapur me ty, në mënyrë që në fund, këto gra që janë duke dëgjuar këtë dialog, të fitojnë aftësi që vetë ata ta ndajnë "shapin prej sheqerit". Vetëm mendo para se të kooperosh Biblën me Kur'anin sepse e vërteta do të qartësohet, e ti do të mbetesh e turpëruar.*

Isabela: *S'ka gjë, unë jam e gatshme t'i përgjigjem çdo lloj pyetjeje që mund të bësh.*

Gruaja e krishterë: *Derisa profetizimi i profetit tuaj të dëshmohet me prova, biseda e jonë do të mbesë e parëndësishme.*

Isabela: *Po, ç'është profetësia sipas jush?*

Gruaja e krishterë: *Nëse mund të sjellësh dy dëshmi në profetizimin e profetit tuaj, atëherë Islami është religjion i vërtetë, ndryshe është fals. Për çdo profet, këto dy gjëra kanë qenë esenciale. Së pari. Profetët e mëparshëm kanë paralajmëruar ardhjen e tij, dhe së dyti, vetë ai do të manifestojë mrekulli.*

Isabela: *A ka qenë Adami profet, sipas jush?*

Gruaja e krishterë: *Po ka qenë!*

Isabela: *A ka paralajmëruar ndonjë profet për ardhjen e tij?*

Gruaja e krishterë: *Jo, sepse para tij s'ka pasur profet!*

Isabela: *Pra, ky nuk qenka kusht i profetizimit, sepse në të kundërtën as Adami nuk i ishte përjashtuar këtij ligji! Ndërsa, për manifes-*

timin e mrekullive nuk gjendet asnjë kusht, sepse sipas biblës, profetët gënjeshtarë kanë mundësi të bëjnë mrekulli edhe më të mëdha.

Gruaja e krishterë: *Ti prapë me avazin tënd dhe nuk pranon asgjë. A do të më japish dëshmitë për profetizimin e profetit tuaj apo jo?*

Isabela: *Kjo është një pyetje që unë dua ta bëj ty. Me çfarë dëshmish të krishterët besojnë profetizimin e profetit Mojsiut, Davidit, Solomonit, Jakocit, Jozefit, Noelit, Abrahamit, etj. Vetëm më thuaj ta dëgjoj argumentin dhe unë në të njëjtën mënyrë do dëshmoj për profetin tim, dhe jam e sigurt se do të kënaqë intelektin tuaj dhe s'do të keni më mundësi ta refuzoni.*

Gruaja e krishterë: *Ne i kemi pranuar profetët tonë sipas akteve të tyre.*

Isabela: *Çfarë aktesh, detajizoji pakëz që të mos mbesë dyshim e konfuzion në pretendimet tua.*

Këtu ajo mbeti pa fjalë. Ju duk se u fut në një kurth të atillë që çfarëdo përgjigjeje t'i jepte Isabelës, do të bëhej shkak për humbjen e debatit dhe për diskreditimin e krishterimit. Por, në këtë situatë, ajo nuk mund të heshte.

Gruaja e krishterë: *Ne nuk dimë për profetët tjerë. Ne jemi të koncentruar te Jezusi dhe përmes tij i besojmë të gjithë profetët*

Isabela: *Pse pra të mos vazhdohet edhe pak më gjatë dhe në të njëjtën mënyrë të besosh edhe profetësinë e profetit Muhamed, ku vetiu do të paraqitet dëshmia e profetizimit të tij*

Gruaja e krishterë: *Dëshmia më e madhe e profetit të Zotit është se ai ringjalli të vdekurit, shëroi të verbrit, i shpëtoi njerëzit nga kurthet e shejtanit.*

Isabela: *Ku janë dëshmitë se profeti juaj i bëri të gjitha këto mrekulli? Ku janë gjithë ata që i ringjalli ai? Ku janë ata të verbër që ua ktheu pamjen? Ne i besojmë të gjitha këto si të vërteta për Jezusin, por ku është dëshmia për to? Nga ana tjetër, profeti jonë ka dëshmi të gjallë, dëshmi që jeton përgjithmonë. Kjo është mrekullia e Kur'anit të Shenjtë. Prej se u shpall, thirrja është aktive për sot dhe për të ardhmen, për të gjithë ata që e refuzojnë, për të krishterët, për jehudinjtë, për idhujtarët, që të formulojnë diçka të ngjashme sa një e katërta e tij, sa dhjetë versione, pak sosh apo qoftë edhe një version të vetëm. Por asnjë i krishterë, asnjë jahudi, asnjë idhujtarë nuk ja doli të të formulojë diçka të tillë. Kjo është mrekulli e gjallë që do të mbesë deri në ditën e gjykimit. Përkundër kësaj, mrekullitë e profetëve të tjerë, kanë qenë për një popull të caktuar, për një vend e për një kohë të caktuar.*

Gruaja e krishterë: *Keni filluar biseda irrevelante! A mund ta quash 'mrekulli e të gjitha kohëve' një libër që urdhëron burrin të martohet me katër gra? Zoti jonë ka thënë se ai ka qenë rrugë ndërmjet të vërtetës dhe jetës, dhe pa të askush s'do ta gjejë Zotin - At.*

Isabela: *Kur'ani i Shenjtë kurrë nuk ka urdhëruar martesë me katër gra, në kushte e rrethana të caktuara, ka lejuar. Por, nëse martesa me shumë gra është krim, ç'mund të thuash për Davidin e Solomonin për të cilët në Bibël thuhet se kanë pasur qindra gra?! Nëse Jezusi ka thënë se ai është rruga ndërmjet të vërtetës e jetës, kjo edhe më shumë po vërteton fjalët e Kur'anit të madhërishëm, sepse edhe aty thuhet, jo vetëm që ka qenë në rrugë të drejtë, por këtë drejtësi ua ka treguar edhe të tjerëve (Anfalë:16). A nuk mjafton për dëshmi fakti se profeti e konvertoi barbarizmin, shtypjen, agresivitetin, idhujtarinë, aduterinë, në adhurues të devotshëm të Allahut dhe qindra mijë të tjerë ndoqën standardet e tij?! Ky pra i jetësoi arabët në gjithë jetën e tyre. Nga ana tjetër, Zoti juaj - Jezusi, mundi të tubonte 12 dishepuj rreth vetes, e pastaj edhe ata jezusi i quajti të pasinqertë e disa edhe i mallkoi.*

Gruaja e krishterë: *Ti po flet shumë, por dëshmitë e profetit tuaj ende nuk i paraqite.*

Isabela: *Mua po më duket, se derisa ti mendon ç'të thuash, bisedën time as që e dëgjon. Prandaj, ti nuk meriton diskutim!*

Gruaja e krishterë: *Jo, ti nuk ke aftësi të kuptosh mrekullitë që po ekspozohen para teje.*

XII

Isabela nuk tha asgjë pas kësaj! Në gjithë ambientin mbretëroi një heshtje e gjatë. Gratë e krishtera u ndien të lënduara. Edhe vetë gruaja e mrekullive qëndronte e heshtur thuajse i ishin mbaruar fjalët.

Isabela: *Mua më duket se jeni lodhur. Le ta ndërpresim diskutimin për sot, pushoni pakëz dhe po deshët ejani nesër sërish të vazhdojmë.*

Gruaja e krishterë: *Jo, jo, unë nuk shkoj askund pa e definuar të vërtetën nga e pavërteta. Ka mundësi që ju të jeni lodhur..*

Isabela: *Nga ana ime keni lirinë të qëndroni e të diskutojmë derisa të qartësohet vija që ndan të vërtetën nga e pavërteta. Unë vetëm desha që ju të mos mbesni të pafuqi*

Gruaja e krishterë: *Në fakt, unë e kam vendosur ta çoj diskutimin deri në fund pa ndërprerje. Më thuaj, pse ishte e nevojshme ardhja e islamit kur krishterimi ishte përhapur deri në skajet e largëta të botës.*

Isabela: *Po të mos kishte ardhur Islami, e vërteta s'do të vinte në botë, sepse ajo ishte venitur pothuaj tërësisht. Mësimet e të dërguarve të mëparshëm ishin ndryshuar rrënjësisht. Për vetë të dërguarit u shpif në maksimum dhe iu mveshën atyre atribute amorale të cilat nuk i kishin. Pra, ishte Islami që pruri të vërtetën dhe i shfajësoi ata prej çdo akuze të shpifur. Pra Islami e ngriti rëndësinë religjioze. Përkundër reveleimet të mëparshëm që ishin ndryshuar, erdhi Kur'ani që plotësoi këtë zbrazëtirë. Mësimet e drejta të profetëve të mëparshëm që ishin ndryshuar rrënjësisht, Kur'ani i qartësoi. Për shembull, të krishterët për ta personifikuar Krishtin, e ngritën në partnershipin e Zotit. Islami e ndriçoi çështjen e birit - "Zot" dhe të Zotit - Zot, duke qartësuar Madhërinë dhe Atributet e Zotit për botën. Popujt u kishin shpifur akuza të turpshme profetëve, duke i quajtur si gënjeshtarë, adultor, tradhtarë, vrasës, etj, kurse Islami i shkarkoi prej këtyre akuzave të shpifura. Me kalimin e kohës, ndryshimet e revelimeve u bënë të "shenjta" dhe populli besonte në shenjtërinë e tyre, ndërsa Kur'ani*

solli mësimet origjinale të profetëve dhe premtoi ruajtjen e këtyre mësimeve deri në fund. Tashmë s'ka nevojë për një revelim tjetër deri në fundin e jetës në tokë. Përfundimisht, profetët e mëhershëm dhe librat e tyre të shpallura, kanë qenë për një popull e për një vend të caktuar, ndërsa profeti ynë bashkë me revelimin e Kur'anit kanë ardhur për tërë njerëzimin pavarësisht nga vendi, raca dhe kombi, dhe është garantuar ruajtja e korrektësisë në to.

Gruaja e krishterë: *Ti je duke bërë diskutime të panevojshme. Ti nuk përmende asnjë mrekulli të profetit tënd, as që solle ndonjë dëshmi mbi profetizimin e tij, sepse pyetjet mbi mësimet e tij do të vijë pasi të shqyrtohet pasi të shqyrtohet vetë problemi i tij.*

Isabela: *Po ti vetë pyete nevojën e ardhjes së islamit dhe unë shkurtimisht t'i numërova disa nevoja. Tani është i vetmi shteg që ju ka mbetur për të nxjerrë këso argumentesh. Unë vetëm të thashë edhe njëherë për mrekullinë e tij të gjallë - Kur'anin. Pse nuk provoni edhe ju me gjithë këtë famë si mrekullibamës e si njohëse e mirë e krishterimit e Islamit, pse nuk provoni të bëni diçka të ngjashme, e pastaj përpiqu ta hedhësh poshtë. Por nuk kanë pasur sukses në diçka të tillë, as ata që kanë kaluar para teje, as ata që do të vijnë pas teje. Kjo është dëshmi më e madhe se Muhamedi ka qenë profet i Allahut dhe mesazher i tij, sepse askush tjetër nuk mundi t'i prezantojë botës diçka të tillë! Edhe një dëshmi tjetër pas shpalljes së profetizimit, profeti reformoi një shoqëri të tërë në një institucion dhe me Kur'anin e shenjtë brenda jetës së tij, islami u përhap në gjithë Arabinë, për t'u përhapur më vonë këtu në Spanjë! A mund të gjesh ndonjë shembull të këtillë në ndonjë profet të rrejshëm? Unë mendoj se jo!*

Gruaja e krishterë: *Ti mund të thuash si të duash, por profeti juaj nuk meriton të ndiqet e të shkohet rrugës së tij. Si mund të quhet reformator një profet që ka derdhur gjak në jetë e që është martuar me shumë gra?! Pse nuk shikon shembullin e zotit Jezus, as nuk u martua kurrë në jetën e tij!?*

Isabela: *Pasi ju po e konsideroni Jezusin - Zot, ai s'kishte nevojë të martohej. Ne mendojmë të kundërtën, profeti jonë ishte njeri dhe si të gjithë të tjerët ai kishte nevojë për të gjitha ato që ka nevojë njeriu.*

Nuk ma merr mendja se mund ta emërtosh edhe një profet tjetër që është konsideruar për njeri që nuk është martuar.

Gruaja e krishterë: *Njeri perfekt është ai që është i dalluar prej të tjerëve.*

Isabela: *Po, pse po flasim për njeriun tani, ju besoni në Jezusin “bir” dhe “zot”?!*

Gruaja e krishterë: *Njëkohësisht edhe njeri i përsosur!*

Isabela: *A ka ngrënë e ka pirë ai?*

Gruaja e krishterë: *Sigurisht, të ushqyerit e tij nuk ishte në kapacitetin e Zotit por në atë të njeriut.*

Isabela: *Si ishte i ndarë ai, ose më mirë cili është definicioni i njeriut të përsosur?*

Gruaja e krishterë: *Njeriu i përsosur është ai që nuk ka asnjë të metë!*

Isabela: *Këtu pajtohem plotësisht me ju dhe më duket se vetëm tashti ke arritur të kuptosh burimin esencial të besimit. Pra, njeri i përsosur është ai që nuk ka të meta, pra që është model për të tjerët, që të tjerët mund ti ndjekin veprat e tij. A është kështu?*

Gruaja e krishterë: *Pikërisht ashtu.*

Isabela: *Këtu na ngjadhet një problem tjeter, se të krishterët jetojnë jetën sociale brënda statusit material. Me fjalë tjera, ata martohen, kanë gratë dhe fëmijët. Kështu po del se të krishterët nuk po e ndjekin shembullin e jetës së tij. Ata bëjnë luftëra të shumta kundër myslimanëve e ‘mosbesimtarëve’ të tjerë, megjithëse ai kurr nuk luftoi! Prandaj pra, të krishterët që pretendojnë të ndjekin rrugën e Jezusit kanë hapur luftra të shenjta dhe janë martuar. Atëherë, ku qëndron dëshmia se të krishterët janë ndjekës në rrugën e Krishtit?*

Gruaja e krishterë: *E ke ngatrruar situatën, ai është shembull në jetën shpirtërore dhe jo në ate fizike, ai s’ka të bëjë me jetën fizike...*

Isabela: *Por për njeriun, nevoja shpirtërore është e lidhur ngushtë me jetën fizike, që janë vetëm si një kombinim, për ndryshe të krishterët do të duhet të ndjekin dikë tjetër në jetën fizike. Muhamedi a.s, ka qenë prej të tillëve që duhet ndjekur si shembull në jetë, për luftë e për paqe, për të vobektin e për të pasurit, për të dobëtit e për mbretërit. Ai ishte çoban, tregtar, burrë i martuar, baba fëmijësh, emigrant, rrugëtar, jetim, i varfër, e deri edhe qeverisës. Në të gjitha këto situata, ai mbeti shembull për t’u ndjekur në aspektin fizik. Por në aspektin shpirtëror, ai thërriste në besimin e drejtë, falej e agjëronte, jepte zeqatin, e kështu me radhë...*

Pas këtij fjalimi që bëri Isabela, të gjithë të pranishmit mbetën si të hutuar e të çuditur. Të gjitha gratë e krishtera që prisnin çdo moment të shohin mrekullit e gruas së krishterë para Isabelës, u befasuan në dobësitë e saj. Isabela shprehu keqardhje për ndonjë keqkuptim, dhe u la lamtumirën.

U përfol më pas, se pothuaj të gjitha gratë e krishtera që prezentuan në debatin mes Isabelës e Gruas së krishterë, megjithse brënda një kohe të gjatë, pranuan islamin.

Për sa kohë që Isabela jetoi, ajo u angazhua në maksimum në shërbimin e Islamit.

Ajo jetoi tetëdhjetë vjet dhe kur vdiq, miliona njerëz i bënë nderimin e fundit për në varrezat, afër parkut të luleve, të quajtur “Kopshti i Edenit”.

- *fund* -

Hajrudin S. Muja

ISABELLA - (3)

(Summary)

Isabella was taken to the large room in which her friends were sitting and the monk informed them that princess Arkia would come shortly after finishing her preliminary prayer and then he left. Now Mirano, Mertha and Hanana found the opportunity to talk secretly to Isabella. They had full talk about their present situation and various plans were discussed about releasing Isabella. It was put to Isabella that, in order to be relieved of her permanent troubles, she should temporarily become a Christian. But Isabella spurned at the suggestion and said that whatever trouble came to her in connection with Islam they would God willing be an atonement for her sins and strengthen the faith, and if God wanted her to be released from the clutches of these oppressors, He will provide means for it.

خيرالدين مويا

إسابيلا (3)

(حسب الرواية بنفس العنوان للكاتب مولانا محمد سعيد)

(خلاصة البحث)

و بعد أن أحضروا إسابيلا بالغرفة الكبيرة، حيث كانت تجلس زميلاتها، الرهبان اخبروا بأن الاميرة آركيا سوف تأتى بسرعة بعدما انهت صلاواتها الادية، و هم خرجوا بدورهم. هنا ميرانو و مارثا و هنا انتهزوا الفرصة لتبادل حديث سرى مع إسابيلا فيما يتعلق بخطتهن للافراج عنها. و حسب الخطة المعدة لكى تنقذ نفسها من هذا الاضطهاد و أكثرهوا عليها أن تعتنق المسيحية. و لاكن إسابيلا التي كانت مصرة أن ترفضى هذا الاقتراح لأنها تريد أن تبقى تحت ظلال الاسلام و لا تريد أن ترتكب مثل هذه الاخطاء. هي كانت على يقين بانها سوف تتحرر من هذا الاضطهاد فقط بميئة الله سبحانه و تعالى.

PORTRETE TË SAHABIJATEVE

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha

FATIMETU ZEHRA
Aroma e Pejgamberit a.s.

"Mehdiu është prej pasardhësve të mi nga djemtë e Fatimes".
Muhamedi a.s.

Tregimi i jetës së Fatimes është kapitull i ndritshëm i biografisë së Pejgamberit a.s. Një panoramë e bukur nga pamjet e shtëpisë së Pejgamberit fisnik dhe një shembull i shkëlqyeshëm i jetës së sahabëve të ndershëm.

* * *

U lind Fatimetu Zehra, Allahu qoftë i kënaqur me të, në vitin e ndërtimit të Qabesë, pesë vjet para shpalljes së misionit të Muhamedit a.s.

Ndërsa nëna e saj ishte një zonjë e matur, e cila kishte bashkuar urtësinë e mençurinë, prejardhjen fisnike, vlerat e larta morale si dhe pasurinë e madhe, dhe në kohën e injorancës quhej e pastër dhe cilësohej me llagapin Zonja e grave të Kurejshve.

I besoi Pejgamberit a.s. në kohën kur nuk i kishin besuar njerëzit, i kishte zënë besë atij, atëherë kur e kishin përgënjeshtruar njerëzit dhe

e kishte ndihmuar me pasurinë e saj në kohën kur këtë ia kishin mohuar të tjerët.

Allahu xh.sh. i kishte dhënë kësaj zonje të ndershme fytyrë të qeshur, moral të lartë, prejardhje fisnike dhe pasuri të shumta.

Kjo, pra, ishte nëna e Fatimetu Zehra.

Kurse babai i saj ishte zotëria i të gjithë të dërguarve, vulë e të gjithë pejgamberëve dhe imam (prijës) i të devotshmëve.

Ja çfarë prejardhje të ndershme kishte ajo.

Dhe çfarë babai të madh kishte ajo.

* * *

Fatimja ishte fëmija i fundit dhe zakonisht fëmija më i vogël gëzon dashurinë dhe kujdesin e prindërve.

Kështu, pra, Fatimja ishte aroma e Pejgamberit a.s. Ishte i kënaqur kur kënaqej ajo dhe nevrikosej kur nevrikosej ajo.

Mirëpo, dashuria prindërore nuk kishte qenë pengesë që ajo të mos edukohej e të përgatitej që në të ardhmen të ishte në gjendje t'i bartte përgjegjësitë dhe të ballafaqohej me problemet e jetës.

Transmetohet se ajo vetë i kryente të gjitha punët e shtëpisë pa e ndihmuar askush. Ajo ia lidhte plagët babait të saj, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, në betejën e Uhudit.

Kur Fatimja arriti moshën e pjekurisë, sytë e të gjithëve ishin drejtuar kah ajo. Në mesin e atyre që e kërkuan dorën e saj ishin edhe Ebu Bekri, Omeri… Mirëpo, Pejgamberi a.s. u ishte përgjigjur atyre me një përgjigje të kënaqshme dhe me të sikur dëshironte që Fatimen ta fejojë për Aliun, Allahu qoftë i kënaqur me të.

* * *

Në vitin e tetë të hixhretit, Aliu r. a. e kërkoi prej Pejgamberit a.s. të fejohej me Fatimen. Pejgamberi a.s. shumë shpejt iu përgjigj kërkesës së tij. Aliu r.a. nga gëzimi ra në sexhde duke e falënderuar Allahun xh.sh. dhe, kur ai ngriti kokën prej sexhdes, Pejgamberi a.s. i

tha: *"Allahu ju bekoftë juve, ju bëftë të lumtur në jetën tuaj dhe prej jush të dalin trashëgimtarë të mirë"*.

Dëshmitarë të vënies së kurorës ndërmjet Fatimes dhe Aliut r.a. ishin Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Talha dhe Zubejri prej muhaxhirëve dhe një numër i ngjashëm prej ensarëve.

Kur njerëzit u ulën në vendet e tyre, Pejgamberi a.s. tha:

"I falënderuar qoftë Allahu me begatinë e Tij, i adhuruar me fuqinë e Tij. Vërtet, Allahu i madhërishëm e bëri martesën trashëgimi të mëtutjeshme, çështje të obligueshme, gjykim të drejtë, të mirë të përgjithshme, nëpërmjet së cilës lidhet farefisi dhe bashkohen njerëzit. Allahu i madhëruar në Kur'an thotë: ***"Dhe Ai nga uji*** *(fara)* ***krijoi njeriun, e bëri atë të ketë fis dhe të ketë miqësi. Zoti yt ka mundësi të jashtëzakonshme".*** *(25:54).*

Dëshmoj para jush se unë e martova Fatimen për Aliun në vlerë prej katërqind mithkalë (peshë për matjen e argjendit) argjend, nëse ai pëlqen me këtë sipas sunetit dhe farzit.

Allahu i bashkoftë ata dy, i bekoftë dhe i shtoftë trashëgimtarët e tyre.

Me këtë e përfundoj fjalën tonë dhe kërkoj falje prej Allahut të madhërishëm".

Dhe u dërgua zonja e grave të muslimanëve në shtëpinë e burrit të saj.

Prej orendive shtëpiake ajo kishte një krevat të shqyer (arnuar), një jastëk prej lëkurës i mbushur me fije, një enë prej lëkure, një lekë, një sitë, një peshqir, një tenxhere, një eshkë (rehevan) dhe dy kënata.

* * *

Pejgamberi a.s. nuk e përballoi dot largimin e Fatimes prej tij dhe vendosi që ajo të jetë në fqinjësi të tij. Mirëpo, në afërsi të tij gjendeshin shtëpitë e Harithetu bin Numanit dhe, një ditë prej ditësh, erdhi deri te Pejgamberi a.s. dhe i tha:

Jam informuar se ti dëshiron që Fatimeja të jetë pranë teje dhe ja këtu janë shtëpitë e mia të fisit benu Nexhar, janë më afër teje. Prandaj, unë ta bëj me dije se unë, pasuria ime janë në disponim të Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Për këtë të betohem ty, o i Dërguari i Allahut, se pasurinë, të cilën e merr prej meje është më e dashur për mua se pasuria të cilën e lë.

Pejgamberi a.s., atëherë i tha:

"Po e thua të vërtetën. Bekimi i Allahut qoftë mbi ty."

Pejgamberi a.s. pastaj e transferoi në fqinjësi të tij dhe e vendosi atë të banojë në njërën prej shtëpive të Harithit, Allahu qoftë i kënaqur me të.

* * *

Prej momentit të vendosjes së Fatimes në fqinjësi të babait të saj, për çdo mëngjes shkonte në shtëpinë e saj dhe kur thërriste ezani i mëngjesit e hapte shtalken e derës së saj dhe thoshte:

"Paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi ju, o Ehli bejt, dhe Zoti ju bëftë të pastër nga çdo e metë".

Kur Pejgamberi a.s. kthehej nga ndonjë udhëtim, së pari shkonte në xhami dhe i falte në të dy rekate, pastaj qëndronte një kohë të gjatë në shtëpinë e Fatimes e më vonë shkonte në shtëpitë e grave të tij.

* * *

Tregohet nga Muhamed ibnu Kajsi se si Pejgamberi a.s. doli një ditë në një udhëtim së bashku me Ali ibnu Ebi Talibin. Në mungesë të tyre, Fatimja r.a. kishte vënë dy byzylykë, një gjerdan e dy vathë dhe e kishte vendosur në derë të shtëpisë një perde, në shenjë gëzimi të ardhjes së babait dhe të burrit të saj.

Kur erdhi Pejgamberi a.s. hyri brenda, sahabët e tij u ndalën te dera, ngase nuk e dinin a të qëndronin aty apo të shkonin për shkak të qëndrimit të tij të gjatë brenda në shtëpi. Pastaj doli Pejgamberi a.s. dhe në fytyrën e tij u dukën shenjat e hidhërimit derisa ai hipi në minber.

Fatimja e kuptoi se ai kishte vepruar ashtu për shkak se ai i kishte parë dy byzylykë, gjerdanin, dy vathët dhe perden.

Ajo i hoqi vathët, gjerdanin, byzylykët e perden dhe ia dërgoi Pejgamberit a.s. dhe i tha atij që ia kishte dhënë t'ia dërgonte:

Thuaji Pejgamberit a.s. bija e jote të bën selam dhe po të thotë se të gjitha këto po i dhuron për hir të Allahut.

Kur ai erdhi i tha:

"Ke vepruar ashtu si duhet, të pastë baba. Kjo botë nuk ka të bëjë me Muhamedin a.s. e as me familjen e Muhamedit. Sikur kjo botë tek Allahu ta ketë vlerën e të mirës sa krahu i një mize, nuk do të jepte për ta pirë një jobesimtar një gotë ujë."

* * *

Pas një kohe shtëpia e Fatimes u gëzua me lindjen e pasardhësve të mirë. Dy prindërve fisnikë u erdhën në jetë: Hasani, Hysejni dhe Muhsini, Zejnebi dhe Umu Kulthumi.

Gëzimi i Pejgamberit a.s. për ta ishte shumë i madh. Tregohet se, kur lindi Hasani, prindërit e tij ia kishin lënë emrin Harb (Luftë). Kur kishte shkuar Pejgamberi a.s. u kishte thënë: *"Ma sillni birin tim, si e keni emërtuar?"*

Ata u përgjigjën: Harb (Lufta).

Atëherë, Pejgamberi a.s. u tha: *"Jo. Por emri i tij do të jetë Hasen (i bukur)."*

* * *

Pejgamberi a.s. luante me fëmijët e Fatimes, i përkëdhelte, i donte dhe kërcente me ta. Ndodhte që ndonjëri prej tyre t'i hipte në shpinë derisa ai falej. Kështu, ai vonohej në namazin e tij dhe e zgjaste sexhden që mos ta rrëzonte nga krahët e tij.

Pejgamberi a.s. e kishte bërë traditë që, kohë pas kohe, të flinte në shtëpinë e Fatimes dhe ai i shërbente fëmijët e saj, ndërsa prindërit e tyre ishin ulur pranë tij.

Një natë prej netësh Pejgamberi a.s. e dëgjoi Hasanin që kërkonte ujë, ai u ngrit deri te kënata dhe e mbushi tasin, atëherë e zgjati dorën Hysejni që ta merrte ujin, por Pejgamberi a.s. ia largoi dhe së pari i dha Hasanit. Këtë e vërejti Fatimja dhe i tha:

Më duket sikur atë po e do më tepër?

Pejgamberi a.s. ia ktheu: *"Jo, por ai lypi i pari."*

* * *

Kur Fatimja hynte te Pejgamberi a.s., ai ia shtrinte dorën, i uronte mirëseardhje dhe e ulte në kuvendin e vet.

Po ashtu, kur Pejgamberi a.s. hynte në shtëpinë e Fatimes, ajo ngrihej në këmbë, i uronte mirëseardhje dhe ia kapte dorën e ia puthte.

Ajo kishte hyrë te Pejgamberi a.s. kur ai ishte i sëmurë. Në momentet e fundit të jetës së tij, Pejgamberi a.s. i tha diçka në vesh, e ajo filloi të qante. Pas një çasti i pëshpëriti diçka në vesh dhe ajo nisi të qeshte. Aishja ishte dëshmitare e kësaj skene dhe kishte thënë me vete:

Kam llogaritur se kjo grua është më e vlefshmja në mesin e të gjitha grave, por sot po shoh se kjo është si të gjithë gratë e tjera derisa për një çast qan e pastaj qesh.

Pasi që Pejgamberi a.s. kishte ndërruar jetë, ajo e kishte pyetur për këtë rast, e Fatimja ishte përgjigjur:

Më pëshpëriti e më njoftoi se ai do të vdiste, e për këtë unë qava.

Pastaj më pëshpëriti e më tha se unë do të jem e para nga familja e tij që do t'i bashkëngjitesha, atëherë qesha.

* * *

Pas vdekjes së babait të saj, Fatimja jetoi vetëm disa muaj dhe iu bashkua atij. Ajo jetoi gjashtë, tre apo dy muaj më shumë, sipas varianteve të ndryshme.

Ajo iu përgjigj thirrjes së Krijuesit të saj në muajin Ramazan të vitit të njëmbëdhjetë sipas hixhretit dhe ajo u gëzua që iu bashkua babait të saj.

Kur i erdhi vdekja, ajo e mori përsipër që ta lante veten me duart e veta dhe i tha shoqes së saj Esmas, të bijës së Umejrit, pasi që ishte pastruar në mënyrën më të mirë:

Oj Esma, sillmi rrobat e mia të reja, të cilat i veshi.

Pastaj tha:

Unë u pastrova, prandaj nuk dua që askush ta zbulojë qefinin tim.

Pastaj, buzëqeshi. Ajo nuk ishte parë duke buzëqeshur pas ndërrimit jetë të babait të saj, veçse në momentin kur ajo kishte ndërruar jetë.

Allahu e mëshiroftë aromën e të Dërguarit të Allahut me mëshirën e Tij të pakufishme. Ajo ishte e martuar për Aliun në muajin e Ramazanit dhe kishte shkuar në xhenet po ashtu në Ramazan.

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha

FATIMAH ZAHRA
The scent of the prophet

(Summary)

“Mahdi is a descendent of mine of the line of Fatimah” - Mohammed

The life story of Fatimah is a bright chapter in the biography of the prophet. It is an extraordinary example of the life of the sahabs.

* * *

Fatimah, may Allah be pleased with her, was born during the time of the rebuilding of the Kaaba, five years before her father was sent as a prophet.

Her mother was a judicious woman, who had combined prudence and wisdom, her noble origin and high moral values with great wealth. Because of her moral purity she was considered the leader of all the women in this world.

الدكتور عبدالرحمن رأفت الباشا

فاطمة الزهراء

ريحانة روسول الله صلى الله عليه و سلم

(خلاصة البحث)

"المهدى من عترتى من ولد فاطمة" محمد رسول الله

قصة حياة فاطمة الزهراء فصل مشرق من سيرة الرسول العظيم (صلعم)

و صورة رائعة من سور حياة بيت النبوة الكريم.

و مثل رائع لما كان عليه الصحابة الكرام.

ولدت فاطمة الزهراء رضوان الله عليها سنة بناء الكعبة قبل البعثة المحمدية لخمس سنين.

أما أمها سيدة رزان جمعت العقل الحصيف إلى النسب الشريف و ضمت إلى ذلك الخلائف الفاضلة و الثروة الطائلة، فكانت تدعوا في الجاهلية بالطاهرة و تنعت بسيدة نساء قريش.

RECENSIONE

Akademik Jashar Rexhepagiq

FJALORI I NOCIONEVE ISLAME - VEPËR E SHKËLQYER, ME DISA VËREJTJE E SUGJERIME

Një autor (ose më shumë sish), po qe se me vite është i preokupuar me sajimin e librit në të cilin trajtohen nocione e emra të ndryshëm dhe posaçërisht thesari leksikor nga një fushë e caktuar, për sukses në këtë veprimtari komplekse është normale të merren parasysh disa parakushte themelore, në radhë të parë njohja solide e fushës përkatëse, në këtë rast e Islamit (dhe e islamistikës), e kjo do të thotë edhe njohja e filozofisë, e bazës religjioze dhe e kulturës islame e veçmas e gjuhës arabe, por edhe e gjuhëve dhe e letërsive të tjera orientale. Puna në hartimin e fjalorit të Islamit me siguri i kalon caqet e ngushta të doktrinës islame, prandaj me këtë fushë merren më me sukses, para së gjithash, ata që njëkohësisht kanë njohuri më të gjithanshme dhe universale e, përveç kësaj, më shumë prirje për analiza subtile, krahasime, gjeneralizime dhe një varg kualitetesh individuale. Me këto hulumtime vërtet delikate, që kërkojnë gjurmime, verifikime dhe plotësime serioze me konsultime të literaturës shumë të gjerë deri te shkrimi definitiv dhe përcaktimi gjuhësor i përcaktoreve, dekada me radhë merren dy orientalistë të shkëlqyeshëm: prof. dr. Rade Bozhoviq dhe mr. Vojislav Simiq. Librin e tyre *Nocionori i Islamit* (Pojmovnik islama) e ka botuar Shtëpia Botuese "Narodna knjiga" në Beograd, në edicionin e saj "Bota arabe" (Arapski svet). Fjalori është botuar më

2003 dhe, bashkë me parathënien, ka gjithsej 160 faqe.

Para këtij fjalori, Nerkez Smailagiq do të botojë *Leksikonin e Islamit* (Leksikon islama, Sarajevo, 1990), kurse Abdullah Shkaliq do ta botojë fjalorin *Turcizmat në gjuhën serbokroate* (Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku, Sarajevo, 1985), por autorët në *Nocionorin e Islamit* do të punojnë shumë më herët, para më se njëzet vjetëve. Vepra është shkruar me alfabetin latin, kurse përcaktoret janë renduar sipas alfabetit cirilik. Këtë, si thonë autorët në Parathënie, e kanë bërë për "respektimin e multikulturalitetit".

Sajuesit e *Nocionorit të Islamit* kanë trajtuar në radhë të parë një varg termash më të rëndësishme dhe më pak të njohura dhe fjalësh themelore, para së gjithash, nga shkenca që merret me studimin e Islamit. Islamistika është zhvilluar brenda orientalistikës duke hulumtuar persishten, arabishten dhe turqishten nga aspekti linguistik, por duke e ndërlidhur gjuhën shkencore, gjuhën letrare e gjuhën e shkruar ose gjuhën me të cilën njerëzit shërbehen në komunikim të përditshëm me historinë e letërsinë e Lindjes së Afërme dhe me doktrinën fetare islame.

Derisa në literaturë ndeshemi me tituj të shumëllojshëm, prej të cilëve më të shpeshtë janë: fjalori, leksikoni, e më rrallë-glosari etj., autorët kanë marrë termin *Nocionor* (fjalor i nocioneve), përkatësisht libër që përmban regjistrin e nocioneve me shpjegime dhe tekst të punuar ndryshe me qëllim që, me anë të nocioneve, të njihet më për së afërmi dhe të kuptohet doktrina islame.



Njohës të arabishtes dhe të kulturës e të besimit Islam, R. Bozhoviq e V. Simiq, në Parathënien e tyre të këtij libri theksojnë kompleksitetin e të folurit të kësaj gjuhe. Kështu, p.sh., te ne thuhet "ezan", ndërsa në librin e tyre *"Nocionori i Islamit"* thuhet "azan", sepse nuk është as "a" e pastër, as "e" e pastër si thuhet te ne. Megjithatë, këtu me plot të drejtë është marrë përcaktorja "a" e jo "e" si te ne. Megjithatë, me shumë të drejtë është marrë përcaktorja "shejh" e jo "shah".

Është shumë pozitive që *"Nocionori"* nuk përmban vetëm analizën e shumë nocioneve dhe ideve themelore

islame, por edhe shpjegimet për një varg personalitetesh të shquara meritore për jetën shpirtërore dhe prosperitetin e botës Islame. Në *“Nocionor”* janë përfshirë në pika të shkurtra dhe qenësore mendimtarë dhe personalitete të tjera të shquara të njohura dhe më pak të njohura arabe e persiane dhe ithtarë të doktrinës islame, p.sh. nga rendi i shkencëtarëve, mistikëve persianë, juristëve fetarë, teologëve më të njohur, komentuesve të shquar të Kur’anit, misionarëve të doktrinës shiite, poetëve, historianëve e të tjerëve.

“*Nocionori*”, i cili përmban afër 1200 përcaktore, i zgjeron njohuritë tona mbi vlerën e vërtetë të Islamit në të kaluarën dhe sot. Libri do t’i ndihmojë drejtpërdrejt edhe gjuhëtarit, e mbi të gjitha orientalistit, edhe historianit, edhe teologut, edhe kulturologut, edhe antropologut, edhe etnologut dhe ekspertëve e studiuesve të tjerët të kësaj fushe të rëndësishme në botë dhe te ne.

Përparësi të “*Nocionorit*” janë ato që përmban dhe trajton shumë terma që nuk i gjejmë në fjalorin e Shkaliqit “*Turcizmat në gjuhën serbokroate”* e as në fjalorin e Nerkez Smailagiqit “*Leksikoni i Islamit”*.

Autorët Bozhoviq e Simiq shkruajnë në nga disa rreshta por në mënyrë kryesisht mjaft informative për disa nocione, sidomos personalitete që e kanë studiuar Islamin ose kanë kontribuuar për studimin e Islamit. Në këtë libër, modest për nga numri i faqeve, gjejmë emrin e *Xhamal al-Din al-Afganit* (në fq. 146-147), i cili, si thonë autorët, është “një nga figurat më markante të Islamit në shekullin XIX. Ishte shumë i arsimuar; e njihte filozofinë mesjetare arabe... dhe bënte debate të rrepta me shkencëtarët perëndimorë për ta mbrojtur Islamin”. (Po aty, në fq. 146). Do ta kujtoj edhe një personalitet, e ky është *Çisti Hvaxha Muin al-Din Hasan*, një nga figurat më të shquara të sofizmit, e njëkohësisht themelues i rendit të përhapur mistik në Indi - çistit. Gjatë jetës së tij (lindi më 1141, vdiq më 1236) vizitoi “gati të gjitha vendet dhe qendrat religjioze myslimane” (Po aty, fq. 144).

Veçohet shpjegimi i *Islamit*, në fq. 62-65 të *“Nocionorit*”. Shpjegimi në esencë është paraqitur saktësisht dhe hollësisht. Ky term kaq i rëndësishëm ka munguar plotësisht te Shkaliqi, e mungon edhe në “*Leksikonin e Islamit”* të Smailagiqit. Në tekstin e “*Nocionorit”*, Islami është shpjeguar si “religjion i ri” i myslimanëve “të cilin e ka shpallur Muhamedi e në të cilin nuk ka klerikë” (Po aty, 62). Ndoshta pjesa e fundit e formulimit (se në këtë religjion “nuk ka klerikë”) ka dy kuptime, dhe është e tepërt, sikurse edhe termi mbi “nënshtrimin *absolut* (vullnetit të Zotit)”. Vendi i emërtimit “nënshtrimi absolut” mbase është më afër përcaktimit: bindje, përkatësisht përkushtim Zotit. (Shiko librin “*Çka është Islami”*/ Šta je islam, Beograd, 2001, fq. 27/).

Në librin e Milan Vukomanoviqit me titull *Religjioni* (Religija, Beograd, 2004) në fq. 28 gjejmë një shpjegim të shkurtër por gjithashtu konsekuent të Islamit, që thotë: “Fjala *Islam* tekstualisht do të thotë nënshtrim vullnetit të Zotit dhe i përket si *religjionit* monoteist që ka prejardhjen nga zbulimi i profetit Muhamed nga shekulli VII, po ashtu edhe *bashkësisë* së aderuesve të kësaj feje dhe *qytetërimit* që ka dalë prej saj”.

Autorët (Bozhoviq dhe Simiq) e kanë ndriçuar këtu, përveç të tjerash, përhapjen e Islamit në botë dhe veçmas në vendet e Ballkanit (Shqipëri, Jugosllavi, BeH, Maqedoni dhe Bullgari). Janë shpjeguar edhe detyrat themelore dhe kryesore të Islamit (pesë sosh) dhe në fund (në fq. 65) dy rrymat më kryesore: *sunitët* që përbëjnë shumicën, dhe *shiitët*, që, sipas autorëve, janë “rreth 20 për qind”, ndërsa, sipas “*Nocionorit”*, në vende të tjera, dhe në shumicën e literaturës, këta të fundit proporcionalisht janë më pak - diku midis 10 e 13 për qind. Në këtë nocion, pa dyshim, njërin nga nocionet më të rëndësishme, krahas theksimit të aspektit religjioz, nuk do të duhej harruar edhe rëndësinë filozofike, shkencore dhe përgjithësisht shpirtërore të Islamit, duke përfshirë këtu edhe kuptimin dhe përmbajtjen e tij etike, sociale dhe pedagogjike.

“Nocionori” përmban me qindra terma dhe emra të personaliteteve që nuk gjenden në literaturën tonë leksikore. Përveç personaliteteve të tjera, këtu janë prezantuar personalitetet e këtushme *Hafiz Ibrahim Maglajliq*, reis-ul-ulema (në fq. 82), *Sabit Uzhiçanin* (në fq. 107), *Fehim Spaho*, reis-ul-ulema i Bashkësisë Fetare Islame në Jugosllavi prej 1938 deri më 1942 (në fq. 112) etj., por nuk janë prezantuar *Gazi Husrev-beg*, as *Muhamed Uzhiçanin* dhe një varg emrash të tjerë të rëndësishëm të historisë së kulturës dhe të fesë islame te ne. Këtu janë dhënë një varg përcaktimoresh që janë trajtuar më plotësisht dhe më mire se për shembull në fjalorin e A. Shkaliqit “*Turcizmat në gjuhën serbokroate*”. Ja disa këso fjalësh, shprehjesh dhe definicionesh.

Në fq. 61 të “*Nocionorit*” termi *iman* (besimi në Zotin) është shpjeguar më mirë dhe më shumë se në fjalorin e Shkaliqit (shiko tek ai në fq. 345). Përcaktorja *kibla* (drejtimi kah Meka, përkatësisht Qabeja, në fq. 76) këtu është përpunuar pak më shumë, e më hollësisht te Nerkezi (në fq. 328-329).

Në mënyrë precize, të qartë dhe mjaft të përpiktë është përshkruar libri

i shenjtë i myslimanëve - *Kur'ani* (në fq. 77-78), i cili, sipas autorëve, është "bazë e tërë jetës shpirtërore dhe materiale, themel i *umme*-s, bashkësisë."

Autorët theksojnë me të drejtë se pranë emrit *al-Kur'an* duhet të shtohet obligativisht ndajshtimi *al-Karim* (I nderuari). Është interpretuar në mënyrë solide edhe termi *salat* (lutja - falja e myslimanëve, në fq, 108-109), veçmas e atyre pesë lutjeve (faljeve) gjatë ditës që i ka caktuar Islami. Këtë dispozitë, Nerkezi, në *"Leksikonin"* e tij (në fq. 527-532) e ka përpunuar më hollësisht. Bozhoviqi dhe Simiqi i kanë ndriçuar në fq. 122 më gjithanshëm se Shkaliqi në "Turcizma" (shiko tek ai fq. 621) edhe emërtimet për shkencëtarët fetarë myslimanë dhe personalitetet e larta fetare (imamët, myftinjtë, kaditë), përkatësisht *ulema*-të. Edhe përcaktorja *zikër* (në fq. 55), përkatësisht invokacioni i emrit të Zotit, është ndriçuar më gjerësisht dhe më preciz se në Fjalorin e Shkaliqit (shiko tek ai fq. 653).

Në *"Nocionor"* ka shumë terma e emërtime të shpjeguara në mënyrë shumë precize etimologjike e përmbajtjesore dhe në bazë të shkencës, të filozofisë sufistike e të teologjisë Islame, në radhë të parë të *Kur'anit* dhe të të arriturave kulturore. Duke u nisur nga shkalla e rëndësisë së disa përcaktoreve, disa janë të ndriçuara më hollësisht, disa madje në disa faqe, si p.sh., pranë *Islamit* e *Kur'anit*, *dervishi* (në fq. 47-48), *Muhamedi* (në fq. 94-96), *Fatima* (fq. 125-126), *fikhu* (fq. 127-128), *halifa* (fq. 133-134), *haxhi* (fq.137-139), *xhehneti* (fq. 149-150), *sheriat*i (fq. 155-156), *shiizmi* (fq. 157-158). Janë komentuar shkëlqyeshëm dhe hollësisht *shumë terma shiite*, sekte të ndryshme të shiitëve dhe një varg përcaktoresh të reja, që nuk i gjejmë në fjalorë e leksikone të tjera.

Në *"Nocionor"*, për shembull, flitet për një varg sektesh socialo-fetare, sikurse janë *Vahabitët* (nga shekulli 18), gjithashtu *Ismailitët* dhe *Zeiditët*, sektet shiite e të tjera.

***"Nocionori"* përmban me qindra terma e emra të personaliteteve që nuk janë në literaturën leksikore ekzistuese te ne.**

Edhe disa përcaktore terminologjike, duke u nisur nga esenca e tyre dhe domethënia e përgjithshme e shkalla e aplikimit, kanë merituar analizë më të hollësishme, e të tilla janë: *myslimani* (shiko fq. 92), *sofizmi* (fq. 114), *tarikati* (shumë shkurt në fq. 116-117), *tesavufi* (fq. 119), *mevludi* (fq. 86-87), *qitabi* (ose qitapi, në fq. 121), kurse dy terma - *misticizmi islamik dhe arabistika* nuk janë shpjeguar as minimalisht.

Nuk janë të plota, vende-vende janë shumë të mangëta deskripcionet e institucioneve islame fetare dhe fetare-arsimore, e disa kanë munguar fare. Në këtë grup hyjnë: *xhamia* (fq. 147), *teqeja* (fq. 118), *hanikah*-u (fq, 135), *tyrbet* (në fq. 120), *medreseja* (fq. 87), *mejtepi* (fq. 88). Është shumë pozitive që disa xhami të njohura të Bosnjës, p.sh. në Sarajevë, Mostar, Banja-Llukë e në vende të tjera janë shënuar së paku me disa rreshta, por nuk janë shpjeguar: *imaret*, *ders-hana*, *kutubhana*, *sibian-mejtepi*, *ibtidadia*, *idadia*, *sulltania*. Nuk janë shënuar as emërtimet e disa shkollave të larta, as institucionet universitare e shkencore, p.sh. *Darul-Kurra*, *Darul-Hadis*, *El-Az-har* etj. Nuk janë përcaktuar nocionet e termave: *mualim*, *muderis*.

Kanë munguar disa disiplina Islame si *ahlak*, *hikmet*, *tarih*, *texhvid*. Në libër jepen të dhëna elementare për disa rende të dervishëve - pak më shumë për *bektashinjtë* (në fq. 35) dhe për *mevliatë* (në fq. 86), *kaderitë* (fq. 71), *rufaitë* (në fq. 106) dhe *hamzëvitët* (fq. 135), e nuk janë përfshirë edhe disa tarikate të dervishëve si: *saditët*, *sahelitë dhe melamitë.* Për shembull *sadi* (ose saadi) dhe teqe të tyre sot ka më shumë në Kosovë, sidomos në Gjakovë dhe në fshatrat përreth.

Sajuesit e "Nocionorit" kanë përpunuar në radhë të parë një varg termash dhe fjalësh themelore më të rëndësishme dhe më pak të njohura, para së gjithash nga shkenca që merret me studimin e Islamit.

Është shumë pozitive që *"Nocionori"* është i pasuruar me nja njëqind personalitete nga periudhat e ndryshme kohore dhe pjesë të ndryshme të botës Islame, por është e pakuptueshme që në libër mungojnë edhe disa emra të rëndësishëm të shkencës dhe të filozofisë, e disa edhe të letërsisë dhe të teologjisë Islame, si *Biruni*, njëri nga shkencëtarët më të mëdhenj mesjetarë (i lindur më 973, vdekur më 1050), ose *Ibn Sina* (Avicena), filozof arab, studiues i shkencave ekzakte, politikan, poet e mjek (i lindur më 980, vdekur më 1037), gjithashtu *Ibn Roshd* (Averoes, 1126-1198), filozof dhe studiues i shquar arab i teologjisë, e nga të mëvonshmit *Evlia Çelebia*, udhëpërshkrues osman nga shekulli 17. Përpos të tjerëve, është i pakapërcyeshëm *Nasradin Hoxha* i popullarizuar në popull, me prejardhje nga folklori i Lindjes së Afërme.

Nuk gjejmë as informacione të shkurtra për vendet dhe krahinat në të cilat është çmuar posaçërisht kultura, tradita dhe feja islame, p. sh. Arabia,

Horasani, Anadolli, Andaluzia e të tjera.

Edhe disa shembuj konkretë dhe analiza më të përafërta të fjalëve, të emërtimeve dhe të nocioneve, do të ofronin një shikim më të plotë të vlerave dhe të rezultateve të “*Nocionorit”*.

Në fq. 7 fjala *Abdall* është shpjeguar si “zëvendës, surrogat dhe një nga shkallët e hierarkisë së shenjtërve të sufive”. Eshtë i domosdoshëm shpjegimi plotësues se kjo fjalë (abdall) njëkohësisht do të thotë: tutkun, naiv, budalla. (Shiko te Shkaliqi në fq, 66).

Në fq. 9, përcaktorja *abdest*, a*vdes*, përkatësisht të marrësh avdes, nuk jam i sigurt se përdoret me atë titull.

Në fq. 15 termi *azan*, *ezan* nuk është vetëm “thirrje për lutje - namaz”, por edhe paralajmërim. Në popull është i njohur vetëm me emërtimin *ezan*.

Akaba (në fq. 17) është nocion i ri për lokalitetin ndërmjet Mekës e Medinës, me të cilin nuk është marrë Shkaliqi.

Akaidi (në fq. 17) është dogmatikë Islame mbi rregullat e besimeve islame, sidomos 22 dogmat kryesore Islame, që janë paraqitur në mënyrë të përsosur dhe pasqyruese.

Akiati (në fq. 18) është term profesional në teologjinë Islame dhe paraqet një risi në “*Nocionor*”.

Akshami në fq. 18 interpretohet si “emërtim i lutjes së katërt myslimane me radhë”, por nevojitet plotësimi se do të thotë edhe: muzgu i parë, para mbrëmjes, sipas Shkaliqit - do të thotë -pjesa e mbrëmjes pas perëndimit të diellit (shiko fq. 79).

Alah ose *Allah* (fq. 18) do të thotë Zot. Është mirë që autorët i kanë dhënë shënimet për 99 emra të Allahut, si dhe suren *Ikra* se Allahu është: “Ai që njeriut ia mëson atë që ai nuk e di”.

Do të shtonim se ndajshtimi më i mirë i Allahut është se Ai është i Vetmi Zot, Krijues i botës, i Përjetshëm, i Padukshëm, i Gjithëpranishëm, i Plotfuqishëm, i Gjithëdijshëm dhe se e sundon Botën.

Ahireti (fq. 23) interpretohet si “ajo botë, si jeta pas vdekjes”. Mendohet për atë jetën tjetër, përkatësisht për botën në të cilën, sipas mësimit Islam, shkohet pas vdekjes. Termi është shpjeguar në *“Nocionor”* më shumë dhe më mirë sesa te Nerkezi (në fq. 16) dhe Shkaliqi (në fq. 74). Nga ana tjetër, edhe autorët e “*Nocionorit”* disa përcaktimore, si *Ahmedia* (çallma, shalli), *Bazument* (një lloj hajmalie), *Basmala* (më me përcaktim dhe më shumë në përdorim në të folur: *Bismilah*), *Gula* (enë në formë të vorbës), *Exhel* (dita e gjykimit, vdekja), *Iftar* (darka e Ramazanit), *Ukubet, Efendi* (zotëri), *Zeqat* (mëshirë, e obligueshme për të gjithë myslimanët më të pasur) dhe disa të tjera, i shpjegojnë, sipas shembullit të Shkaliqit ose sipas interpretimeve krejtësisht të ngjashme në *Turcizmat* e tija.

Nën shkronjën *B* autorët e “*Nocionorit”*, Bozhoviqi e Simiqi, kanë paraqitur edhe disa terma të reja, si *bab* (emërtim për nxënësit që mësojnë tek imami i rendit më të lartë), *babistan al-mazahiba* (vepra persiane që përshkruajnë religjione të ndryshme), *bajumia* (sekt egjiptian që tubonte popullsinë më të varfër dhe hajdutët), *Baki* (varrezat më të vjetra myslimane në Medinë), *baraka* (bekimi i Zotit drejtuar njeriut) e të tjera. Një varg përcaktoresh dhe emërtimesh të reja edhe në pjesët e tjera të “*Nocionorit”*, p. sh. *gajb*, term profesional i sufizmit (në fq. 41), që tregon diçka që është e pakuptueshme, e fshehur, *gulat*, term i ri (në fq. 42) tregon emërtimet e personave, para së gjithash, shiitëve që akuzohen për teprime, *giibaba* (f. 42), emërtim për anëtarët e rendit bektashi e të tjerëve, gjithashtu *dar-al-nadva* (në fq. 46), një lloj shumice në qytete në kohën e Muhamedit.

Vakat, fjalë arabe në fq. 38, tregon “kohën e lutjes myslimane” (faljes së namazit - Shën. i përkthyesit), por ka munguar domethënia tjetër: koha, stina. Është e njohur ajo fjala e urtë popullore: “Vakti kulla ndërton në qenar[1]. Vakti ndërton, vakti rrënon”. Në popullin tonë (mysliman), krahas këtij termi është shumë në përdorim edhe ndajfolja *vaktile*, me domethënie - në kohë të vet; dikur.

Nën shkronjën *V*, ka qenë e domosdoshme të përfshihet së paku edhe përcaktorja *vallahi-bilahi!* (betim më i fortë; Për Zotin! Pasha Zotin!).

Termi *vilajet* (në fq. 39) është dashur të shpjegohet më shkurt si territor i një valiu.

Nën shkonjën *G* është treguar mirë rruga e zhvillimit dhe kontributi i teologut, juristit dhe mendimtarit origjinal Islam dhe reformatorit të fesë *Muhammad al-Gazali-t* (1059-1111) në fq. 40, e gjithashtu disa sufi, shehlerë sofistë dhe shkencëtarë osmanë.

Megjithatë, na duhet të vërejmë se ka munguar një termin i rëndësishëm - *Gajret*, përkatësisht emërtimi i Shoqatës Bamirëse Kulturore-Arsimore, që ka vepruar në Bosnjë, Sanxhak dhe mjedise të tjera para së gjithash myslimane.

Përndryshe, fjala *gajret* ka më shumë domethënie, me pikëçuditëse do të thotë: përpiqu, qëndro në dhembje etj. Në “*Fjalorin e madh të gjuhës kroate*” të Vladimir Aniqit (Zagreb, 2003) në fq. 338 për fjalën gajret jepen këto

[1] Qenar (persisht), vijë, skaj, skajicë; lloj shtroje ose pëlhure e pambuktë që ka shenjë në skaje. Më shumë për këtë shiko te Shkaliqi në fq. 189.

përcaktore: 1. zelli, përzemërsia, përkushtimi ndaj dikujt; 2. mundimi, përpjekja, durimi; 4. ndihma, solidariteti (shfaqet në emrat e organizatave bamirëse myslimane).

Është një varg termash nën shkronjën *D*, si *dava* (fq. 44), që definohet si “apel, thirrje”, por ka edhe domethënie të tjera; sipas Shkaliqit (në fq. 207) *dava* është padi, proces, akuzë, gjithashtu pohim. *Dar-al-harb* (ose *Darul-harb)*, në fq. 46, sipas autorëve, është “vend i luftës”, përkatësisht fushë beteje. Përfshin “territoret ku ligjet myslimane nuk e ushtrojnë fuqinë e vet”. Ky është interpretim i afërt me interpretimin e Shkaliqit, i cili, në fq. 206 thotë se “dari-harb” është “shtet jomysliman në të cilin myslimanët nuk i gëzojnë ato liri fetare që i gëzojnë në shtetin mysliman”. Është e dukshme se nga të gjitha përcaktoret që fillojnë me shkronjën “d”, më së miri dhe me një varg elementesh të reja është formësuar termi *dervish (*shiko fq. 47-48).

Dy terma që mungojnë nën këtë shkronjë janë: *defter* (*tefter*), përkatësisht, fletore, protokoll, regjistër; gjithashtu libër tregtarësh për debi e kredi, si dhe libra fiskalë në Perandorin Osmane ku regjistroheshin të hyrat. (Për më shumë shiko në *Fjalorin e madh* të Aniqit në fq. 1576). Termi tjetër, gjithashtu i rëndësishëm, e që nuk është i paraqitur në “*Nocionor*”, është *divan-i*. Ky term ka shumë domethënie, si p.sh. vëllimi i poezisë ose prozës, dispozitë (te Nerkezi në fq. 126, e te Shkaliqi në fq. 220). Tek Aniqi, (fq. 224), shiko gjashtë domethënie të kësaj fjale.

Në grupin e nocioneve dhe të emrave nën shkronjën *Gj*, është dashur të regjistrohen së paku edhe dy: *Gjergjelez (Alia*), trim legjendar i myslimanëve boshnjakë në këngët e gojëdhënat popullore dhe *Gjulistan* (kopshti i trëndafilave).

Nën shkronjën *E* janë dhënë tetë nocione, por mungojnë: *elif*-i (emërtimi i shkronjës së parë të alfabetit arab), *evlia* (njeri i shenjtë) dhe *elifbesufara* (abetarja arabe).

Nën shkronjën *I* (në fq. 57, 58, 65, 68) janë paraqitur një varg personalitetesh nga rendi i reformatorëve, i njohësve arabë të traditës, i shkencëtarëve spanjollo-arabë (p.sh. Ibn Hamza), i poetëve mistikë, i mistikëve spanjollo-arabë (p.sh. Ibn Arabi) që, krahas termave të tjera, e kanë pasuruar mjaft “*Nocionorin*”. Nga fjalët që nuk janë përfshirë nën këtë shkronjë, e që është dashur të paraqiteshin së paku me nga disa rreshta, po përmend këto: *ilmihat* (tekst shkollor nga mësim feje islame), *ihtibar* (nderim, respekt, vlerësim), e më parë e kemi përmendur fjalën *imaret* (kuzhinë bamirëse publike).

Një vështrim të veçantë e meriton përcaktorja *imam* e përpunuar pak më shumë në fq. 60 të “*Nocionorit*”. Është pozitive që autorët (Bozhoviq e Simiq) japin domethënien e parë të termave edhe gjatë historisë dhe kushtet të cilat kandidatët për imam duhet t’i plotësojnë, nga të cilat kushti i parë është jeta e pacenë dhe karakteri shembullor, e te shiitët që imamë të zgjidhen “besimtarët e shëndoshë, të ndershëm dhe të dijshëm”. Përpos këtyre rezultateve, pa dyshim, pozitive dhe informacioneve të tjera, këtu mund të hynin edhe ato katër kuptime të imamit sipas Shkaliqit (në fq. 345), si dhe një varg vërejtjesh dhe qëndrimesh në *Leksikonin* e Nerkezit (në fq. 267-269). Është interesante se në librin *A e dini?* (Beograd, 2004) në fq. 181 është paraqitur ndryshimi midis imamit e hoxhës në këtë mënyrë: imami është klerik i lartë i religjionit mysliman (Islam), kurse hoxha është klerik i rëndomtë. Imami është klerik mysliman, si abati - te katolikët; popi - tek ortodoksët; pastori - te protestantët dhe rabini - te hebrenjtë.

Nën shkronjën *J* janë dhënë vetëm gjashtë njësi gjuhësore (Islame). Te Nerkezi, për shembull, janë dhënë edhe tri njësi: *jeniçerët* (fq. 293-294), *gjuhët e Islamit* (fq. 300) dhe *Jerusalemi* (fq. 294-299).

Nën shkronjën *K* autorët kanë përpunuar 57 fjalë e terma, ndër të cilat më hollësisht: *Kaba* (ky term ndoshta do të ishte më e drejtë të përpunohej nën shkronjën *Q*, pra të përcaktoheshin me emërtimin Qaba e në parantezë - Kaba), *kaderie* (rend i dervishëve), *al-kalam* (fjala, të folurit, tregon “përdorimin e filozofisë në mbrojtjen e doktrinës religjioze”. Po aty, fq. 72), *karmatët* (emërtimi i pjesëtarëve të një lëvizjeje religjioze-politike shumë të përhapur), *kahin* (magjistar, falltar, klerik në bashkësitë e lashta), *kibla* (drejtimi kah Meka), e sidomos *Kur’ani* (në fq. 77-78). Në lidhje me këtë libër të shenjtë ndoshta do të duhej përmendur vetëm se në shekullin IX janë përcaktuar mënyra të ndryshme të leximit të *Kur’anit* në disa qendra: në Medinë, Mekë, Damask, Kufa etj. (Për më shumë shiko në librin: Milan Vukomanoviq, *Religija*, Beograd, 2004, fq. 29).

Është simpatike që nën shkronjën *L*, është përpunuar në mënyrë precize maksima e Muhamedit *La ilahe illa lah* (S’ka zot tjetër pos Allahut, në fq. 80). Aty është edhe Lapashi xhamia në Livno dhe nja dhjetë terma të tjera, faktikisht të marra nga *Turcizmat* e Shkaliqit.

Nga termat nën shkronjën *M*, që janë më shumë (150 përcaktore), disa janë të përpunuara më hollësisht, p.sh. *mahkama* (gjyqi fetar), *mevlevije* (rendi i dervishëve), *Medina*, *Meka*, *Vëllezërit Myslimanë*, e sidomos dhe me

fakte *Muhamed*i. Disa përcaktore, si p.sh. shkollat, veçmas *medreseja* (në fq. 87) janë shpjeguar pak e pjesërisht edhe njëanshëm, si edhe është thënë në vështrimin tonë.

Do t'i regjistrojmë edhe disa përcaktore që mungojnë në *"Nocionor"*, e këto janë: *nevruzi-sulltan* (dita e parë e pranverës, 21 marsi), *rrethprerje* (syneti), *Orient*, *Orientalistikë*, *padishah* (emërtim për sundimtarët myslimanë), *Palestina*, *Persia; letërsia*, *gjuha dhe kultura persiane*; *gjysmëhëna* (simboli i Islamit); *agjërimi*, *pashai*, *pashallëku; Pashallëku i Beogradit; rahmeti* (mëshira e Zotit dhe domethëniet e tjera); *rekati* (pjesë e lutjes së namazit), *raja*, *rubaia*, *Rumelia*, *sevapi*, *sevabi* (shpërblimi për vepër të mirë), *sihri*, *sihiri* (të bamet, magjitë); *Mehmed-pasha Sokoloviq; Dita e Gjykimit; sulltani* (titulli i sundimtarit); *sabri*, *saburi* (durimi); *salnama* (vjetari, almanaku); *sanxhaku* (disa domethënie); sunitët, sekt ose rrymë e Islamit, e cila, në fq. 113 është shpjeguar vetëm me dy fjali, ndërsa shiitët dhe shiizmi janë shpjeguar në 3 shtylla (në fq. 157-158). Nuk janë përfshirë edhe disa terma, si p.sh. *tarih* (historia), *tanzimati* (reformat), *terbijeti* (edukata, prestigji), *tevxhidi* (rregullat fonetike për mësim të drejtë të Kur'anit), *turk* (pjesëtar i popullit turk, shpeshherë do të thotë edhe mysliman), *turcizëm*, *Topçider*[2] , *fallakë* (formë më e rëndë e dënimeve trupore në mejtepet e vjetra), *ferman* (urdhëresë me shkrim e sundimtarëve myslimanë, të cilën duhej ta respektonte gjithkush, për më shumë shiko në librin *A e dini* (Da li zate, Beograd, 2004, fq. 50), *hafiz*, *hafuz* (personi që e di përmendësh tërë Kur'anin), *hesap*, *hesab* (llogari, numër, vlerësim), *hiqaje* (përrallë, ngjarje diçka që ka ndodhur), *Hurijet* (Shpallja e Kushtetutës në Turqi në vitin 1909; emërtim i shoqatës zejtare myslimane në Sarajevë); *çarshi*, *çelebi* (zotëri, njeri i edukuar mirë), *xhan* (shpirt), *Shahname* (ep i madh heroik i poetit persian Firdusi).

Rezyme

Në "Nocionorin" (Fjalorin e nocioneve) të Islamit është dhënë një numër bukur i madh përcaktoresh terminologjike të përpunuara me themel, në radhë të parë fjalësh, emërtimesh dhe personalitetesh nga filozofia, teologjia, kultura dhe mendimi shkencor Islam. Ka edhe terma që janë shkruar nën ndikimin ose sipas shembullit të Shkaliqit, Smailagiqit dhe autorëve të veprave të tjera. Është fakt se Bozhoviqi e Simiqi i kanë ndriçuar në mënyrë më të gjithanshme dhe më të drejtë shkencore disa përcaktimore, duke aplikuar një varg metodash të punës hulumtuese - historike, komparative, teorike e të tjera (p.sh. ndikimet e ndërsjella të religjioneve të ndryshme). Megjithatë, si na tregon shikimi dhe pasqyra e "*Nocionorit*", ka munguar një numër bukur i madh i termave që në një masë bukur të madhe do ta plotësonin *"Nocionorin"*, dhe shpresoj se autorët, me rastin e ribotimit, do të përpiqen që libri të jetë i plotësuar së paku me ato përcaktimore që gjithashtu do të paraqitnin pasurimin e përmbajtjes dhe karakteristikat qenësore të Islamit.

Vepra e R. Bozhoviqit dhe e V. Simiqit është shumë e rëndësishme sepse përmban lëndë të besueshme, burime të shumta dhe informacione të vlefshme. Përpos të tjerash, *"Nocionori"*, që ka afër 1200 përcaktimore, i zgjeron njohuritë tona mbi vlerën e vërtetë të Islamit në të kaluarën dhe sot. Libri do t'i ndihmojë drejtpërdrejt edhe gjuhëtarit, e mbi të gjitha orientalistit, edhe historianit, edhe teologut, edhe kulturologut, edhe antropologut, edhe etnologut dhe ekspertëve dhe studiuesve të tjerë të kësaj fushe aq të rëndësishme në botë dhe te ne.

Të dy autorët (Bozhoviqi e Simiqi) janë përpjekur dhe në shumë pikëpamje kanë pasur sukses t'i parashtrojnë sa më besnikisht, me siguri e vërtetësi përcaktoret e trajtuara në *"Nocionor"* dhe, ajo që gjithashtu është për t'u lavdëruar, t'i parashtrojnë këto pa paragjykime, pa aversione ose elemente të intolerancës dhe të smirës.

Me *"Historinë e Islamit"* të Arnoldit, *"Nocionorin"* dhe literaturën e burimet e tjera të panumërta, edhe te ne tanimë janë pjekur kushtet që t'i qasemi sa më seriozisht, individualisht ose në ekipe, edhe sajimit të *historisë së kulturës dhe të qytetërimit Islam*, sepse një vepër e tillë na mungon shumë.

Përktheu:
Vehap Shita

[2] Topçider - periferi e dikurshme, park dhe vend për piknik në Beograd, turqisht topçu deresi (lugina e topxhinjve).

RECENSIONE

Anthony Arnove

DEKLARATA E STAMBOLLIT

"Iraku është gabimi më i madh i politikës së jashtme në historinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës"
John Reid, udhëheqësi i shumicës demokrate në Senat

Deklaratë e ndërgjegjshme e porotës
Tribunali Botëror për Irak
Stamboll, Turqi, 27 qershor 2005

Në shkurt të vitit 2003, disa javë para fillimit të një lufte jolegjitime kundër Irakut, në të gjitha anët e botës miliona njerëz u tubuan nëpër rrugë duke protestuar. Thirrjes së qytetarëve të tubuar nëpër këto protesta askush nga institucionet e larta ndërkombëtare nuk iu përgjigj. Institucionet e tilla sipas gjitha gjasave nuk patën guxim dhe ndërgjegjeje që ta kundërshtojnë agresivitetin e qeverisë së SHBA-së dhe Britanisë së Madhe. Këtë agresivitet askush nuk mundi ta parandalojë. Tanimë kaluan dy vjet, që nga invadimi i Irakut të okupuar dhe të shkatërruar. Sulmi ndaj Irakut është edhe sulm ndaj drejtësisë, lirisë, sigurisë sonë, ardhmërisë sonë, sulm ndaj gjithë neve. Ne, njerëz të ndërgjegjes, vendosëm që një akt të tillë ta kundërshtojmë. E formuam Tribunalin Botëror për Irak (WTI) me shpresë se ardhmëria jonë do të ketë liri dhe paqe.

Legjitimiteti i Tribunalit Botëror për Irak gjendet në vetëdijen e kolektivit njerëzor. Ky sesion i WTI-s në Sta-

mboll paraqet kulmin e vargut të 20 hetimeve të mbajtura nëpër qytete të ndryshme botërore të fokusuara në invadimin dhe okupimin jolegjitim të Irakut. Konkluzionet e atyre sesioneve apo hetimeve të mbajtura në Barcelonë, Bruksel, Kopenhagë, Gjenevë, Hiroshimë, Stamboll, Lisbonë, Londër, Mumbai, Nju-Jork, Ostersaund, Paris, Romë, Stokholm, Tunizi, Gjermani dhe nëpër qytete të ndryshme të Japonisë, kësaj deklarate i shtohet me një ekzemplar të posaçëm.

Sami Frashëri

Ne, si porotë me një ndërgjegje të lartë, u takuam në Stamboll nga dhjetë vende të ndryshme. Dhe kryem hetimet e 54 dëshmive të Panelit, përfaqësuesit dhe dëshmitarët, të cilët kanë ardhur nga rajone të ndryshme të botës, përfshirë këtu edhe Irakun, SHBA-në dhe Britaninë e Madhe.

Tribunali Botëror për Irakun e mbajti mbledhjen në Stamboll, prej 24 deri më 26 qershor 2005. Qëllimi kryesor i këtij Tribunali Botëror për Irakun ishte që të flasë dhe përhapë të vërtetën për luftën në Irak, duke nënvizuar përgjegjësinë e atyre që janë të përgjegjshëm për luftë dhe rëndësinë e arritjes për lirinë e popullit irakian.

I. Aspekti i Konstatimit

1. Invadimi dhe okupimi i Irakut ka qenë dhe është jolegjitim. Motivet të cilat qeveria e SHBA-së dhe Britania e Madhe i ofruan si arsye për invadimin dhe okupimin e Irakut në mars të vitit 2003, u dëshmuan se ishin të rrejshme. Ekzistojnë shumë dëshmi të cilat e vërtetojnë konkluzionin se njëri ndër motivet kryesore për luftë ishte që të vendoset kontrolli i dominimit mbi Lindjen e Afërt dhe të rezervave të mëdha të naftës së saj, si pjesë e përpjekjeve amerikane për hegjemonizmin global.
2. Gënjeshtra të paturpshme për ekzistimin e armatimit për shkatërrime masive në Irak dhe lidhjet me terrorizmin e Al-Kaidës dhe regjimit të Sadam Huseinit u trilluan për t'u krijuar përkrahja publike për një sulm "preventiv" ndaj popullit sovran dhe të pavarur.

3. Tashmë disa vite Iraku gjendet në bllokim. Vënia johumane e sanksioneve të ashpra ekonomike më 6 gusht 1990, vendosja e ndalimit të zonave fluturuese në pjesët veriore dhe jugore të Irakut, si dhe bombardimi i pa ndërprerë i këtij vendi, kanë pasur për qëllim të zvogëlojnë dhe dobësojnë resurset materiale dhe njerëzore të Irakut si dhe aftësitë për të lehtësuar invadimin dhe okupimin, që do të pasonte. Në atë ndërmarrje udhëheqësit amerikanë dhe britanikë kishin përparësi në bashkëpunim me Këshillin e Sigurimit të KB-së.
4. Qeveria e Bushit dhe e Blerit duke u munduar që ta zbatojnë agjendën e mbretërisë, në mënyrë të paturpshme injoruan pjesën dërrmuese të kundërshtarëve të luftës, e cila u shpreh nga miliona njerëz anembanë botës.

   Kjo luftë e iniciuar nga ana e tyre është lufta më e padrejtë, më e pamoralshme dhe më tradhtare në historinë e luftërave.
5. Mekanizmat e themeluara politiko-juridikë ndërkombëtarë, nuk patën sukses në parandalimin e këtij sulmi, por as që t’i thërrasin në përgjegjësi ekzekutorët e atij sulmi. Imuniteti të cilën Qeveria e SHBA-së dhe aleatët e saj e gëzojnë, ngacmoi një krizë serioze ndërkombëtare, e cila rrezikoi edhe rëndësinë e ekzistimit të së drejtës ndërkombëtare, të dokumentit për drejtat e njeriut dhe të ndikimit të institucioneve ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Kombet e Bashkuara, që me atë pak autoritet dhe dinjitet u lanë të merren me këtë krizë.
6. Okupimi amerikano-britanik i Irakut gjatë këtyre 27 muajve shtetin dhe shoqërinë irakiane e solli në shkatërrim. Ligji dhe rendi janë shpërbërë, që për rezultat pati mungesën e përgjithshme të sigurisë. Infrastruktura fizike u shndërrua në gërmadha; sistemi i mbrojtjes shëndetësore është në gjendje të mjerueshme; sistemi i arsimimit praktikisht ka pushuar së funksionuari; nga të gjitha anët ka shkatërrime të mëdha; kurse trashëgimia arkeologjike e popullit irakian është profanizuar.
7. Me qëllim që të minohet identiteti dhe integriteti irakian si komb, okupatori qëllimisht i acaroi ndasitë etnike, sektare dhe fetare në shoqërinë irakiane. Kjo është në pajtueshmëri me politikën e njohur imperialiste “përçaj dhe sundo”. Aq më tepër, ka ndihmuar shtimin e dhunës ndaj femrës, diskriminimin e jashtëm, dhe ka forcuar marrëdhëniet patriarkale.
8. Vënia e sanksioneve në vitin 1990 nga KB, shkaktoi vuajtje që nuk mbahen mend dhe mijëra të vdekur. Situata u përkeqësua mbas okupimit. U mbytën së paku 100.000 civilë; 60.000 janë internuar në Amerikë në kushte antinjerëzore, të paakuzuar; me mijëra njerëz janë zhdukur, ndërsa keqtrajtimet (torturat) janë bërë rutinë.
9. Privatizimi jashtëligjor, anulimi i rregulloreve dhe liberalizimi i ekonomisë irakiane, që udhëhiqet nga regjimi okupues, e ka detyruar Irakun të bëhet me ekonomi nënshtruese, të cilën e kontrollojnë FMN dhe Banka Botërore, kurse që të dyja janë pjesë e pa ndashme e konsensusit të Uashingtonit. Forcat e okupatorit gjithashtu kanë vu nën kontrollin e tyre rezervat e naftës irakiane.
10. Të gjitha ligjet dhe institucionet e formuara nën mbikëqyrjen e okupatorit nuk kanë kurrfarë force ligjore apo morale. Mu për këtë para një kohe u mbajtën zgjedhjet e paligjshme, kuvendi parlamentar, qeveria ekzistuese dhe Qeveria për punimin e plan-projektit të Kushtetutës.
11. Ekziston rezistenca e hapur për okupim. Rezistenca politike, shoqërore dhe qytetare me metoda të qeta i janë nënshtruar represionit të forcave okupuese.

    Pikërisht okupimi dhe barbarizmi i saj kanë shkaktuar rezistencë të ashpër dhe të armatosur me disa veprime dëshpëruese. Sipas principeve të ndërtuara në Dokumentin e KB-s dhe së drejtës ndërkombëtare, rezistimi i popullit ndaj okupimit është i arsyeshëm. Meriton përkrahjen e gjithë atyre që brengosen për drejtësi dhe liri.

II. Akuzat

Në bazë të konstatimeve paraprake, duke u thirrur në Dokumentin e Kombeve të Bashkuara si dhe në dokumente tjera të paraqitura në këtë dokument, porota nxjerr akuzat vijuese.

A. Kundër Qeverisë së SHBA-së dhe Britanisë së Madhe:

1. Për planifikim, përgatitje dhe kryerje të krimit më të madh: agresionin luftarak duke shkelur Dokumentin e Kombeve të Bashkuara dhe principet e Ninbergut. Dëshmitë për këtë pikë të akuzës, e cila ka dalë në opinion mund të gjenden në Memorandumin e Downing Streeti-t nga 23 korrik 2002, në të cilën qëndron: “Aksioni ushtarak tashti konsiderohet i pashmangshëm. Bushi deshi largimin e Sadamit me aksion ushtarak, dhe këtë ta arsyetojë duke u mbrojtur nga terrorizmi dhe armatimi për shkatërrime masive. Por, për ta kënaqur politikën e tij shërbimet informative bënë montimin e fa-

kteve. Të dhënat e shërbimeve informative janë trilluar me qëllim të mashtrimit të popullit amerikan, britanik dhe përfaqësuesit e zgjedhur të tyre;

2. Për caqet e banuara me civilë të Irakut dhe të infrastrukturës civile me sulme të drejtuara me qëllim ndaj civilëve, spitaleve, qendrave mjekësore, kuartet e banuara, qendrave me transformator dhe pajisjet për pastrimin e ujit. Shembull i qartë i këtij krimi është shkatërrimi i tërësishëm i qytetit Faluxhi;

3. Për përdorimin e forcës dhe sistemit të armatimit joproporcional me veprime shkatërruese, sikurse municionet me kasetë, bombat e ndezshme, uranium të varfëruar, dhe armë kimike. Dëshmi deri në detaje Tribunalit u janë ofruar nga provat e ekspertëve, për rritjen drastike të sëmundjeve nga leukemia te fëmijët nën pesë vjeç, dhe mu në ato vende të cilat janë goditur nga raketat me UV.

4. Për shfrytëzimin e municionit me UV, edhe përkundër vërejtjeve me cilat janë ballafaquar shkencëtarët dhe veteranët e luftës lidhur me veprimet, shkatërrimet dhe pasojat e saj afatgjate ndaj njerëzimit dhe rrethinës.

5. Administrata amerikane duke pohuar se nuk ekzistojnë dëshmi të bazuara shkencore të mjaftueshme për veprime shkatërruese nga UV, më me dëshirë ka vendosur që të vërë në rrezik miliona jetë të disa gjeneratave të ardhshme, sesa ta ndërpresin përdorimin e tyre, qoftë edhe për rreziqe potenciale;

6. Për moskursimin e jetës së civilëve gjatë aksioneve ushtarake dhe periudhës së okupimit, e cila pasonte. Kjo vërehet, për shembull, nga metoda e bombardimit “Tmerr dhe shok” si dhe nga sjelljet e forcave okupuese nëpër kontrolle dhe punkte të ndryshme;

7. Për mënyrën aktive të formimit të kushteve nën të cilat pozita e femrës irakiane seriozisht është dëmtuar, kundër pohimeve të pandërprera të liderëve të forcave të koalicionit. Liria e lëvizjes së femrës me të madhe është kufizuar, duke e zvogëluar paraqitjen e saj në jetën publike, në arsimim, mjetet për ekzistim, në angazhimet politike dhe shoqërore. Ekzistojnë dëshmi për shtimin e dhunimeve seksuale dhe të tregtisë me shërbime seksuale në raport me fillimin e okupimit të Irakut;

8. Për përdorimin e dhunës vdekjeprurëse ndaj protestuesve të qetë, duke përfshirë vrasjen e më tepër se 12 protestuesve paqësorë në Falluxhi, në prill të vitit 2003;

9. Për shqiptimin e dënimeve pa akuza dhe pa gjykata, duke përfshirë dënimet kolektive të irakianëve. Ekzistojnë shumë dëshmi për operacionet “rrëmbe dhe ik”, zhdukjen e njerëzve dhe atentatet;

10. Për nënshtrimin dhe torturat e ushtarëve dhe civilëve irakianë, si dhe për egërsitë dhe poshtërimet antinjerëzore rreth e rrotull tyre. Këto sjellje poshtëruese nënkuptojnë nënshtrimin e ushtarëve dhe civilëve irakianë me akte raciste, etnike, fetare dhe diskriminimit bigoniak, si dhe refuzimi për ushtarët irakianë që ta kenë statusin e robërve të luftës, e cila sipas konventës së Gjenevës është e domosdoshme. Ekzistojnë shumë dëshmi për burgosjet dhe paraburgosjet jashtëligjore dhe pa kurrfarë procedure të shkruar ligjore. Torturime dhe mundime të papara çnjerëzore ndaj njerëzimit ndodhën në burgun Abu Graib, si dhe në Mosul, në logorinë Bucca dhe Basra. Mercenarë të punësuar dhe kontraktuesit privatë për zbatimin e torturave kanë shërbyer në zvogëlimin e përgjegjësisë;

11. Për ndryshimet e ligjeve të vendit, që u sulmua dhe u okupua në mënyrë të paligjshme, shkeljeve të marrëveshjeve ndërkombëtare për përgjegjësinë e forcave okupuese ashtu që të bëhet grumbullimi i fitimeve të paligjshme (me masat sikurse Urdhëresa 39, të cilën e ka nënshkruar L. Paul Bremer III

Qeverisë së përkohshme të koalicionit, me të cilën lejohet që investitorët e huaj të blejnë dhe të marrin firmat shtetërore irakiane dhe të riatdhesojnë fitimet dhe mjetet e qind për qindta në çfarë do momenti dhe kontrollimit të naftës irakiane.

Janë dhënë dëshmi të panumërta të korporatave, të cilat kanë fituar në këto transaksione;

12. Për shkatërrime të qëllimshme të ambientit, për ndotjen e rrethit me municionin e UV, për tymin e djegur të burimeve të naftës, për njolla të mëdha të naftës, si dhe për ndotjen e tokave të punuara; për ndërprerje me qëllim të furnizimit të sistemit ujor dhe kanalizimit në mënyrë kufizuese të luftës biologjike-kimike; lejimi në mosintervenimin ndaj plaçkitjeve dhe për përhapjen e

materialit radioaktiv nga depot nukleare. Ekziston dokumentacion i hollësishëm për ndotjen e ajrit, ujit, tokës si dhe për ndotjet radioaktive;

13. Për mungesën e mbrojtjes së trashëgimisë së pasur arkeologjike dhe kulturore të Irakut duke lejuar plaçkitjen e muzeve dhe të lokacioneve historike, si dhe vendosjen e bazave ushtarake nëpër vende të ndjeshme kulturore-arkeologjike.

    Këto ndodhën përkundër vërejtjeve paraprake të UNESCO-s dhe të zyrtarëve të muzeve irakiane.

14. Për ndalimin e së drejtës në informim, duke përfshirë këtu edhe *censurën* e medieve irakiane, sikur se të gazetave (për shembull, Al-Havza, Al-Mashrik dhe Al- Mustakila) dhe radiostacioneve (Radio Bagdad), mbylljen e zyrës së korrespodencës irakiane të televizionit Al-Xhezira, paditjen e gazetarëve të huaj, burgosjen dhe vrasjen e profesorëve të universitetit, intelektualëve dhe shkencëtarëve;

15. Për definicionin e sërishëm të konceptit "mundime" shkeljen e së drejtës ndërkombëtare për të mundësuar shfrytëzimin e mundimeve dhe të burgosjeve të paligjshme, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e më tepër se peseqind njerëzve në Guantanama pa kurrfarë akuze dhe pa kurrfarë qasjeje në mbrojtjen juridike. Shfrytëzohen "dorëzimet e posaçme" të dërgimit të njerëzve nëpër vende tjera me qëllim të ushtrimit të torturës ndaj tyre, vende këto që njihen për shkeljen e të drejtave njerëzore dhe për burgjet në të cilat kryhen tortura ndaj të të burgosurve.

16. Për kryerjen e krimeve kundër paçes duke shkelur vullnetin e lëvizjes kundër luftës globale. Nuk mbahet në mend që një vetëdijesim publik, e shprehur nga miliona njerëz anembanë botës t'i kundërshtojë një sulmi të pashmangshëm në Irak. Sulmi i bëri të parëndësishëm. Praktikisht kjo lë të kuptojë se Qeveria amerikane dhe aleatët e saj milionа njerëzve u bëri me dije se zëri i tyre mund të injorohet dhe qetësohet me një imunitet të plotë;

17. Për udhëheqjen e një politike luftarake të përhershme kundër kombeve sovrane. Siria dhe Irani tashmë janë të shpallura si caqe potenciale. Me shpalljen e "luftës globale kundër terrorit", Qeveria amerikane i dha vetes të drejtën ekskluzive në përdorimin e forcës ushtarake kundër kujtdo qoftë. In toleranca etnike dhe fetare po nxitet në pjesët e ndryshme të botës. Okupimi amerikan i Irakut edhe më shumë e forcoi okupimin e Izraelit të Palestinës duke e shtuar represionin mbi popullin palestinez. Të fokusuarit mbi sigurinë shtetërore dhe përforcimi i militarizmit rezultoi me pakësimin serioz të sigurisë njerëzore dhe të drejtave të njeriut në mbarë botën.

B. Kundër Këshillit të Sigurimit të KB-së

1. Për neglizhencën që populli irakian të mbrohet nga agresioni kriminal;
2. Për zbatimin e sanksioneve të tmerrshme ekonomike ndaj Irakut, përkundër njohurive që ato sanksione drejtpërdrejt shkaktojnë humbjen masive të jetës njerëzore si dhe qytetarëve të pafajshëm u sjellin dëme të shumta;
3. Për lejimin që SHBA dhe Britania e Madhe të ushtrojnë bombardime të paligjshme nëpër zonat e ndaluara të fluturimit, shfrytëzimin e shqiptimeve të trilluara që në KB të përcillet rezoluta, dhe në asnjë moment, të mos lejohen diskutimet në Këshillin e Sigurimit për këto shkelje, e që në këtë mënyrë Këshilli u bë pjesëmarrës dhe mban përgjegjësi për mbytjen e civilëve dhe shkatërrimin e infrastrukturës irakiane;
4. Për lejimin që SHBA-së të dominojnë mbi Kombet e Bashkuara dhe të konsiderohen të përjashtuara për çfarëdo lloj përgjegjësie për të cilat kishte pasur mundësi të thirret nga cilado qoftë anëtare e KB-së;
5. Për lëshimin e parandalimit të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, të cilat i kanë iniciuar SHBA-të dhe partnerët e tyre të koalicionit në Irak;
6. Për lëshimin që SHBA-të dhe partnerët e tyre të koalicionit të thirren në përgjegjësi për shkeljen e drejtave ndërkombëtare gjatë invadimit dhe okupimit, dhe duke i lejuar zyrtarisht, me këto veprime dhe shtirje aktive, Këshilli u bë pjesëmarrës në këtë okupim të paligjshëm.

C. Kundër Ministrisë së Koalicionit të Vullnetit

Për pjesëmarrje në invadimin dhe okupimin e Irakut, me ç'gjë i ndanë përgjegjësitë ndaj krimeve të kryera.

D. Kundër qeverive të shteteve tjera

Për lejimin e përdorimit të bazave ushtarake dhe hapësirave të rrezatuara, si dhe zgjerimin e përkrahjeve tjera logjistike për invadim dhe okupim, me këtë duke u bë pjesëmarrës i krimeve të filluara.

E. Kundër korporatave private të cilat kanë fituar kontratat për rekonstruksionin e Irakut, të cilët kanë kërkuar dhe më pas edhe kanë fituar "dëmshpërblimin" nga regjimi i paligjshëm okupues.

F. Kundër Korporatave të Mediumeve të Mëdha

1. Për gënjeshtra të qëllimshme të cilat planifikohen nga SHBA dhe Britania e Madhe dhe lëshimet që të udhëhiqen hetimet e përgjegjësisë për ato dezinformata, madje kur ato edhe ishin të ballafaquara me dëshmi të mjaftueshme, të cilat e tregonin të kundërtën. Në mesin e shtëpive të mëdha informative të cilët natyrisht se bartin përgjegjësi për ekspozimin dhe përhapjen e gënjeshtrave për armatimin irakian të shkatërrimeve masive përmendim *"New York Times"*, dhe natyrisht gazetaren e tyre Judith Miller, burimet kryesore të informatave të së cilës ishin në regjistrin e të paguarve të CIA-s. Përmendim gjithashtu edhe FOX News, CNN, NBC, CBS, ABC, BBC, dhe ITN. Në këtë regjistër gjithashtu gjenden edhe *Express*, *Sun*, *Observer*, *Washington Post* e kështu me radhë;
2. Për shkak të mosraportimit të mizorive të kryera ndaj popullit irakian nga forcat okupuese, dhe mospërfilljes së përparësive dhe të dinjitetit të obliguar për zërat e vuajtura, ndërsa apelet globale për paqe dhe drejtësi margjinalizohen;
3. Për shkak të raportimit joobjektiv gjatë rrjedhave të okupimit; për heshtjen dhe diskreditimin e të gjithë atyre që nuk pajtoheshin dhe që nuk raportonin në mënyrë objektive për harxhimet e tërësishme nacionale dhe të pasojave nga regjimi okupues, i cili me anë të gënjeshtrave mundohej të arsyetojë praninë e tij të mëtutjeshëm në Irak;
4. Për shkak nxitjes së një klime të frikshme ideologjike, të racizmit, ksenofobisë, islamofobisë, që pastaj kjo të shfrytëzohej për arsyetimin dhe lejimin e legjitimitetit të dhunës, të cilat i kryejnë ushtarët e regjimit okupues;
5. Për përhapjen e ideologjisë, e cila feston burrërinë dhe luftën, dhe pastaj atë (luftën) e normalizon si një zgjidhje politike;
6. Për shkak bashkëpunimit në një luftë agresive dhe inkurajimit të regjimit okupues, e cila nga shumica konsiderohet fajtore për krime të luftës dhe të krimit kundër njerëzimit;
7. Për shkak të mundësimit, të legalizimit dhe zgjerimit dezinformues, të përvetësimit mashtrues dhe të paligjshëm të resurseve njerëzore dhe financiare në një luftë të paligjshme, e cila u nxit në bazë të preteksteve të trilluara;
8. Për promovimin e korporatave ushtarako-parimore të "sigurisë" të cilët janë kundër produktive për interesat fondamentale dhe prioritetit të popullsisë në botë dhe të cilët seriozisht e kanë dëmtuar popullatën civile.

III. Rekomandimet

Duke e pranuar të drejtën e popullit irakian për rezistencën që i bëjnë okupimit të paligjshëm të vendit të tyre dhe të zhvillimit të institucioneve të pavarura, si dhe duke pohuar se e drejta për rezistencë ndaj okupimit është e drejtë e udhëheqjes së luftës për vetëvendosje, liri dhe pavarësi, e cila është e lëshuar nga Dokumenti i Kombeve të Bashkuara, ne, porota e ndërgjegjes, e shprehim solidaritetin tonë me popullin e Irakut.

Rekomandojmë:

1. Urgjentisht dhe pa kurrfarë kushti të tërhiqen forcat e koalicionit nga Iraku;
2. Që forcat e koalicionit qeveritar t'i paguajnë dëmet e luftës, dhe Irakut t'ia paguajnë kompensimin për shkatërrimet humanitare, ekonomike, ekologjike dhe kulturore të shkaktuara nga invadimi dhe okupimi i paligjshëm.
3. Që të gjitha ligjet, kontratat, marrëveshjet dhe institucionet të vendosura gjatë okupimit të cilat nga populli irakian për interesa të veta konsiderohen si armiqësore dhe të dëmshme të shpallen të pavlefshme dhe të anulohen;
4. Që menjëherë të mbyllet burgu në Ishullin Guantanamo, si dhe të gjitha burgjet tjera ushtarake amerikane jashtë SHBA-së, të shpallen emrat e të burgosurve, t'u jepet statusi i robërve të luftës dhe të kalojnë nëpërmes procedurës së rregullt;
5. Të fillojnë hetimet në thellësi për përgjegjësit e agresionit për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit në Irak, duke filluar me Xhorxh Bushin, kryetarin e SHBA-së, Toni Blerin, kryeministrin e Britanisë së Madhe, njerëz të çështjeve vendimtare të atyre vendeve dhe të vendeve të koalicionit vullnetar, njerëz nga zinxhiri komandues ushtarak, të cilët e kanë hartuar strategjinë e kësaj lufte kriminele, duke filluar nga lart e teposhtë; si dhe personat nga Iraku të cilët kanë ndihmuar në përgatitjen e këtij invadimi të paligjshëm dhe të cilët e kanë përkrahur okupatorin.

   T'i cekim vetëm disa emra të personave të cilët duhet të përfshihen në hetime të tilla: kryeministrat e vendeve të koalicionit vullnetar, siç janë Junichiro Koizumia nga Japo-

nia, Jose Maria Aznar nga Spanja, Silvio Berluskoni nga Italia, Jose Manuel Durao Baroso dhe Santana Lopez nga Portugalia, Roh Moo Hyun nga Koreja Jugore, Andres Fogh Rasmussen nga Danimarka; zyrtarët publikë, siç janë Dick Cheney, Donald H. Ramsfeld, Paul Wolfowitz, Colina L. Powell, Condoleze Rice, Richard Perle, Douglas Feith, Albert Gonzales, dhe L. Paul Bremer, nga SHBA-të; vijojnë figurat politike nga Britania e Madhe: Jack Straw, Geoffrey Hoon, John Reid, dhe Adam Ingram; vazhdojmë me komandantë ushtarak nga SHBA, duke filluar me: gjeneral Richard Meyers, gjen. Tomyy Franks, gjen. John P. Abizaid, gjen. Ricard S. Sanchez, gjen. Thomas Metz, gjen. John R. Vines, dhe gjen. George Casey; vijojnë udhëheqës ushtarakë nga Britania e Madhe: gjen. Mike Jackson, gjen. John Kiszeley, mareshali i aviacionit Brian Burridge, gjen. Peter Wal, admirali i prapavijës David Snelson, gjen. Robi Brims, dhe nënmareshali i aviacionit Glen Torpy; në mes të tjerëve janë edhe kryekomandantët dhe oficerët komandues të vendeve të koalicionit, të cilët i kanë ushtarët e tyre në Irak, sikurse që janë kolaboracionistët irakianë ashtu si Ahmad Çalabi, Ijad Alavi, Abdul-Aziz al-Hakimi dhe gjen. Abdul Kader Mohhammed Jasem Mohona;

6. Të fillohet me procesin verifikues për përgjegjësinë e atyre të cilët moralisht dhe personalisht janë përgjegjës për pjesëmarrje në këtë luftë të paligjshme, sikurse që janë gazetarët të cilët me qëllim kanë gënjyer, seksionet e medieve të cilët propagandonin urrejtje racore, etnike dhe fetare, dhe drejtorët gjeneralë të korporatave multinacionale, të cilëve u realizohej pasuria në këtë luftë;
7. Me qëllim që në mbarë botën njerëzimi të fillojë me aksione paqësore kundër korporatave amerikane dhe britanike të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë realizuar pasuri në këtë luftë. Disa nga ato korporata janë: Halliburton, Bechtel, Carlyle Group, CACI Inc., Titan Corporation, Kellogg, Brown & Root (filial e Halliburtonit), Dyn Corp, Boeing, Exxon Mobil, Texaco, British Petroleum. Kompanit në vijim janë që e kanë akuzuar Irakun dhe që kanë fituar dëm “shpërblimin”: Toys “Я” Us, Kentucky Fried Chicken, Shell, Nestle, Pepsi, Phillip Morris, Sheraton, Mobil. Këto aksione mund ta marrin formën e veprimit direkt, si për shembull mbylljen e punishteve të tyre, bojkotimin e prodhimeve të tyre dhe sjellje presioni ndaj aksionarëve që të bëjnë tërheqjen e parave të deponuara;
8. Të lajmërohen të rinjtë dhe ushtarët që në mënyrë të ndërgjegjshme të bëjnë refuzimin për paraqitjen e tyre në ushtri dhe të marrin pjesë në një luftë të paligjshme; gjithashtu, edhe vendet të pranojnë aprovimin e ndërgjegjshëm për azil politik;
9. Që njerëzimi në mbarë botën të rezistojë dhe hedh poshtë çdo përpjekje të qeverive të veta për ofrimin e përkrahjeve materiale, logjistike apo morale ndaj okupimit të Irakut.

Ne, Porota e ndërgjegjes, shpresojmë se madhësia dhe përcaktimi i këtyre rekomandimeve do të bëhen bazament i botës në të cilën institucionet ndërkombëtare me vullnetin e popullit do të modelohen dhe stermodelohen, dhe assesi nga frika apo interesat personale, në të cilat gazetarët dhe intelektualët nuk do të jenë të shurdhër, në të cilën vullneti i popullit në tërë botën do të jetë kryesore, kurse sigurimi individual do të mbizotërojë ndaj sigurisë shtetërore dhe profitit të korporatave.

Arudhati Roy, Indi, *Spokesperson of the Jury of Consience*
Ahmet Oztyrk, Turkey
Ay, Se Erzan, Turkey
Chandra Muzzafar Malaysia
David Krieger, United States
Eve Ensler, United States
François Houtart, Belgium
Jae-Bok Kim, South Korea
Mehmet Tarhan, Turkey
Miguel Angel De Los Santos Cruz, mexiko
Murat Belge, Turkey
Rela Mazali, Israel
Salaam Al Jobourie, Iraq
Taty Almeida, Argentina.

Shtetet dhe i numri i ushtarëve të tyre në Irak

Britania e Madhe	7.200
Koreja e Jugut	2.800
Italia	1.600
Geruzia	900
Polonia	900
Rumunia	628
Danimarka	530
Australia	498
Salvadori	380
Fixhi	168
Mongolia	160
Azerbajxhani	150
Shqipëria	120
Letonia	120
Sllovakia	104
Republika Çeke	100
Lituania	60
Armenia	46
Estonia	40
Bosnjë e Hercegovina	36
Maqedonia	35
Kazakistani	27
Sllovenia	4

Shtetet të cilat i kanë tërhequr ushtarët e tyre nga Iraku

Bullgaria....................... dhjetor, 2005.
Republika Dominikane ......maj, 2004.
Hondurasi.......................... maj, 2004.
Hungaria....................... dhjetor, 2004.
Japonia ....qershor, 2006.
Moldavia ....shkurt, 2005.
Holanda ....prill, 2005.
Zelanda e Re ....Shtator, 2004.
Nikaragua.......................shkurt, 2004.
Filipinet........................qershor, 2004.
Portugalia.......................shkurt, 2005.
Spanja ....maj, 2004.
Tajlanda .... gusht, 2004.
Tongo........................... dhjetor, 2004.
Ukraina .... dhjetor, 2005.

Ky material është marrë nga libri, “Irak logika povlaçenja”, të autorit Anthony Arnove, Sarajevë, 2007.

Përgatiti dhe përshtati:
Shevki Sh. Voca

RECENSIONE

Nexhat Ibrahimi

IMAM VEHBI ISMAILI, *xhevahir mbi xhevahirë* (Analizë rrugës jetësore të Imam Vehbi Ismailit)

"Botimi i veprave të Imam Vehbiut do ta kthejë ate në vendin e origjinës, nga na e mori Amerika para 60 viteve."

Kohë më parë populli shqiptar dhe gjuha shqipe e fitoi edhe një thesar të çmueshëm, kompletin e veprave të Imam Vehbi Ismailit. Kompleti përfshin tetë vëllime, ku janë përfshirë 28 vepra autoriale apo të përkthyera të Imam Vehbi Ismailit dhe disa kontribute për autorin. Meqenëse janë shkruar disa biografi të shkurtra për të, vëmendjen do ta përqendrojë në disa aspekte të tjera të jetës, ndryshe, dhe të veprës së këtij vigani të fesë islame në gjuhën shqipe.

***

Imam Vehbi Ismaili është personalitet i rrallë porsi uji në shkretëtirë. Ky pohim paksa metaforik bazohet në angazhimin optimal të tij për ndriçimin e çështjeve dhe temave që e preokuponin kohën dhe hapësirën kur ai jetoi dhe veproi. Pohimi i tillë bazohet dhe në spektrin e fushave të shumta që ai trajton në meditimet dhe studimet e tij. Për këtë arsye, përpunimi dhe arsyetimi më i themeltë i vlerësimit të opusit intelektual, shkencor dhe organizativ të Imam Vehbiut kërkon njohje të kontekstit të gjerë kohor dhe hapësinor të lindjes, zhvillimit dhe kontributit të tij të gjithanshëm. Gjithashtu, veçanësinë e Imam Vehbiut e përbën edhe qasja e tij besimore dhe intelektuale kundrejt bashkëkohësisë dhe themelësia e tij autentike dhe autoritative prej iluministi në shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve e problemeve të rëndësishme të kohës.

Theksimi i këtij komponenti hap para lexuesit, e sidomos para hulumtuesit, shtigje të shumta dhe jep shenjë për më shumë karakteristika të opusit të tij. Sidomos në këtë rrafsh është me rëndësi angazhimi i tij arsimor në aktivitetin e tij prej *thirrësi* (misionaristi), që në fakt e orientoi, madje edhe e përcaktoi karakterin dhe tematikën e preokupimeve të tij. Meqë opusi i tij krijues kap një periudhë të gjatë kohore, rreth shtatë dekada, disa tema të tij në shikim të parë i përkasin "asaj" kohe, por pas leximit dhe rileximit të tyre, vërejmë se ato shkrime reflektojnë aktualitet, afrim brezash e rafinitet shpirti. Për këtë shkak, tërë opusi i tij krijues është i afërt me lexuesin e shekullit XXI, madje shpeshherë për lexuesin e periudhës post-moderniste paraqet madje edhe doracak të pashmangshëm të kohës. Normalisht, krijimtaria e tij intelektuale kërkon që të vlerësohet pikarritja e punës së tij në kohën e tij dhe njëkohësisht ajo të vlerësohet edhe nga pozicionet e aktualitetit tonë.

Imam Vehbiu pa dyshim është njëri prej intelektualëve më të dalluar të kohës ndër shqiptarët, por edhe më gjerë, duke filluar që nga koha e Pasluftës së Dytë Botërore (1946) e deri në fund të shekullit XX (1996), kur Imami i shkroi shkrimet e tij të fundit. Veprat e tij, edhe pse karakterizohen me ngjyrën e kohës kur dhe ku trajtoheshin, ato tërësisht e reflektojnë komponentin edukativ, arsimor, patriotik dhe tolerant për bashkëbesimtarët e tij në Amerikë dhe, në masë më të vogël, edhe në trojet shqiptare përmes ekzemplarëve të paktë që si xhevahire të vlefshme depërtonin në Kosovë e Maqedoni dhe, vetëm pas vitit 1990, edhe në Shqipëri. Opusi i tij prej njëzet e disa veprash autoriale ose të përkthyera, të përfshira në këtë botim në tetë vëllime dhe shumë artikuj, shkrime, recensione, parathënie e pasthënie për

veprat e të tjerëve, përkundër diskontinuitetit kohor e, madje, edhe hapësinor, flet për Imam Vehbiun se ai ishte një personalitet markant, qendror dhe rrallëherë i përsëritshëm i epokës kur jetoi dhe veproi. Me të drejtë ai hyn në radhën e pararendësve dhe bashkëkohësve të tij, si Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Haki Sharofi, Sherif Ahmeti etj.

Megjithatë, ndonëse vëllimi i madh i veprës së tij te lexuesi kritik mund të hedhë një dilemë, se mbase vëllimi i konsiderueshëm i veprës së tij e relativizon këtë opus, ne jemi të prirë të mendojmë se vepra e Imam Vehbiut është prodhim nga brenda, prodhim i shpirtit të tij, ndërsa u destinohet shpirtrave të pastër, por të sfiduar nga sistemet dhe ideologjitë e shumta dhe të rrezikshme moderne për rrethin e tij dhe kohën kur jetoi.

Përse? Sepse, koha kur lindi dhe u zhvillua Imam Vehbiu ishte periudha postosmane, e dominuar nga fuqitë e huaja dhe nën trysninë e fuqishme të elementeve destruktive që punonin në llogari të fqinjëve greko-sllavë. Shqipëria dhe trojet shqiptare nuk patën mundësi ta artikulojnë qartë dhe fuqishëm aspektin e tyre nacional, kurse aspekti fetar islam ishte në rrezik serioz nga hakmarrja pikërisht për shkak të përcaktimit fetar dhe të aleancës historike me osmanlinjtë muslimanë. Madje, shqiptarët u ndëshkuan rëndë duke i copëtuar trojet e tyre në shumë shtete ballkanike dhe duke i dëbuar ata nga trojet e tyre shekullore. Tërë krijimtaria shqiptare islame disashekullore, tërë ai thesar i krijuar sinqerisht, shkoi në asgjësim ose u la në harresë. Populli që i dha një perandorie mbi 30-të kryeministra, me dhjetëra e dhjetëra intelektualë të lartë, që krijoi një trashëgimi aq të pasur në letërsi e arkitekturë, përnjëherë mbeti analfabet, i pambrojtur, pa të kaluar politike, kulturore, shkencore. Kjo vërtet ishte më shumë se tragjike!

Pikërisht në këtë kohë lindi dhe veproi Imam Vehbiu. Madje ai e kishte edhe më vështirë se shqiptarët e tjerë, sepse pas studimeve të përfunduara, për shkak të vrasjes së të vëllait dhe pas burgosjes së babait, ai nuk mundi t'i kthehet familjes, e as vendit të tij të dashur, por mbeti në emigracion, për disa vite në Egjipt, ndërsa nga viti 1949 - në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Si brenda Shqipërisë dhe brenda tokave shqiptare në ish-Jugosllavi, ashtu edhe jashtë tyre, për shkak të ofensivës dhe dhunës së papërshkruar të shteteve armike dhe, për shkak të antipatisë ndaj Islamit dhe myslimanëve, ulemaja shqiptare u vra, u burgos e u shantazhua; si pasojë e kësaj gjendjeje, ajo heshti. Por, nuk heshtën të gjithë. Nga kjo heshtje frike, dhune e shantazhi, me urtësi të jashtëzakonshme foli zëri i Imam Vehbiut. Zë i ri

djaloshar, por shumë i qartë e këmbëngulës vazhdoi të flasë nga kontinenti i Amerikës.

Dikush mund të vërejë: Po, ai foli, por Imam Vehbiu nuk ishte brenda trojeve shqiptare dhe zëri i tij mezi dëgjohej.

Vërtet Imam Vehbiu vepronte në Amerikë, në mesin e bashkëkombësve të tij, në mesin e besimtarëve të tij, por zëri i tij nuk mbeti i padëgjuar as për trojet shqiptare. Nëpërmjet kontakteve individuale, nëpërmjet përkthimeve ose prezantimeve të shkrimeve të tij, zëri i Imamit bëhej gjithnjë e më i fuqishëm. Vlen të theksohet se gjithnjë, në të gjitha shkrimet, Imam Vehbiu është sa mysliman, aq edhe shqiptar, karakteristikë kjo e çdo emigranti, respektivisht dy aspekte të një qenieje, dy faqe të një medaljoni.

Siç do ta vërejmë nga shënimet biografike, Imami është aktivist me plot energji në të gjitha fazat e jetës së tij, është plot gjallëri dhe shumë optimist. Edhe pse vepra e tij krijohet në shtatë dekada, edhe pse vepra e tij në disa pikëpamje të aktualitetit relativizohet, siç theksuam edhe më herët, mendojmë se shkrimet e tij kanë vlerë trans'historike, ato kanë mesazh të qëndrueshëm, jetëgjatë dhe pa diga ideologjike. Kjo vlerë do të vërehet në çdo vepër të tij, në çdo shkrim të tij, qoftë shkrim historik, besimor, etik ose thjesht shkrim rasti. Imam Vehbiun e kemi imam, vaiz, hatib, këshillues, shkencëtar, patriot, prind, familjar, shok, mik ...

Shkrimet e tij (sidomos ato të vazeve e hutbeve: *Predikimet e xhumasë*) karakterizohen me tërheqshmëri të gjallë, posedojnë afinitet për meditim, cilësi letrare, narrative, por edhe sugjestivitet të caktuar. Ai flet drejtpërdrejt, por zëri i tij është këshillues dhe i ëmbël. Ai qorton në këshillat e tij, por nuk ka të hidhëruar. Ai dhe shkrimet e tij u përshtateshin rrethanave të dhëna, pa e humbur kurrë burimin dhe modestinë. Por, kur Imam Vehbiu shkruan shkrime shkencore, metoda e tij ndryshon, sepse ai tash është shumë rigoroz, e i argumentueshëm, ashtu siç e kërkon natyra e shkrimeve shkencore (lexo me kujdes veprat: *Dritë nga Kur'ani, 150 hadithe, Studime islame* etj.).

Përkundër faktit qe ai shkruan me zotësi në shumë fusha, kemi bindjen se Imam Vehbiu si historian-edukator e ka tejkaluar Imam Vehbiun në rrafshet e tjera. Ai shkroi për pejgamberët, për Muhammedin a.s. e, veçanërisht, për shokët e ngushtë të Muhammedit a.s.. Shkroi ose e përktheu historinë edhe ndryshe, në trajtë letrare, që personalisht jam i entuziazmuar (Lexo veprat: *Banorët e shpellës, Jusufi a.s., Muhammedi Profeti islam, Bilali* etj.). Ne kujtojmë se ky përcaktim i tij qe i imponuar nga

nevojat e besimtarëve të tij, nga niveli i arsimimit të tyre fetar, që ai shpesh e theksonte në shkrimet e tij.

Duke menduar për Imam Vehbiun dhe veprën e tij në kohën e dhënë, mund të thuhet se pikërisht ky është imami i fundit shqiptar që do ta mbante titullin imam, hoxhë, vaiz, hatib e edib në kuptimin tradicional islam: dijetar i fuqishëm e i themeltë në shumë fusha, si klasike, ashtu edhe bashkëkohore. Imami është shembull i vyeshëm se si çdo imam duhet të kontribuojë shumë e më shumë, mirë e më mirë, duke dalë nga gëzhoja e konzervatizmit dhe duke e përqafuar dritën e arsyes dhe diturisë.

Në fund të këtij shkrimi të rastit do të theksojë se borxhi i ynë ndaj Imamit është afirmimi, prezantimi dhe shtrirja e veprës së tij në të gjitha shtresat e popullit: nga lexuesi i abetares e deri te akademikët, nga shkolla fillore e deri te akademitë, nga besimtarët e përpiktë e deri te pabesimtarët.

Botimi i veprave të Imam Vehbiut të shtrira në gjithë globin tonë ku ka shqiptarë, e sidomos në trojet shqiptare, do ta kthejë Imam Vehbiun në vendin e origjinës, nga na e mori Amerika para 60 vitesh.

****

Më duhet të theksoj se duke punuar në detyrën e redaktorit të veprave të Imam Vehbiut, pata kënaqësi të jashtëzakonshme, sepse u ballafaqova me një njeri të madh dhe me një mjeshtër të letrave, çfarë rrallë lindin në trojet tona. Por, njëkohësisht, për shkak të barrës me të cilën u ballafaqova, pata edhe përgjegjësinë që nuk do ta dëshiroja sërish në përvojën time. Pas shumë këshillimeve me vetë Imamin dhe familjen e tij, pas shumë këshillimeve me institucione e individë, mendoj se bashkë me tërë redaksinë e kemi zgjedhur mënyrën më të mirë për t'i prezantuar veprat e zgjedhura të Imam Vehbiut. Ndonëse vetë Imami na i ka lënë duart e pastra që të vendosim ashtu si ta shohim më të arsyeshme, së bashku me redaksinë kemi bërë maksimumin që vepra e tij të publikohet sa më origjinale dhe në dritën më të mirë, duke e ruajtur edhe tiparin shkodran, të cilin Imam Vehbiu edhe pse në largësi e ruajti me fanatizëm.

Me këtë rast veçanërisht ndiej obligim t'i falënderohem vetë Imam Vehbiut (Allahu e mëshiroftë), i cili në propozimin tim e pranoi që vepra e tij të botohet si tërësi, që të bëhet e kapshme për të gjithë shqiptarët dhe shqipfolësit. Mirënjohje publike meriton SHB "Logos-A" që ndërmori një hap të tillë për botimin e veprës së Imamit. Vërtetë Imam Vehbi Ismaili, është **xhevahir mbi xhevahirë**. Këtë do ta kuptojmë vetëm pas leximit të veprës komplete të tij.

Mbetemi me shpresë se këto vëllime librash do ta tregojnë tërë madhështinë njerëzore të Imam Vehbiut dhe do të kontribuojnë që më lehtë të kuptohet feja jonë e dashur, por edhe e kaluara jonë islame-muslimane, shpeshherë e zhvlerësuar dhe e anatemuar nga "ana tjetër" dhe nga "të tjerët". Çdo lëshim eventual në përgatitjen e veprave na përket neve dhe se paraprakisht kërkojhmë falje, ngase vetëm Allahu është i përkryer!

(Teksti, me disa ndryshime të vogla, paraqet fjalën e redaktorit në veprën e Imam Vehbiut.)

KRONIKË

Pajazit Nushi

VDIQ AKADEMIK JASHAR REXHEPAGIQI[1]

Të nderuar familjarë të akademik Jashar Rexhepagiqit, kolegë dhe zonja e zotërinj të pranishëm

Më ka takuar detyrë e pikëllushme që ta them fjalën e ndarjes nga anëtari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës Jashar Rexhepagiqi, i cili vdiq papritmas dhe vorroset sot. I ndjeri Jashar ka lënë pas vetes një zbrazëti, që, sigurisht, nuk do të plotësohet gjatë shumë brezave të ardhshëm. Pikëllimi që ka shkaktuar vdekja e tij është pikëllim i përbashkët i yni, i qytetarëve të Plavës ku lindi para 81vjetësh, i qytetarëve të Beranës e Pejës ku ndoqi dhe i përfundoi mësimet e gjimnazit, i shumë pedagogëve nga Zagrebi ku i përfundoi studimet për pedagogji, i qytetarëve të Prishtinës, ku e kaloi pjesën më të madhe dhe më produktive të veprimtarisë krijuese dhe i të gjithë bartësve të kultures pedagogjike në Kosovë dhe më gjerë.

Akademik jashar Rexhepagiq

I ndjeri Jashar në zhvillimin e kulturës pedagogjike e ka murosur jetën dhe gjithë veprimtarinë e vet. Prandaj, dita e sotme, dita e fundit e ndarjes nga ne, është njëkohësisht ditë e pikëllimit e të gjithëve që punojnë në shkollat e Kosovës të të gjitha niveleve dhe të të gjitha tipave, sepse nuk besojë të ketë arsimtarë të këtyre shkollave, që të mos kenë lexuar dhe mësuar artin e mësimdhënies dhe veprimtarinë e edukimit të brezit tonë të rinj nga veprimtaria edukative, arsimore dhe shkencore, si edhe nga veprat e botuara nga i ndjeri.

Kur vdesin akademikët zakonisht pyetet për veprimtarinë e tij krijuese në shkencë dhe në art si edhe për vitet e moshës së tyre. Lidhur me këtë më duhet të them se para plotë një viti u ndamë të gjithë nga tetëdhjetëvjetori i lindjes dhe i aktivitetit shkencor të tij duke i dëshiruar pleqëri të shëndetëshme dhe të këndshme për veten dhe për familjen, si edhe punë të mbarë në përfundimin e projekteve hulumtuese personale dhe të përbashkëta. Askush nuk do të imagjinonte se pas një viti do të mblidhemi të gjithë në të njëjtin vend për t`i dhënë lamtumirën e fundit kolegut dhe mikut tonë të ngushtë. Por, prurjet e këtilla janë të paparapara edhe në afate më të shkurtëra, siç ka qenë rasti me të ndjerin Jashar, i cili pardje na ka vizituar në Akademi, institucion i vetëm, që pas familjes, kohët e fundit ishte bërë vend i vetëm i takimit me kolegë, shokë, miqë dhe me dashamirë.

Ky vit - viti i vdekjes së akademik Jashar Rexhepagiqit - është vit i ndërprerjes së studimeve të veçanta shqiptare të pedagogjisë dhe i kultures hulumtuese të posaçme të arsimit dhe të shkollës, sidomos të shkollës shqipe, në Kosovë dhe më gjerë. Për këtë shkak, dhembja dhe pikëllimi i të pranishëmve është njëkohësisht ndjenjë dhembjeje dhe pikëllimi e shumë pedagogëve, e studentëve në radhë të parë e studentëve të Universitetit të Prishtinës, por edhe e Universitetit të Tetovës dhe të Universitetit të Novi Pazarit dhe të mjediseve të tjera universitare, sepse prej tij drejtpërdejtë dhe indirekt kanë marrë mësimet e para për punën arsimore dhe për metoda të hulumtimeve shkencore shumë studentë të këtyre mjediseve universitare.

Filloi punën si profesor i shkollës Normale dhe i Gjimnazit të Prizrenit më 1953, vazhdojë punën pedagogjike në Shkollën Normale të Prishtinës, ku ishte edhe drejtor i kësaj shkolle, prej nga kalojë në profesoriat të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës më 1958 dhe prej këtij institucioni u zgjodh profesor i Fakultetit Filozofik të Prishtinës prej themelimit të tij më 1962 deri më 1990, kur u pensionua dhe përfundoi mësimdhënien dhe punën shkencore si profesor ordinar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës duke vazhduar veprimtarinë shkencore jo vetëm në universitet, por

edhe në Shoqatën e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës prej themelimit të saj në vitin 1974 dhe më pas, prej 18 prillit 1978 e vazhdoi aktivitetin e tij shkencor në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Zhvillimi i shkollave të larta, i fakulteteve, i Universitetit të Prishtinës, i Shoqatës së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe prej shndërrimit të kësaj Shoqate në Akademi të Shkencës dhe të Arteve të Kosovës kolegu i ynë Jashar Rexhepagiqi ka qenë ndër të parët, të cilët janë zgjedhë në këto institucione. Ka qenë themelues i Degës së studimeve pedagogjike në Fakultetin Filozofik të Univesitetit të Prishtinës dhe pjesëmarrës aktiv në themelimin e disa institucioneve shkollore, të revistave arsimore, kulturore dhe shkencore në Kosovë. Të rrallë janë ata krijues shkencor që shkruajnë vepra poetike, ashtu siç ndodhë rrallë here që krijuesi letrarë të shkruaj vepra shkencore. Akademik Jashari ka shkruar edhe poezi dhe ka botuar pesë vepra të poezisë. U mor me studime iranologjike në Ballkan dhe me studim të sekteve të dervishëve e të teqeve të tyre në Kosovë, në Sanxhak dhe më gjerë dhe për çështjet zhvillimore të tyre ka botuar disa punime. Këto janë vetëm disa dëshmi të veprimtarisë mësimdhënëse, të rezultateve kërkimore dhe të krijimtarisë poetike të kolegut tonë të nderuar të realizuara në kushte, në raportet dhe në rrethana të vështira dhe të ndërlikuara të Kosovës në dekadat e rënda të saja pas përfundimit të Luftës II Botërore deri më sot.

Veprimtaria e tij arsimore dhe shkencore përmban një substancë karakteristike: me esencën e vet rezultati i kësaj veprimtarie është ndikimi direkt dhe indirekt i kësaj veprimtarie të tij në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve të të gjitha mjediseve ku ka vepruar për rëndësinë e ngritjes së kuadrove mësimore dhe shkencore në Kosovë dhe më gjerë. E gjatë është koha krjuese e Jashar Rexhpagiqit dhe e madhe është tërësia e veprave të tija. Argumentimi më i fuqishëm i këtij pohimi është botimi i 21 librave dhe i më se 360 punimeve profesionale dhe shkencore të botuara në revista arsimore, kulturore dhe shkencore në shqipe, rusishte, turqishte, persishte dhe në gjuhën boshnjake. Veprimtaria e botuar, e parë vertikalisht, shtrihet prej vështrimeve dhe recensimeve të librave, të artikujve, të vështrimeve eseistike, të shqyrtimeve të çështjeve të veçanta edukativo - arsimore, kritikave shkencore e letrare, përpilimit të librave shkollorë deri në kumtim të rezultateve hulumtuese të veprimtarisë së personaliteteve pedagogjike, historike e filozofike, në shkrime monografike për zhvillim të institucioneve arsimore dhe edukative, në hartim të zërave enciklopedike për zhvillim të arsimit e të shkollave të Kosovës si edhe të personaliteteve arsimore të njohura të shqiptarëve në rend të parë, dhe përfundon në studimin e çështjeve fundamentale

të pedagogjisë ndërkombëtare të botuar nga ASHAK në vitin 2008, si edhe në paraqitjen e tij të fundit në Bibliotekën Universitar dhe Kombëtare me rastin e shënimit të 100 vjetorit të Shkollës Normale të Elbasanit. Poqese i vështrojmë sado pakë këto vepra do të zbulojmë një pasuri të dhënash e faktesh, këndvështrimesh, synimesh dhe vlerësimesh të autorit, që përshkruhen dhe shpjegohen qartë dhe bindshëm; me të kuptuar të përmbajtjes së tyre lexuesit do t`i bëhet e mundur rivështrimi i vetes sonë dikur dhe do ta kuptojmë më mirë të tashmën për të projektuar më qartë të ardhmën tonë. Në këtë rrugtim prej vështrimeve recensuese deri në trajtim të çështjeve fundamentale të pedagogjisë ndërkombëtare përcaktohet rruga e zhvillimit të mendimit të akademikut të ndjerë mbi çështjet konkrete deri në ato abstrakte të nivelit të lartë. Qasja mendore dominuese e trajtimit të këtyre çështjeve qasja gjenetike e përqendruar më tepër në studim të historisë së zhvillimit të shkollave dhe të arsimit të shqiptarëve në territorin e ish Jugosllavisë. Me hulumtim të zhvillimit të shkollave dhe të arsimit të shqiptarëve ka filluar karriera studimore e akademik Jashar Rexhepagiq dhe, mund të them se, prej hulumtimit të kësaj çështjeje nuk është larguar asnjë herë. Pikërisht, përmbajtja e këtyre studimeve i ka plotësuar zbrazësitë e historisë së zhvillimit të shkollave shqipe dhe rolin e personaliteteve politike e arsimore në historinë kombëtare të shqiptarëve. Efekti i rezultateve të studimeve është dalluar edhe në botimet mbi zhvillimin e shqiptarëve dhe të shkollave të tyre në gjuhët e popujve fqinjë duke përfshirë edhe futjen për herë të parë të këtyre rezultateve në botimet enciklopedike. I ndjeri Jashar përfaqësoi mendimin pedagogjik shqiptar me kompetencë shkencore dhe gjuhësore të lartë në boshnjakishte, kroatishte, serbishte, etj.

Me vdekjen e akademik Jashar Rexhepagiqit mbyllet përgjithmonë rruga e jetës së tij, por hapet rruga e studimit të veprës që ka lënë pas. Le të jetë kjo rrugë e kujtimeve për të dhe për veprën e tij ngushëllim për familjen, për ne kolegët e tij, për studentët, arsimtarët dhe për të gjithë pedagogët. Lavdi historianit të pedagogjisë, i cili prej ditës së sotme u bë edhe vetë personalitet i historisë së pedagogjisë, sidomos i asaj shqiptare.

[1] Fjala e mbajtur në mbledhjen komemorative të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës me rastin e vdekjes së akademik Jashar Rexhepagiqit, më 29 janar 2010.

KRONIKË

VDIQ BASHKËPUNËTORI I “EDUKATËS ISLAME” AKADEMIK JASHAR REXHEPAGIQI (1929-2010)

Më 28 janar 2010 në orët e pasditës në Prishtinë, ndërroi jetë, profesori shumë vjeçar në Universitetin e Prishtinës dhe anëtari i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, prof. Dr. Jashar Rexhepagiqi. Për aspektin e veprimtarisë dhe kontributit të tij në lëmin e pedagogjisë, islamologjisë dhe kulturës në përgjithësi për të ndjerin kanë shkruar dhe do të shkruajnë ekspert të lëmive përkatëse, por ajo që më obligon mua me këtë rast është të shkruaj për angazhimin dhe kontributin e tij si anëtar i redaksisë së revistës “Edukata Islame”.

Akademik Jashar Rexhepagiqi

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, në muajin qershor të vitit 2001 bëri një organizim të ri në redaksinë e revistës “Edukata Islame”, e cila është revista e parë islame që botohet në Kosovë, si organ i saj. Në hulumtimin për anëtar të redaksisë, kërkuam ndihmën edhe të Akademikut tanë të nderuar, duke e ditur përvojën e tij të gjatë në lëmin e edukimit dhe arsimi-

mit. Akademik, Jashar Rexhepagiqi me kënaqësi iu përgjigj ftesës tonë. Andaj, prej atëherë e deri më 12 janar 2010, kur ai prezantoi në mbledhjen fundit të redaksisë ishte plotë elan dhe ide të reja për ngritjen e nivelit si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe artistik të revistës. Si në çdo mbledhje ai vinte i përgatitur. E lexonte revistën prej fillimi deri në mbarim, duke analizuar çdo temë. Kësaj radhe me vete kishte sjell, në formë të shkruar idetë e tij, sikur ta dinte se ajo do të jetë pjesëmarrja e tij e fundit në mbledhjen e revistës ”Edukata Islame” të cilën aq shumë e çmoi dhe u kujdes për mirëvajtjen e saj.

Gjatë kësaj periudhe afër dhjetë vjeçare, akademiku ynë i nderuar e pasuroi revistën tonë me punimet e tij të shumta, duke i dhënë asaj një dimension të ri edukativo arsimor, të përmasave të gjëra, duke hapur horizonte të reja si në aspektin kulturës islame dhe asaj më të gjerë. Kështu në çdo numër të “Edukatës Islame” e shohim të jetë prezent me punime prej më të ndryshmëve. Për numrin e fundit, të “Edukatës Islame” që ishte në përgatitje e sipër, vetëm pak orë para se të ndërronte jetë solli temën “Fjalor i nocioneve islame”, i cili punim mund të jetë edhe i fundit të jetës së tij. Kjo tregon përkushtimin e tij të vazhdueshëm për shkencë dhe hulumtime shkencore deri në momentin e vdekjes. As një herë nuk u ndal duke hulumtuar dhe gjurmuar, aty e gjente dhe kënaqësinë më të madhe të tij.

Me rastin e vdekjes së akademikut tanë të nderuar, revista “Edukata Islame” humbi anëtarin e saj më të vyeshëm të redaksisë. Ne e lusim Allahun e Gjithëfuqishëm që rahmetliun ta shpërblejë me xheneti Firdevs, për kontributin e tij të madh që ai dha për ngritjen e nivelit shkencor tek të rinjtë tanë, gjatë tërë jetës së tij.

Në vazhdim po sjellim bibliografinë e punimeve të tij të botuara në faqet e “Edukatës Islame”:

1. Vlera arsimore dhe edukative e revistës “Edukata Islame”, (nr. 67, 2002, fq. 21-25.)
2. Një vepër e vëllimshme dhe me vlerë shkencore, (Faik Luli, Islam Dizdari: Mevludet në gjuhën shqipe, Shkodër, Camaj-Pika, 2002, 712 fq.) , nr. 72, 2003, fq.239-246
3. Përparësitë, fushat e veprimit dhe kufijtë e ndikimit të proceseve integrative në rajonin e Sanxhakut dhe në territorin e Kosovës. (Nr. 70, 2003, fq. 197-206).
4. . Mbi një monografi të shkëlqyeshme (Bajro Agoviq, Dzamije u Crnoj Gori - Xhamitë në Mal të Zi), Podgoricë, 2001, fq. 1-495, (Nr. 73, 2004, fq.89-105.)
5. Nevoja e studimit të arsimit të lartë tek ne dhe disa sugjerime, (nr.74. 2004, fq.135-140).

6. Sami Frashër mbi kulturën dhe arsimin islamo-persian, (nr. 75, 2004, fq.31-45.)
7. Teqeja halveti në Rahovec dhe dorëshkrimet e saj, (nr. 76. 2005, fq.65-75).
8. Vepra e Bajram Shatrit, vlera dhe rëndësia e saj, nr. 80, 2006, fq. 263-267).
9. Disa observacione mbi revistën "Edukata Islame", (nr. 86, 2008, fq.281-285).
10. Referat për Prof.Dr. Muhamed Mufakun për t'u zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave edhe Arteve të Kosovës,(nr.88, 2009, fq. 227-232).
11. Një vepër shkencore për gruan me vlera të veçanta, (nr.90, 2009. fq.285-288).

Qemajl Morina
(kryeredaktor)



Propozimet e Akad. Jashar Rexhepagiqit në mbledhjen e fundit të redaksisë "Edukata Islame" më 12.01.2010

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina
Kisha ortodokse serbe dhe shqiptarët 5

Jusuf Zimer
Vendimi dhe lejimi 19

Kutb Mustafa Sano
Parimet e bashkëpunimit ndërmjet medhhebeve islame..................33

Ramadan Shkodra
Xhamia "Sulltan Murat" (792h\1389) monumenti më i vjetër islam në Prishtinë..63

Mr. Sadik Mehmeti
Transmetuesit e haditheve dhe numri i haditheve të transmetuar në veprën "Mashāriq ash-sharīf"............................85

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi
Psikologjia e të së mirës dhe të së keqes nga aspekti Kur'anor dhe shkencor 105

Dr. Naceur Jabnoun
Islami dhe menaxhmenti - (2)...119

Qemajl Morina
Sami Frashëri në krye të gazetës "Tarablus garb" në Tripoli të Libisë...151

Jahja Hondozi
Krijimtaria letrare e Sheh Hilmi Maliqit (1865-1928)..................157

Avni Aliu
Është jetësore të ndiqet rruga e Zotit...163

Prof. dr. Hysen Matoshi
Hapësira etnike e kulturore shqiptare dhe Kisha Ortodokse Serbe...181

Hajrudin S. Muja
Isabela - (3)...207

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha
Fatimetu Zehra - Aroma e Pejgamberit a.s...................................245

Akademik Jashar Rexhepagiq
Fjalori i nocioneve islame - vepër e shkëlqyer, me disa vërejtje e sugjerime 255

Anthony Arnove
Deklarata e Stambollit...267

Nexhat Ibrahimi
Imam Vehbi Ismaili, xhevahir mbi xhevahirë 281

Pajazit Nushi
Vdiq Akademik Jashar Rexhepagiqi 287

Vdiq bashkëpunëtori i "Edukatës Islame" Akademik Jashar Rexhepagiqi (1929-2010) 291

Përmbajtja 295